

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Viti i 92-të i botimit  
Tetor-nëntor 2024 / Nr. 6

# Mbrojtja



112  
SHQIPTARE  
USHTRI

**DREJTOR I QKMBMMFA**  
ARBEN SKËNDERAJ**Shefe e Sektorit të Botimeve &  
Kryeredaktore**  
ANJEZA MUSOLLARI**GRAPHIC DESIGNER**  
AFËRDITA HYSAJ**REDAKTORE / KORREKTORE**  
SUELA HODA**BASHKËPUNËTORË**

KOLONEL HYSNI GJERGJI

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

KOLONEL (R) SALI ONUZI

© Ministria e Mbrojtjes

*Materialet e publikuara në këtë revistë nuk mund të  
riprodhohen elektronikisht apo fizikisht e të  
përdoren për qëllime përfitim, pa marrë  
autorizim nga botuesit e saj.*

**Botues:**  
*Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe  
Muzeut  
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes*

**Adresa:**  
*Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"*

*Revista mund të gjendet në formatin  
elektronik (pdf) në adresën:  
[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/  
revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)*



# Mbrojtja

- Shqipëria historike, 112 vjet FA, 80 vite çlirim kombëtar, 15 vite vokacion euro-atlantik 4
- Ministri Vengu: Prioriteti ynë, anëtarësimi i Kosovës, ndihmë Ukrainës, mbrojtje kolektive në zonën euroatlantike 6
- Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu: Sakrifica e dëshmorëve, themeli i së ardhmes sonë 8
- Emergjencat, prezantohet projekti "ALBAdapt", Ministri Vengu: Forcojmë sistemin e paralajmërimit të hershëm, krijojmë rrjetin e vullnetarëve 9
- Sfidat e reja në detin Mesdhe dhe Ekonomia Blu, në fokus të Forumit të Rojës Bregdetare 10
- Këshilli i Ministrave miraton projektligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Forcës Rezerviste në Republikën e Shqipërisë" 12
- Projektbuxheti historik i 2025, në siguri dhe forcim të kapaciteteve mbrojtëse 17
- Ministri Vengu i dorëzon shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gradën "Gjenerallejtënant" 19
- Realizohet me sukses stërvitja "Rrjedhja e Vjosës-24" 23
- Niset në Letoni Kontingjenti XVI, ministri Vengu: EOD, kapacitet kombëtar 25
- Efektivët e Kontingjentit XV EOD përfunduan detyrën në mbështetje të stërvitjes "Resolute Warrior-2024" 26
- Krijimi i Ushtrisë Kombëtare Shqiptare nga Qeveria e Përkohshme e Vlorës (1912-1914) 28
- Baza Ajrore e Farkës 57 vite fluturime humanitare, sakrificë, përgjegjësi 32
- ANO, tre dekada rugëtim profesional, arsimor, mision drejt karrierës ushtarake 34
- Arma e Kimisë, shërbimi elitar i FA-së 42
- 75 vite art, botime, shtyp periodik. Rugëtimi në dekada i QKMBMMFA 44
- "Për Atdheun që 15 vjeç", Naxhi Zhupa, krenari e historisë shqiptare 48
- 80-vjetori i çlirimit të Atdheut, historia e krenarisë kombëtare 52
- Atdheu përjetë mirënjohës! 54
- Nimete Progonati, "Zhan d'Arka" shqiptare (Në 80-vjetorin e rënies) 56
- "Pa dëshmorë nuk ka Atdhe" 58
- Dëshmorë të BrS, rënë për çlirimin e Tiranës 68
- Brigada XXIV/ në çlirimin e Tiranës dhe të Shkodrës 71
- 80 - vjetori/ i Brigadës XVIII Sulmuese 74
- Alfred Moisiu, jeta dhe karriera e pasur e një ushtaraku dinjitoz e të talentuar 79
- Organizata Kombëtare e Dëshmorëve të LANÇ dhe të Dëshmorëve të tjerë të Atdheut, takim jubilar me rastin e 80-vjetorit të Çlirimit të Atdheut 78
- "Women in Uniform", burim i vyer i eksperiencës dhe përvojës 84
- ZGJOHUNI! Alarm nga teknologjia në duart e gabuara 86
- Gjuha shqipe, amaneti i të parëve, simbol i identitetit kombëtar 89
- Nëntori i bekuar i shqiptarëve 92
- Duhesh të jesh Shqiptar, ta kuptosh 94
- Uniforma ushtarake. Lëkurë e dytë 96

# 48

## 80-vjetori i çlirimit të Atdheut, historia e krenarisë kombëtare

Drejtuesit e njësive të mëdha  
partizane - Anëtarët e Shtabit të  
Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional  
Çlirimtare, 10 korrik 1943

1. Major Abaz Kupi (1891-1976)
2. Myslym Peza, (1897 - 1984)...



# 04

**Shqipëria historike, 112 vjet FA,  
80 vite çlirim kombëtar, 15 vite  
vokacion euro-atlantik**

# 6

**Ministri Vengu: Prioriteti ynë,  
anëtarësimi i Kosovës, ndihmë  
Ukrainës, mbrojtje kolektive  
në zonën euroatlantike**



# 94

**Duhesh të jesh Shqiptar, ta kuptosh**

Një ditë, një djalë i ri ishte duke gjuajtur nëpër male, një shqiptonjë fluturoi mbi të duke rrahur fort krahët dhe ndaloj në një shkëmb. Shqiptonja ishte shumë e madhe dhe mbante një gjarpër në sqepin e saj. Pas pak, shqiptonja fluturoi mbi shkëmb dhe ndaloj aty, ku kishte folenë e saj. Djalosh...



**Krijimi i Ushtrisë  
Kombëtare Shqiptare  
nga Qeveria e  
Përkohshme  
e Vlorës (1912-1914)**

Sigurimi i Kuvendit kombëtar dhe i veprimtarisë së Qeverisë kërkonin organizimin e forcave të armatosura. Për këtë qëllim Ismail Qemali, që më 26 nëntor, formoi një komision organizues dhe u dërgoi pleqësive të fshatrave një qarkore...

**Faqe 28**



**“Për Atdheun që 15 vjeç”,  
Naxhi Zhupa, krenari  
e historisë shqiptare**

Intervistoi:  
**ANJEZA MUSOLLARI,**  
Shefe e Sektorit të Botimeve

“Biografinë personale, çdo njeri e bën vetë për aq sa jeton. Kjo njihet ndryshe edhe si pasqyrë e jetës, e raporteve që vendos me të afërmit, shoqërinë, ligjet, miqtë, familjarët. Pra biografia përbëhet nga copëzat e jetës, aktiviteteve, sukseseve, etj...

**Faqe 44**



# Shqipëria historike, 112 vjet FA, 80 vite çlirim kombëtar, 15 vite vokacion euroatlantik

**4** dhjetori i vitit 2024, i gjen Forcat e Armatosura në 112-vjetorin e krijimit të tyre dhe 80-vjetorin e Çlirimit të vendit. Me këtë rast në ambientet e garnizonit ‘Skënderbej’, nga i cili kanë dalë mbi 45 mijë burra dhe gra në uniformë u organizua një ceremoni festive. Të pranishëm në këtë ditë të shënuar ishin, ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu, zëvendësministrat Dorian Tola dhe Enkelejd Joti, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjenerallejtënant Arben Kingji, deputetë të Kuvendit, komandantë të forcave, atashetë ushtarakë të akredituar në vendin tonë. Trupat aktivë ishin formuar nëpër kuadrate, dhe një pjesë e arsenalit të armëve ishin dislokuar në shesh. Ministri i Mbrojtjes e konsideroi vendimin për krijimin e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare vetëm gjashtë ditë pas shpalljes së Pavarësisë, jo thjesht një akt administrativ, por një akt themelues të Shqipërisë moderne, duke përcaktuar mbrojtjen dhe sigurinë si një çështje me rëndësi jetike për shtetin e sapoformuar. “Nuk mund të ketë pavarësi pa vetëmbrojtje, dhe nuk mund të ketë shtet-ndërtim pa siguruar kushtet e vazhdimësisë. Në këtë kuptim,

themelimi i Forcave të Armatosura ishte një akt pavarësie të cilës i bashkëngjitej dhe misioni i sovranitetit”, - u shpreh ministri Vengu. Më tej, zoti Vengu shprehu konsideratat më të larta për burrat dhe gratë që themeluan dhe çuan përpara Ushtrinë Shqiptare dhe solli në vëmendje sfidat aktuale me të cilat Forcat tona të Armatosura



*112 vite pas aktit të themelimit, 80 vite pas aktit të rezistencës, 15 vite pas aktit të konfirmimit të vokacionit tonë euro-atlantik, teksa gëzojmë të gjithë së bashku të mirat e sigurisë kolektive që ofron Aleanca më e suksesshme në historinë moderne, ndërkohë që përballemi me kërcënime të reja, të cilat nuk janë vetëm në horizont por bëhen gjithnjë e më të prekshme, sot pra, na duhet të mendojmë për vazhdimësinë dhe për misionin, për kombin dhe aspiratat e tij.*



duhet të përballen. “Sot, 112 vite pas aktit të themelimit, 80 vite pas aktit të rezistencës, 15 vite pas aktit të konfirmimit të vokacionit tonë euro-atlantik, teksa gëzojmë të gjithë së bashku të mirat e sigurisë kolektive që ofron Aleanca më e suksesshme në historinë moderne, ndërkohë që përballemi me kërcënime të reja, të cilat nuk janë vetëm në horizont por bëhen gjithnjë e më të prekshme, sot pra, na duhet të mendojmë për vazhdimësinë dhe për misionin, për kombin dhe aspiratat e tij. Në këto 10 vite, është bërë një punë e lavdërueshme dhe e gjithanshme për t’u forcuar, për t’u modernizuar. Por kemi ende shumë punë për të bërë. Sot, ushtarët, nënoficerët, oficerët shqiptar, janë më të përgatitur, më të mirë trajnuar e arsimuar, më të mirë pajisur, dhe më të mirë trajtuar. Në këtë kontekst, dua të shpreh mirënjohjen tonë të thellë, ndaj të gjithë aleatëve e partnerëve

që kontribuuan dhe vazhdojnë të kontribuojnë në modernizimin e Forcave tona të Armatosura”, - tha ndër të tjera ministri Vengu, i cili nuk harroi të kujtojë ushtarakët e rënë në krye të detyrës. Nga ana e tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjenerallejtënant Arben Kingji tha se gjatë gjithë historisë së tyre, FA-të kanë reflektuar vlerat më të mira kombëtare, kanë demonstruar përkushtim, profesionalizëm, duke u transformuar dhe modernizuar vazhdimisht për të rritur kapacitetet operationale në interes të përmbushjes së misionit kushtetues dhe kontributit për paqen dhe sigurinë. Në përfundim të ceremonisë, Toga Ceremoniale dhe orkestra Frymore e FA-së zhvilluan një parakalim ceremonial, ndërkohë që ministri Vengu u takua me familjarë të ushtarakëve dhe nxënësit e shkollave të mesme të pranishëm në ceremoni.





# Ministri Vengu: Prioriteti ynë, anëtarësimi i Kosovës, ndihmë Ukrainës, mbrojtje kolektive në zonën euroatlantike



Ministrat e Mbrojtjes të vendeve anëtare dhe vëzhguese të Iniciativës SHBA - Karta e Adriatiku (A-5) u mbledhën në Tiranë, për të diskutuar një sërë çështjesh të rëndësishme, që shtrohen në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë për Ballkanin Perëndimor dhe më gjerë.

Ky ministerial u bashkëdrejtua nga ministri i Mbrojtjes së Shqipërisë, z. Pirro Vengu me pjesëmarrjen e posaçme të Ndihmës Sekretares amerikane të Mbrojtjes për Çështjet e Sigurisë Ndërkombëtare znj. Celeste Wallander.

Në përfundim të tij, ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu mbajti një konferencë për shtyp bashkë me Ndihmës Sekretaren Amerikane të Mbrojtjes për Çështjet e Sigurisë, Celeste Wallander.

Ministri Vengu në fjalën e tij falënderoi SHBA-të dhe vendet anëtare të Kartës, kolegë të pranishëm, për bashkëpunimin në fushat ushtarake dhe të sigurisë, me qëllim paqen dhe prosperitetin në rajon.

Ministri Vengu ndau në përfundim të këtij ministeriali temat kryesore të diskutimeve mes përfaqësuesve të lartë të Iniciativës SHBA - Karta e Adriatikut. "Patëm mundësi të ndaleshim mbi ndërlikimet në ambientin strategjik të sigurisë në kontinentin evropian përfshirë

edhe rajonin e Ballkanit Perëndimor. Theksuam dhe njëherë rilevancën e Kartës së Adriatikut dhe çdo vendi anëtar, në mënyrë të veçantë rolin e pazëvendësueshëm të SHBA-ve në rajon”, u shpreh ministri i Mbrojtjes në deklaratën e përbashkët, pas mbylljes së punimeve të ministerialit. Pjesë e diskutimeve të ministerialit të A-5 ishte edhe sulmi i fundit në veri të Kosovës: “Shqyrtuam një sërë rreziqesh dhe sfidash me karakter hibrid dhe një vëmendje të shtuar mori sulmi kriminal i pak ditëve më parë në Zubin Potok, ndaj infrastrukturës kritike të Republikës së Kosovës. Ndërkohë që gjej rastin të përsëris solidaritetin tonë me shtetin e Kosovës, të gjitha vendet dënuan këtë sulm të rrezikshëm për sigurinë dhe stabilitetin rajonal dhe kërkuar sjelljen e përgjegjësve para drejtësisë”, - theksoi ai. Ndër të tjera në këto diskutime, sipas ministrit të Mbrojtjes, u fol edhe për ri-energizimin e Kartës së Adriatikut, duke parë dinamikën gjeopolitike dhe ndryshimin e vazhdueshëm të ambientit strategjik të sigurisë:

“Kjo, - theksoi ministri Vengu, - duke jetësuar Politikën e Dyerve të Hapura të Kartës, dhe për ne anëtarësimi i Kosovës mbetet prioritet absolut, por dhe për të qenë më pro-aktiv në angazhime të përbashkëta në NATO, specifikisht në Forcat e Përparuara të Aleancës në Europën Juglindore; Misionin për trajnimin, asistencën dhe mbështetjen për forcat ukrainase; Misionin e NATO-s në Irak; por dhe kontribuues në agjendën e sigurisë dhe mbrojtjes së përbashkët të Bashkimit Europian, si p.sh. në misionin ALTHEA



në Bosnje dhe Hercegovinë”, - nënvizoi Vengu.

Një pikë e rëndësishme e këtij takimi ishte edhe diskutimi mbi zhvillimin e kapaciteteve të mbrojtjes, në përputhje me procesin e planifikimit të mbrojtjes së NATO-s, por dhe mbi investimet e Shqipërisë në industrinë ushtarake, rrjetin infrastrukturor, si dhe ndërveprueshmërinë mes forcave ushtarake.

Sipas ministrit Vengu, këto do të përbëjnë një kontribut domethënës të vendeve tona për forcimin e qëndrueshmërisë kombëtare dhe “mbrojtjes kolektive në zonën euroatlantike”.

“Me përfundimin e këtij ministeriali, mbyllet edhe angazhimi i vendit tonë për këtë vit sa i përket kësaj iniciative”, - tha ai.

Gjatë 2024 Shqipëria mirëpriti një sërë eventesh të nivelit të lartë politiko-ushtarak në kuadër të “Balkans CHODs”, SEDM dhe pikërisht SHBA-A5, duke u kthyer në një pol për bashkëpunimin rajonal në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes.



# Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu: Sakrifica e dëshmorëve, themeli i së ardhmes sonë

Me rastin e 80-vjetorit të çlirimit të Vlorës, ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu së bashku me kryetarin e bashkisë së Vlorës, z. Ermal Dredha, kryen homazhe në Varrezat e Dëshmorëve, në nderim të kujtimit të atyre që sakrifkuan për lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë.

Vengu theksoi se, “lufta e shqiptarëve për liri kulmoi me çlirimin e vendit 8 dekada më parë në disa nga qytetet më të mëdha të vendit, dhe një prej tyre ishte Vlora”.

“Në këtë 80-vjetor të Çlirimit të Vlorës, kujtojmë me krenari dhe mirënjohje të thellë ata që luftuan dhe dhanë jetën për të mbrojtur atdheun. Është nder dhe përgjegjësi e madhe të kujtojmë dëshmorët, sakrifica e të cilëve janë themeli i të ardhmes sonë dhe një kujtesë e fortë e detyrimit për ta ruajtur këtë trashëgimi me nder”.



## Forcat e Armatosura organizuan një demonstrim në qytetin e Vlorës me rastin e 112 - Vjetorit të Pavarësisë

Pilotët dhe teknikët e bordit të helikopterit “Cougar” realizuan një fluturim demonstrues duke valëvitur flamurin kombëtar.

Helikopterët “Cougar” dhe “Black Hawk” të Forcës Ajrore, anijet e Forcës Detare dhe trupat e Regjimentit të Operacioneve Speciale zhvilluan një demonstrim në gjirin e Vlorës, i cili përveç qytetarëve, u ndoq nga afër edhe nga ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu, shefi i Shtabit të Përgjithshëm gjenerallejtënant Arben Kingji dhe drejtues të tjerë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura. Trupat dhe mjetet e përfshira simuluan realizimin e një operacioni të ndalimit detar për marrjen e kontrollit të një anijeje të dyshuar, duke ndërhyrë nga deti me gomone dhe grupet e bordingut të Forcës Detare dhe nga ajri me trupat e Forcave Speciale dhe helikopterët “Cougar” dhe “Black Hawk”.



# Emergjencat, prezantohet projekti “ALBAdapt”, Ministri Vengu: Forcojmë sistemin e paralajmërimit të hershëm, krijojmë rrjetin e vullnetarëve

Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu mori pjesë në prezantimin e projektit të rëndësishëm “ALBAdapt - Programi për Zhvillimin Urban Rezistent ndaj Klimës në Shqipëri”, një iniciativë që synon të mbështesë Shqipërinë në përmirësimin e shërbimit të hidrometeorologjisë.

Ky projekt është një hap i madh në forcimin e kapaciteteve të vendit për t'u përballur me rreziqet dhe pasojat nga fenomenet ekstreme klimatike. Të pranishëm në aktivitet ishin edhe zëvendëskryeministria znj. Belinda Balluku, njëherësh ministre e Energjisë dhe Infrastrukturës, ministria e Turizmit dhe Mjedisit, znj. Mirela Kumbaro, ambasadorët e Gjermanisë dhe Zvicrës, etj.

Gjatë fjalës së tij, ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu vlerësoi krijimin e mekanizmit të paralajmërimit të hershëm në rastet e emergjencave civile, ndërsa u shpreh se çdo vit përmbytjet i kushtojnë buxhetit të shtetit dhjetëra milionë euro. Vengu theksoi se përmbytjet prekin mesatarisht çdo vit 50 mijë banorë kryesisht pranë zonave bregdetare, një pjesë e madhe e territorit të vendit që zë 40% të PBB-së.

“Çdo vit përmbytjet prekin disa dhjetëra milionë euro nga pikëpamja e dëmshpërblimeve dhe kostove të rikuperimit. Qëllimi kryesor i këtij projekti është të krijojë një qasje gjithëpërfshirëse.

Këtë vit kemi bërë një buxhetim të ndryshëm, kemi bërë ture me të gjitha bashkitë para miratimit të buxhetit për të rritur financimet për infrastrukturën parandaluese dhe rritjen e kapaciteteve të pushtetit vendor”, - tha Ministri Vengu.

Sot Shqipëria nuk ka një mekanizëm paralajmërimi të hershëm plotësisht funksional, ndaj sipas ministrit Vengu, “një prej arsyeve që ky fond është alokuar është mbështetja përmes mekanizmave të burimeve njerëzore. Kjo nënkupton sensorë



në gjithë vendin, një sistem që i ndërlidh këto informacione, njerëz të dedikuar që këtë informacion do ta përcjellin te njerëzit e duhur”. Ministri Vengu u bëri thirrje edhe qytetarëve dhe veçanërisht banorëve të zonave me risk të lartë, të angazhohen në rast emergjencash, ndërsa theksoi rëndësinë e krijimit të një rrjeti vullnetarësh. “Shqipëria duhet të fillojë të krijojë rrjet vullnetarësh njëloj si Zvicra, Sllovenia, Finlanda, Gjermania etj., që kanë një rrjet vullnetarësh shumë të konsoliduar. Është shumë e rëndësishme të kemi një rrjet vullnetarësh që i vijnë në mbështetje mekanizmit. Kemi disa bashki që po pilotojnë një sistem vullnetarizmi dhe duam ta shtrijmë atë në territor”, - tha ministri Vengu.

Projekti do të zbatohet në periudhën 2024-2030, me një buxhet prej rreth 34.5 milionë eurosh, i bashkë-financuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, Republika Federale e Gjermanisë, Zvicra, dhe

Fondi i Gjellbër për Klimën.

Sot, Shqipëria bëri një hap të madh drejt forcimit të qëndrueshmërisë klimatike me prezantimin e projektit “ALBAdapt - Programi për zhvillimin Urban Rezistent ndaj Klimës në Shqipëri”. Ky projekt, i bashkë-financuar nga qeveritë e Gjermanisë, Zvicrës, Fondi i Gjellbër për Klimën dhe Shqipëria, ka për qëllim rritjen e kapaciteteve për parashikimin dhe menaxhimin e rreziqeve klimatike. Me një buxhet prej 34.5 milionë eurosh, ALBAdapt do të krijojë një sistem të avancuar paralajmërimi për përmbytjet dhe fenomene të tjera ekstreme, duke shpëtuar jetë dhe mbrojtur pasuri natyrore. Me rëndësi është edhe krijimi i një rrjeti të konsoliduar vullnetarësh, në mbështetje të këtij mekanizmi. Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile janë të angazhuara për një Shqipëri të sigurt dhe të qëndrueshme për brezat e ardhshëm!



# Sfidat e reja në detin Mesdhe dhe Ekonomia Blu, në fokus të Forumit të Rojës Bregdetare

**F**orumi i Funksioneve të Rojës Bregdetare Mesdhetare zhvilloi mbledhjen e tij të radhës në Tiranë, organizuar nga Forca Detare/Roja Bregdetare shqiptare. Qëllimi i këtij forumi është të rrisë bashkëpunimin midis agjencive të rojeve bregdetare të vendeve mesdhetare me përfaqësues nga 14 shtete anëtare, dy shtete vëzhguese, përfaqësues nga pesë agjenci dhe institucione të BE-së, si dhe organizata ndërkombëtare dhe institucione kombëtare.

Tema kryesore e forumit për këtë vit ishte “Sfidat e Reja në Detin Mesdhetar: Ekonomia Blu, Tranzicioni Ekologjik dhe Funksionet e Rojës Bregdetare”. Gjatë dy ditëve të forumit, u zhvilluan katër panele me fokus në praktikën më të mira dhe bashkëpunimin ndërmjet vendeve.

Forumi MCGFF është një mundësi e shkëlqyer për të forcuar bashkëpunimin rajonal dhe për të adresuar sfidat e zakonshme në detin Mesdhe, duke pro-

*“Shteti shqiptar është i palëkundur në angazhimin e tij për të ofruar burimet dhe mbështetjen e nevojshme për operacionet efektive të Rojës Bregdetare, duke njohur rolin kritik që Roja Bregdetare luan në ruajtjen e sigurisë detare dhe zbatimit të ligjit në det. Nëpërmjet investimeve të qëndrueshme dhe planifikimit strategjik, Shqipëria është e vendosur të fuqizojë Rojën Bregdetare për të përmbushur misionin e saj në mënyrë efektive, duke përfutur përfundimisht komunitetet tona bregdetare dhe publiku i gjerë”.*

movuar një qasje të përbashkët për ruajtjen e burimeve dhe sigurisë detare.

Forumi i Funksioneve të Rojës Bregdetare Mesdhetare (MCGFF) është një platformë vullnetare, jo politike dhe e pavarur e përbërë nga 24 vende mesdhetare. Takimi i parë i MCGFF me iniciativën e Italisë u zhvillua në Gjenova, Itali në vitin 2009.

Takimet e radhës të këtij forumi janë zhvilluar në Francë, Spanjë, Portugali, Itali, Turqi, Francë, Marok, Itali dhe Shqipëri.

I pranishëm në këtë takim ishte dhe Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, i cili përshëndeti përfaqësuesit e vendeve të Mesdheut, të mbledhur në Tiranë, në Forumin e Funksioneve të Rojës Bregdetare Mesdhetare, organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme Detare e Bashkimit Evropian. Gjatë këtij Forumi, ministri i Mbrojtjes theksoi rëndësinë strategjike të detit Mesdhe për sigurinë rajonale dhe tregtinë ndërkombëtare, duke e cilësuar atë një korridor jetik për lëvizjen e mallrave midis Evropës,



ganizuar që shfrytëzojnë kufijtë porozë të rajonit. Për më tepër, Mesdheu është një rrugë kritike për emigrantët që ikin nga konflikti dhe varfëria, duke çuar në rritjen e trafikimit të qenieve njerëzore. Këto sfida jo vetëm që rrezikojnë jetët njerëzore, por gjithashtu tendosin burimet kombëtare dhe destabilizojnë komunitetet. Trajtimi i këtyre çështjeve kërkon bashkëpunim të zgjeruar midis vendeve mesdhetare, strategji të zbatimit të ligjit dhe qasje gjithëpërfshirëse që i japin prioritet shqetësimeve të sigurisë dhe shqetësimeve humanitare, duke krijuar një mjedis detar të sigurt dhe të drejtë për të gjithë”, - theksoi ministri i Mbrojtjes. Z. Vengu vlerësoi rolin e Rojës Bregdetare si një rol jetik në ruajtjen e sigurisë dhe zbatimit të ligjit në mjedisin detar. Gjithashtu ai vlerësoi partneritetet me agjencitë

Afrikës dhe Lindjes së Mesme.

“Megjithatë, - theksoi ministri Vengu, - kjo rrugë kritike detare përballët gjithashtu me sfida të ndryshme sigurie, duke kërkuar masa të forta sigurie që nënvizojnë nevojën për përpjekje të përbashkëta”. Sipas ministrit të Mbrojtjes: “Rajoni i Mesdheut përballët me çështje të ngutshme si emigracioni i paligjshëm, kontrabanda dhe trafikimi i qenieve njerëzore, të cilat paraqesin kërcënime të rëndësishme për sigurinë dhe të drejtat e njeriut. Deti shërben si një rrugë kryesore transiti për mallrat e paligjshme, duke përfshirë drogën dhe armët, shpesh të ndihmuara nga rrjetet e krimit të or-



detare të BE-së si FRONTEX dhe EMSA për rritjen e efektivitetit të operacioneve të Rojës Bregdetare. Ndërsa shprehu angazhimin e palëkundur të Shqipërisë për bashkëpunim mes vendeve të Mesdheut: “Shteti shqiptar është i palëkundur në angazhimin e tij për të ofruar burimet dhe mbështetjen e nevojshme për operacionet efektive të Rojës Bregdetare, duke njohur rolin kritik që Roja Bregdetare luan në ruajtjen e sigurisë detare dhe zbatimit të ligjit në det. Nëpërmjet investimeve të qëndrueshme dhe planifikimit strategjik, Shqipëria është e vendosur të fuqizojë Rojën Bregdetare për të përbushur misionin e saj në mënyrë efektive, duke përfutur përfundimisht komunitetet tona bregdetare dhe publiku i gjerë”, - theksoi ministri Vengu.

# Këshilli i Ministrave miraton projektligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Forcës Rezerviste në Republikën e Shqipërisë”

Këshilli i Ministrave miratoi në mbledhjen e tij të fundit, projektligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Forcës Rezerviste në Republikën e Shqipërisë”. Ky projektligj ka për qëllim përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e shërbimit rezervist në Republikën e Shqipërisë, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e shtetasve, të organeve shtetërore e subjekteve private për mobilizimin.

Projektligji, që funksionon si pjesë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë, do të shërbejë për të siguruar individë të trajnuar, me qëllim kompletimin e strukturës së FA-së, ruajtjen e nivelit të gatishmërisë dhe operacionalitetit të kërkuar si dhe rritjen e kapaciteteve të mbrojtjes, të nevojshme në kontekstin aktual të sigurisë në rajon e më gjerë si dhe për plotësimin e detyrimeve kombëtare në kuadër të NATO-s, operacioneve në përgjigje të krizave, operacionet e mbështetjes së paqes, sigurisë rajonale e globale si dhe operacionet e emergjencave civile. Projektligji i ri përmban 34 nene që rregullojnë aspektet e organizimit të shërbimit në rezervë, përfshirë kriteret për pranimin, kohëzgjatjen e shërbimit dhe detyrimet e autoriteteve përkatëse. Shërbimi në rezervë do të përfshijë një forcë rezerviste që do të përbëhet nga 25% e forcave aktive, ose rreth 2100 personel, duke siguruar kështu një kapacitet të rëndësishëm për reagim të shpejtë në raste emergjente. Sipas përcaktimeve të projektligjit të ri, ushtarakët, të cilët, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, kanë dalë në rezervë sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si edhe shtetasit civilë, të cilët plotësojnë



kriteret e pranimit të shërbimit ushtarak në rezervë, rekrutohen nëpërmjet procedurës së konkurrimit dhe nënshkruajnë kontratën përkatëse për shërbimin ushtarak në rezervë me kohëzgjatje jo më pak se 2 vjet me të drejtë rinovimi, por pa kaluar kriteret e qëndrimit në shërbimin ushtarak në rezervë.

Me përfshirjen e tij në strukturat rezerviste të Forcave të Armatosura, ushtarakët

në rezervë gëzojnë të gjitha të drejtat si ushtarakët aktivë, ndërsa i jepet grada ushtarake që ka pasur në momentin e ndërprerjes së shërbimit aktiv në Forcat e Armatosura. Shtetasit shqiptarë që nuk kanë shërbyer më parë në shërbimin ushtarak aktiv në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe që plotësojnë kriteret e pranimit në shërbimin ushtarak në rezervë titullohen dhe u jepet grada e parë ushtarake.



## Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu takohet me homologun e tij Guido Crosetto në Romë

Ministri i Mbrojtjes së Shqipërisë, z. Pirro Vengu u takua në Romë, me ministrin e Mbrojtjes të Italisë, z. Guido Crosetto.

Gjatë bashkëbisedimit me homologun e tij, ministri Vengu i shprehu mirënjohjen për angazhimin e tij dhe ekipit të tij në forcimin e bashkëpunimit midis dy vendeve.

Ministri Vengu theksoi rëndësinë e partneritetit të ngushtë me Italinë, veçanërisht në kontekstin e sfidave të përbashkëta në hapësirën adriatiko-joniane dhe në vigjilencën e përbashkët për situatën e sigurisë në Ballkanin Perëndimor. Gjatë këtij takimi, dy ministrat shprehën vendosmërinë që partneriteti i natyrshëm strategjik, nën impulsin edhe të dy kryeministrave Giorgia Meloni dhe Edi Rama, të prodhojë efekte edhe në fushën e Industrisë Ushtarake.

Ministri Vengu dhe homologu i tij italian z. Guido Crosetto diskutuan ndër të tjera edhe për situatën e sigurisë dhe zhvillimet dinamike në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Angazhimet e përbashkëta operationale në kuadër të NATO-s dhe BE-së me vëmendje në misionin e KFOR-it, në Kosovë, ishin një tjetër temë e diskutimeve, ashtu si edhe zhvillimi i kapaciteteve të forcave shqiptare apo modernizimi dhe mundësitë e zhvillimit të industrisë ushtarake detare.



# Ministri Vengu, vizitë zyrtare në Francë

Gjatë vizitës së tij në Francë, në kuadër të pjesëmarrjes në Panairin Ndërkombëtar EURONAVAL, ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu u prit në një takim të veçantë nga ministri i Mbrojtjes i Republikës së Francës, z. Sébastien Lecornu. Fillimisht ministri Vengu u prit me nderime ushtarake nga homologu i tij francez dhe më pas delegacionet biseduan për çështje me interes të përbashkët për të dy vendet. Ministri i Mbrojtjes së Shqipërisë, z. Pirro Vengu i shprehu homologut të tij, z. Sébastien Lecornu mirënjohjen për vëmendjen kushtuar Shqipërisë dhe rolit të saj në sigurinë dhe stabilitetin e Evropës Juglindore. Teksa vlerësoi bashkëpunimin mjaft të mirë mes Shqipërisë dhe Francës, të dy ministrat diskutuan rreth projekteve konkrete në të ardhmen e afërt për modernizimin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe zhvillimin e kapaciteteve të reja mbrojtëse, në përputhje me objektivat e përbashkëta të NATO-s. Ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu vlerësoi se në vijim të thellimit të marrëdhënieve dypalëshe, veçanërisht pas vizitave të ndërsjella të presidentit Macron dhe kryeministrit Rama dhe nënshkrimit të marrëveshjeve ndërqeveritare të nivelit më të lartë, bashkëpunimi mes dy vendeve mbështetet edhe në dimensionin gjithnjë e më të rëndësishëm të industrisë ushtarake.



*"Bashkëpunimi mes dy vendeve mbështetet edhe në dimensionin gjithnjë e më të rëndësishëm të industrisë ushtarake".*

# Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin “Për shërbimin e kërkim - shpëtimit në Republikën e Shqipërisë”

Kuvendi i Shqipërisë miratoi me 72 vota pro dhe 2 abstenim projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin “Për shërbimin e kërkim - shpëtimit në Republikën e Shqipërisë”.

Ky projektligj ka si qëllim funksionimin e një shërbimi efikas dhe bashkëkohor të kërkim - shpëtimit, duke rregulluar fushën e përgjegjësisë së këtij shërbimi, si dhe duke iu përgjigjur nevojave aktuale për rristurimin e këtij shërbimi në respektim të përcaktimeve të detyrimeve të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil.

Teksa mbrojti projektligjin në seancë plenare, ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu tha se ky ligj është një hap thelbësor, qoftë nga pikëpamja e linjimit me standardet ndërkombëtare, qoftë nga pikëpamja e rritjes së kapaciteteve të shërbimit të kërkim - shpëtimit në vendin tonë. Sipas ministrit Vengu, “gjatë tre viteve të fundit ka rritje të trafikut ajror dhe atij detar në vendin tonë dhe kjo vjen bashkë me detyrimin për të pasur një shërbim kërkim - shpëtimi më të mirë dhe një mbulim sa më të përafshir me standardet, qoftë nga pikëpamja e incidenteve detare, qoftë nga pikëpamja e incidenteve ajrore”.

“Ndaj, - theksoi ministri i Mbrojtjes, - arsyeja kryesore e ndërhyrjes së qeverisë në këtë projektligj është mundësia që shërbimi i kërkim - shpëtimit, që ka lidhje me Forcën Ajrore, Forcën Tokësore, Forcën Detare, të jetë në lartësinë e kësaj sfide të re në vendin tonë”. Ndërsa arsyeja e dytë e ndërhyrjes, sipas Ministrit Vengu, ka të bëjë me linjimin me konventat ndërkombëtare dhe veçanërisht me Konventën e Aviacionit Civil Ndërkombëtar: “Në bazë të këtyre konventave, Shqipëria ka obligime ndërkombëtare për të ofruar një shërbim të besueshëm dhe efikas, të bashkërenduar me shërbime partnere, veçanërisht në rastin e aksidenteve ajrore dhe detare brenda rajonit të përgjegjësisë së kërkim - shpëtimit të Republikës së Shqipërisë”, - u shpreh ministri Vengu.

Në këtë ligj të ri parashikohet krijimi i funksioneve të mbikëqyrjes së kërkim - shpëtimit, që do të thotë se agjencia ekzistuese, që është Autoriteti e Aviacionit Civil, do të mbartë sipas konventave ndërkombëtare dhe detyrën e monitorimit të shërbimit të kërkim - shpëtimit dhe do të auditojë rregullisht performancën, investimet, sistemet teknologjike gjithashtu edhe kapacitetet njerëzore në funksion të këtij shërbimi 24 orësh në vendin tonë.

Sipas këtij ligji të sapo miratuar parashikohet ngritja dhe funksionimi i Komitetit Kombëtar të Kërkim - Shpëtimit, pranë Ministrisë së Mbrojtjes. Ky komitet do të kryesohet nga koordinatori Kombëtar i Kërkimit - Shpëtimit, i cili është Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të



**“Arsyeja kryesore e ndërhyrjes së qeverisë në këtë projektligj është mundësia që shërbimi i kërkim - shpëtimit, që ka lidhje me Forcën Ajrore, Forcën Tokësore, Forcën Detare, të jetë në lartësinë e kësaj sfide të re në vendin tonë”.**

Forcave të Armatosura dhe do të ketë anëtarë përfaqësues nga të gjitha ministratë përgjegjëse për fushën e kërkim - shpëtimit, si dhe nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Ky do të jetë autoriteti që do të bëjë edhe bashkërendimin e forcave në rast aksidentesh detare apo ajrore.

# Bashkëpunim në rast emergjencash, ministri Vengu prezanton në Kuvend marrëveshjen me Slloveninë

Ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu prezantoi në Komisionin Parlamentar të Politikës së Jashtme projektligjin “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Sllovenisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë mbi Bashkëpunimin në Mbrojtje ndaj katastrofave natyrore dhe të tjera”. Kjo marrëveshje për bashkëpunimin në fushën e emergjencave civile do të ndikojë në mënyrë të konsiderueshme në rritjen e mëtejshme të kapacitetit dhe reagimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në përballimin e situatave të krijuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera. Sipas marrëveshjes, kjo ndihmë e ndërsjelltë mund të përfshijë ekipe shpëtimi dhe ekspertë individualë, pajisje mbrojtëse dhe shpëtimi dhe ndihmë humanitare. Për të siguruar një ndihmë më të shpejtë dhe më të efektshme në mbrojtje dhe shpëtim dhe në eliminimin e



pasojave të një fatkeqësie, në bazë të kësaj marrëveshjeje, palët do t’u japin ekipeve të shpëtimit dhe ekspertëve individualë që ofrojnë ndihmë një procedurë të thjeshtuar për kalimin e kufirit shtetëror, duke marrë parasysh kushtet e aplikueshme të hyrjes. Po ashtu në marrëveshje përcaktohet se avionët dhe anijet mund të përdoren për transport emergjent të ekipeve të shpëtimit

ose ekspertëve individualë që ofrojnë pajisje ndihme, mbrojtjeje, shpëtimi dhe lloje të tjera të ndihmës në përputhje me këtë marrëveshje. Ndërsa përdorimi i avionëve ushtarakë dhe anijeve ushtarake për qëllimet e kësaj marrëveshjeje lejohet vetëm në marrëveshje me shtetin pritës. Marrëveshja pritet të ratifikohet në seancë plenare.

Forcat e Armatosura tashmë janë pajisur me autoblanda amerikane. Mjete taktike të blinduara për efektivët e Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë (BKL), i janë shtuar prej pak ditësh flotës së Forcës Tokësore të ushtrisë shqiptare, duke rritur ndjeshëm kapacitetet e saj operacionale. Forca Tokësore, tashmë me hapa të sigurt drejt standardeve që kërkon Aleanca e Atlantikut të Veriut për anëtarët e saj, pas rritjes së buxhetit për shpenzimet ushtarake në 2% të PBB-së.

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu, për këtë arritje të radhës të Forcave të Armatosura u shpreh se: “falë asistencës së aleatit strategjik, SHBA-së, tashmë Forca Tokësore hedh një hap tjetër drejt modernizimit, një proces që do të vijojë edhe me risetimin e industrisë ushtarake, duke rikthyer prodhimin e armëve në uzinën e Poliçanit, Gramshit dhe Mjekësit. “Ky investim shënon një hap të rëndë-

## Ministri i Mbrojtjes: Pasurimi i flotës së mjeteve në Forcën Tokësore, hap tjetër drejt modernizimit

sishëm në procesin e modernizimit dhe rritjes së gatishmërisë së strukturave ushtarake, në përputhje me prioritetin tonë për forcimin e infrastrukturës mbrojtëse. Pasurimi i

flotës së mjeteve në Forcën Tokësore është gjithashtu një element për rritjen e aftësive tona mbrojtëse dhe përmbushjen e standardeve ndërkombëtare”.



# Projektbuxheti historik i 2025, në siguri dhe forcim të kapaciteteve mbrojtëse

Ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu e cilësoi projektbuxhetin për vitin 2025, një buxhet historik, që shënon një hap të rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve mbrojtëse dhe të sigurisë kombëtare. Gjatë fjalës së tij në seancën parlamentare dedikuar projektbuxhetit të vitit 2025, ministri Vengu tha se për vitin 2025, buxheti i sektorit të Mbrojtjes parashikon një total prej 52,7 miliardë lekësh, që përbën një rritje prej 4,6% krahasuar me vitin 2024. Teksa kërkoi mbështetjen për miratimin e këtij projektbuxheti, ministri i Mbrojtjes u shpreh se, shpenzimet e Mbrojtjes rriten nga 215\$ për frymë, në 219\$ për frymë në vitin 2025.

“Për vitin e dytë radhazi, Buxheti i Mbrojtjes mbetet mbi kufirin 2% të PBB, ndërkohë që mbi 20% e totalit të shpenzimeve i dedikohen investimeve në pajisje kritike dhe modernizim”, - u shpreh ministri Vengu. Sipas tij, për vitin që vjen totali i shpenzimeve kapitale vjen në rritje: “Kemi një vlerë prej 28,2 miliardë lekësh, ku shpenzimet kapitale me financim të huaj janë në masën 12,2 miliardë lekësh”, - tha ministri i Mbrojtjes.

“Hapësira fiskale, - shtoi ministri i Mbrojtjes, - na lejon që të konsiderojmë nga viti 2025 edhe mundësinë e kredisë së huaj nga vendet partnere dhe përkatësisht nga partneri ynë strategjik për të financuar projektet e modernizimit të forcave të armatosura”. Një nga prioritetet kryesore të këtij buxheti është rritja e pagave për personelin ushtarak: “Është parashikuar një rritje domethënëse mbi pagë, nga e cila përfitojnë rreth 6 mijë ushtarakë, ku rishtas përfitojnë rreth 2500 prej tyre. Rritja e vijueshme e pagave e çon në fakt në 71% rritjen që nga viti 2021. Pra përpjekja e madhe buxhetore që i kërkojmë taksapaguesit shqiptar i dedikohet pikë së pari



trajtimin dinjitoz të personelit ushtarak. Ky është vetëm një ilustrim sesi rritja ekonomike e vendit rishpërndahet në familjet shqiptare”, - theksoi ministri Vengu.

Ky është një hap domethënës drejt arritjes së objektivit të qeverisë shqiptare për një trupë ushtarake të mirëpajisur, të mirëpaguar dhe të mirëstërvitur, nënvizoi më tej, ministri i Mbrojtjes. Nga ana tjetër, sqaroi ministri në fjalën e tij, projektbuxheti siguron rreth 1 miliard lek, për strukturën rezerviste përgjatë vitit 2025, si një komponent i rëndësishëm, për t’iu përgjigjur në kohë nevojave dhe ndryshimeve të sigurisë rajonale dhe më gjerë. Synimi është që deri në vitin 2030 ky komponent të përbëjë rreth 1/5 e Forcave të Armatosura ose në shifra 2100 forca.

Modernizimi dhe rritja e gatishmërisë operacionale, zë vendin më të madh të burimeve financiare me një peshë specifike prej 54,8% e Buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2025. Ky buxhet siguron

vijimësinë e 21 projekteve të modernizimit, që janë në zbatim e sipër dhe fillimin e 8 projekteve të reja në sisteme mbrojtëse për rritjen e reagimit të shpejtë të Forcave të Armatosura.

Një vëmendje kryesore në këtë projektbuxhet është edhe pjesa e emergjencave civile që në këtë buxhet, sipas ministrit Vengu janë në vlerën 5,5 miliardë lekë, duke njohur rritjen më të konsiderueshme të viteve të fundit.

Ringritja e Industrisë Ushtarake në vendin tonë, një proces tashmë i nisur, i cili do të kthejë aftësitë zhvilluese dhe prodhuese, të municioneve, lëndëve plasëse dhe armatimit të lehtë, mbështetur në teknologjinë më të avancuar për prodhimin e tyre, për ta kthyer këtë industri në nivele konkurruese edhe për tregjet ndërkombëtare, është një tjetër pikë e këtij buxheti. Sipas Ministrit Vengu, rivitalizimi i Industrisë Ushtarake, do të sjellë gjenerimin e të ardhurave brenda vitit 2025.



# Tirana mbledh Ministerialin e Mbrojtjes për Evropën Juglindore

Në Tiranë u zhvillua Ministeriali i Mbrojtjes për Evropën Juglindore (South East Defence Ministerial - SEDM), i cili mbledhi ministra dhe përfaqësues të lartë nga disa vende. I pranishëm në këtë ministerial ishte ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, z. Pirro Vengu, i cili gjatë fjalës së tij u shpreh se: “Në këto kohë të vështira për paqen dhe stabilitetin global, është e rëndësishme të dërgojmë mesazhin e qartë se qëndrojmë bashkë dhe ndërveprojmë me njëri-tjetrin për t’u bërë ballë rreziqeve dhe sfidave të shumëllojshme, si ato konvencionale ashtu edhe ato hibride, me të cilat po përballlemi.”

“Ministeriali i SEDM rikthehet në Tiranë, në një proces ku ka nisur në fakt 28 vite më parë dhe besoj se pavarësisht dinamikave dhe zhvillimeve në mjedisin gjeopolitik dhe atë strategjik të sigurisë ndër vite, objektivat dhe arsyet e themelimit të kësaj iniciative mbeten ende relevante, konkretisht bashkëpunimi rajonal, fqinjësia e mirë, rritja e kapaciteteve të mbrojtjes dhe integrimi në strukturat euroatlantike qëndrojnë padyshim të vlefshme edhe sot.

Për Shqipërinë ky bashkëpunim qëndron si një busull orientuese drejt një familjeje demokratike me vlera të shëndosha dhe padyshim ne, në mënyrën e bashkëpunimit që kemi thelluar ndër vite, kemi arritur të mbajmë gjithashtu larg ambiciet dhe ndërhyrjet e aktorëve dashakeqës, që mund të minojnë kursin euroatlantik të vendeve dhe rajonit tonë”, - u shpreh ministri Vengu gjatë fjalës së tij.

Sipas ministrit të Mbrojtjes: “Shqipëria këtë vit është kthyer në një nyje të bashkëpunimit, të sigurisë dhe mbrojtjes rajonale, duke kryesuar dhe mikpritur disa formate të rëndësishme, siç janë A5 - Karta e Adriatikut, Mbledhjen e Shefave të Shtabeve të Forcave të Armatosurave të vendeve të rajonit dhe padyshim edhe ky ministerial, që është një pikë tjetër kulmore”. Gjithashtu, ministri Vengu theksoi angazhimin e Shqipërisë përkrah aleatëve të saj në NATO: “Është fakt se kthjelltësia dhe angazhimi ynë politik është institucional dhe ushtarak në mbështetje të agjendës së NATO-s dhe BE-së, nuk mund të vendoset në dyshim veçanërisht për rritur



qëndrueshmërinë kombëtare, forcuar mbrojtjen kolektive dhe frenuar ambiciet e aktorëve të tretë, të cilët vazhdojnë në mënyrë brutale dhe veçanërisht, Rusia ndaj Ukrainës dhe popullit të saj të pafajshëm”, - nënvizoi ministri Vengu. Gjatë fjalës së tij, ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, theksoi faktin se qasja e Shqipërisë për të shumëfishuar interesat dhe qëndrimet në rajon është e dukshme me vendosjen në dispozicion të aseteve dhe infrastrukturës kombëtare, duke përmendur këtu Bazën Ajrore të Kuçovës dhe projektin për Portin e ri ushtarak të Porto Romanos.

Gjatë këtij ministeriali, u vlerësua kontributi i Shqipërisë në drejtimin e Brigadës së Evropës Juglindore (SEEBRIG) për sigurinë dhe stabilitetin rajonal dhe botëror. Ky ministerial, i cili këtë vit mbahet në

Tiranë, mbledhi përfaqësues të vendeve anëtare të SEDM, përfshirë Shqipërinë, Bosnje-Hercegovinën, Bullgarinë, Greqinë, Italinë, Kroacinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Rumaninë, Turqinë, Slloveninë, Serbinë, Ukrainën, Moldavinë, Gjeorgjinë dhe SHBA-të. Gjithashtu, në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues nga organizatat RACVIAC dhe UNDP/SEESAC.





## Gjeneralmajor Arben Kingji mori pjesë në Konferencën e 12-të të Iniciativës së Bashkëpunimit në Fushën e Mbrojtjes (DECI)

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji, mori pjesë në Konferencën e 12-të të Iniciativës së Bashkëpunimit në Fushën e Mbrojtjes (DECI), e cila u zhvillua në Vjenë, Austri. Kjo iniciativë kryesohet nga Italia dhe ka në përbërje të saj Shqipërinë, Austrinë, Hungarinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut. Përveç përfaqësuesve të vendeve anëtare, në nivel Shef Shtabi, në konferencë morën pjesë edhe zëvendëskomandanti i Forcës së Bashkuar të NATO-s në Itali, gjenerallejtënant Peter Scott, zëvendëskomandanti i KFOR, gjeneral brigade Federico Bernacca, komandanti i EUFOR, gjeneralmajor Laszlo Sticz, si

dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Bosnje-Hercegovinës, gjeneralmajor Gojko Knezevic. Çështjet kryesore të zhvilluara gjatë këtij takimi përfshijnë stabilitetin dhe sigurinë rajonale; zhvillimin e kapaciteteve, trajnimeve dhe mundësive për bashkëpunim si dhe përfshirja e DECI në organizata ndërkombëtare. Në seancën e parë u ofrua një përditësim mbi situatën e sigurisë nga zëvendëskomandanti

i Komandës së Forcës së Bashkuar të NATO-s në Napoli, zëvendëskomandanti i KFOR-it dhe nga komandanti i EUFOR, për të vijuar më tej me diskutimet dhe shkëmbimin e mendimeve të Shefave të Shtabit. Në fjalën e tij në këtë seancë, SHSHPFA gjeneralmajor Arben Kingji, pasi falënderoi homologun austriak për organizimin e konferencës, vuri theksin në rolin e bashkëpunimit ushtarak për një mjedis të qetë dhe të sigurt. Gjeneralmajor Arben Kingji vlerësoi se sfidat dhe dinamikat në mjedisin e sigurisë shtrojnë nevojën për nxitjen e bashkëpunimit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Më tej, gjatë fjalës së tij ai u ndal gjithashtu edhe në rolin e vendit tonë për nxitjen e bashkëpunimit dhe stabilitetit rajonal, përpjekje këto të çuara edhe më përpara gjatë kryesimit nga vendi ynë përgjatë gjithë

këtij viti, i iniciativave rajonale të shefave të shtabit të Ballkanit dhe SHBA-Karta e Adriatikut. Ai vlerësoi situatën në Veri të Kosovës si delikate dhe dënoi çdo tentativë për të destabilizuar situatën dhe cenuar integritetin territorial të Kosovës. Në seancën e dytë dedikuar zhvillimit të kapaciteteve, trajnimeve dhe mundësive për bashkëpunim, u diskutua rreth projekteve dhe angazhimeve të përbashkëta me qëllim nxitjen e bashkëpunimit dhe ndërveprueshmërisë. Në këtë seancë, gjatë fjalës së tij, gjeneralmajor Arben Kingji vlerësoi rolin proaktiv të Italisë si vend kryesues i kësaj iniciative, si dhe përmendi disa nga angazhimet



e FARSH-së në struktura shumëkombëshe, rritjen e kontributit në KFOR dhe vullnetin për të rritur prezencën në krahun lindor të NATO-s dhe në EUFOR. Në fjalën e tij, ai theksoi integrimin euroatlantik të vendeve aspirantë dhe prezencën e NATO-s dhe BE-së, si elemente kyç për stabilitetin dhe sigurinë e rajonit. Në seancën e tretë u diskutua rreth bashkëpunimit aktual të DECI me organizatat ndërkombëtare dhe mendësitë e nxitjes së këtij bashkëpunimi në të ardhmen. Duke marrë në konsideratë rëndësinë e bashkëpunimit rajonal, gjeneralmajor Arben Kingji vlerësoi dhe shprehu mbështetjen për nismat që mund të kontribuojnë në këtë drejtim, si dhe vuri theksin në nevojën për të mbështetur mundësitë e arsimimit dhe stërvitjes, duke marrë në konsideratë rolin e tyre në zhvillimin dhe ndërveprueshmërisë së personelit.

# Ministri Vengu i dorëzon Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gradën “Gjenerallejtënant”

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Arben Kingji, me propozim të kryeministrit të vendit z. Edi Rama dhe dekret të miratuar nga presidenti i Republikës Sh.t. z. Bajram Begaj, merr gradën “Gjenerallejtënant”. Kjo gradë, shefit të Shtabit të Përgjithshëm, në ceremoninë e organizuar me këtë rast, iu dorëzua nga ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu. Në fjalën e tij përshëndetëse, ministri Vengu vlerësoi gjenerallejtënant Kingjin, si një gjeneral që është ngritur në karrierë, duke kaluar të gjitha etapat e nderit dhe duke shërbyer me sukses në shumë detyra të ngarkuara. Sipas ministrit Vengu, ky është edhe një moment i veçantë, pasi ylli i tretë në Forcat e Armatosura është rikthyer pas gati një dekade e gjysmë. Ministri i Mbrojtjes tha se gjenerallejtënant Kingji e ka merituar këtë yll të tretë.

“Dikush mund ta ketë ndjekur karrierën e tij që në kohën e Afganistanit, dikush që në kohën që ka drejtuar regjimentin në Poshnje, që kur ka drejtuar Forcën Tokësore, apo kur ka mbajtur pozicione të tjera përfaqësimi në funksion të FA-ve. Unë në këto pak muaj kam njohur një person që, së pari ka forcën e karakterit si udhërrëfyes në mbrojtje të interesave kombëtare, në mbrojtje të të gjithë interesave të ushtarakëve, të familjarëve të tyre dhe të përmirësimit të gjithanshëm dhe të modernizimit të FA-ve”, - theksoi, gjatë fjalës së tij, Ministri i Mbrojtjes.

Teksa i uroi suksese në vijim të ushtrimit të detyrave, ministri Vengu u shpreh se, gradimi i gjenerallejtënant Kingjit përbën edhe motivim për të gjithë ushtarakët e tjerë të karrierës, të cilët mund të arrijnë përmes dedikimit, disiplinës dhe vetëmohimit në majën e karrierës ushtarake.

“Dikush mund të thotë që sot kemi shumë gjeneralë dhe shumë pak ushtarakë. Unë nuk e besoj këtë. Unë besoj që gjeneralët dhe oficerët në përgjithësi janë kapacitet kombëtar dhe duhet t’u ofrojmë mundësinë, që qofshin aktivë apo rezervistë, të kenë një kontribut të vazhdueshëm në funksione shtetërore”, - u shpreh Ministri Vengu, duke shtuar se buxheti i vitit 2025 është më domethënës i këtyre dy dekadave të fundit, që siguron që karriera ushtarake të jetë forcë tërheqëse për shumë të rinj.

Nga ana e tij, gjenerallejtënant Arben Kingji shprehu mirënjohjen për vlerësimin e bërë nga Ministri i Mbrojtjes, Kryeministri e Presidenti, por pati edhe një falënderim për të



gjithë efektivët e FA-së.

“Falënderim i veçantë shkon për të gjithë ushtarët, nënoficerët dhe oficerët, me të cilët kam qenë bashkë në realizmin e një sërë detyrave, duke pasur parasysh se pas viteve ’90, FA kanë kaluar një sërë sfidash, etapash, procesesh, siç janë modernizimi dhe reformimi, të cilat pa ndihmën e tyre nuk do të realizohej kjo që jemi sot, institucioni më dinjitoz dhe më korrekt, në të cilin ne shërbejmë”, - u shpreh shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, i cili vuri theksin edhe te vendimet e fundit të qeverisë, sa i përket trajtimit më dinjitoz të të gjithë personelit të FA-së.



# Përfundoi me sukses stërvitja “Multinational Readiness Exercise (MNRE)” në Persano, Itali

Në zbatim të plan kalendarit të stërvitjeve të Forcës Tokësore për vitin 2024, një togë e Regjimentit të Këmbësisë së Jugut (RKJ) mori pjesë në stërvitjen “Multinational Readiness Exercise (MNRE)”, e cila u zhvillua në Persano, Itali.

Kjo stërvitje ishte pjesë e serisë së stërvitjeve të Grup - batalioni të Bashkimit Evropian, në të cilën morën pjesë personel nga brigada “Garibaldi” e Forcave të Armatosura italiane si dhe personel nga Forcat e Armatosura hungareze.

Stërvitja kishte si qëllim rritjen e integritetit, ndërveprueshmërisë dhe kohezionit të forcave në nivel stafi dhe njësisë, me synim sigurimin e kapaciteteve të kombinuara për një dislokim efektiv sipas detyrave të NATO-s dhe Bashkimit Evropian.

Në këtë stërvitje efektivat e Regjimentit të Këmbësisë së Jugut kryen një sërë detyrash sipas skenarëve të stërvitjes si: shoqërim konvoji, menaxhim refugjatësh, pika kontrolli, operacione sigurie bllokim dhe kundërsulm.

Personeli i togës së Regjimentit të Këmbësisë së Jugut përfaqësoi denjësisht FARSH në këtë stërvitje, duke marrë vlerësime tepër pozitive nga autoritetet drejtuese.



## Toga e Regjimentit të Këmbësisë së Jugut të kontingjentit të IV “FLF BGR”, në Bullgari, përmbylli me sukses muajin e katërt të misionit në stërvitjen “FLASH”

Toga e Regjimentit të Këmbësisë së Jugut e Kontingjentit të IV “FLF BGR”, (Forward Land Force Bulgaria), dislokuar në Novo Selo, Bullgari, në muajin e katërt të kryerjes së misionit, ka përfunduar me sukses angazhimet në kuadër të stërvitjes “FLASH”, duke treguar aftësi të shkëlqyera në skenarë luftimi.

Në bashkëpunim me forcat aleate të NATO-s, efektivët tanë shfaqën profesionalizëm dhe përgatitje të lartë, duke dëshmuar angazhimin e Shqipërisë në forcimin e sigurisë dhe stabilitetit në rajon.

Rezultati i kësaj stërvitjeje është reflektim i disiplinës dhe stërvitjes së vazhdueshme që efektivët kanë kryer në RKJ dhe në veçanti në trajnimin që këto trupa kryen gjatë stërvitjes paradislokuese.





# Përfundoi stërvitja e Forcës Detare “Flotex 2024”

**S**tërvitja “Flotex” është stërvitja vjetore kryesore e Forcës Detare, e cila shërben për vlerësimin dhe certifikimin e aftësive dhe kapaciteteve të Distrikteve Detare dhe Flotiljeve Detare në bashkëpunimin me Qendrën e Zhytjeve dhe Shërbimin Hidrografik për realizimin e misionit dhe detyrat e tij themelore.

Gjithashtu nga anijet e Flotiljeve të Distriktit Detar Verior dhe Distriktit Detar Jugor u zhvilluan qitjet detare me armatimin e anijeve, bazuar në skenarë të supozuar.

Qëllimi i kësaj stërvitjeje është përmirësimi i bashkëpunimit midis mjeteve detare dhe Grupit të Bordingut të Flotiljes Detare, Qendrën e Zhytjeve e Shërbimin Hidrografik si dhe testimi i procedurave të zbatimit të ligjshmërisë detare për operacionet e Ndalimit Detar dhe Kërkim-Shpëtimit (SAR). Forca Detare do të vazhdojë të kontribuojë me kapacitetet e saj në interes të rritjes së sigurisë detare në detin Adriatik dhe Jon si dhe detin Mesdhe si pjesë e angazhimeve të saj në kuadër të NATO-s.

# Realizohet me sukses stërvitja “Rrjedhja e Vjosës-24”

Për herë të parë, FAj zhvilloi një stërvitje, e quajtur “Rrjedhja e Vjosës 24”. Kjo stërvitje ishte një stërvitje komando-shtabi ajrore e nivelit taktik, me dislokim/ribazim të mjeteve ajrore si dhe me dislokim të shtabit të FAj jashtë vend-dislokimit të saj të përhershëm. Si pararojë e kësaj stërvitjeje, në muajin tetor, Qendra e Kontroll - Raportimit (QKR) e FAj, zhvilloi një testim të kapaciteteve të saj, duke realizuar fushim në Midë.

Nëpërmjet zhvillimit të kësaj stërvitjeje, FAj synoi realizimin e objektivave të saj që kishin të bënin me: shfrytëzimin dhe shndërrimin e kapaciteteve të saj në “Civilian Emergency Management” të vend-instalimit të aseteve që disponon (Shtabi i FAj, Qendra e Kontroll-Raportimit dhe personeli i Bazës Ajrore të Farkës me helikopterët e saj “Cougar” dhe “Blackhawk”); mundësitë e realizimit të misionit të shtabit të FAj dhe Bazës Ajrore të Farkës jashtë vend-dislokimit të tyre të përhershëm; rritjen e gatishmërisë luftarake, testimin e kapaciteteve të dislokueshmërisë nga vend-dislokimi i përhershëm në rajone të përkohshme, testimi i kapaciteteve dhe aftësive profesionale të efektivit të Sallës Operacionale dhe të Grupit të Menaxhimit të Sistemeve, të shtabit të FAj dhe Bazës Ajrore Farkë, për operimin në kushte të vështira dhe jashtë vend-dislokimit të përhershëm.

Gjithashtu, kjo stërvitje synoi dhe rritjen e ndëreveprueshmërisë operacionale me institucionet vendore të rajonit të Prefekturës së Gjirokastrës, vendi ku u zhvillua stërvitja; testimin e aftësive planëzuese, koordinuese dhe ekzekutuese në operacionet e FAj; testimin e kapaciteteve reaguese në misionet e Kërkim-Shpëtim-it/SAR; si dhe kryerjen e transportit ajror në nivel grup/skuadër.



Në përfundim të stërvitjes u zhvillua DVD i saj. Të pranishëm ishin Prefekti i Qarkut të Gjirokastrës, z. Odise Kote, përfaqësues nga bashkia, drejtorja arsimore e Gjirokastrës, të ftuar nga KM, FT, AFA, përfaqësues nga SHP, ASNI, si dhe maturantë të gjimnazeve të qytetit të Gjirokastrës.

Të pranishmit ndoqën me kureshtje demonstrimet e helikopterëve “Cougar” dhe “Blackhawk” në tre skenarë me tematikë misione evakuimi MEDEVAC, CASEVAC dhe SAR në situatë emergjencash civile.

Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ferdinand Dimo, pasi falënderoi të gjithë pjesëmarrësit në stërvitje dhe të ftuarit, u ndal në rëndësinë e realizimit të këtyre lloj stërvitjesh, duke nënvizuar faktin që Forca Ajrore me kapacitetet e saj nuk është një aset vetëm i Forcave të Armatosura, por një aset kombëtar, edhe në shërbim të popullatës dhe komunitetit civil, në situata humanitare dhe emergjencash civile.




# Personeli i Detashmentit UAV, përfundon me sukses trajnimin në Kesan, Turqi

Për një periudhë njëmuajore, 10 efektivë të Detashmentit të Avionëve pa Pilot (UAV) të Forcës Ajrore, zhvilluan trajnimin për përdorimin e Dronëve YIHA-X, në Qendrën e Trajnimit në Kesan, Turqi.

Ky trajnim synoi rritjen e aftësive operacionale të personelit në përdorimin e teknologjive moderne të fluturimit pa pilot. Shumë shpejt këta dronë do t'i shtohen modernizimit të Forcës Ajrore, duke forcuar dhe rritur kapacitetet e saj.

Personeli i Forcës Ajrore në këtë trajnim, tregoi një performancë të lartë, kjo falë trajnimit dhe përgatitjes së lartë, që është arritur në më pak se një vit nga krijimi i Detashmentit UAV.



## U zhvillua ceremonia për përfundimin e “Kursit të kërkim-shpëtimit ujor”

Në ambientet e Qendrës Stërvitore u zhvillua ceremonia e përfundimit të kursit funksional të kërkim-shpëtimit ujor. Në këtë kurs, morën pjesë 15 efektivë të togës ujore, të kompanisë operacionale, në Bazën e Mbështetjes dhe Emergjencave Civile. Në ceremoninë e certifikimit ishin të pranishëm shefi i Shtabit të Komandës Mbështetëse, kolonel Idriz Kuça, komandanti i Qendrës Stërvitore, kolonel Ylli Zyla, komandanti i BMEC, kolonel Hajdar Gurra dhe të ftuar të tjerë.

Përmes këtij kursi efektivët e togës ujore, u aftësuan për kryerjen e detyrave si luftues, shpëtues dhe evakuues në organizimin dhe kryerjen e operacioneve të

kërkim-shpëtimit në zona të përmytura, lumenj, liqene dhe det.

Në përfundim të ceremonisë u shpërndanë certifikata dhe u realizua një foto e përbashkët.





# Niset në Letoni Kontingjenti XVI, ministri Vengu: EOD, kapacitet kombëtar

**N**ë Komandën Mbështetëse u zhvillua ceremonia e nisjes së Kontingjentit XVI EOD prej 21 ushtarakësh, i cili do të marrë pjesë në misionin e Prezencës së Përpunuar të Përforcuar të NATO-s, duke iu atashuar brigadës shumëkombëshe në Camp Adazi, Letoni.

Në ceremoni ishin të pranishëm ministri i Mbrojtjes, zoti Pirro Vengu, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Arben Kingji, komandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëqim Çela, familjarë të efektivëve të kontingjentit dhe të ftuar të tjerë.

Në fjalën e tij, komandant Çela falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe njëkohësisht Kontingjentin XVI, duke shprehur bindjen se ata janë vazhdues të denjë të

rrugës së nisur nga kontingjentet e mëparshme.

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, vlerësoi sakrificën e pjesëmarrësve në këtë kontingjent dhe mbështetjen e pakufizuar nga familjet e tyre për sigurinë dhe paqen ndërkombëtare: "Sakrifica juaj edhe ajo e familjeve tuaja, të cilat i përshëndes me shumë respekt sot, merr vlerësimin më të madh nga ne, nga bashkëkombësit tuaj dhe nga atdheu. Ju uroj mision të mbarë dhe të suksesshëm", - tha ministri. Vengu theksoi se kapacitetet EOD janë të mirënjohura tashmë si kapacitet kombëtar. Komandanti i Kontingjentit XVI, major Algert Lala, u shpreh në emër të kontingjentit se me disiplinë dhe profesionalizëm do të përfaqësojnë dhe rrisin vlerat e Forcave tona të Armatosura në këtë mision.



## Efektivët e Kontingjentit XV EOD përfunduan detyrën në mbështetje të stërvitjes “Resolute Warrior-2024”

**E**fektivët e Kontingjentit XV, të cilët i janë atashuar brigadës shumëkombëshe të Prezencës së Përparuar të Përforduar, në Letoni, përfunduan detyrën në mbështetje të stërvitjes “Resolute Warrior”. Gjatë kësaj stërvitjeje, toga EOD ka realizuar mbështetjen me operacione EOD për të gjitha njësitë e brigadës shumëkombëshe, duke bërë asgjësimin e municioneve të paplasura të kalibrave të ndryshëm. Realizimi me sukses i detyrave të rëndësishme në kuadër të misioneve ndërkombëtare, i radhit efektivët tanë krah aleatëve të tjerë të NATO-s.

Në ceremoninë e ditës së Vizitorëve të Shquar në kuadër të stërvitjes “Resolute Warrior”, në të cilën morën pjesë personalitete të larta, ndër to Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, Republika e Shqipërisë u përfaqësua nga ambasadori i saj në NATO, zoti Ilir Gjoni. Zoti Gjoni, realizoi takim me efektivët e Kontingjentit XV, ku shprehu falënderime dhe mirënjohje për kontributin e tyre në operacione ushtarake të NATO-s. Gjithashtu zoti Gjoni kreu homazhe në nder të dy Dëshmorëve të Atdheut, të rënë në krye të detyrës në Camp Adazi, Letoni.



## Përfundoi operacioni EOD në mbështetje të emergjencave civile, në bashkinë Himarë

Ekipi i ekspertëve të Kompanisë EOD në Batalionin e Xhenios, i është përgjigjur kërkesës së autoriteteve përkatëse për vlerësimin e municioneve të paplasura të gjetura në fshatin Borsh.

Ekspertët, pasi siguruan perimetrimin e zonës, bënë vlerësimin e kujdesshëm të municioneve dhe arritën në përfundimin se municionet e gjetura ishin predha artilerie E-TH 85mm.

Municionet e paplasura u konsideruan të lëvizshme dhe duke zbatuar të gjitha masat e sigurisë u bë transportimi dhe magazinimi i tyre në mjediset e Batalionit të Xhenios.

# Specialistët e Kompanisë EOD, asgjësojnë municionet e rrezikshme në hotspotin Jub - Sukth, bashkia Durrës

Gjatë realizimit të operacionit për kontrollin dhe pastrimin nga municionet e paplasura në hotspotin Jub-Sukth, bashkia Durrës, ekspertët xhenerë kanë konstatuar municione të tipit trupa djegoresh të rrezikshme.

Personeli i kompanisë EOD, i trajnuar dhe certifikuar për pastrimin e zonave të ndotura nga municione të paplasura, bëri vlerësimin e detajuar të trupave të djegoreve dhe i klasifikoi ato si të rrezikshme e të palëvizshme. Duke zbatuar masat e sigurisë ekipi EOD, realizoi asgjësimin në vend të municioneve, duke shmangur premisat për ngjarje të jashtëzakonshme.



## Specialistët e kompanisë EOD, realizuan eliminimin e rrezikut nga municionet e paplasura

Ekipi EOD realizoi detyrën për eliminimin e rrezikut nga municionet e paplasura të gjetura nga banorët e zonës pranë Urës së Beshirit, bashkia Tiranë. Me marrjen e njoftimit për prezencë municionesh të rrezikshme efektivët e kompanisë EOD në Batalionin e Xhenios, u angazhuan menjëherë për sigurimin e zonës dhe identifikimin e municionit të gjetur, duke bërë vlerësimin e kujdesshëm të tij, ku u konsiderua të ishte i lëvizshëm dhe i transportueshëm. Duke zbatuar rregullat e sigurimit teknik, specialistët EOD bënë transportimin dhe magazinimin e tij në ambientet e Batalionit të Xhenios.





Ismail bej Qemali  
dhe Isa Boletini  
në Vlorë 1912

# KRIJIMI I USHTRISË KOMBËTARE SHQIPTARE NGA QEVERTIA E PËRKOHSHME E VLORËS (1912-1914)

**S**igurimi i Kuvendit kombëtar dhe i veprimtarisë së Qeverisë kërkonin organizimin e forcave të armatosura. Për këtë qëllim Ismail Qemali, që më 26 nëntor, formoi një komision organizues dhe u dërgoi pleqësive të fshatrave një qarkore me anën e së cilës porositeshin të mobilizonin njerëzit e aftë për armë dhe t'i mbanin ata në gatishmëri. Më 4 dhjetor 1912, Kuvendi i Vlorës zgjodhi Qeverinë e përkohshme dhe Ismail bej Vlorën kryeministër. Po atë ditë u zgjodh Ministër i Luftës Mehmet Pashë Dërralla. Nga struktura dhe përbërja e Ministrisë së Luftës njohim pozicionin e zëvendësministrit të Luftës, në të cilin u caktua Xhelal Koprencka dhe të disa komandantëve ushtarakë, si Isa Boletini, Hajredin bej Cakrani, Riza bej Gjakova etj. Pas formimit të saj, Qeveria dërgoi një forcë të vogël të armatosur me vullnetarë patriotë (vullnetarë kosovarë) të ruanin bregun e Vjosës. Ajo ngriti komisione të mbrojtjes kombëtare nëpër krahina dhe urdhëroi mobilizimin e batalioneve redif e mustafëz për mbrojtjen nga forcat greke që kishin ardhur deri në Himarë. Kërkesa e saj për të çarmatosur ushtarët turq në Myzeqe e për të armatosur ushtarë shqiptarë, nuk u pranua, as nga Turqia e as nga Austro-Hungaria e Italia. Në janar 1913, Qeveria kish ngritur dhe armën e Xhandarmërisë, e cila në fund të vitit numëronte 4 detashmente me nga 300 xhandarë secili.

Por puna e mbrojtjes do të kishte një hap në fillim të majit 1913... Më 5 maj 1913 (më 22 prill sipas kalendarit të vjetër), Qeveria e Përkohshme e Vlorës do të diskutonte e miratonte Rregulloren për organizimin e përkohshëm të Ministrisë së Luftës. Në përbërje të Ministrisë së Luftës do të ishte Shtati (Shtabi) Madhor. Për shkak të njohjes dhe kredibilitetit që gëzonte, Major Ali Shefqeti do të emërohej në detyrën e lartë e të nderuar të Kryetarit të këtij Shtabi. Kjo ishte bërë e domosdoshme, sepse kishin kaluar 5 muaj që Ministria e Luftës (nga 4 dhjetor 1912) funksiononte pa një akt themelor normativ (me siguri në bazë urdhrash të veçantë për çështje konkrete që dilnin. Ministria e Luftës do të kishte gjithashtu edhe zyrën Qertare (të prapavijës, apo intendencës), zyrën hertare (të organizimit e personelit) dhe zyrën Shëndetare, të cilat në disa artikuj e botime janë dhënë tjetër për tjetër. Që kishte një zyrë të tillë të Intendencës në Ministrinë e Luftës e shkruan vetë Ali Shefqeti në një shkresë dërguar Ministrisë së Financave. E gjejmë edhe

në një shkresë të 29 marsit 1914, për uniformat e oficerëve dhe ushtarëve drejtuar gjeneralit holandez Dever, firmosur dhe vulosur po me atë vulë, "Qarku Qerta". Në vijën e dytë të Rregullores së Ministrisë së Luftës përcaktohej edhe ndërtimi i brendshëm i vetë Shtabit Madhor, i cili, nga ana e tij, përbëhej nga: 1 - Qarqet e Shtabit Madhor (të themi drejtori, a departamente); 2 - Shkresina e Shtabit Madhor, (Sekretari arkivi); 3 - Komisioni i rregulloreve; 4 - Komisioni i trajtimit të policisë dhe të xhandarmërisë dhe 5 - Komisioni i ndërtimit (a xhenios, si të thuash). Rregullorja në mënyrë sintetike kish fiksuar edhe detyrat e të drejtat e Shtabit. Në vijën 4 të Rregullores së Ministrisë së Luftës përcaktohej se: "Zyra e Shtabit Madhor asht e detyrueme për me i rradhit nomet, rregulloret dhe ushtrimoret e Armëve të ndryshme që i duhen ushtërisë dhe për me e sigurue disiplinën e ushtërisë e qetësinë e vendit". Rregullorja kërkonte që, deri sa të bëhej Organizmi themelor, Qarqet e Shtabit Madhor do të vepronin si një Komision, i cili do të studionte projektet që do t'i paraqiteshin, të cilat edhe mund t'i ndryshonte dhe, bashkë me raportin përkatës, do t'ia kalonte Qeverisë nëpërmjet Ministrisë së Luftës. Kështu vetë Shtabi Madhor vepronte në fillimet e tij si një Komision (Qark). Kjo del dhe nga vula që ai përdorte: Qarku i Shtabit Madhor (1913), në një shkresë të firmosur nga Kryetari i Shtatmadhorisë Ali Shefqeti. Ky është padyshim një tregues i gjendjes së vështirë financiare, në mos edhe i mungesës së kuadrove përkatës, të cilët duhej të qenë të diplomuar si oficerë Shtabi. Në Vlorë ishin paraqitur e vënë në dispozicion të Qeverisë 70 oficerë dhe 150 nënoficerë shqiptarë. Shtabi Madhor do të hartonte edhe projekt detyrat e raportet e Zyrave të tjera, të cilat ai i konsultonte me to (ndryshoheshin kur duhej), i parapëlqente (ose jo) dhe ia kalonte gjithashtu Ministrisë së Luftës. Fakti që Ministria e Luftës e shtetit të ri shqiptar u konceptua dhe u ndërtua me Shtab Madhor, që më 1913, tregon se ndërtimi i Ushtisë së rregullt filloi nga lart poshtë, karakteristikë për një shtet ligjor, modern. Rregullorja e përkohshme e Ministrisë së Luftës në vijën 7 të saj përcaktonte se: "Do të ishin në veprim nomet (ligjet) e Turqisë deri sa të radhiteshin nomet (ligjet) dhe rregulloret e reja". Kjo ndodhi edhe në organizmin ushtarak, ku mbet në fuqi dhe u zbatua ligji për mobilizimin e redifëve (rezervistëve) dhe mustafëzve (forca vendore territoriale), që kishin



Mehmet Pashë Dërralla, ministër i Luftës



Ali Shefqeti (Shkupi) kryetar i Shtabit Madhor

qenë para shpalljes së Pavarësisë. Këto batalione u mobilizuan dhe luftuan kundër reparteve të ushtrisë greke që po përparonin në Shqipërinë e jugut.

Në krye të tyre në terren ndodhej Xhelal Koprencka (firmosës i Pavarësisë), zëvendësministri i Ministrisë së Luftës. Komandantë të batalioneve me redifë (rezervistë) ose mustafëiz (territorial) ishin vetë bejlerët, të zotët e bujqve ushtarë, që veç komandimit, përgjigjeshin edhe për logistikën dhe ndërrimin e batalioneve në front. Hajredin bej Cakrani, njëri nga firmosësit e deklaratës së Pavarësisë dhe feudal i madh nga Cakrani i Mallakastrës, që kishte mbaruar studimet e larta ushtarake në Stamboll, ai kishte qenë para 28 nëntorit dhe ishte edhe pas tij, komandant i batalionit “mustafëiz” të Lushnjës, plus dhe komandant i operacionit qeveritar në front kundër grekëve. Për këto reparte dhe veprimtarinë e tyre pothuajse nuk bëhet fjalë në tekstet e historisë, por ato shkrihen e shihen thuajse të gjitha si “forca vullnetare”, kur në fakt ato kishin detyrim ligjor, po se po patriotik, të shërbenin e luftonin, siç edhe bënë një pjesë e mirë e tyre, batalionet e Beratit, Mallakastrës, Skraparit, Tepelenës, Përmetit, Leskovikut e Gjirokastrës, në jug kundër pushtuesve grekë dhe në Shkodër redifët dhe mustafëzët nga Shqipëria e Mesme, (Shijaku, Tirana, Kavaja e Elbasani) dhe nga Shkodra e Dibra, kundër pushtuesve malazezë. Por në praktikë nuk shkonte gjithçka siç shkruhej. Ministri i Luftës Mehmet Pashë Dërralla, më 31 janar 1914, i shkruante komandës së bylykut të Dukatit që të dërgonte emrat e 57 redifëve (rezervistë) që ishin nisur për të patur nën këqyrje pozitën e Llogorasë dhe, siç kish raportuar ajo vetë, ishin arratisur. Më 2 shkurt komandanti i batalionit Alem Mehmeti njoftonte se atje nuk kish mbetur asnjë redif. Edhe komandanti i batalionit mustafëz, Sadullai i shkruante, më 7 dhjetor 1912, Ministrisë së Luftës, se 200 ushtarët që pati, 100 në Delvinë e 100 në Sarandë, ishin arratisur nga mungesa e ushqimit dhe ai ishte kthyer në Tepelenë vetëm me ordinancën e tij. Kajmekani i Vlorës Mustaf Asimi njoftonte, më 15 dhjetor 1912, se “ushtria popullore që ndodhet në anë të Mesaplikut ka mungesa municioni e ushqimi, e sidomos rregulli e disipline, dhe... armiku iu bën thirrje për dorëzim”. Sidoqoftë këto mangësi nuk e zhvlerësojnë punën që ishte bërë për krijimin e ushtrisë dhe veprimin e saj në terren. Përplekjet e Qeverisë vijojnë më tej. Kryetari i Shtabit Madhor Ali Shefqeti (Shkupi), më 3 qershor 1913, i përcjell për studim Ministrinë të Punëve të Brendshme, Myfit bej Libohovës, variantin e parë të rregullores së Milicisë shqiptare, para se të bisedohej në Këshillin e Ministrave). Kjo Rregullore sot gjendet në Arkivin e shtetit shqiptar si një dëshmitare e punës së Shtabit madhor të atëhershëm, madje edhe është botuar e bërë publike. Edhe konsulli austro-hungarez Lejhaetz, njoftonte Vjenën se Zyra (e Shtabit Madhor) hartoi “Rregulloren mbi formimin e Milicisë shqiptare”, sipas së cilës kjo e fundit duhej të ishte një forcë e organizuar, e ngritur mbi bazën e detyrimit ushtarak të përgjithshëm dhe që kishte për detyrë mbrojtjen e vendit deri sa të krijohet një ushtri e rregullt. Më pas del Urdhri për formimin e Kompanisë këmbësore model të ushtrisë, ku shtrohet edhe nevoja e fillimit të shërbimit të detyrueshëm ushtarak. Nga informacioni i konsullit Lejhanetz del se “administrata ushtarake shqiptare kishte ndërmend të bënte më parë studime mbi sistemet e ndryshme ushtarake europiane, pastaj, të vendoste ose të merrte njërin prej tyre ose të krijonte një sistem të ri, të vetin, që u përshtatej kushteve të vendit. Prandaj konsulli i përcillte Vjenës lutjen e kësaj

administratë për t'i vënë sa më shpejt në dispozicion një numër librash shërbimi lidhur me organizimin, stërvitjen dhe shërbimin e brendshëm të armëve të ndryshme të ushtrisë...., si këmbësoria, kaloria, artileria, xhenioja, prapavija dhe shëndetësia. “Në fakt brenda 26 ditëve nga krijimi i Shtabit, më 31 maj 1913, Kryetari i tij informonte ministrinë e Luftës, mbi punën që po bëhej për krijimin e kompanisë model të Ushtrisë, sipas të cilës do të ndërtohej Ushtria Kombëtare. Aty shtrohej edhe nevoja e fillimit të afërmi të shërbimit të detyrueshëm ushtarak. Më 4 shtator, gazeta “Dielli” në SHBA shkruante se “Qeveria mbledh ushtarë me 240 grosh në muaj, jo me pahir, po cili do vetë. Flitet se Guberna shqiptare do të mbledhë gjer në 20 mijë veta, të cilët do të jenë të veshur, mbathur dhe armatisur mirë, me topa, mitraloza dhe municione”, etj. Në arkivin e shtetit ruhet edhe një foto e kompanisë model të krijuar me emrat e oficerëve të tyre. Po në “Dielli”, më 31 tetor 1913, me burim nga Vlorë njoftohej se: “në Vlorë janë tre taborë (batalione.



Vula e Shtabit Madhor 1913

S. O) ushtarë të Shqipërisë të veshur, të mbathur e të armatisur dhe të stërvitur mirë, me topa etj. Janë edhe 7 çeta shqiptare (pra vullnetare) të organizuara fare mirë, të cilat kanë që me 300-500 njerëz njëra. Kryetarët e çetave janë këta: Mehmet Pavari, Nexhip Bënja, Salih Butka, Dino Çiçi Gjinokastra, Namik Delvina, kapedan Spiro Korça dhe Çerçiz Topulli”. Me detyrën e kryetarit të Shtabit Madhor, major Ali Shefqeti komunikonte me telegraf dhe transmetonte vendime të Qeverisë apo urdhra e udhëzime të Ministrisë së Luftës e të vetë Shtabit për veprime luftarake, dërgim oficerësh, armatimi e municioni në terrore të ndryshme të vendit, në jug kundër forcave pushtuese greke dhe në Dibër, ku po zhvillohej kryengritja e shtatorit të vitit 1913. Shtabi i drejtuar prej tij i kish sugjeruar Qeverisë dhe ajo kishte porositur jashtë shtetit, sidomos në Austro-Hungari, topa, mitraloza, uniforma, dhe ajo që të befason, edhe “një numër librash shërbimi dhe veprash të ndryshme që do t'i shërbenin administratës ushtarake të Qeverisë”. Që më 1913, Shtabi Madhor i pat hyrë një punë të veçantë për terminologjinë ushtarake. Për këtë çështje ai pat angazhuar një komision të posaçëm, në të cilin bënë pjesë oficerë të kulturuar si Mustafa Maksuti dhe Kamber Sejdi (dëshmor i atdheut) nga Elbasani, ish-profesor i frëngjishtes në gjimnazin ushtarak të Manastirit. Veprimtarisë së këtij komisioni i takojnë shumë terma që përdorim sot në fushën ushtarake. Por puna e

Qeverisë së Vlorës për Ushtrinë do të vështirësohej pas Vendimit të Konferencës së Ambasadorëve të 29 korrikut 1913, i cili ndonëse njihte shtetin shqiptar, (nën garancinë e Fuqive të Mëdha), e vinte atë nën kontrollin e një Komisioni Ndërkombëtar që ngarkohej për organizimin e gjithë degëve të administratës civile (por jo dhe asaj ushtarake) ashtu siç caktoi oficerë të huaj për organizimin vetëm të xhandarmërisë. Efektet negative të mungesës së organizimit ushtarak do të ndjeheshin fort në ngjarjet tronditëse e tragjike të vitit 1914, ndërkohë që garancia e Fuqive të Mëdha u shkri si kripa në ujë. Historiografia zyrtare shqiptare nuk e ka evidentuar dhe vlerësuar sa duhet veprimtarinë ushtarake të Qeverisë së Vlorës. Prof. Arben Puto në "Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e fuqive të mëdha 1912-1914", i referohet vetëm konsullit Lejhanetz për një "zyrë të shtatmadhorisë, që me nënvleftësim e quante njëlloj organi ushtarak i Qeverisë së përkohëshme. kur ai ishte një organ i vërtetë ushtarak. Për më keq teksti i Akademisë ushtarake i vitit 1986 as nuk e përmend këtë "Zyrë shtatmadhore". Prof. Arben



Puto, konkludon se Qeveria e Vlorës mori disa masa organizative paraprake, por nuk arriti asnjëherë të krijonte as dhe bërthamën e një ushtrie kombëtare. Ndërsa teksti i akademik i Historisë i vitit 2002 ripërsërit konsullin austriak dhe e quan krijimin e një ushtrie të rregullt një "objektiv i parakohshëm, i parealizueshëm në ato rrethana. Po këtë shkruan edhe "Historia e popullit shqiptar gjatë shekullit të XX". Ky mendim për administratën ushtarake nuk na duket bindës dhe mendojmë se duhet hetuar e diskutuar më tej. Në kujtimet e tij, Ismail Qemali shkruan se: "Si u ktheva (nga Londra) në Vlorë, në qershor 1913, Qeveria e përkohshme i dyfishoi përpjekjet për organizimin e vendit dhe për ruajtjen e rendit. Mund të ishin quajtur fare mirë detyra të pamundshme për t'u kryer, por punën e bënte më të lehtë karakteri i shqiptarit - durimin, maturinë dhe patriotizmin e paepur të të cilit, mes gjithë atyre ngatërresave e halleve, nuk ka fjalë e lëvdatë që ta përshkruajë. Pikërisht falë virtyeteve të kësaj race... qeveria ime ia doli mbanë t'i sjellë stabilitet shtetit dhe të sigurojë një administratë normale". Krijimi i Ministrisë së Luftës, i Shtabit Madhor, i bazës ligjore e normative krijimi i xhandarmërisë, mobilizimi në luftë i disa batalioneve redifë e muztafëz, plus tri kompanive me nizamë shqiptare, krijimi i një kompanie model të ushtrisë së rregullt dhe nën shembullin e saj të tre batalioneve me ushtarë aktiv, dhe një grupi me 120 kalorës, a nuk përbënin këto një bërthamë të ushtrisë së rregullt, apo një ushtri të vogël në numër? Kjo veprimtari nuk mbeti vetëm në disa masa organizative paraprake. Ngritja e Ushtrisë së rregullt dhe asaj të përhershme ishin një nevojë e kohës, por ato nuk u realizuan sipas parashikimeve, për shkak të kushteve shumë të vështira në të cilat u detyrua të vepronte Qeveria, të mosnjohjes

së saj nga përfaqësuesit e fuqive të mëdha si qeveri kombëtare e të ndërhyrjeve të tyre të padrejta. Qeveria e Vlorës vepronte në një territor të lirë, të çliruar dhe në kushte lufte me pushtues të egër. Ajo nuk kish pse të vonohej, forcat ushtarake ishin një detyrë urgjente e kohës dhe ajo iu përgjigj asaj me sa mundësi pati. Ndërkohë duhet shënuar se batalionet me redifë dhe ato mustafëz, brenda territorit ku shtrinte veprimtarinë e saj Qeveria e Vlorës në fakt i përkisnin një ushtrie të rregullt, pse ishin organizuar mbi bazën e ligjit ushtarak, me organika standard, për moshën e pjesëmarrësve, numrin e tyre, komandën, uniformën dhe armët që i mbanin në magazinat e ushtrisë etj. Fakti që nuk ishin forca aktive, të përhershme, d.m.th. nizamë, apo ushtarë aktivë, nuk i bën ato ushtri (forcë) e parregullt. Ato edhe sot janë pjesë e Forcave të armatosura në katër anët e Botës. Shtu këtu dhe faktin që Qeveria kishte vendosur, më 13 janar 1913, dhe realizoi krijimin e armës së xhandarmërisë. Kujtojmë se xhandari i vitit 1913 ishte edhe ruajtës i rendit edhe ushtar i luftës, një forcë ende e pa diferencuar. Pra ishte pjesë e ushtrisë së rregullt. Prandaj edhe në përbërjen e Shtabit Madhor kishte një Komision të trajtimit të policisë dhe të xhandarmërisë. Diferencimi i kësaj arme, ndarja e xhandarmërisë nga policia dhe ushtria u bë më vonë, deri në vitin 1920. Krijimi i ushtrisë nga Qeveria e Ismail Qemalit është regjistruar edhe në raportet e dy oficerëve të huaj, kapitenit austriak Ulmanky dhe gjermanit Claner, të cilët siç shkruan prof. as. dr. Marenglen Kasmi, të urdhëruar nga Shtabi i Përgjithshëm austro-hungarez, kryen një vizitë dyjavore në Shqipëri. Kapiteni Ulmanky vizitoi qytetet e Shkodrës, Lezhës, Durrësit, Tiranës dhe Pogradecit, ndërkohë që kapiteni Clanner vizitoi Shqipërinë e Jugut. Raporti që ata hartuan mbi vizitën e tyre në Shqipëri është jo vetëm tepër i hollësishëm dhe të krijon bindjen e një analize të thellë dhe të kujdesshme për gjendjen e shoqërisë shqiptare në prag të ardhjes së Wiedit, si për situatën politike, ekonomike dhe ushtarake të Shqipërisë. Dy kapitenët në raportin e tyre shkruajnë: "Qeveria e Ismail Qemalit në ndryshim nga qeveritë e tjera lokale shqiptare, ishte më e veçantë. Ajo konsiderohej si Qeveria zyrtare e Shqipërisë dhe mbante lidhje diplomatike me qeveritë europiane. Në të vërtetë ndikimi i saj shtrihej vetëm në qytetin e Vlorës dhe në territoret e afërta të qytetit". "Qeveria, - shkruajnë autorët, kishte xhandarmërinë e saj dhe, në ndryshim nga qeveritë e tjera lokale shqiptare, kishte krijuar edhe ushtrinë e saj, kishte një forcë ushtarake, me një ministri lufte si dhe një shtab madhor që drejtonte ushtrinë, e cila gjithsesi ishte në fazën e saj të formatimit. Krahësuar me qeveritë e tjera lokale, ajo e Vlorës kishte të ardhurat më të mira si pasojë e vjeljes së taksave portuale... Brenda vendit mbizotëronte një farë qetësie e rregulli dhe të huajt mund të udhëtonin pa probleme. Po ashtu shërbimi postar dhe ai telegrafik funksiononte në të gjithë vendin. Ky raport i dy kapitenëve austro-hungarez e gjerman, nga dy vende të njohura për organizimin modern ushtarak në Europë, dhe përfundimi i tyre se Qeveria e përkohshme e Vlorës kishte krijuar edhe ushtrinë e saj, vlen shumë për çështjen që po trajtojmë dhe mund të themi se i vë kapak asaj. Ndërkohë nuk duhet të harrojmë se kjo ushtri nuk ishte një ushtri evidencash dhe rrogëtarësh, por një forcë që kish luftuar e luftonte në front për të ndalur përparimin e forcave sidomos greke për të pushtuar Vlorën e territore të tjera nën autoritetin e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës dhe që përkrahte, aq sa kishte mundësi, edhe me oficerë, armatim e municion kryengritjen e Dibrës të shtatorit 1913.



“

Personeli i Bazës Ajrore të Farkës është kualifikuar për të përmbushur standardet dhe misionin e saj. Kjo bazë është një simbol i bashkëpunimit me aleatët tanë në ushtrime të përbashkëta, ku pjesëmarrësit kanë treguar dinjitet dhe profesionalizëm për të koordinuar veprimet për të përmbushur misionin.

# BAZA AJRORE E FARKËS

## 57 vite fluturime humanitare, sakrificë, përgjegjësi

**B**aza Ajrore e Farkës është krijuar më 6 dhjetor të vitit 1967. Zanafilla e kësaj baze është në vitin 1956, kur pilotë e teknikë shqiptarë u dërguan për t'u trajnuar në ish-Bashkimin Sovjetik në Rusi, ndërsa në vitin 1957 u krijua njësi e parë e transportit ushtarak nr. 5818 dhe struktura e saj organizative përfshinte një MI-4, tre MI-1, disa aeroplanë JAK-11, JAK-18 dhe PO-2. Komandanti i njësive u emërua Peço Polena, komandant i trios së parë të MI-4 u emërua Petrit Malindi. Mersin Minxha u emërua komandant i treshes së dytë të MI-1 ndërsa Refit Jazo ishte komandanti i avionëve JAK-18.

#### 4 shtator 1957, fluturimi i parë

Helikopteri i pilotuar nga Peço Polena fluturoi në segmentin Tiranë-Shkodër-Tiranë. Në vitin 1967, rreth 30 helikopterë të rinj MI-4 të prodhuara në Republikën Popullore të Kinës u përfshinë në këtë njësi. Kjo njësi u emërua "Regjimenti i parë helikopter", më 6 dhjetor 1967 dhe komandanti i saj u emërua Lulo Musaj. Regjimenti përfshinte tre skuadronë të helikopterëve MI-4, një makinë për riparimin e helikopterëve, pistën për heliport, duke lejuar ngritjen dhe uljen e njëkohshme të helikopterëve, kazermave dhe kushteve normale për personelin, rojet dhe gjithë infrastrukturën e nevojshme për të përmbushur detyra.

Baza Ajrore e Farkës ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në realizimin e trajnimeve të ndryshme ushtarake të asaj kohe, por gjithashtu ka ndihmuar popullatën në emergjenca civile, veçanërisht në rastet e përmbajtjeve, zonat malore të bllokuara nga bora, tërmetet apo edhe në kohë krizash.

Kjo bazë gjithashtu ka ndihmuar në trajnime të ndryshme të Forcave Ajrore, ose ushtrime të përbashkëta me forcat e njësive të tjera të Forcave të Armatosura, duke treguar cilësi të lartë dhe nivel të trajnimit të fluturimit.

Për të kryer misionin e saj, personeli i kësaj baze trajnohet intensivisht për të mbajtur në gatishmëri të vazhdueshme teknikën e ajrit, për të kryer detyra të tilla si: transportimi i trupave, operacionet e kërkim-shpëtimi (SAR), shpërndarja e ndihmës ushqimore ose transportimi i pacientëve në emergjencave civile.

Në vitet e fundit infrastruktura e bazës

është përmirësuar ndjeshëm kryesisht për shkak të asistencës së ofruar nga Ushtria Italiane. Hekuroporti i ri është ndërtuar me të gjitha pajisjet përkatëse për uljet dhe ngritjet ditore dhe nate. U rindërtuan kazermat, si dhe makineritë për mirëmbajtjen e helikopterëve; drejtimi dhe kulla e fluturimit është e pajisur me vegla moderne. Personeli i Bazës Ajrore të Farkës është kualifikuar për të përmbushur standardet dhe misionin e saj. Kjo bazë është një simbol i bashkëpunimit me aleatët tanë në ushtrime të përbashkëta, ku pjesëmarrësit kanë treguar dinjitet dhe profesionalizëm për të koordinuar veprimet për të përmbushur misionin.

Itali, SHBA, Turqi, Greqi, Gjermani, Francë dhe Mbretërinë e Bashkuar.

Disa prej drejtuesve të Bazës Ajrore të Farkës në vite: Lulo Musaj, Refat Kasimati, Hetem Mehmeti, Sinan Çela, Enver Taho, Beqir Barxha, Raqi Qarri, Syrja Gjoka dhe Frederik Beltoja. 57-vjetori i krijimit të gjen Bazën Ajrore të Farkës të modernizuar me helikopterët "Black Hawk", duke u bërë më operacionale edhe në misionet ndërkom-bëtare. Në këtë 57-vjetor të Bazës Ajrore Farkë, kujtohet me respekt të veçantë dhe vlerësim çdo përpjekje, kurajë, mundim dhe djersë e derdhur ndër vite nga breza të tërë pilotësh, teknikësh, specialistësh, të cilët kanë sakrifikuar edhe jetën e tyre



Çdo vit kjo bazë mbart mbi 500 fluturime në operacione humanitare për të ndihmuar njerëzit në nevojë, për transportin e të sëmurëve, kundër zjarreve, transportin e ndihmave humanitare, në mbështetje të komunitetit gjatë përmbajtjeve, etj. Shumica e personelit teknik dhe pilot janë kualifikuar në shkollat dhe njësitë perëndimore si në

në përmbushje të misionit dhe detyrave në shërbim të qytetarëve dhe vendit.

Kontributi i dhënë ndër vite nga ata është transmetuar sot edhe tek brezat e rinj, që evidentohet me pjesëmarrjen e tyre në Emergjencat Civile në ndihmë të komunitetit, stërvitjet e përbashkëta brenda dhe jashtë vendit.



# ANO, tre dekada rrugëtim profesional, arsimor, mision drejt karrierës ushtarake

**M**ë datë 05.11.1993, u hap Akademia e Nënoficerëve, misioni i së cilës ishte përgatitja e përqendruar e nënoficerëve të karrierës, duke rikthyer një traditë të përhershme dhe të konsoliduar.

Trajnimi i trupës së nënoficerëve e ka filluesën e saj në vitin 1919, ku u hap për herë të parë shkolla dhe kurset e nënoficerëve, të cilët vijuan deri në vitin 1939. Në vitet 1950-1965 u hapën kurse të ndryshme të shërbimit për nënoficerë në komandat përkatëse. Në vitin 2003, Qeveria Shqiptare i akordoi akademisë emrin e kolonelit holandez Ludowik Thomson, duke u quajtur Akademia e Nënoficerëve "Thomson", në vlerësim dhe në respekt të veprës së shquar për kontributin e dhënë në Shqipëri, për përmirësimin e trupës ushtarake gjatë viteve 1911-1915, ku dhe vdiq në vendin tonë në krye të detyrës.

Në historinë e FARSH-së, hallka, pozicioni, dhe roli i nënoficerit të karrierës në përgjithësi është vlerësuar, por në periudha të ndryshme kohore vlerësimi është i ndryshëm. Kështu, në vitet

1912-1914, 1920-1966 dhe 1994-2002 nënoficeri ka pasur një rol të rëndësishëm në strukturën organizative dhe ka gëzuar një rol të dorës së parë në stërvitjen, menaxhimin, dhe komandimin e nënrepartëve, e më rrallë të repartëve të shkallëve të vogla taktike.

Pas vitit 1945 dhe deri nga mesi i viteve '60, në ushtrinë shqiptare vazhdon të ruhej mendimi i mëparshëm që të ruhej i njëjti konceptim në lidhje me numrin, rëndësinë dhe rolin e nënoficerëve në jetën dhe përgatitjen e repartëve dhe nënrepartëve të saj. Me vlera ishte roli i tyre në stërvitjet e vogla. Por me heqjen e gradave nga viti '60 deri në vitin '90 numri i nënoficerëve ra ndjeshëm.

Pas viteve '60 nënoficerët merreshin në shërbim përmes një kontrate që nënshkruhej nga titullari i repartit përkatës dhe natyrisht pasi plotësonte disa kriterë që nuk kishte përfunduar më parë një shkollë për nënoficer.

Si domosdoshmëri e kohës doli themelimi dhe konsolidimi i

institucionit të përgatitjes së nënoficerit, dhe në nëntor 1993, me Urdhër të Ministrit të Mbrojtjes u krijua Akademia e Nënoficerëve.

#### **Shkollat e Nënoficerëve në Shqipëri nga viti 1912 – 2002**

Viti 1919 - Shkollat e xhandarmërisë dhe aspirantëve për nënoficerë.

Viti 1925 - Shkolla e Nënoficerëve në Durrës, kishte 1 kurs çdo vit, 6 muaj kursi.

Viti 1929 - Shkolla e Nënoficerëve për këmbësori, artileri, xhenio.

Viti 1931 - Shkolla e Perfeksionit të Nënoficerëve në Durrës. Merrte nënoficerë nga ushtria, pasi kishin kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak dhe i kualifikonte si nënoficerë karriere.

Viti 1950 - Shkolla e përgatitjes së nënoficerëve të Prapavijës, më pas u emërua Shkolla e Intendencës.

Në vitet '60, '70, '80 - U hapën shkolla të përkohshme për Artilerinë, Tanket dhe Xhenion në Elbasan. Më pas, shkolla të njëjta me kohë dhe programe të reduktuara për nënoficerë jo të karrierës, që përgatisnin nënoficerë jo me rrogë dhe që u ngritën pranë Korpuseve dhe Komandave të Forcës Detare, Mbrojtjes Kundërajrore, pranë Grupimit në Elbasan.

Më 8 Prill 1994 - Mbi bazën e Shkollës së Instruksionit në Zall Herr, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes më 5.11.1993, u hap Akademia e Nënoficerëve.

Misioni i Qendrës së Arsimit Profesional të Nënoficerëve (ANO) është: “Formimi, kualifikimi dhe përgatitja e nënoficerëve të të gjithë niveleve në FARSH dhe personelin e mesëm civil të administratës, ekuivalent të nënoficerëve, si dhe bashkëpunon me strukturat e FARSH-së për specializimin e nënoficerëve.

Përgjegjësitë dhe detyrat themelore të Qendrës së Arsimit Profesional të Nënoficerëve (ANO) janë: Zhvillimi dhe certifikimi i kurseve institucionale dhe funksionale, Hartimi i planeve dhe programeve mësimore. Testimi dhe përzgjedhja e kandidatëve për ndjekjen e kurseve sipas ligjeve në fuqi e kriterëve të miratuara nga instancat eprorë. Kualifikimin e personelit të mesëm civil të administratës në strukturat e FA. Testimin e përzgjedhjen e kandidatëve për instruktorë pranë

QAPN (ANO), Kryerjen e studimeve dhe dhënien e ekspertizës në fushën e zhvillimit të personelit nënoficer në FARSH; Testimin/Certifikimin e nënoficerëve që përfundojnë fazën e dytë të kursit bazë dhe kursit të Avancuar pranë të gjitha Qendrave Stërvitore në Komanda dhe Repartet e FA-së.

Bashkëpunimin me struktura të tjera në FA në interes të kualifikimit (specializimit) të personelit nënoficerë. Kurset mësimore organizohen dhe zhvillohen sipas kriterëve të përcaktuara në dokumentin “Politika e Arsimit dhe kualifikimit të ushtarakëve

të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për përparimin në gradë, miratuar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr.765 datë 08.06.2021.

QAPN trajtohet si strukturë vartëse e AFA-së, në përputhje me ligjet, urdhrat dhe udhëzimet përkatëse për arsimimin ushtarak, parimet themelore të punës në institucion, për mënyrën e organizimit dhe drejtimit, zbatimin e konceptit të arsimit ushtarak profesional për nënoficerët në FA-së dhe të punonjësve të mesëm (C2) civilë që kryejnë detyra funksione në radhët e FA-së. Procedurat dhe kriteret që do të zbatohen nga strukturat përgjegjëse për përzgjedhjen e

Ushtarit/Detarit të IV për ndjekjen e Kursit Fillestar të Nënoficerit. Sipas nenit 5, pika 5, të ligjit 59/2014, “nënoficer aktiv është ushtaraku i titulluar si i tillë me urdhër të SHSHP të FA-së”.

Rekrutimi i nënoficerëve bëhet nëpërmjet konkurrimit të brendshëm. Në konkurrim mund të marrin pjesë vetëm ushtarët/detarët IV që plotësojnë kriteret e përcaktuara. Struktura përgjegjëse për zhvillimin e testimit është AFA/Akademia e Nënoficerëve.

Aplikimi bëhet pranë komandave, ku ushtarët/detarët e IV kryejnë shërbimin, sipas formatit të kërkesës që tërheqin pranë zyrave të

personelit të Forcave. Konkurrimi nuk është i hapur ndaj publikut jashtë FA. Pozicionet organike në TOP janë të hapura si për meshkujt dhe femrat. Preferohen kandidatët që kanë arsim të lartë dhe njohuri në gjuhët e huaja.

#### **Kriteret e konkurrimit për të ndjekur kursin fillestar të nënoficerit**

Ushtari/Detari IV për të ndjekur Kursin Fillestar të Nënoficerit duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme: Në momentin e aplikimit, të ketë jo më pak se dy vjet si ushtar/detar i IV; Në momentin e aplikimit të mos jetë më shumë se 32 vjeç; Të jetë vlerësuar jo më pak se “mbi mesatar” në dy vlerësimet e fundit vjetore (vlerësimet i referohen vlerësimit të superiorit); Të ketë kryer arsimin parauniversitar; Të jetë vlerësuar kalues në testin e përgatitjes fizike; Të jetë i aftë nga ana shëndetësore; Të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 165 cm për meshkujt dhe 160 cm për femrat.

#### **Zhvillimi i konkurrimit përfshin**

Zhvillimi i konkurrimit: Testimin intelektual; Testimin fizik; Ekzaminimin mjekësor; Testimin e njohurive në njohjen e gjuhës angleze. Pranimi kryhet në bazë të Udhëzimit të MM Nr. Nr.03 datë 18.02.2016, “Për procedurat dhe kriteret për rekrutimin e nënoficerëve aktiv në FARSH”, pika 15 “Procedurat e titullimit “nënoficer aktiv” dhe gradimin “nëntetar”, germa b, “Në përfundim të kursit, Komandanti i QAPN-së, i përcjell SHSHP të FA-së, nëpërmjet Komandantit të AFA-së, propozimin për titullimin e kursantëve”.

**“ Trajnimi i trupës së nënoficerëve e ka fillesën e saj në vitin 1919, ku u hap për herë të parë shkolla dhe kurset e nënoficerëve, të cilët vijuan deri në vitin 1939. Në vitet 1950-1965 u hapën kurse të ndryshme të shërbimit për nënoficerë në komandat përkatëse.**



### **Kurset që zhvillohen pranë Qendrës së Arsimit Profesional të nënoficerëve janë:**

Kurset Institucionale; Kursi Fillestar i Nënoficerit, 5 javë në QAPN; Kursi Bazë i Nënoficerit, faza e parë 8 javë në QAPN dhe faza e dytë 8 javë pranë Qendrave Stërvitore në njësi e reparte; Kursi i Avancuar i Nënoficerit, faza e parë 8 javë në QAPN dhe faza e dytë 8 javë pranë Qendrave Stërvitore në njësi e reparte; Kursi i Lartë i Nënoficerit, 8 javë në QAPN; Kursi i Kryekapterit, 8 javë në QAPN.

### **Kurset Funksionale**

Kursi i Administratës së Mesme Civile, 2 javë në QAPN. Kursi i Instruktorit, 3 javë në QAPN. Hartimi i programeve mësimore në QAPN, është mbështetur kryesisht në dhënie e njohurive bazë kursantëve për të përvetësuar format dhe teknikat e drejtimit në nivele të ndryshme, duke filluar nga niveli i grupit, e deri në atë të togës. Gjithashtu kursantët marrin njohuritë e duhura për teknikat, format dhe metodat e punës në shtabet e njësive dhe reparteve.

Njëkohësisht prioritet iu jepet implementimit në programet mësimore edhe të STANAG-ve, të cilat kryesisht konsistojnë në: Rregullore, Ligjshmëri, Operacionet luftarake dhe humanitare dhe ato paqeruajtëse, barazinë gjinore, Plani Kombëtar i kërkim-shpëtimit etj. Nisur nga kurset sipas niveleve që zhvillohen në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerit si dhe eksperiencat që marrin gjatë kohës që ato ushtrojnë detyrën funksionale në reparte ku ato shërbejnë si dhe informacionit të marrë nga komandat, vërehet një ndryshim shumë pozitiv në ngritjen e aftësive të tyre profesionale.

Nënoficeri i njohur si "shtylla kurrizore e ushtrisë" është i përfshirë direkt në stërvitjen dhe trajnimin e trupave, ndaj arsimimi dhe

kualifikimi i tyre këto vitet e fundit ka dhënë një impakt shumë pozitiv në rritjen dhe performancës e Komandave/njësive, ku ato shërbejnë. Duke qenë se QAPN është i vetmi institucion arsimor për të gjithë korpusin e nënoficerëve në FA, çdo nënoficer, pas një periudhe 3-4 vjeçare, rikthehet përsëri pranë këtij institucioni për kryerjen e kurseve të radhës, për të marrë njohuri dhe dije të një niveli më lartë, e cila është një domosdoshmëri për ecurinë e tyre në grada dhe karrierë. Gjithashtu dera e QAPN-së (ANO) është e hapur për secilin prej tyre, që kërkon ekspertizë në një fushë të caktuar.

Nisur nga historiku i ekzistencës së këtij institucioni arsimor/profesional për nënoficerë ndër vite, QAPN (ANO) ka pësuar një ngritje dhe ndryshim rrënjësor pozitiv, qoftë në mënyrën e organizimit, përzgjedhjes së personelit Instruktor.

Vlen të theksohet se i gjithë procesi mësimor në QAPN zhvillohet nga vetë nënoficerët, çka tregon ngritjen e tyre nga ana profesionale.

Gjithashtu bashkëpunimi me vendet Aleate, konkretisht me Gardën Kombëtare të New Jersey-it, SHBA, ka dhënë një hop shumë cilësor në arsimimin dhe trajnimin e trupës së nënoficerëve, më e theksuar kjo në këto dy-tre vitet e fundit. Programi mësimor është i ndërtuar në mënyrë të tillë, ku përqindja e teorisë dhe asaj praktike t'i përgjigjet vetë nevojave që ka funksionet organike ku këto nënoficerë shërbejnë.

Konkretisht nëse do flasim për kursin fillestar dhe kursin bazë të nënoficerit, afërsisht 68% e këtij programi është trajnim/stërvitje (Praktikë) dhe 32% e zë pjesa teorike. Për kursin e Avancuar 58.3% është trajnim/stërvitje (Praktikë) dhe 41.7% pjesa teorike. Kursi i Lartë i Nënoficerit 64.2% Teori dhe 35.8% Praktikë. Kursi i Kryekapterit, 80.08% Teori dhe 19.2% praktikë.

# FORCAT SPECIALE, heronjtë e heshtur të Forcave të Armatosura

**B**atalioni i Forcave Speciale është krijuar me Vendim të Këshillit të Mbrojtjes nr.2, datë 16 tetor 1998. Qëllimi kryesor i krijimit të kësaj njësie ishte që të krijohet një forcë elitë e kombit që të përballonte turbulencat politike, ekonomike e ushtarake që po kalonte vendi pas viteve '90, siç ishte rasti i pa precedentë i sulmit të organizuar ndaj repartit të Peshkëpisë, ku humbën jetën disa ushtarakë, apo ngjarjet e 97-ës, të cilat destabilizuan vendin. Kjo njësi u krijua pikërisht me qëllimin e vetëm të kalonte vijën e operacioneve klasike konvencionale, duke patur në gjirin e saj operatorë specialë, të aftë të vepronin me grupe të vogla në fshehtësi të plotë, por me efekt të madh për interesat e vendit. Kjo njësi do të operonte brenda dhe jashtë vendit në luftën kundër terrorizmit dhe formave të tjera të kërcënimeve, kur lypset nevoja dhe të përdorej si aset i rëndësishëm i FA-ve për të kryer detyra direkte, zbulim special apo asistencë ushtarake gjë që forcat e tjera konvencionale nuk i përmbushnin dot. Vendi i dislokimit të forcave speciale fillimisht ishte në rajonin e Farkës dhe momentalisht ndodhet i dislokuar në Zall-Herr, Tiranë.

## Aktiviteti i Forcave Speciale

Aktivitetin reparti e ka filluar, më datë 24.02.1999, dhe ishte i përbërë



nga Shtabi dhe 4 grupe speciale. Komandanti i parë i Batalionit Special ka qenë Kolonel Hysen Ymeri, një nga zbuluesit më të mirë të ushtrisë, i cili ka dhënë një kontribut mjaft të çmuar në ngritjen dhe zhvillimin e kësaj njësie.

Krijimi i forcave speciale u konsiderua i një rëndësie të veçantë, sepse për herë të parë Forcat tona të Armatosura kishin në gjirin e vet një njësi elitë e aftë të vepronte në tre dimensionet tokë-ajër-det për t'i paraprirë çdo lloj forme kërcënimi apo rreziku me një shpejtësi dhe aftësi të jashtëzakonshme.

## Forcat Speciale dhe rëndësia e tyre

Rreziqet kombëtare po afirmohen gjithnjë e më shumë si modele asimetrike e hibride dhe përballja ndaj tyre kërkon metoda të veçanta që kalon përtej koncepteve konvencionale. Të gjitha këto ndryshime në qasjen me sigurinë dhe format hibride që po përdorin vende si Rusia, kryesisht ndaj vendeve Baltike dhe Ballkanit perëndimor, na dikton nevojën për të patur forca speciale të afta të përgjigjen në çdo kohë këtyre ndryshimeve. Mjedisi i sotëm strategjik karakterizohet, si kurrë ndonjëherë më parë, nga e panjohura dhe nga e pa parashikuara. Skena e sigurisë botërore influencohet, përditë e më tepër nga shtete autokrate dhe organizata terroriste, të cilat po arrijnë të krijojnë rreziqe e kërcënime për sigurinë e përgjithshme mbarë botërore. Konflikti i fundit mes Izraelit dhe organizatës terroriste të Hamas apo ai Rusi-Ukrainë, kanë nxjerrë në pah domosdoshmërinë e zhvillimit dhe integritit të forcave speciale në këtë mjedis, duke përqaftuar metodat, konceptet dhe teknologjitë e fundit të përdorura në këto luftime.

## Si është i organizuar ky batalion?

Forcat Speciale, sipas doktrinës së NATO-s, SOF dhe kushteve e kërcënimeve në mjedisin e sigurisë rajonal e global, konsiderohen asete strategjike të një vendi. Ato janë njësi të specializuara, të mirë organizuara, të mirë trajnuara dhe të kompletuara me personel të përzgjedhur në bazë të një trajnimit të gjatë taktiko-psikologjik dhe të aftë për t'u përshtatur me metodat jo-konvencionale në qasjen me objektivin. Këto operacione mund të kryhen në një spektër të plotë në një mjedis të përbashkët operacional, të pavarura ose me forcat konvencionale, për të ndihmuar të arrijë gjendjen e dëshiruar.

Batalioni special është i organizuar e strukturuar në bazë të reformimit të fundit të gjithë FA-së dhe është pjesë e Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS), duke patur në organikë kompani të operacioneve speciale me drejtim tokë-ajër-det, e aftë të planëzojë e zhvillojë operacione speciale me spektër të plotë në një mjedis të përbashkët operacional. Batalioni special zotëron aftësi dhe kapacitetet e nevojshme të përmbushë me sukses tre detyra bazë

që janë aksionet Direkt (AD), Asistencë ushtarake (AU) dhe Zbulim Special (ZS).

Batalioni Special zotëron teknologjinë e fundit të pajisjeve dhe modernizimit si mjete të shikimit natën, shënjestër lazer për armët, kamera termale dhe mjete motorike ujore të gjeneratës së fundit që mundësojnë këtë njësi të përbushë të gjitha detyrat specifike që i ngarkohen.

Batalioni special është njësi unike në llojin e vet pasi operon në tre drejtimet si tok-ajër-det, në një konceptim krejtësisht ndryshe nga kapacitete konvencionale. Kjo nënkupton që batalioni special duhet të balancojë dhe modernizojë të gjitha këto kapacitete në të tre drejtimet. Por mbetet sfida akoma për t'u zhvilluar kapaciteti ajror pasi në konceptet dhe doktrinat e NATO-s, SOF, çdo njësi e forcave special duhet të zotërojë asetet e veta ajrore të dedikuara për operacionet speciale. Kjo njësi aktualisht nuk i ka në dispozicion kapacitetet ajrore, por ka planifikuar t'i ketë në të ardhmen e afërt këto kapacitete. Por, gjithsesi ky kapacitet mund të ofrohet edhe nga vendet aleate nëse e kërkon nevoja për t'u dislokuar në komandat e SOCC të operacioneve speciale. Gjithashtu në rekomandimet e komandës së SOFCOM në NATO SHAPE apo në doktrinat bazë të SOF si AJP3.5, forcat speciale duhet të kenë komandim-kontroll të shkurtër dhe të qartë në mënyrë që të sigurohet pavarësia dhe të mos dekonspirohet operacioni. Pra rekomandohet që varësia e Forcave Speciale të jetë direkt nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm. Misionet e forcave speciale ndryshojnë nga ato klasike konvencionale nga metoda e qasjes me objektivin. Në mjedisin e sotëm të sigurisë po gjenerohen gjithnjë e më shumë metoda asimetrike të luftës dhe kjo situatë kërkon medoemos përdorimin e forcave speciale pasi misionet klasike konvencionale nuk mund të jenë efektive në këtë mjedis. Misionet e forcave speciale janë më pak të kushtueshme, pasi vetëm një grup i vogël operatorësh mund të kryejnë detyra me efekt operacionalo-strategjik për vendin.

Konsideratat politiko-ushtarake mund të kërkojnë operacione klandestinë ose teknikat e fshehta dhe pranimin e një shkalle të lartë rreziku politik apo ushtarak që nuk mund të realizohet me operacione nga forcat konvencionale.

#### **Pse operacionet speciale janë unike?**

Operacionet speciale janë unike, sepse ofrojnë zgjidhje strategjike të problemeve ose i shërbejnë nivelit operacional dhe plotësimit të objektivave politike.

#### **Disa karakteristikë të forcave speciale**

- Forcat speciale janë, nga natyra, bashkëpunuese dhe të gjithanshme. Forcat speciale FS janë organizuar në mënyrë të tillë që të bashkëpunojnë me forcat ajrore, forcat detare dhe tokësore nga vendet kontribuuese të trupave (TCNs), që përbëjnë një direktivë speciale të veçantë për misionin komandën e komponentëve të operacioneve (SOCC), me një staf të përbashkët për të planifikuar dhe drejtuar operacione speciale.
- Forcat speciale të NATO-s konsiderohen asete strategjike për t'u përdorur dhe menaxhuar për arritjen e objektivave strategjike dhe në disa raste të zhvillojnë detyra në nivel operativ. FS janë të organizuar përmes një SOCC, që së bashku me komandat e komponentëve të forcave tokësore, ajrore dhe detare qëndron në gatishmëri për misione të ardhshme.

#### **Karakteristikat dhe cilësitë e forcave ushtarake**

Forcat speciale janë bashkëpunuese dhe të gjithanshme. Forcat

speciale janë organizuar në mënyrë të tillë që të bashkëpunojnë me forcat ajrore, forcat detare dhe tokësore nga vendet kontribuuese të trupave (TCNs), që përbëjnë një direktivë speciale të veçantë për misionin, komandën e komponentëve të operacioneve (SOCC), me një staf të përbashkët për të planifikuar dhe drejtuar operacione speciale.

Forcat speciale të NATO-s konsiderohen asete strategjike për t'u përdorur dhe menaxhuar për arritjen e objektivave strategjike dhe në disa raste të zhvillojnë detyra në nivel operativ. FS janë të organizuar përmes një SOCC që së bashku me komandat e komponentëve të forcave tokësore, ajrore dhe detare qëndron në gatishmëri për misione të ardhshme. Operacionet speciale zhvillohen në një zonë të përbashkët operacionesh (JOA) me forcat e tjera ajrore, tokësore dhe detare. Në këtë kontekst një komandanti të nivelit operativ i krijohet efekt i madh sinergjik me unitetin e komandës, integrim në nivel operacional të forcave dhe të sigurojë mbështetje për forcat e tjera të NATO-s.

Operacionet speciale zakonisht kryhen me risk të lartë pasigurie në mjedis krejtësisht armiqësor dhe me sensibilitet të lartë politik, duke krijuar efekte që mbështesin arritjen e objektivat gjithëpërfshirëse strategjike-operacionale. Këto



operacione zhvillohen duke përdorur aftësitë dhe teknikat të fshehta infiltruese dhe kërkojnë pjekuri dhe trajnim maksimal për shkak se dështimi ka efekte politike. Operacione speciale mund të zhvillohen në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me forcat konvencionale dhe mund të përfshijnë bashkëpunim dhe planëzim të përbashkët ndërinstucional si me forcat tona po ashtu edhe forcave indigjene ose ato rezervë.

#### **Ndryshimi i misioneve konvencionale nga ato speciale**

Operacionet speciale ndryshojnë nga operacionet konvencionale për vetë shkallën e rrezikut politik, teknikat operacionale, mënyrat si bëhet qasja me objektivin, varësia nga intelijenca e detajuar operacionale dhe përdorimi i faktorëve indigjenë. Operacionet speciale janë unike në llojin e vet, sepse varen shumë nga cilësitë aftësitë taktike-fizike

e psikologjike të operatorëve specialë që mund të krijojnë kushte shumë të favorshme për faktorin konvencional në një komandë të bashkuar operacionale. Operacionet speciale zhvillohen në thellësi të prapavijës së kundërshtarit dhe veprojnë në fshehtësi të plotë, duke i shkaktuar dëme psikologjike atij.

#### **Parimet e operacioneve speciale**

Tempo e lartë operacionale, ku shpejtësia dhe objektivi janë të lidhura pazgjidhshmërisht, pasi mund të gjendesh nën presionin e kohës për neutralizimin apo eliminimin e objektivit të kërkuar. Forcat speciale duhen integruar që në gjenezën e një konflikti, pasi janë të afta të ndihmojnë leadershipin ushtarak me këshilla operacionale e strategjike për të analizuar faktorët politik, ekonomik e ushtarakë që ndikojnë në një konflikt.

- Operacionet speciale zakonisht merren me forcën e rëndësës së kundërshtarit dhe si objektiva mund të jenë VIP-a civilë ose ushtarakë. Operacionet speciale udhëhiqen nga parimet si fleksibilitet, zhdërvjelltësi dhe përshtatshmëri në mjedisin operacional.
- Operacionet speciale zakonisht kryhen me risk të lartë pasigurie në mjedis krejtësisht armiqësor dhe sensibilitet të lartë politik, duke krijuar efekte që mbështesin arritjen e objektivat gjithëpërfshirëse strategjike-operacionale. Këto operacione zhvillohen duke përdorur



aftësitë dhe teknikat të fshehta infiltruese dhe kërkojnë pjekuri dhe trajnim maksimal për shkak se dështimi ka efekte politike.

- Operacionet speciale mund të zhvillohen në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me forcat konvencionale, të cilat përfshijnë bashkëpunim dhe planëzim ndërinstitutional, si me forcat tona po ashtu edhe forcave indigjene ose ato rezervë.
- Operacionet speciale ndryshojnë nga operacionet konvencionale për vetë shkallën e rrezikut politik, teknikat operacionale, mënyrat si bëhet qasja me objektivin, varësia nga inteligjenca e detajuar operacionale dhe përdorimi i faktorëve indigjene.
- Operacionet speciale janë unike në llojin e vet sepse varen shumë nga cilësitë aftësitë taktike-fizike e psikologjike të operatorëve specialë që mund të krijojnë kushte shumë të favorshme për faktorin

konvencional në një komandë të bashkuar operacionale.

- Operacionet speciale zhvillohen në thellësi të prapavijës së kundërshtarit dhe veprojnë në fshehtësi të plotë, duke i shkaktuar dëme psikologjike atij.

#### **Disa prej operacioneve, ku Forcat Speciale të ushtrisë shqiptare kanë qenë të pranishme**

Që nga krijimi i tij, ka marrë pjesë në shumë operacione dhe misione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Operacionet e para kanë filluar gjatë konfliktit të Kosovës në vitin 1999. Gjatë kësaj kohe prej gjashtë muajsh grupet speciale të Batalionit Special kanë marrë pjesë aktive në monitorimin e kufirit. Në vitin 2001-2002 grupet Speciale të b.FS morën pjesë në bashkëveprim me forcat e policisë së Shtetit për vendosjen e Rendit Kushtetues dhe qetësisë publike në rrethin e Tropojës, duke kryer shumë shërbime Speciale.

Në vitin 2001 në kohën e konfliktit me armë kundër shqiptarëve të Maqedonisë, katër grupe speciale kanë marrë pjesë në monitorimin e kufirit shtetëror në Republikën e Maqedonisë, si dhe kanë kryer detyra të ndryshme zbulimi .

Në vitin 2003-2004 Batalioni i Forcave Speciale ka marrë pjesë në shumë misione, ku detyrat kryesore kanë qenë monitorimi i gjithë vijës bregdetare, lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore, drogës, armëve në bashkëveprim me forcat e anti-terrorit të Ministrisë së Brendshme, duke bërë të mundur realizimin me sukses të plotë të gjitha misioneve të ngarkuara. Por Forcat speciale kanë zhvilluar disa misione jashtë vendit, si në Irak, Afganistan, Kosovë konkretisht: Në gusht të vitit 2002, deri në shtator të vitit 2004, batalioni i Forcave Speciale ka marrë pjesë në 4 misione paqeruajtëse në Kabul të Afganistanit nën komandën e ISAF.

Nga viti 2005 deri në vitin 2008, batalioni i Forcave Speciale ka marrë pjesë me dy grupe speciale në operacionin “Liria e Irakut”, Mosul, Irak.

Misionet e forcave speciale arritën kulmin e tyre me pjesëmarrjen në misionet luftarake “Eagle” nga viti 2010 deri në vitin 2014, duke zhvilluar gjithsej 8 misione luftarake.

#### **Misioni i Forcave Speciale në mbrojtje të jetës patjetër ka dhe ‘koston’ e vet**

Me të gjitha angazhimet e suksesshme në misionet luftarake apo në ato të paqes, Batalioni Special ka patur edhe humbje jete, ku vlen të përmendet heroizmi i Kapiten Feti Voglit, i cili sakrifikoi gjithçka për paqen e sigurinë në botë. Vepra dhe lavdia e tij janë tashmë pjesë e pandarë e aktivitetit tonë të përditshëm si brenda dhe jashtë vendit, duke na shërbyer si frymëzim e krenari për të vijuar plotësimin e ëndrrës së tij për të patur sa më shumë paqe e harmoni në botë.

Forcat speciale sot kanë një vizion të qartë për zhvillimin e rezistencës dhe qëndrueshmërisë kombëtare, duke qenë pararojë e ndryshimeve në mjedisin e sigurisë. Sulmet hibride me strategjitë e fshehura, miksimi i taktikave konvencionale me ato jo-konvencionale, sulmet kibernetike, dezinformimi, lufta psikologjike, na bënë të vetëdijshëm mbi rolin e Forcave Speciale në ngritjen e strategjive të rezistencës kombëtare, shumëzimin e forcave, forcimin e partneritetit publik-privat, komunikimin strategjik dhe qasjen gjithëpërfshirëse me të gjithë aktorët shtetërorë dhe jo-shtetërorë.

Jemi të bindur dhe të përgatitur për të përmbushur të gjitha detyrimet tona në kuadër të mbrojtjes së vlerave të padiskutueshme të aleancës sonë NATO, duke u përballur direkt me sfidat dhe kërcënimet asimetrike për të siguruar lirinë e prosperitetin e popujve tanë.

# Artileria Shqiptare, sfida mes dy luftërash

**Italian Cannone 75/27 Mod. 11,  
at the Museo Civico Forze Armate  
1914-1945 in Montecchio Maggiore,  
Italy.**

[illegible]

(Top italian Mod. 75/27, 11, në Muzeun Civil të Forcave të Armatosura 1914-1945, në Montecchio Maggiore, Itali.)

# TANKU

**Tanku kinez Tip 62 (62式;), peshonte 21 tonë (peshonte afërsisht sa gjysma e tankeve të tjerë që kishim ne) dhe kishte një top kalibër 85 mm. Nga ky tip ne kishim më pak se 20 copë dhe përdorej kryesisht nga Garda. Foto është e vitit 1972, nga filmi “Kapedani”.**



**Mitraloz i rëndë  
“Guryanov”  
7,62 mm (MRG),  
Shqipëri 1973**





**Obuz "Skoda" 100 mm (Skoda Houfnice vz 14)  
Në anën tjetër, nga e majta: Obuz 10.5 cm  
leFH18/40 dhe Obuz 10.5 cm leFH 18**



**Mitraloz i rëndë "Guryanov" 7,62 mm (MRG),  
Shqipëri 1973**



**ABD: Top stacionar 130 mm B-13  
Kishim dy bateri në dy skajet e Gjirit të Durrësit: te  
Currilat dhe në Kalanë e Turrës**



**1 shtator 1939, nisi Lufta e Dytë Botërore.  
Tanku "Fiat - Ansaldo L6/40"**

# ARMA E KIMIISË, shërbimi elitari i FA-së

**S**hërbimi Kimik i Ushtrisë gjatë gjithë kohës ka qenë shërbim elitë që përgjigjej para këshillit të Mbrojtjes për vetë natyrën dhe rëndësinë e veçantë të detyrave që ai zgjidhte për Mbrojtjen e Forcave të Armatosura të popullit e të ekonomisë. Periudha 70-vjeçare e këtij shërbimi ka qenë një periudhë e gjatë pune vetëmohuese e përkushtimi nga qindra kuadro e mijëra ushtarë që kanë shërbyer në këtë armë, që me punën dhe sakrificat e tyre e çuan këtë shërbim në nivelet më të larta të mundshme; shërbim sa i vështirë aq dhe i nevojshëm, si për kohë lufte dhe për kohë paqeje, shërbim human që mbron dhe shpëton jetë njerëzish në çdo situatë. Kjo ka qenë dhe do të mbetet përherë detyra e mbrojtjes kundërkimike.

Nënreparti i parë i shërbimit të Mbrojtjes Kundërkimike, u krijua më 23 nëntor të vitit 1953. Komandanti i Nënrepartit të parë të Shërbimit Kimik (kështu quhej struktura e parë e krijuar) u emërua Shyqyri Kondi. Po në këtë kohë me urdhër të Këshillit të Mbrojtjes u krijua edhe Dega e Mbrojtjes Kundërkimike pranë Shtabit të Përgjithshëm.

Kuadrot e parë ishin ata të dalë nga lufta antifashiste dhe të përgatitur me kurse dhe kryesisht në shkollat ushtarake të ish-Bashkimit Sovjetik dhe më vonë në Akademinë tonë të Mbrojtjes, si Shyqyri Kondi, Kristaq Haxhimiali, Thodhori Gjoni, Hamit Murga, Uran Puto, Abdyl Dobi, Esat Xhepa Guri Shyti, Lame Prifti,

Qëndro Laba, Enver Lagji, Hysen Murtati, Sami Meçollari, Hysen Kola, Kristaq Mici, Pirro Begvarfi, Zija Liçi, Servet Muka e shumë e shumë të tjerë që dolën më vonë nga Shkolla e Lartë e Bashkuar e Oficerëve.

Në vitin 1954 pranë Shkollës së Bashkuar të oficerëve u hap edhe Kursi i Kimisë, që filloi të përgatiste kuadrot e para të vendit, të cilët me ndjenjë të lartë dhe përkushtim rritën nivelin teknik dhe gatishmërinë luftarake të reparteve dhe njësive të Ushtrisë.

Gradualisht, me rritjen e modernizimit të ushtrisë u shtua dhe u modernizua edhe shërbimi kimik, që ndonjëherë edhe e quanim Arma e Kimisë, dhe kjo për përmasat dhe rëndësinë që mori. Kështu në vitin 1961, kompania e kimisë u kompletua me teknikën e armatimit kimik, me teknikë zbulimi dhe përpunimi. Rëndësi e veçantë fillimisht, i kushtohej përvetësimit të teknikës dhe kompletimit të ushtrisë me mjetet e mbrojtjes kundërkimike.

Në vitin 1964, pranë Akademisë së Shtabit të Përgjithshëm u hap dega e Mbrojtjes Kundërkimike, me shef katedre N/kolonel Kristaq Haxhimihalin, prej ku filluan të dalin kuadrot e lartë ushtarak.

Në vitin 1967, me vendim të Këshillit të Mbrojtjes u krijuan tre batalione, dy të mbrojtjes kundërkimike, njëri në Tiranë me komandant Koço Stojkun dhe tjetri në Berat me komandant Refat Shehatin, kurse batalioni i tretë ishte ai flakëdhës në Tiranë me komandant Ahmet Mehmetin, që të tre Rezervë të Shtabit të



Përgjithshëm. Po në këtë kohë pranë shtabeve të divizioneve u krijuan kompanitë e mbrojtjes kundërkimike dhe ato flakëdhënëse, të cilat me kalimin e Ushtrisë në sistemin me Korpuse, kaluan në batalione kimie dhe flakëdhënëse, të kompletuara me teknike dhe armatim të plotë kimik. Po kështu, pranë korpuseve u krijuan edhe laboratorët e kimisë të korpuseve me shefa laboratorësh inxhinierë kimistë, që kishin në vartësi edhe oficinat e riparimit të teknikës dhe armatimit kimik të korpusit dhe, që kanë bërë një punë të lavdërueshme për rritjen cilësore teknike të këtij shërbimi.

Më 1969, pranë reparteve të kimisë në Brar, u krijua Shkolla e Përgatitjes së Kuadrove Oficer Rezervist, me komandant Muharrem Durmishin.

Zhvillimi i vullshëm i shërbimit kimik bëri që edhe drejtimi të kalonte nga degë në Drejtori të Mbrojtjes kundërkimike. Në këtë kohë, kur drejtues të saj ishin Enver Lagji dhe Muharrem Durmishi, u bë një punë shumë e madhe në drejtim të studimit dhe prodhimit në vend të mjeteve të mbrojtjes kundërkimike dhe të likuidimit të pasojave të ndotjeve. Është, pikërisht, kjo kohë kur u krijuan shumë grupe pune studimore me specialistë më të mirë, të cilët e kurorëzuan me sukses krijimin e uzinës së kimisë, që prodhoi kundërgazin shqiptar me parametra të matshëm me bashkëkohorët, u prodhua paketa individuale kundërkimike, kompletet e degazimit e përpunimit, kostumet mbrojtëse e kompleti mbrojtës Nr.1 e shumë të tjera.

Pranë ambienteve të kompanisë së kimisë, më 1 gusht 1965, u hap Laboratori Qendror i kimisë në FA, me kimistin e talentuar Kudret Meta dhe dy laborantë. Hapja e këtij Laboratori kishte si qëllim përgatitjen teknike të kuadrove të mesëm dhe të lartë të kimisë, kryesisht si një bërthamë studimore për aplikimin në ushtri të të rejave shkencore lidhur me ADM (Armët e Dëmtimit në Masë) dhe mbrojtjen prej tyre, sidomos në drejtim të armës së kimisë dhe mjeteve djegëse, për t'iu përgjigjur situatave të mundshme kimike, që mund të krijoheshin, duke e përqendruar vëmendjen fillestare në këto probleme: gjetja dhe aplikimi i metodave të analizave të lëndëve helmuese luftarake; kryerja e analizave të lëndëve që ndotëse, që mbahen në ruajtje; aplikimi i metodikave për përgatitjen dhe përdorimin e mjeteve që ndotëse; studimi i aftësisë mbrojtëse të mjeteve të mbrojtjes kundërkimike; përgatitja e përzierjeve djegëse për flakëdhënësit.

Jo vetëm kaq, por prodhoi dhe furnizoi edhe industrinë me gypa indikator për gazrat e dëmshëm industrialë, hoqi nga importi shumë kimikate dhe lëndë të tjera të domosdoshme për prodhimin e këtyre gypave.

Që nga viti 2007, me mbështetjen e qeverisë Amerikane dhe nën monitorimin e plotë të OPCW (Organizata për ndalimin e armëve kimike) u bë asgjësimi i plotë i të gjithë sasisë së LHL (Agjent kimik) që ka disponuar Shqipëria.

#### **LHL (Agjentët kimikë) + Mjetet e përdorimit = Arma kimisë**

Ushtria jonë ka patur në dispozicion vetëm një nga dy komponentët që përbëjnë armën e kimisë LHL dhe nuk ka disponuar asnjëherë mjete të përdorimit të tyre.

Shqipëria, deri në vitin 2007, ka trashëguar nga sistemi i kaluar komunist rreth 16 ton iprit mësimor, sasi të vogla të klorpikrinës – LHL ngacmuese – asfiktike, që është përdorur vetëm në Luftën e Parë Botërore për qëllime luftarake. Po ashtu, kemi patur sasi të vogla (jo me ton dhe kuintal, por me kg- iprit luftarak, luizit dhe sarin, që janë përdorur për studime shkencore. Vonë janë sjellë sasi

të vogla kloracetofeni.

Laboratori Kimik, në vitin 1969, arriti që me këmbëngulje të sintetizonte (prodhonte) pothuajse të gjitha llojet e LHL që njiheshin përfshi sarinë në sasi shumë të vogla dhe kjo është bërë për të patur mundësi të studioheshin e prodhoheshin mjetet e zbulimit të tyre kimik të mbrojtjes prej tyre dhe të mos ndotjes së tyre.

Laboratori prodhoi të gjithë gypat indikator të lëndëve helmuese. Sasitë e saj kanë qenë tepër të vogla dhe nuk është përdorur asnjëherë për qëllime luftarake, manovra apo stërvitje.

Kur përmendet kjo armë, në kujtesë të vjen menjëherë kundërgazi. Te ne, fillimisht erdhën modele sovjetikë dhe kinezë, por më pas u arrit të prodhohet në vend nga Ndërmarrja e Prodhimeve Kimike të Ushtrisë në Tiranë. Kundërgazi eksperimental u prodhua në vitin 1971, ndërsa në vitet 80-të, kur punohej me ritëm të plotë për të kompletuar të gjitha nevojat e ushtrisë, sasia vjetore arriti në 100000 komplete në vit.

Maska dhe gypi i kundërgazit prodhoheshin nga Ndërmarrja Gomë-Plastikë Durrës. Ndërmarrja Kimike u nda me administratë më vete dhe u quajt "Rep.Ush.1190". Aty nisën të prodhoheshin karboni aktiv dhe katalitik për mbushjen e kundërgazeve, kutitë tymuese



individuale dhe të tankeve (ku ngjeshja e kallëpit me lëndën përbërëse kryhej me një presë me friksion 120 tonë, të realizuar nga Kombinati Metalurgjik Elbasan), si dhe produkte të tjera për stërvitje. Karboni aktiv dhe katalitik prodhohej nga bërstitë e farave të ullirit. Përveç kundërgazit individual, ishin dhe filtrat e mbrojtjes kolektive, të cilët montoheshin në strehime apo objekte të tjera. Përveç këtyre, ishin dhe filtrat 50 dhe 100 m3/orë. Filtrat kanë të njëjtin konstruksion si të kundërgazit individual, pra një element filtrues prej letre të valëzuar dhe një element filtrues prej karboni katalitik. Parafiltri, siç e thotë dhe emri, është i përbërë vetëm nga element filtrues prej letre me strukturë speciale. Për këto filtra u kryen studime për t'i prodhuar në vend dhe u arrit deri te prodhimi eksperimental i prototipave. Tepër i vështirë ishte realizimi në rrugë industriale i letrës së valëzuar (si fizarmonikë). Te parafiltri, kishte përmasat e një fizarmonike të vogël. Problem i kushtueshëm ishte dhe mbyllja e kapakut në po atë mënyrë siç mbyllen dhe kutitë e konservave. Te kundërgazi individual, këto probleme ishin zgjidhur, sepse kishte përmasa të vogla.

Gati një industri e tërë e realizuar me mjeshtëri nga ushtarakët tanë.

# 75 vite art, botime, shtyp periodik

## Rrugëtimi në dekada i QKMBMMFA

**S**htëpia e Ushtarakëve është e lidhur ngushtësisht me ndryshimet dhe zhvillimin e Forcave të Armatosura. Ajo nisi rrugëtimin e saj në një ndërtesë krejt të veçantë në Rrugën e Kavajës, e projektuar dhe e zbatuar nga inxhinieri i Armës së Xhenios të Ushtrisë Mbretërore Shqiptare, major Dhimitër Dhespoti.

Shefi i parë i “Shtëpisë së Oficerëve ishte kapiteni i Klasit I, Fehmi Poshi, oficer intendence i Komandës së Mbrojtjes Kombëtare.

Pas lirimit në të njëjtën ndërtesë, më 14 nëntor 1947, u përrua “Shtëpia Qendrore e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare”. Ajo, së

bashku me hotel “Internacional”, që shërbente për ngrënien e fjetjen e oficerëve beqarë, lulishten në qendër dhe me sallën 300 vendesh e kinoteatrit dhe më pas “Estradës së Ushtarit” (1952), përbënin një kompleks të plotë shërbimesh për kohën, për të gjithë ushtarakët e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare.

Pararendës i strukturës së “Shtëpisë Qendrore” ishte seksioni i Artit, në të cilin bënte pjesë Kori i Ushtrisë, Banda Frymore dhe Teatri, të cilët kishin kohë që kishin filluar aktivitetin e tyre artistik, e më pas seksioni për “Shkollat dhe arsimimin”, seksioni i “Prapavijës”, Klubi Sportiv “Partizani” dhe Laboratori Fotografik.





Kjo organikë e miratuar përbëhej nga rreth 130 veta, numër ky që herë-herë rritej, sepse në korin e ushtrisë përfshiheshin edhe ushtarë të shërbimit të detyrueshëm ushtarak.

Pjesë e misionit të këtij institucioni, për gati një dekadë rresht, krahas gjallërimit të jetës artistike në Ushtrinë Shqiptare nga grupet artistike, ishte edhe dhënia e ndihmës së domosdoshme, të kualifikuar e konkrete nga të gjithë sektorët kundër analfabetizmit, që gati mbretëronte në radhët e Ushtrisë Shqiptare, si dhe arsimimi, kulturimi e mësimi i gjuhëve të huaja nga ana e oficerëve të sapo dalë nga lufta.

I vetmi grup artistik i këtyre viteve, “Kori i Ushtrisë”, jepte koncerte e shfaqje jo vetëm në “Shtëpinë e Oficerëve”, por edhe kinematë qytetëse “Kosova” e “Nacional”, duke plotësuar kërkesat e shumta nga i gjithë populli i Tiranës, për të arritur në koncertin kulmues me këngë partizane, patriotike e popullore dhe në fund me “Castadivën” e kënduar nga Tefta Tashko Koço.

Turnetë artistike vijuan edhe në aksionet e rinisë, në rrugën Kukës-Peshkopi, hekurudhën Durrës-Tiranë, në kantierin e tharjes së kënetës në Maliq, në kanalin “Naum Panxhi”, por edhe në qytetin e Ohrit e më pas në atë të Shkupit, për shqiptarët me banim në këto qytete së bashku me Grupin e Valleve (’47).

Banda e Ushtrisë, përveç se ishte një aset i çmuar, në krijimtarinë dhe ekzekutimin e muzikës shqiptare, ishte prezente në koncertet e saj, në ceremoni e manifestime të panumërta, në përkujtimin e ngjarjeve historike kryesore, në parada apo edhe në pritjet protokollare të Shtetit Shqiptar. Kjo trupë artistike profesioniste u kthye në furnizuese e të gjitha institucioneve të tjera artistike shtetërore.

Klubi Sportiv “Partizani”, pjesë e “Shtëpisë Qendrore të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare” dha një ndihmesë të rëndësishme në organizimin dhe zhvillimin e lëvizjes fizikulturore e sportive në Garnizonin e Tiranës dhe në reparte të tjera të Ushtrisë Shqiptare. Laboratori Fotografik, si pjesë e propagandës figurative me vlera dokumentare artistike dhe edukuese për ushtrinë, filloi menjëherë aktivitetin me pasion e këmbëngulje, duke grumbulluar negativët e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe të jetës partizane, duke hedhur themelet e fondit arkivor.

Në dhjetor të vitit 1949, “Shtëpia Qendrore e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare” përbëhej nga Ansambli i Këngëve dhe i Valles, Kori e Grupi i valleve; Seksioni i muzikës, Banda e Orkestra Simfonike; Teatri, Kinemaja, Seksioni i Arsimimit, Biblioteka, Seksioni i Fizikultures, skuadra e futbollit, basketbollit, voleybollit, atletikës së lehtë dhe të rëndë, shahu, noti e motoçiklizmi; Seksioni i shërbimeve, e në përmbyllje e plotësonte ai i ushqimit social, pra Bufeja, e cila nga viti 1968, nuk u bë pjesë e kësaj strukture. E gjithë kjo strukturë përbëhej nga një efektiv prej 253 vetash, të cilët 13 ishin oficerë dhe 240 nëpunës civilë.

Tërësia e trupave, artistike, sportive, qendrat lëvizëse të agjitacionit në reparte e njësitë, por edhe në stërvitjet e mëdha me trupa për kohën, shtypi, shfaqjet e filmave kinematografikë, propaganda figurative dhe botimet albumeve e fletëpalosjeve, të përgatitura nga “Shtëpia Qendrore e Ushtrisë Popullore” (SHQUP), luajtën rol të rëndësishëm në edukimin ideo-artistik e sportiv, jo vetëm për repartet e garnizonit të Tiranës, të Ushtrisë Shqiptare, por edhe në skenat e ambientet, ku qytetarë të shumtë ndiqnin aktivitetet, në





kushtet e realitetit shqiptar të kohës.

Nga kjo punë me strukturë komplekse, për nga funksionet që kryente, e organizuar dhe intensive në radhët e të rinjve, që kryenin e përfundonin shërbimet ushtarake, dolën mjaft artistë, këngëtarë, kompozitorë të shquar dhe sportistë të talentuar, në sferat e ndryshme të jetës e të mjeshtërisë fizikulturore e sportive. Në vitet '50-'60 të shek. XX, pati ndryshime të ndjeshme në organikat e SHQUP-it, në vitin 1958 u suprimua Teatri i Ushtrisë e një vit më pas, Klubi Sportiv "Partizani", Ansambli i Ushtrisë dhe Banda e Ushtrisë u shkëputën nga ky institucion, për t'u rikthyer përsëri, këto dy të fundit në vitin 1966.

Në vitet 1962-1964, SHQUP-i u vendos në godinën e korpusit parlamentar të Akademisë së Shkencave, të cilat shërbyen për zhvillimin e veprimtarive të shumta të organizuara nga ky institucion. Në këto ambiente ndodhej edhe Biblioteka me rreth 20.000 tituj librash. Më pas SHQUP-i u vendos përkohësisht në ambientet ku sot është Banka Kombëtare Shqiptare dhe si sallë për koncerte shërbeu godina që ndodhej mbas Komandës së

Gardës.

Në vitet '60, në SHQUP ndërvepronin Sektori Metodik, i Kulturës, i Propagandës, i Krijimtarisë, Biblioteka dhe Dega e Mbështetjes.

Në tërësi këta sektorë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zbatimin e misionit që përçonte ky institucion nëpërmjet formave të ndryshme, për t'i bërë sa më efektive krijimtarinë në sferën e gjerë të propagandës, ndihmës metodike nëpër reparte, diafilmat me pamje nga stërvitjet e ndryshme, gatishmërisë, jetës ushtarake, përgjithësimet e përvojës së përparuar me botimet që prodhonte SHQUP-i etj. Një vend të rëndësishëm zinte organizimi nga drejtuesit e edukimit, të vizitave e të ekskursioneve në fshatrat ku bëhej kolektivizimi, në aksionet ku ndërtoheshin hekurudhat, në hidrocentrale, takimet me shkrimtarë të ndryshëm, por edhe me të dalluarit në ushtri.

Më 10 korrik 1968, u përrua godina e re pranë Urës së Lanës, tek rruga e Elbasanit, në të cilën u vendosën dy drejtori ndërvepruese, SHQUP-i në katin e dytë dhe në katin e parë Drejtoria e Ushqimit Social, që në zhargonin përditshëm njihej "Restoranti i SHQUP-it".

Në këtë qendër të re ndodheshin dy salla, njëra me 204 vende uljeje dhe skenë dhe tjetra me 50 vende, holli kryesor për vendosje ekspozitash tipologjike, si dhe për organizimin e homazheve për ushtarakë dhe personalitete të tjerë shtetërorë. "Shtëpia Qendrore e Oficerëve" mbante peshën kryesore të aktiviteteve të natyrave të ndryshme në shkallë ushtrie por edhe për aktivitetet e argëtimit me familjet dhe fëmijët e ushtarakëve, sidomos ditëve të shtuna, të diela dhe ditët festive.

Vitet '70-'80, u shoqëruan me ndryshime strukturore të SHQUP-it, u suprimua sektori i krijimtarisë dhe sektori i prodhimit kinematografik, krijuar në vitin 1976, i cili iu kalua Kinostudios "Shqipëria e Re", u formua sektori metodik, u bënë spastrime e seleksionime në fondin e bibliotekës.

Në këtë periudhë, me rastin e përvjetorëve të shumtë të festave të ndryshme historike, aktivitetet e Orkestrës Frymore, Ansambli të Ushtrisë, dhe Estradës së Ushtrisë ishin të shumta. Krahas tyre SHQUP-i organizonte shpërndarjen e shtypit, aktivitete kulturore, artistike, shfaqje filmash me pjesëmarrësit e paradave, stimuj moral, propagandimi i të dalluarve, fletëpalosje të ndryshme, shfaqje të përbashkëta me institucionet artistike të Shtetit, të cilat rezultuan në 100 koncerte e shfaqje artistike, disa ekspozita fotografike, 60 shfaqje kinematografike në njësitë e repartet e Ushtrisë.

SHQUP-i organizoi edhe festivalin e filmit me tematikë për mbrojtjen, ekspozita fotografike me tematika: "Për mbrojtjen", emisione muziko-letrare e artistike, ligjërata "Pasqyrimi i mbrojtjes së atdheut në letërsinë artistike", diskutime krijuese "Aktivitetet kulturore-artistike dhe lidhja e tyre me jetën, stërvitjen, disiplinën dhe gatishmërinë në Ushtrinë Shqiptare", etj.

Gjatë vitit 1985, trupat artistike u shkëputën nga drejtimi i SHQUP-it dhe formuan komandë më vete dhe pas dy vitesh edhe Shkolla e Lirë Ushtarake e Kinostudios “Shqipëria e Re”, me përjashtim të Komandës së Batalionit Artistik, që vijoi të qëndronte në vartësi të SHQUP-it.

Trupat artistike të SHQUP-it, Ansambli i Ushtrisë, Orkestra Frymore dhe Estrada e Ushtrisë, si shkolla të para profesioniste të artit shqiptar, kryen një veprimtari të gjatë artistike në 50 vite (1944-1994), duke dhënë 6000 koncerte, si brenda dhe jashtë Shqipërisë, ndërsa Sektori i prodhimit kinematografik, 1967-1974, prodhoi rreth 50 filma dokumentarë ushtarakë, propagandistikë dhe mësimorë.

Që nga viti i krijimit të SHQUP-it e në vijimësi, ndryshimet që ajo ka pësuar në strukturën e saj, janë të lidhura ngushtë me domosdoshmërinë e realizimit sa më të mirë të misionit të këtij institucionit. Struktura organizative dhe organika që ka patur kjo Pasuri e Rëndësishme Kombëtare, mesatarisht ndër vite ka rezultuar me një personel prej rreth 200 vetash.

Reformave të shumta në Forcat e Armatosura, në vitet '90 e më pas, përfshinë institucionin e Shtëpisë Qendrore të Ushtrisë, e cila qysh në fillim, me rikonceptimin e misionit të saj, pësoi ndryshime jo vetëm në rimehtëtimet e saj të herëpashershme por u shoqëruan edhe me shkurtime në strukturë e personel. Ndërkohë u rivendosën gradat ushtarake, u hoq funksioni i komisarit politik dhe i sekretarit të partisë dhe u vendos ligji i depolitizimit dhe i departizimit të institucionit.

Pas kalimit në “Qendër të Kulturës të Ushtrisë” (’92), u rikonceptua “Ansambli i Ushtrisë” dhe “Estrada e Ushtarit” (’93), e në vend të tyre u ringrit Grupi artistik, që së bashku me Orkestrën Frymore të Ushtrisë, vijuan aktivitetet e tyre nëpër repartet e ndryshme të Ushtrisë Shqiptare, por edhe në stërvitjet e përbashkëta të zhvilluara në kuadrin e Marrëveshjes për Partneritetin për Paqe, koncerte për forcat shumëkombëshe që erdhën në Shqipëri në 1997 etj.

Në përbërje të këtij institucioni (administrata, biblioteka, grupi artistik, orkestra frymore: 86 veta) u përfshi edhe Qendra e Foto-Filmit të Ushtrisë (’97), e cila u fuqizua me aparatura televizive (’93), duke prodhuar rreth 20 filma dokumentarë dhe një numër të madh kronikash televizive, duke konkurruar edhe në Festivalin Ndërkombëtar të filmit ushtarak në Rumani, i vlerësuar me “Çmim Special”.

Në dekadën e parë të “Shekullit të Ri”, të përgatitjes dhe futjes në NATO, Institucioni, tashmë me emrin “Qendra e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes”, ashtu si dhe FASH-i pësuan ndryshime thelbësore, qysh nga misioni i saj, i cili përcaktonte: “Informimi i qytetarëve dhe efektivave të Forcave të Armatosura të RSH-së, mbi aktivitetin që zhvillojnë këto forca, operacionet e tyre në kohë paqe, në konflikt apo luftë, edukimi i efektivave të FA-së e ndjenjat e patriotizmit, vlerat e qytetare dhe vlerat e lirisë e demokracisë”.

Bashkëpunimi e përafrimi me Strukturat e NATO-s ndikuan edhe



në riorganizimin e “Qendrës së Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes”, i cili u ngrit në nivel drejtorie, si: Marrëdhënie me Publikun dhe informim, Drejtorja e Publikimeve, Drejtorja e Aktiviteteve dhe Marrëdhënieve me Komunitetin, Drejtorja e Aktiviteteve Sportive, që rroknin rreth 129 veta.

Me kalimin në strukturën e re organizative dhe vendosjen në planin e përhapjes së FARSH-së (2014), ky institucion me urdhr nr. 615, datë 23.07.2014, mori emërtimin “Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes; Muzeu dhe Shtëpitë e Pushimit të Ushtarakëve”, me përbërje: Drejtorja e Kulturës, Medias dhe Botimeve, Drejtorja e administratës dhe shërbimeve, Muzeu i FA-së dhe Shtëpitë e Pushimit të Ushtarakëve, me personel rreth 157 veta. Mbështetur në urdhrin nr.1217, dt.09.10.2016, ky institucion u emërtua “Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes, Muzeut të FA-së”, i cili vijon aktivitetin për realizimin e misionit të saj.



**“Për Atdheun që 15 vjeç”,  
Naxhi Zhupa, krenari  
e historisë shqiptare**



Intervistoi:  
**ANJEZA MUSOLLARI,**  
Shefe e Sektorit të Botimeve

**“B**iografinë personale, çdo njeri e bën vetë për aq sa jeton. Kjo njihet ndryshe edhe si pasqyrë e jetës, e raporteve që vendos me të afërmit, shoqërinë, ligjet, miqtë, familjarët. Pra biografia përbëhet nga copëzat e jetës, aktiviteteteve, sukseseve, etj. Sa më të paqme të jenë këto raporte në jetën tonë të përditshme aq më dritësore do të jetë BIOGRAFIA E JETËS”. Janë citime të një njeriu “Enciklopedi e Historisë”, të cilin pata nderin ta njoh dhe fatin të dëgjoj të vërtetat e Luftës Nacional Çlirimtare, si të paktët që kemi fatin të jenë mes nesh. Naxhi Zhupa për lexuesin tonë sjell të vërtetat e luftës, dhimbjet për shokët e humbur, mes lotëve të mallit. Mes vargjeve të kësaj poezie, portretizohet portreti i pionierit-partizan, luftëtarit, invalidit të Luftës Nacionalçlirimtare, ushtarakut artiljer, 75 vjet në shërbim.

Invalid i luftës, ky dëshmor i gjallë  
Emër i nderuar, vepra ia ka falë  
Njërin këmbë, krahun, tjetrin, syrin në ballë  
E ka lënë në luftë për Çlirim të mbarë  
Një jetë të tërë ky njeri i rrallë  
Me predhën në trup e shpellën në ballë  
Si s'i foli goja, oh..., të thoshte një fjalë

#### **Përhëndetje, komandant Naxhi Zhupa!**

*Përhëndetjet më të mira, dhe ju falënderoj shumë për ftesën që më bëtë në këtë 80-vjetor të Çlirimit të Atdheut. Kam kënaqësi që ndodhem në këtë ambient, ku unë jam arsimuar fillim e mbarim, në të gjitha hapësirat e mundshme të arsimit ushtarak që kishte Shqipëria në atë kohë, por edhe për arsimin e përgjithshëm. Ndjej kënaqësi, tani që jam në këtë moshë, të shoh që ka një kujdes të*

*veçantë në këtë 80-vjetor, që ka njerëz që e njohin dhe e vlerësojnë historinë. Ju falënderoj edhe një herë për gjithçka!*

#### **Komandant Naxhi, kur dhe ku keni lindur?**

Unë kam lindur në fshatin Fterrë, një fshat të vogël, jo shumë i dëgjuar, diku në verilindje të Borshit, në fillim të vitit 1930, sipas asaj që na kanë thënë prindërit. Ishim 7 fëmijë. Fëmijërinë e kam kaluar në fshat me prindërit, ku familja ime është marrë kryesisht me blegtori. Kam qëndruar me prindërit deri në moshën 14-15 vjeçare, më pas, ndryshoi jeta... Unë iu bashkova Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Ishte e natyrshme dhe e brendshme thirrja që ndjeva atëherë, nuk më detyroi as nxiti njeri. Kishte ardhur situata e tillë që unë, si edhe bashkëmoshatarët e mi, të nxiteshim që t'i bashkoheshim lëvizjes. Unë u ndodha në ato vite me bagëtitë në zonën e Zagorisë, të Përmetit, ku u lidha me lëvizjen, e që atëherë, më 2 korrik të vitit 1943, kisha përplasjen e parë me pushtuesit, diku në të dalë të Këlcyrës. Ndërsa efektivisht me lëvizjen jam bashkuar, më 13 gusht 1943 deri më 9 maj 1945, pra është një periudhë prej 416 ditësh mos gabo. Fillimisht në batalionin e Asim Zenelit, pak kohë, në grupin e parë, dhe shumicën e kohës në Brigadën VIII sulmuese, është një brigadë e vlerësuar në mënyrë të veçantë nga udhëheqësi i luftës, Enver Hoxha. Brigada kaloi fitimtare nga beteja në betejë, për arsye se na takoi të ishim në disa nga ngjarjet më historike të vendit të asaj lufte, siç ishte mbrojtja e Kongresit të Përmetit, Operacioni i madh i Qershorit, që ishte operacioni më i rëndësishëm në Shqipëri, çlirimi i qyteteve me radhë, duke filluar nga Konispoli, luftuam edhe në Gjirokastrë, morëm pjesë në çlirimin e Beratit, të Kuçovës, Lushnjës dhe në fund këtu në Tiranë, në operacionin më të madh që zhvilloi UNÇSH-ja, operacioni për çlirimin e Tiranës, 17 Nëntori, të cilin e kujtuam edhe para pak ditësh.

#### **Cili ka qenë një nga operacionet ushtarake më të vështira, ku ju keni marrë pjesë?**

Janë shumë. Unë, siç thashë, në luftë kam qenë për 413 ditë,

383 ditë kam qenë në brigadë dhe nga këto përlogaritje, unë kam qenë partizan sulmi i vijave të para fillim e mbarim. Nuk kam qenë në role komanduese, por kam marrë pjesë në vijë të parë me 113 lloje luftimi dhe aktivitete luftarake nga më të ndryshmet. Kam kaluar disa periudha, që kur i mendoj mbledh supet, them me vete nuk e di si ia kam dalë. Po të shohësh me kujdes fotografinë time kur kam qenë partizan, pionier me xhakëtë, ku në mëngë e vende-vende gjen shenja plumbi. Motra dikur më qëndisi shenjat e plumbave. Kam kaluar peripeci, lufta është për të vrarë, për të vrarë kundërshtarin, ka shumë vështirësi.

#### **Si është të humbësh para syve të tu shokët e betejës?**

Kam shumë... (prej syve të lodhur nga rrugëtimi i gjatë i jetës plot sfida rrjedhin dhimbshëm lot). Kur i kujtoj...(dhe duart e përvijëzuara damarësh blu, dridhen, sa shumë tregojnë ato për emocionet e risjella pas 80 vitesh). Po marr vetëm një shembull në luftën për çlirimin e Tiranës, ku unë u plagosa. Në zonën ku ka qenë kombinati ushqimor, përballë kanë qenë kazermat e vjetra, aty ishte një garnizon shumë i fuqishëm i nazistëve. I mësymë, shumë postbllokun, por na goditën me këta topat kundërtank që shikoni këtu, na goditën në postbllokun e tyre, ishim katër veta dhe na zunë për fundi mbeturinat e copat... Aty u plagosa rëndë. Por rruga ishte rreth 10 metër larg, ku kaluan dy tanke naziste, por nuk na panë, se mund të na shkelnin. Mirëpo, dy nga ne ishim të plagosur, nga katër që ishim gjithsej. Një nga shokët që nuk ishte i plagosur u bëri me shenjë grupit të mbështetjes për të na ndihmuar e për të na tërhequr. Ata u ngritën në ndihmën tonë, por i preu breshëria dhe mbetën të dy të vrarë në vend... Njëri prej tyre ishte një vit e gjysmë më i madh se unë, ishte moment shumë i rëndë... Kam pasur momente të tilla të rënda, ku na janë vrarë shumë shokë, kur s'kishim as mjetet më të thjeshta për t'i varrosur siç e meritonin. Janë momente të luftës që kur i kujton në këtë moshë...

Dhe ne përkulemi me mirënjohje dhe me respekt të jashtëzakonshëm për veprën e tyre! Qoftë i paharruar kujtimi i gjithë miqve, shokëve e bashkudhëtarëve të luftës Nacionalçlirimtare!

**Vetëm në brigadën tonë janë vrarë nga fillimi e në mbarim 148 veta. Të vjen keq kur sot dëgjon të thuhet “nuk u luftua”, por ç' flisni kështu?! Është marrëzi!**

Dhe ja tek kemi një histori të gjallë, që e sjell mes fjalës së tij gjithë këtë kalvar të madh mundimesh të bijve e bijave më të mira të këtij vendi që kanë sjellë këto ditë me diell që po shijojmë ne sot!

...Vetëm në Tiranë, gjatë atyre ditëve u vranë 194 veta nga këto tre brigada që ishin brenda qytetit e 300 e ca janë të plagosur. Por ka edhe të tjerë që pas çlirimit të Tiranës nga plagët që morën, humbën jetën më pas në spital, i pata aty pranë meje. Njeriu revoltohet kur dëgjon sot shqiptarë, gazetarë, diplomatë, që kanë qenë të njohur, të cilët thonë që nuk u luftua, injorojnë një vepër të pakrahasueshme. Luftën nacionalçlirimtare e bëri populli shqiptar, nuk e bënë 200 apo 2000 komunistë, e bëri një popull i tërë. Respekto popullin dhe vendin tënd! Ne ishim anëtar të Aleancës, kishim detyrimet tona, kishim angazhimin tonë, kishim

krenarinë të luftonim deri ku të na kërkohej.

**Emocione të tilla mund të na e transmetojnë vetëm njerëz që i kanë kaluar mbi supet e tyre këto histori dhe ju jeni histori e gjallë. Emocione të jashtëzakonshme na përcollët Komandant! Ju jeni brezi i atyre partizanëve të cilët në një moshë fare të vogël iu futët Forcave të Armatosura, Ushtrisë Popullore të asaj kohe.**

**Sa vjeç ishit kur ju u afruat pranë këtij institucioni?**

Në shkurt të vitit 1945 ne ishim në postën jugore, kur erdhi një urdhër i Komandantit të Përgjithshëm që thoshte: “Në brigadat tuaja ka partizanë pionierë, të cilët kanë nevojë më shumë se kushdo tjetër për arsimim. Ne kemi vendosur që t'i kthejmë menjëherë në Shqipëri ata!”. Na grumbulluan shpejt e shpejt




për të zbatuar urdhrin. Nga Hani i Hotit është pesë ditë larg në këmbë dhe ne u kthëm këtu në shkurt të 1945, erdhëm këtu ku është Gjykata e Lartë, ka qenë komanda e garnizonit ushtarak të Tiranës. Na bënë thirrje, sepse duke qenë se ishim moshë e vogël nuk kishim detyrime. Ndonjë hezitoi, dëshironin të ktheheshin në familje, kuptohet. Shumica vendosën, duke biseduar edhe me njëri-tjetrin, sepse ne tashmë ishim mësuar me ushtrinë, vendosëm të qëndronim. Na grumbulluan në hyrjen e ish-Shkollës së Bashkuar, më 28 mars të atij viti, ishim rreth 100, 100 e ca veta

fillimisht, pastaj u shtuam. U krijua dhe filloi shkolla ushtarake, e cila atëherë u quajt "Shkolla e Pionierëve Partizanë". Në vitin 1946, këtë emër e ndryshuan dhe e bënë "Shkolla e Kadetëve", ku shumica qenë kandidatë për oficerë. Erdhën duke u shtuar, gjithnjë pjesëmarrës të luftës, por kishte edhe nga ata që vinin nga terreni, që kishin qenë pjesëmarrës në aktivitetet e luftës. Më 10 korrik të vitit 1946, bëmë paradën për dy vjet, ku arritëm që pjesëmarrës të luftës ishin 434 veta, ish-partizanë pionierë, shumica nga debatikasit. Kam edhe polifoton e këtij efektivit dhe me stafin drejtues. Në vitin 1947, me vendim të Presidiumit të Kuvendit Popullor mori emrin Shkolla Ushtarake "Skënderbej". Ky kontingjent i luftës vazhdoi deri në fund të vitit 1948, ku ky kontingjent më pas u dërgua grupe-grupe jashtë Shqipërie për studime, në të gjithë degët e ushtrisë: këmbësori, aviacion, kimi,

të gjithë detyrat ushtarake, nga bateria apo kompania, siç i thonë tani, e deri në brigadë e nëpër shtabe, kam punuar gjithandej. Në fund edhe në edukim në sektorin politik. Të them të drejtën, jetën e lidha që në fillim, kur u angazhova në luftë, me ushtrinë dhe e mbylla me ushtrinë, 43 vjet, pra u dashurova me ushtrinë. Edhe pse është sektor i vështirë e nuk e pranon kushdo. Aty e mbylla. Por kam mbetur i kënaqur për dy gjëra: E para, unë shërbeva aty ku u caktova, dhe nuk "gërvishta" askund. Në saje të punës, i vura rëndësi vetes që të hidhja këmbën ku duhej, të isha njeri me norma e disiplinë. Mendoj që kam krijuar respekt te ata që më kanë njohur. Jam munduar që t'i shërbej vendit ashtu siç duhet. Nuk kam qenë i vetëm, nuk mund ta mohoj që ka patur shumë e shumë njerëz me vlera që tani nuk jetojnë më.

Pra, jemi produkt i asaj kohe, ajo na kaliti e na bëri t'i shërbejmë vendit.



xhenio, ndërlidhje etj. Unë, bashkë me një grup prej 12 vetash shkua në Beograd për aviacion. Pas kthimit na dërguan përsëri në Bashkimin Sovjetik. Mbaroi kontingjenti që kishin qenë në luftë, në fund të vitit 1948 e më pas vijuan brezat e tjerë.

#### **Si vijoi rrugëtimi juaj më tej në Forcat e Armatosura?**

Unë u ktheva këtu, kalova e u bëra artiljer, mbarova shkollën këtu me rezultate të shkëlqyera. U gradova jashtë radhe me urdhër të veçantë. Më mbajtën 7 vjet këtu pedagog, pastaj kalova nëpër reparte të ndryshme për shërbime në pothuajse në

#### **Jeni brezi që na bëni krenar çdo ditë!**

**Komandant, jemi drejt fundit të bashkëbisedimit tonë. Unë pata fatin e madh që të kisha në këtë intervistë, një njeri të jashtëzakonshëm, me kontribute dhe vlera te padiskutueshme.**

**Jemi në prag të festimeve të 80-vjetorit të Çlirimit të Atdheut. Datat 28-29 i kemi shumë pranë, por jo më larg kemi edhe 4 Dhjetorin, ditën e Krijimit të Ushtrisë Shqiptare. Çfarë do t'u uronit shqiptarëve, por mbi të gjitha bashkudhëtarëve tuaj, ushtarakëve, në detyrë ose jo?**

Përpara se të flas për ushtarakët, dua edhe një herë të theksoj që dëshiroj që të gjithë të mendojnë në interes të vendit, në interes të Shqipërisë, të krenarisë së saj, të asaj që bëri populli shqiptar në atë periudhë, e cila ka mbetur epope, jo se e duam ne lavdinë, por ka mbetur epope, sepse në historinë e luftërave dhe të kryengritjeve, përveç asaj të Skënderbeut, është e vetmja për sa i takon hapësirës, kohës, pjesëmarrjes dhe përfundimeve. Me dy fjalë: ajo epope, Lufta Nacionalçlirimtare konsolidoi pavarësinë e vitit 1912. Nëse nuk do të ishte ajo luftë, ne nuk do të ekzistonim si shtet. Do të dëshiroja që ajo epope që konsolidoi pavarësinë, në këtë 80-vjetor të përkujtohet e të festohet me të gjitha të mirat. Në këtë mes ishte rasti që edhe pajtimi kombëtar që nuk u bë asnjëherë, as pas mbarimit të luftës, as pas vitit '91, duhet të bëhet tani. Për sa i takon ushtarakëve që janë në detyrë

tani, do të dëshiroja, si një njeri që u rrita, u plaka e u moshova, që Shqipëria të kishte një ushtri elitë, që të mos gjendeshim në situata të vështira në të ardhmen. Do të dëshiroja që ushtarakët e ardhshëm që do të shërbejnë në ushtri, të duan vendin e popullin e tyre, të duan shërbimin e detyrën! Gjithnjë të duan vendin e popullin e tyre e t'i shërbejnë...

**Bashkohem edhe unë me fjalët e zemrës tuaj, për t'i uruar të gjithë shqiptarisë festa të bekuara të këtij fund nëntori! Shijoni çdo moment në tokën tuaj!**

# 80-VJETORI I ÇLIRIMIT

## të Atdheut, historia e krenarisë kombëtare

Drejtuesit e njësive të mëdha partizane - Anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional Çlirimtare, 10 korrik 1943

1. Major Abaz Kupi (1891-1976)
2. Myslym Peza, (1897 – 1984)
3. Major Spiro Moisiu (1900 – 1981), komandant i Shtabit
4. Baba Faja Martaneshi (Mustafa Xhani) 1910 – 1947)
5. Haxhi Lleshi (1913 – 1998)
6. Dali Ndreu (1912 – 1956)
7. Dr. Ymer Dishnica (1912 – 1998)
8. Ramadan Citaku (1914 – 1990)
9. Enver Hoxha (1908 – 1985), komisar i Shtabit
10. Mustafa Gjinishi (1912 – 1944)
11. Bedri Spahiu (1908 – 1998)
12. Sejfulla Malëshova (1900 – 1971)

Në përbërjen e Shtabit të Përgjithshëm u bënë ndryshime:

Ymer Dishnica e Sejfulla Malëshova kaluan në detyra të reja si anëtarë të Komitetit Antifashist NÇ dhe dy të tjerë, kolonel Hysni Kapo e kolonel Islam Radovicka do të zgjidheshin anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm si dhe gjeneralmajor Mehmet Shehu, pas çlirimit të Tiranës.

Drejtuesit e Brigadave Sulmuese/Brigada e I, 16 gusht 1943, Vithkuq  
Mehmet Shehu, komandant i Br. I dhe Div. I

Tuk Jakova, komisar i Br. I, komisar Div. I dhe komisar Korp. III

Arif Hasko, komisar i Brigadës, pas Tuk Jakovës

Tahir Kadare, zv. komandant i Br. I, komandant i Br. 6, komandant i Korp. II

Muhamet Prodani, komandant i Br. I

Todi Naco, komandant i Artilerisë së Brigadës

Brigada e II, 20 nëntor 1943, Shëngjergj

Beqir Balluku, komandant i Br. II

Vasil Konomi, komisar i Br. II, Gani Goxhi komisar

Irakli Bozo, Zv. komandant i Br. 2, komandant i Br. 9

Kico Ngjela, Zv. komisar

Brigada III, 9 tetor 1943 Arbanë

Hulusi Spahiu, komandant i Br. III

Shahin Ruka, komisar i Br. III

Hamit Keci, zv. komandant

Vasil Nathanaili, zv. komisar

Brigada e IV, 28 dhjetor 1943, Voskopojë

Nexhip Vincani, komandant

Pllumb Dishnica, komisar

Josif Pashko, Zv Komisar

Brigada V, 20 janar 1944, Tërbac, Vlorë

Abas Shehu, komandant, më pas Shefqet Peci

Hysni Kapo, komisar

Dervish Hekali, zv. komandant

Manush Myftiu, zv. komisar

Brigada VI, 26 janar 1944, Përmet

Tahir Kadare, komandant

Mustafa Matohiti, komisar

Riza Veipi, zv. komandant

Jaho Gjolliku, zv. komandant

Haki Toska, zv. komisar

Sotir Filto, zv. komandant

Xhule Ciraku, zv. komisar

Brigada VII, 17 mars 1944, Vlushë, Skrapar

Gjin Marku, komandant i Br. VII, më pas Musa Daci komandant

Kadri Hoxha, komisar i Br. VII, më pas Qazim Kapisyzi

Neshat Hysi, zv. komandant

Adil Carcani, zv. komisar

Ramiz Alia, përgjegjës rinie

Brigada VIII, 23 prill 1944, Sheper

Asaf Dragoti, komandant Br.

Qazim Kondi, komisar

Koco Gjeci, zv. komandant

Rrahman Parllaku zv. komisar

Brigada IX, 16 tetor 1944, Llozhanë

Irakli Bozo, komandant

Mihallaq Zicishti, komisar

Petro Papi, zv. komandant

Brigada X, 6 nëntor 1944, Karbunarë

Koco Gjeci (Papa), komandant

Mane Nishova, komisar

Njazi Cepani, zv. komandant, komandant

M. Bllaci, zv. komisar

Brigada XI, 1 tetor 1944, Fier

Mevlan Dervishi, komandant

Halil Pulo, komisar



Dilaver Poci, zv. komisar, komisar, komandant  
 Brigada XII, 20 maj 1944, Sukë  
 Refat Bajrami, komandant  
 Qemal Klosi, komisar  
 L. Jaho, zv. komandant  
 Rrahman Parllaku, zv. komisar  
 Brigada XIV, 17 gusht 1944, Sheper  
 Gjon Banushi, komandant  
 Kahreman Ylli, komisar  
 Halil Kacanolli, zv. komandant  
 Gafur Cuci, zv. komisar  
 Brigada XV, 29 qershor 1944, Protopapë  
 Teki Kolaneci, komandant  
 Shahin Ruka, komisar  
 H. Babani, zv. komandant  
 V. Koleci, zv. komisar  
 Brigada XVI, 20 gusht 1944, Therepel  
 Rrahman Ruci, komandant  
 Abdyl Këllezi, komisar, më pas  
 Sofo Papajani, komisar  
 Gjon Gjoni, zv. komandant  
 Myzafer Trebeshina, zv. komisar  
 Brigada XVII, 26 shtator 1944, Gjinar, Elbasan  
 Gjeli Argjiri, komandant  
 Qamil Guranjaku, komisar  
 Sefedin Mece, zv. komandant  
 Ndreçi Plasari, zv. komisar  
 Brigada XVIII, 18 gusht 1944, Sllatinë, Dibër  
 Esat Ndreu, komandant  
 Petrit Dume, zv. komandant, komandant  
 Zoi Themeli, zv. komandant  
 Xhevdet Petrela, zv. komandant  
 Teme Sejko, zv. komisar  
 Mico Kallamata, komisar  
 Ilmi Causholli, komisar  
 Sotir Vullkani, zv. komisar  
 Milo Qirko, zv. komisar, komisar  
 Brigada XIX, 20 gusht 1944, Theollog  
 Andrea Nasi, komandant  
 Thoma Xhixho, komandant  
 Vangjo Mitrojorgji, komisar  
 Mehmet Dusha, zv. komandant  
 Lefter Kasneci, zv. komisar  
 Spiro Xhai, zv. komisar  
 Brigada XX, 9 shtator 1944, Protopapë  
 Riza Kodheli, komandant  
 Misto Treska, komisar  
 Llambi Premti, komisar  
 Isuf Keci, zv. komandant  
 Nuri Resnja, zv. komisar  
 Brigada XXII, 18 shtator 1944, Pezë  
 Sali Verdha, komandant  
 Rexhep Zuna, komandant (dëshmor)  
 Neshat Hysi, komandant  
 Tonin Jakova, komisar

Shaban Rexha, zv. komandant  
 Sadik Bocaj, zv. komisar  
 Nimet Ymeri, zv. komisar, komisar  
 Brigada XXIII, 21 shtator 1944, Zall Mner  
 Hamit Keci, komandant, më pas Haxhi  
 Sesi, Muharrem Kokomani  
 Xhavit Qesja, komisar  
 Mërkur Cela, komisar  
 Haki Fejzo, zv. komandant, Rexh Deliu, zv. komandant  
 Sejdin Avdia, zv. komisar, komisar  
 Brigada XXIV, 4 tetor 1944, Bicaj  
 Ndreko Rino, komandant  
 Abedin Shehu, komisar  
 Et'hëm Gjinushi, zv. komisar, komisar  
 Nj. Hoxha, zv. komandant  
 Brigada XXV, 6 nëntor 1944 Tropojë  
 Rexhep Haka komandant  
 V. Daci, komandant  
 Nuri Arapi, komisar  
 Sadik Bekteshi komisar  
 Sh.Hoxha, zv. komandant  
 Brigada XXVII, 29 nëntor 1944, Shkodër  
 Qazim Kapisyzi, komandant  
 Sadik Bekteshi, komisar

## 1. Drejtuesit e Divizioneve

### Divizioni I

Me përbërje Br. 1, 4, 5  
 Komandantë Dali Ndreu, Mehmet Shehu,  
 Komisar Tuk Jakova

### Divizioni II

Me përbërje Br. 3,6,18  
 Tahir Kadare, komandant  
 Kristo Themelko, komisar

Divizioni III  
 Me përbërje Br. 12,14,19  
 Islam Radovicka, komandant  
 Pandi Kristo, komisar  
 Divizioni IV  
 Me përbërje Br. 15.17, 18  
 Asaf Dragoti, komandant  
 Pllumb Dishnica, komisar  
 Divizioni V  
 Me përbërje Br. 3, 5, 18  
 Rrahman Parllaku, komandant  
 Ramiz Alia, komisar  
 Divizioni VI  
 Me përbërje Br. 6,7,8,12  
 Gjin Marku, komandant  
 Myzafer Spaho, komisar  
 Divizioni VII  
 Me përbërje Br. 2,9, 20  
 Panajot Plaku, komandant  
 Gafur Cuci, komisar

## 2. Drejtuesit e Korparmatave

Korp. I (Div 1, 2) Dali Ndreu, komandant,  
 Hysni Kapo komisar  
 Korp. II, (Div 3, 4) Tahir Kadare, komandant,  
 Kristo Themelko komisar  
 Korp. III, (Div 5, 6), Shefqet Peci,  
 komandant, Tuk Jakova komisar

*\*Kjo tabelë nuk pasqyron ngritjet në detyrë dhe lëvizjet e mëvonshme. Për përgatitjen e këtij materiali u shfrytëzuan historikët e brigadave sulmuese, materiale të wikipedias dhe albumi i AQSH-së, kushtuar 70-vjetorit të çlirimit të Atidheut.*




# Atdheu përjetë mirënjohës!

**N**ë panteonin e artë të historisë së kombit kulmon një nga ngjarjet më të mëdha, epopeja e ngadhënjishme e Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare. Kjo luftë në rrugëtimin e kombit shkroi lavdinë e tij. Sado që kohët ecën dhe largojnë madhështinë hyjnzuese të kësaj epopeje, gjaku i derdhur i bijave dhe bijve të kombit thërret në histori, thërret për atë çka ata dhanë jetën në lulen e rinisë.

Liria për të ishte gjëja më e shenjtë, ishte mbi jetën. Me patosin e shpirtit, rrokën armët qindra e mijëra vetë e iu ngjitën maleve në luftë, ku shkruan një histori dritëdhënëse, përballë një

armiku të egër, të madh, çnjerëzor, që kërkonte të rrëronte e zhdukte lirinë e kombit, ekzistencën e tij. Por një popull i tërë, i etur për liri, që kishte treguar se atdheu ishte më i shtrenjtë se çdo gjë, shkroi histori të pa treguar, që sot ngelen si gurë themeli të kujtesës së tij historike. Pëllëmbë e tokë, gjak e histori, partizanët, bijtë e tij, kumtuan mesazhin e madh se gjaku i derdhur do të ishte flamuri i kombit, lartësimi i tij në çdo moment të jetës, flamuri dhe ylli ishin që i udhëhoqi në përpjekje, në betejë, në gjakderdhje, kur dhe shokët i binin pranë, ata ngritën lart atë flamur që simbolizon sot qytetërimin tonë.



## Meleq Gosnishti

Hero i Popullit. U vra gjatë

luftimeve për marrjen e

kalasë së Margëlliçit në

Patos, më 30 mars 1944.

Lindi në fshatin Gosnisht

të Përmetit. I biri i Iliaz dhe

Hatixhe Gosnishtit. Qe fëmija

më i madh nga shtatë fëmijët

e kësaj familje. Emigroi që

në moshën 14 vjeçare drejt

Parisit dhe u kthye më vonë

për të marrë pjesë në Luftën

për çlirimin e Vendlit. U vra

teksta po luftonte në Kalanë

e Margëlliçit së bashku

me të tjerë partizanë dhe

me shokun e tij, Heroin e

Popullit, Mustafa Matohitin.

Dy ditë pas vrasjes së tij, në

Tiranë gjeti vdekjen dhe vëllai

i tij i vogël Zini Gosnishti.

Varri i tij gjendet ende në

rrethin e Përmetit. Për nder

të këtij hero i ka marrë emrin

e tij një ndër shkollat më të

mira 9-vjeçare të rrethit të


Përmetit, gjimnazi i Patosit

dhe një rrugë në Tiranë.

# Mustafa Matohiti, Hero i Popullit

Mustafa Matohiti u lind në Lekdush, më 15 nëntor 1912. Mbaroi shkollën fillore dhe atë plotore në Delvinë. I ati Sabriu rropatej në punë të ndryshme për bukën e gojës, por të birin donte ta shkollonte. Varfëria dhe shtypja ziente përbrenda çdo zemre. Mustafai ishte 17 vjeçar, kur më 28 nëntor 1929, në Gusmar, qendër e n/prefekturës së Kurveleshit, mori iniciativë dhe tha: “Neve kurveleshasve na urrejnë armiqtë e kjo na gëzon dhe do t’i luftojmë akoma më shumë”. Kjo protestë tregon jo vetëm urrejtjen kundër padrejtësive, por edhe zgjuarsinë dhe guximin e Mustafait.

Në vitin 1929 Mustafai u punësua në Tiranë, tek një farmacist. Donte të vazhdonte shkollën, por askush nuk e ndihmonte. Me durim dhe vullnet fitoi në një konkurs provimesh dhe u fut në një shkollë oficerësh. Në shkollë u lidh ngushtë me Asim Vokshin, Hero i Popullit. Në verën e vitit 1933 mbaroi shkollën dhe doli oficer për artilerinë. Emërohet në Elbasan, ku njihet me shumë elementë antizogistë, të cilëve u fliste për historinë dhe luftërat e popullit tonë për liri dhe pavarësi. Në maj 1937 e arrestuan xhandarët e Zogut për veprimtarinë atdhetare dhe e burgosën në Tiranë. Regjimi zogist e përjashtoi nga radhët e ushtrisë dhe i dha banim të detyrueshëm në Delvinë. Madje qeveria zogiste ia kishte shënuar emrin në defterin e njerëzve më të rrezikshëm të regjimit. Pas kësaj, Mustafanë e dërguan me banim të detyrueshëm në Lekdush nën një mbikëqyrje të rreptë. Në nëntor 1938 ai arratiset dhe shkoi në Greqi me shpresë që të shkonte në Luftën e Spanjës, ku ndodheshin Asim Vokshi, Petro Marko, Ramiz Varvarica e të tjerë, por autoritetet greke e ndaluan dhe e dorëzuan te xhandarmëria shqiptare, ku për dy muaj ai u nënshtrua torturave. Agresionin fashist, të 7 Prillit 1939, e priti me një zemërim prej atdhetari të vërtetë. Në 1941 u ndodh në Piqeras, ku zhvilloi veprimtarinë patriotike në bashkëpunim me Mitro Xhanin. Më 18 mars 1942, në kujtim të Luftës së Mashkullorës nga çeta e Çerçiz Topullit, Mustafa Matohiti para autoriteteve dhe popullit mbajti një fjalim të zjarrtë patriotik. Në fund ai nga gjiri nxori një flamur kombëtar, mbi të cilin qe shkruar: “Sot me flamur shpalosur, nesër me pushkë në dorë malevel!”. Kështu deklaroi Mustafai në Mashkullorë dhe ai s’la katund e kasolle pa ligjëruar si bilbili për idealet e luftës për liri. Me udhëzim të Qarkorit të PKSH-së për Gjirokastrën, në lajthitë e Gusmarit, në prill 1942, formoi çetën partizane, ku komisar të saj luftëtarët e lirisë caktuan Mustafa Matohitin... Me iniciativën, pjekurinë e maturinë, Mustafai brenda muajve mars-maj 1942, krijoi në zonën e Kurveleshit këshillat antifashiste nacionalçlirimtare dhe njësitë e armatosura pranë tyre... Në maj 1942, në Kuç u formua celula e parë komuniste për Kurveleshin dhe sekretar u caktua Mustafa Matohiti, i cili ishte njëkohësisht dhe komisar i çetës së parë partizane të krahinës. Më 28 nëntor 1942, në ditën e 30-vjetorit të



Pavarësisë Kombëtare, në krye të 250 kryengritësve kurveleshas, sulmon administratën fashisto-zogiste dhe me trimëri, guxim e mençuri korri një fitore historike që pati një mbështetje të madhe mbarë popullore në Kurvelesh e më larg. Kurveleshi u çlirua nga vargonjtë e mercenarëve dhe pushtuesve fashistë.

Mustafa Matohiti ishte njeri i aksionit të guximshëm, por ai shquhej edhe për oratorinë e përsosur. Fjala shpatë e barut e Mustafait që bashkë me Mehmet Shehun dhe Abaz Shehun demaskuan me argumente krerët ballistë Ali bej Këlcyra, Rasim Babameto, Zenel Gjoleka, atje në rrapet e Dervenit, më 4 maj 1943. E ku nuk shkeli këmba e Mustafait!? E njohu Kurveleshi, Lopësi e Mesapliku, Buzi, Rrëzoma e Krahësi, Bënça, Bregdeti e Përmeti, Kardhiqi, Gjirokastra e Mallakastra, Zagoria, Dëshnica e Poliçani, Tepelena e Konispoli... Aftësitë drejtuese, organizuese dhe fryma luftarake e tij u shfaqën edhe kur u emërua komisar i Grupit të Katërt “Çamëria”, apo kur u caktua komisar i Brigadës VI Sulmuese, më 26 janar 1944. Brigada VI Sulmuese zhvilloi shumë beteja dhe në njërin prej tyre, në atë të 29 marsit 1944, në Mërgëlliç, Mustafa Matohiti, Dino Kalenja, Lefter Talo dhe Meleq Gosnishti, të katër Heronj të Popullit, me gjakun e tyre të kulluar do të shkruanin pavdekësinë dhe lirinë që do të vinte më 29 nëntor 1944, përmes pushkës fitimtare partizane.

# NIMETE PROGONATI,

## “Zhan d’Arka” shqiptare

### *(Në 80-vjetorin e rënies)*

#### **Familja e edukoi me dashurinë për atdheun**

Familja e heroinës në origjinë ka jetuar në varfëri të tejskajshme, por gjithnjë ka ruajtur frymën e shëndoshë dhe dashurinë për atdheun. Babai i saj, Isufi, gjatë jetës provoi punët më të rënda si punëtor krahun në ndërmarrjen Rruga-Ura, si emigrant në Greqi dhe në Francë. Me ndjenjë përgjegjësie ndaj atdheut Isufi ka marrë pjesë në luftimet kundër andartëve grekë gjatë viteve 1913-1914; kundër garnizonit italian për çlirimin e qytetit Tepelenë. Si përkrahës i qeverisë së Fan Nolit, Isufi ka marrë pjesë në betejat e Urës së Brarit, në Shkallën e Tujanit dhe si antizogist ka marrë pjesë në Kryengritjen e Fierit të vitit 1935 etj. Ndërsa gjatë LANÇ-it si anëtar i çetës territoriale ka luftuar në disa betejat, si ajo tek Ura e Dragotit, në Shkallën e Zezë, te Ura e Leklit, në Mogila të Vasjarit, Qafa e Miricës, në Dukaj etj. Edhe dy xhaxhallarë të heroinës kanë kryer detyra si veprimtarë aktivë me organet e pushtetit gjatë LANÇ-it. Mamaja e saj, nënë Fatimeja, ka nga trugu i familjes së saj tre dëshmorë të atdheut. Ajo kur mori lajmin për vrasjen e vajzës në luftë, kërkoi me këmbëngulje të shkente në front e ta zëvendësonte të bijën, por autoritetet e pushtetit vendor nuk e lejuan për arsye moshe, shëndeti dhe kujdestari familjare.

Nimete Progonati, pasi përfundoi arsimin fillor në fshatin Luzat, vazhdoi me këmbëngulje mësimet në shkollën Plotore në qytetin e Tepelenës. Edhe pse në fëmijëri heroina njohu varfërinë migjeniane, në shkollë u dallua për inteligjencë e zell në mësimet. Me prirjen e saj poetike vajza 15-vjeçare ka lënë një fond të vogël me poezi, kryesisht me përmbajtje patriotike, të cilat janë edhe sot një mesazh i fortë atdhetarie për brezat e rinj. Dhe dëshira që ajo u ka shfaqur shoqeve të moshës dhe të afërmeve të saj, ishte që në jetë të bëhej mësuese. Shpesh në shkollë dhe në veprimtaritë që kryheshin i pëlqente të recitonte vargjet e Vaso Pashës: “O moj Shqipni, e mjera Shqipni”. Si debatikase, ka shkruar mësuesi i saj Murat Koçi, në demonstratën e bukës që u zhvillua më 15 shkurt 1942 në Tepelenë, Nimetja, ish-nxënëse e shkollës plotore recitoi para pjesëmarrësve vjershën “Liria”. Ajo me duart e saj të njoma kontribuoi e thuri për partizanët triko leshi, fanella, çorape, qepte yje, shpërndante trakte e komunikata dhe në disa raste iu besuan detyra për të ruajtur shokët kur zhvilloheshin mbledhje me rëndësi, ndaj të cilave ishte e përgjegjshme dhe i plotësonte me shumë korrektësi.

#### **Luftëtare e lirisë**

Nimete Isuf Progonati lindi në Luzat të Tepelenës, më 26 korrik 1929, në një familje atdhetare e patriote, ardhur në Luzat,

më 1805, nga Progonati. Babai i saj, Isufi, ka qenë emigrant në Greqi dhe në Francë dhe me kthimin nga emigrimi punoi punëtor mirëmbajtjeje në ndërmarrjen Rruga Ura. Nimetes që në fëmijëri, nënë Fatimeja bashkë me qumështin, i mëkoi dhe ndjenjën e lirisë e dashurisë për atdheun. Ajo mbaroi shkollën fillore në fshat, ku u dallua si nxënëse e shumë e mirë. Si shumë bashkëmoshatarë, ajo e kishte ndër shokë shtypjen, shfrytëzimin, vuajtjen dhe varfërinë që ekzistonte në fshat e më gjerë në krahinën e Labërisë.

Pushtimin fashist e priti me hidhërim, zemërim dhe urrejtje të madhe bashkë me të gjithë moshatarët. Luzati, më 22 dhjetor 1942, bëri betimin si fshat dhe u lidh me LANÇ-in, ku mori pjesë gjithë fshati: burra, gra dhe fëmijë, e midis tyre dhe Nimetia 14 vjeçare. Në Luzat u formua KANÇ i fshatit me kryetar Fuat Shehun, organizata e gruas antifashiste me kryetare Rakibe Qelin dhe organizata e rinisë me sekretar Kamber Qibinin. Nimetia u dallua midis shoqeve e shokëve të organizatës së rinisë së fshatit në kryerjen e detyrave që i ngarkoheshin. Kur mbushi moshën 14 vjeçe, prindërit e fejuan, por ajo nuk e pranoi, theu zakonet e vjetra dhe paragjykimet e kohës.

Nimetia së bashku me tre shoqe të saj, Qibro Gjyli, Tefta Shehu dhe Dylbie Kopaçi, kur në fshat erdhën partizanët e çetës “Ismali Kaso”, kërkuan të shkonin partizane, por komandanti i çetës Fejzo Ismaili iu tha se, kur të vinin herën tjetër do t’i merrnin, por ata nuk u kthyen më në fshat. Një ditë kaluan forcat e BrVS dhe Nimetja së bashku me tre shoqet u futën në përbërje të kësaj brigade dhe marshuan në drejtim të Përmetit. Më 8 prill 1943, ajo me tre shoqet e saj nisën jetën partizane. Ja si i thotë ajo komandantit të çetës “Kështu dukem e parritur dhe disi e imtë nga varfëria e thellë familjare, por jam më e rritur dhe zemrën e kam zjarr, kështu që kam besim se do të duroj çdo vështirësi, çdo zheg në behar, dimër e acar”.

Pushka e Nimetes u dëgjua nga Përmeti, ku u zhvilluan luftime të ashpra në Biovizhd e Çarshovë, ku ajo u dallua për guxim e trimëri. Më 11 maj, komandanti BrVS, Shefqet Peçi, Hero i Popullit, i dhuroi një automatik dhe e quajti “Zhan d’Arka” shqiptare, ndërsa komandanti i BrIS, Mehmet Shehu, Hero i Popullit, e ngriti lart dhe tha: “Me trimëresha si Nimete Progonati, atdheun do ta çlirojmë me çdo kusht, ajo është shqiptarja e maleve të trimërisë shqiptare”. Në çdo betejë Nimetja tregonte trimëri e guxim, komandanti i kompanisë Metani nuk i linte vajzat që të dilnin në vijën e parë, me qëllim që t’i ruante, por ajo fshehurazi lëvizte dhe dilte në vijën e parë të luftimeve. Kur



komandanti i diktonte, e qortonte ashpër që të ruante veten, por ajo i thoshte se “unë kam ardhur vullnetare partizane që të luftoj kundër armikut, që ka pushtuar vendin dhe jo të bëj sehir, se si luftojnë të tjerët”. Më pas ajo u nis si shqiponjë në vijën e parë të luftimeve, hapi zjarr të fuqishëm, por një plumb e goditi në gjoksin e saj të njomë, automatiku heshti, iu afruan shokët ajo në grahmat e fundit u thotë: “Merreni automatikun tim se u duhet shokëve”. Pushoi automatiku i Nimetes pushoi dhe zemra e saj e re. Ishte mëngjesi i datës 26 korrik 1944.

#### **Ka mbetur në kujtimet e partizanëve**

Dhe më pas, kur u krijua BrVS me Komandant Shefqet Peçin dhe Komisar Hysni Kapon, Nimetja u inkuadrua partizane e kësaj njësie luftarake. Vitet e fëmijërisë, heroinën e vogël e mbushën me urrejtje për regjimin e kohës, për pushtuesit italianë dhe më pas edhe për nazistët hitlerianë, por brenda shpirtit të vogëlushes kishte shumë dashuri e optimizëm për jetën. Fryma e shëndoshë patriotike e familjes së saj, ndikimi i mësuesve patriotë dhe mjedisi që e rrethonte në shkollë e kudo, si dhe propaganda e madhe që zhvilloi partia komuniste dhe udhëheqësit e saj për çlirimin e vendit nga pushtuesit e huaj e tradhtarët në shërbim të tyre, Nimetes i ndriçuan mendjen, i rritën koshiençën e idealin dhe e poqën ideologjikisht para kohe vajzën 14-15 vjeçare. Në ndërgjegjen e heroinës u rrit e u kalit më shumë ndjenja e përgjegjësisë dhe dashuria për fatet e popullit, jeta e të cilit për shekuj me radhë është histori e pandërprerë luftërash për mbrojtjen e nderit dhe dinjitetit kombëtar dhe për të mos u asimiluar kurrë.

Pjesëmarrja në Luftën Nacionalçlirimtare, heroinën e vogël, më të voglën vajzë në gjithë atë armatë të ushtrisë çlirimtare, e kaliti dhe e bëri më veprimtare e energjike. Ajo mori pjesë në

çdo betejë dhe kudo luftoi me trimëri. Partizanëve që nuk dinin shkrim e këndim heroina në kohën e lirë iu bë mësuesja e tyre, gjithashtu shkroi poezi dhe zhvilloi veprimtari kulturore. Në frontin e luftimit dhe në çdo aksion e reja komuniste Nimete Progonati me thirrjen: “Para partizanë”, në vijë të parë e ballë përballë armikut ngriti lart moralin e shokëve për fitore dhe mbolli panik e frikë në radhët e armikut. Pushka e heroinës që ishte më e gjatë se shtati i partizanes trime, shtiu pa pushim mbi armiqtë e tradhtarët, oshtima e saj u dëgjua fuqishëm prej Lumit të Vlorës, në malet e Kurveleshit, në Çajup, për mbrojtjen e punimeve të Kongresit të Përmetit; në Qafën e Gjarprit, Gurin e Prerë, Zaloshnje e Mëlovë, Godolesht të Elbasanit, Shupal e Tujan në Tiranë, Burgajet e Macukull, të Burrelit e deri në Sinjë të Dibrës, ku në betejën e përgjakshme të 26 korrikut 1944, Nimete Progonati “festoi” ditëlindjen me një plumb në gjoksin e njomë, ku afirmoi pavdekësinë e kurorëzuar më pas me titullin e lartë të nderit “Heroinë e Popullit”.

Veteranët e LANÇ-it Xhemal Murataj, Levend Lila dhe Ethem Kambo në kujtimet e tyre tregojnë se në betejën e Çarshovës, më 9-11 maj 1944, Nimete Progonati zuri rob një ballist. Për këtë akt trimërie komandanti i Brigadës, gjeneral Shefqet Peçi e falënderoi partizanen para njësisë luftarake dhe e krahasoi me figurën e heroinës franceze Zhan d’Ark dhe, si shpërblim për aktin e kryer i dhuruan një automatik anglez dhe dy granata dore. Partizania Nimete Progonati ishte bërë një personazh sa e njohur në gjithë brigadën partizane po aq edhe e dashur për shkak të moshës fare të re, për shkathtësinë, energjitë dhe trimërinë e rrallë që tregoi nga njëra betejë në tjetrën deri sa, më 26 korrik 1944, në betejën e Dibrës, heroina dha jetën për lirinë e Shqipërisë. Vdekja vetëm hidhërim shpreh, por humbja e jetës së partizanes trime, ditën që do të festonte me shokët 15 pranverat, u ndje thellë në zemrat dhe në sytë e çdo partizani e partizaneje. Lotët s’i kurseu askush, midis tyre edhe komandanti e komisar i njësisë. “Sot, - tha komisar, - humbëm një luftëtare, një trimëreshë, një vajzë që nuk iu tremb vdekjes, poeteshën e vogël, këngëtares e mirë, vajzën hokatare, që në kohën e lirë na argëtonte, na çlodhte, na zbaviste dhe na bënte për të qeshur. Nderim për jetën e saj njomëzake”.

#### **Përjetësia e heroinës**

Partizanes së vogël si kujtdo që bie në luftë iu bënë nderimet e duhura. Për heroinën është shkruar nga shumë personalitete, figura kuadrosh e veteranë, ish-pjesëmarrës në LANÇ.

Nimete Progonati mban shumë tituj nderi, si: “Heroinë e Popullit” me dekret nr. 5212, datë 21.11.1974, medaljen e “Trimërisë”, të “Çlirimit”, të “Kujtimit”; Është shpallur “Dëshmor i Atdheut” vendim nr. 44, datë 3.8.1971 të Komitetit Ekzekutiv të Tepelenës; Në vendin e rënies, në Sinjë të Dibrës është ngritur një lapidar; Mban emrin e saj shkolla 9-vjeçare e fshatit Sinjë, Dibër; Mban emrin e saj shkolla 9-vjeçare e qytetit Memaliaj; Mban emrin e saj edhe Qendra e Edukimit të Fëmijëve (ish-Shtëpia e Pionierit Tepelenë); Në qendër të qytetit Tepelenë, në bulevardin kryesor, më 11 janar 2001, u përrua busti i Nimete Progonatit, i realizuar nga Artisti i Popullit nga Mumtaz Dhrami. Për heroinën 15-vjeçare janë botuar shumë shkrime, kujtime, portrete, tregime, poezi, këngë dhe dokumentarë televizivë, të cilët e vërtetojnë më së miri jetën dhe veprimtarinë e saj.



# “PA DËSHMORË NUK KA ATDHE”



**Emin Duraku ishte denoncuar nga komunistët serbë, vetëm sepse ishte anëtar i Partisë Komuniste të Shqipërisë, madje këtë fakt ata nuk e kanë mohuar asnjëherë gjatë akuzave publike nëpër gjyqe, që iu kanë bërë shqiptarëve, të cilët sipas tyre edhe e kanë vrrarë Emin Durakun.**

**E**min Duraku është emër i njohur i Lëvizjes Komuniste shqiptare, në Shqipëri dhe në Kosovë. Ai u lind në vitin 1917, në Gjakovë, ku edhe i mori mësimet e para.

Në vitin 1932, së bashku me disa shokë kalojnë kufirin ilegalisht dhe vijnë në Shqipëri me qëllim për të ndjekur mësimet në gjuhën amtare, meqë Jugosllavia monarkike jo vetëm që nuk lejonte shkollimin shqip, por ndëshkonte çdo përpjekje për ta mësuar atë. Gjendja e vështirë ekonomike që sundonte atje u vërejt me të arritur në Shqipëri, e cila ishte e njëjtë si në vendlindjen e tij të okupuar nga Mbretëria jugosllave.

Me të arritur në Tiranë, regjistrohet në shkollën e mesme të qytetit nga e cila më 1935 edhe përjashtohet për shkak të angazhimit të tij në grupet revolucionare, majtiste, që vepronin në kuadër të Lëvizjes komuniste të kohës. Pas përjashtimit nga shkolla, në Tiranë, shkon në Shkodër dhe atje vijon mësimet e shkollës së mesme.

Për shkak të ideve të tij përparimtare shoqërore, ideologjike e politike, duke qenë se puna dhe aktiviteti i tij përcillej nga sigurimi i Shtetit, arrestohet dhe dënohet me tri vite burg. Burgosja e tij merr fund me hyrjen e trupave italiane në Shqipëri, më 1939.

Me të dalë nga burgu, fillon vetë angazhimin në organizimin e rezistencës kundër pushtuesve italianë, të cilët kishin okupuar Shqipërinë.

Së bashku me disa shokë, me të cilët edhe kishte kryer shkollën e mesme në Shqipëri, në vitin 1939 kthehet në Gjakovë. Duke qenë se bindjet e tij politike i kishte orientuar në programin e Lëvizjes komuniste, ai kontakton disa anëtarë të Partisë Komuniste të Jugosllavisë në Kosovë, si Bora Vukmirovic dhe Milladin Popovic, të cilët fillimisht i kishin qëndruar besnikë platformës së lirisë barazisë dhe Vetëvendosjes së kombeve dhe kishin premtuar se ato do të realizoheshin pas çlirimit nga fashizmi. Sërish kalon kufirin dhe kthehet në Shkodër ku merr pjesë në demonstratat antifashiste kundër pushtimit italian që u mbajtën më 28 nëntor të vitit 1939. Duke qenë se bie në sy si militant dhe i vendosur forcat fashiste e arrestojnë dhe e internojnë në ishujt italianë Ventotene.

Gjatë internimit studion literaturën marksiste dhe nga aty, më 1941, i shoqëruar nga bashkëmendimtarët kthehet në Tiranë, me qëllim të krijimit të lidhjes me Partinë Komuniste të sapo ngritur në Shqipëri.

Së bashku me Miladin Popoviqin aktivizohen për përhapjen e pikëpamjeve komuniste në hapësirën e Vilajetit të Kosovës, që nënkuptonte Kosovën e sotme, Sanxhakun e kryesisht trojet etnike shqiptare nën regjimin jugosllav.

Sipas disa të dhënave, Emin Duraku sërish vë kontakt me Partinë Komuniste të Jugosllavisë dhe ishte zgjedhur sekretari i komitetit organizativ. Ishte angazhuar aktivisht në përfshirjen e popullsisë shqiptare në organizatën e quajtur Lëvizja Çlirimtare e Popullit, duke i besuar verbërisht komunistëve jugosllavë, të cilët shqiptarëve u premtonte liri, barazi e Vetëvendosje.

Në fillim të 1942, në Gjakovë me nismën e tij, të Fadil Hoxhës dhe disa komunistëve të tjerë u formua Komiteti Çlirimtar dhe ai u emërua Sekretar i tij. Në fund të vitit 1942, sipas direktivave të komitetit të Krahinës së Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit u zgjodh në Byronë e Komitetit krahinor.

Në vjeshtë të vitit 1942, Emin Duraku kishte kontaktuar grupet komuniste në rrethin e Lypjanit. Në dhjetor të atij viti ndodhej në fshatin Suhadoll, në një rreth aktivistësh serbë, të cilët kohë më parë xhandarmëria shqiptare-italiane i kishte

arrestuar dhe dënuar për posedim të armëve. Pasi ishte konsideruar se qëndrimi i tij në Suhadoll ishte me rrezik, natën e katër dhjetorit të vitit 1942, ai ishte vendosur në shtëpinë e një serbi të fshatit Grackë. Përcjellësi i tij serb, ishte kapur nga xhandarmëria dhe me qëllim për të shpëtuar kishte denoncuar vendin ku ndodhej Emin Duraku dhe grupi i komunistëve serbë.

Atë natë, në Kuesturë kishte ndodhur në detyrë, Ismail Dragusha, i cili e kishte njohur Emin Durakun, përmes një lidhjeje paraprake familjare dhe ishte përgatitur të nisej me qëllim për ta shpëtuar. Para se Ismail Dragusha të arrinte në Grackë të Vjetër, Kuestura italiane kishte rrethuar shtëpinë e serbit, ku ndodhej Emin Duraku, i cili në përpjekje për të ikur ishte futur në një oxhak, me qëllim që të mos zbulohet. Një ushtar italian e kishte goditur me armë, duke qenë se ai nuk ishte dorëzuar. Emini ishte plagosur rëndë dhe Ismail Dragusha, që ishte nënkomandant i Kuesturës kishte urdhëruar që sa më parë ta dërgonin në Spitalin e Prishtinës. Emin Duraku i ishte lutur Ismajlit, të cilin e njohte dhe i besonte, që ta niste për në Spitalin e Prizrenit, ku do të ishte afër familjes. Të pranishmit kishin konstatuar se plaga ishte e rëndë dhe rruga deri në Prizren ishte e gjatë për të mbijetuar. Në fund ia kishin plotësuar dëshirën, por pa arritur në Spital kishte vdekur, më 5 dhjetor të vitit 1942.

Në aktakuzën e regjimit komunist jugosllav kundër, Idriz Mehmetit nga fshati Banullë në vitin 1945, ai ishte akuzuar se me shumë të tjerë kishte marrë pjesë edhe në kapjen e Emin Durakut. Aty shkruan se "Emin Duraku kishte qenë anëtar i Partisë Komuniste të Shqipërisë". Edhe pse dihej fare mirë se Emin Duraku e kishte plagosur ushtari italian Leone, po ashtu dihej se të gjithë xhandarët shqiptarë kishin bërë përpjekje ta shpëtonin, meqë ishte i njohur i Ismail Dragushës, komunistët serbë kishin dënuar me burg më shumë se 20 shqiptarë, të cilët ishin akuzuar se kanë marrë pjesë në zënien dhe plagosjen e tij. Nga mesi i atyre që janë akuzuar për vrasjen e Emin Durakut dhe që janë ekzekutuar kanë qenë: Habib Emini, Hazir Selimi, nga Banulla, Kadri Bebe Ribari, meqë kishte qenë kryetar i komunës së Lypjanit në atë kohë, ishte dënuar me vdekje pushkatim, ndërsa me 20 vjet burg ishin dënuar Qerim Selimi, Selman Buja, pushkatim, vëllezërit Domaneku, dy prej tyre pushkatim, Idriz Mehmeti e shumë të tjerë.

Emin Duraku ishte denoncuar nga komunistët serbë, vetëm sepse ishte anëtar i Partisë Komuniste të Shqipërisë, madje këtë fakt ata nuk e kanë mohuar asnjëherë gjatë akuzave publike nëpër gjyqe, që iu kanë bërë shqiptarëve, të cilët sipas tyre edhe e kanë vrarë Emin Durakun.

Këto materiale historike janë marrë nga studiues të historisë së luftës, të cilët sjellin në memorien e brezave luftën e paepur të popullit shqiptar për liri dhe pavarësi.

# Luftëtare, partizane dhe drejtuese në rreshtat e Ushtrisë Nacionalçlirimtare

## Gruaja shqiptare luftoi me guxim për të drejtat e saj

Karakteristikë e Ushtrisë Nacionalçlirimtare është se në radhët e saj pati edhe mjaft gra e vajza që u ngritën në përgjegjësi të ndryshme politike e ushtarake. Kjo nuk ishte diçka e rastit, por rezultat, në radhë të parë, i energjive të pashterura luftarake, i talenteve dhe cilësive të larta drejtuese që ato treguan në luftë e sipër, dhe i rolit të saj për të zgjidhur në tërësi problemet e kuadrit të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, duke vlerësuar drejt e në kohë, aftësitë e çdo luftëtari partizan, pavarësisht nga seksi. Kjo theu një koncept tjetër të vjetër frenues e të gabuar, se gruaja gjoja nuk mund të luftojë me armë në dorë, të mohonte aq më tepër aftësitë e saj për të marrë përsipër detyra udhëheqëse në ushtri. Një numër i konsiderueshëm grash dhe vajzash partizane u bënë skuadërkomandante, komandante apo zëvendëskomandante, komisarë apo zëvendëskomisarë, përgjegjëse të rinisë në formacionet e ndryshme, si në kompani, në batalion, në brigadë etj. Rol të rëndësishëm kanë luajtur dhe gratë e vajzat që u ngritën me përgjegjësi në seksionet politike të brigadave dhe divizioneve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Si organizuese dhe drejtuese të punës ushtarake në të gjitha hallkat dhe format e saj, punuan me frymë të lartë luftarake dhe ndërgjegje ushtarake.

Ishin mbi 6.000 gra dhe vajza që dolën në këtë luftë, e dhanë kontributin e tyre për çlirimin e vendit. Ato thyen mjaft koncepte dhe u radhitën përkrah burrave në këtë epope, duke dhënë dhe jetën për çlirimin e vendit. Ato flakën tej zakonet dhe thyen tabutë e kohës, duke u bërë shembull frymëzimi në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Një fakt me domethënie botërore është se në këtë luftë u ekzekutuan në litar apo u dogjën nga nazifashistët gjatë Luftës së Dytë Botërore, heroinat shqiptare: Bule Naipi, Persefoni Kokëdhima, Hibe Palikuqi, Fato Berberi dhe Liri Gero. Në kohën kur vendi ynë u pushtua nga fashistët italianë, në prill e vitit 1939, së bashku me grupet e rezistencës morën pjesë dhe gratë shqiptare. Në ballë të gruas shqiptare u afirmuan intelektuale, por dhe mjaft gra të thjeshta në qytet e fshat, duke bërë qëndresë në forma nga me të ndryshmet.

## Gratë dhe vajzat ishin qëndrestare të vijës së parë

Qendra të rëndësishme të luftës ishin qytetet e mëdha të vendit, ku një rol luajtën shkollat në të cilat mësonin mjaft vajza. Kështu, instituti femëror në Tiranë u bë vatër e rezistencës kundër fashizmit. Të gjithë e kemi parë filmin artistik “Vajzat me kordele të kuqe”, ku i bëhet jehonë pjesëmarrjes masive të tyre në këtë luftë që sapo kishte nisur të organizohej në vendin tonë. Studentet brenda institutit ndërmerrnin veprime të tilla si: nuk nderonin në mënyrë fashiste, grisnin flamurin italian, thyenin fotografitë e Duçes etj.. Në qytete e fshatra të Shqipërisë, format e qëndresës prej gruas ishin të ndryshme. Kështu, gjimnazistet e Shkodrës morën pjesë aktive në demonstratën e madhe antifashiste të organizuar më 28 nëntor 1940. Kurse në Tiranë, studentet e institutit femëror prishën mbledhjen në përkujtim të marshimit fashist mbi Romë, të cilën e kthyen në një demonstratë në rrugët e Tiranës. Shumë prej tyre u përjashtuan nga shkolla e institute. Midis vajzave të përjashtuara



ishte dhe heroina Margarita Tutulani.

Gruaja me prezencën e saj po luante një rol të rëndësishëm dhe me dinjitet e me vlera u rreshtua edhe ajo në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Fillimisht për të rritur numrin e grave e të vajzave në këtë lëvizje u organizuan bërthamë të vogla të gruas. Gra e vajza intelektuale me autoritet e nisën punën e tyre në lagje e fshatra, duke formuar grupe të cilat shpërndanin trakte e komunikata të ndryshme për luftë. Këto mjekonin aktivistë e partizanë të plagosur në aksionet e njësiteve dhe të çetave partizane, dhe shtëpitë e tyre u bënë strehë e u kthyen në vatra të rëndësishme të lëvizjes. Shumë gra në qytete bënë punë me shkollat, ku krijuan grupe dhe celula edukative, në të cilat kryheshin aktivitete, diskutohej, lexoheshin komunikata dhe këndoheshin këngë patriotike.

Në këtë lëvizje, e cila po merrte përmasa, u bashkuan gra të profesioneve të ndryshme si infermiere, mësuese, shtëpiake etj... Femra shqiptare, duke qenë shtyllë në familje, filloi të propagandonte luftën kundër pushtuesve. Ato punonin dhe shfrytëzonin festat tradicionale, mermin pjesë në ekskursione e grumbullime masive, mbledheshin dhe diskutonin për luftën, gatuanin dhe jepnin ndihma materiale etj... Vajzat në shkolla përdorën si mjet propagandues edhe teatrin, ku shfaqnin jetën, përpjekjet dhe luftën e tyre që bënin gratë në familje e kudo. Të gjitha këto forma, po bënin efekt të madh në popull dhe vet gruaja po fitonte vendin e saj në shoqëri dhe po e ndryshonte konceptin e gabuar që kishin shqiptarët në përgjithësi për të.

Gratë e Kavajës, në prill 1942, të mbuluar me çarçaf e perçe dolën bashkë me burrat e me të rinjtë në demonstratë për të kërkuar bukë. Ndërsa në Elbasan, më 8 gusht 1942, mjaft vajza morën pjesë në demonstratën e bukës. Haxhire Myzyri e Aleksandra Mano goditën majorin e xhandarmërisë fashiste. Një nga demonstratat më të përgjakshme ishte ajo në qytetin e

Korçës, ku mbetën të vrarë 59 persona dhe u plagosën 93 të tjerë, shumica e tyre ishin gra.

### **Organizata e gruas antifashiste ishte masive**

Gratë dhe vajzat nuk munguan në frontin e madh të luftës që u krijua kundër pushtuesve. Ato krijuan organizatën e tyre të gruas. Organizata e tyre i vuri vetes si qëllim pjesëmarrjen e saj në luftë, të ishte sa më e organizuar dhe në të ardhmen të merrte pjesë aktive në drejtimin e vendit. U krijua organizata Bashkimi i Gruas Antifashiste Shqiptare. Në të gjitha qytetet dhe krahinat u ngritën këshillat e grave antifashiste. Në Konferencën e Dytë Nacionalçlirimtare të mbajtur në Labinot të Elbasanit, nga 4-9 shtator 1943, mori pjesë dhe një delegacion i gruas shqiptare që përfaqësohej nga Ollga Plumbi, Ela Gjirkondi dhe Nexhmije Xhuglini. Delegacioni i grave kërkoi në këtë mbledhje që Organizata e Gruas të njihej dhe të bëhej pjesë e Frontit Nacionalçlirimtar. Kështu gruaja me plot dinjitet u rreshtua në LANÇ të popullit shqiptar.

Në të gjithë vendin gruaja u përfshi masivisht në luftë. Organizata e gruas krijoi këshillat e saj dhe ato filluan nga zbatimi i detyrave dhe qëllimit që i kishin caktuar vetes në këtë luftë. Mjaft gra humbën jetën në krye të punëve që u ishin ngarkuar nga këshillat e tyre. Kështu Esma Dervishin, anëtare e këshillit në Karbunarë, e vranë se shkonte në mal me ushqime, ndërsa Saretë Gabaj nga Smokthina, u kap nga nazistët dhe u torturua, ku u dogj e gjallë, sepse nuk dha informacion për partizanët.

Organizata filloi punën në çdo krahinë dhe në terren, ku dhe kishte nevojë. Gra e vajza të tilla si Bule Naipi, nga Gjirokastra, e cila vepronte në Libohovë e Konispol, ku organizoi dhe ngriti aktive me gra dhe grupe edukative. Gra të tjera si Qeriba Derri kthehen nga emigracioni dhe bashkohen me lëvizjen antifashiste. Qeribaja ngriti organizatën e gruas në mjaft fshatra të Lumit të Vlorës. Në Operacionin e Dimrit 1944, ajo ndodhej bashkë me partizanët e BrVS, në malet e Çikës. Aty tregoi heroizëm, por u kap nga nazistët dhe burgoset në burgun e Vlorës, ku torturohet barbarisht por informacion armikut nuk i dha e kurrë nuk u dorëzua. Pushkatohet më 4 prill 1944.

Organizata e Gruas shtroi si nevojë të domosdoshme ngritjen e një organi shtypi, i cili do t'i shërbente më mirë çështjes kombëtare. Revista "Gruaja shqiptare" doli në dritë si organ i Bashkimit të Grave Antifashiste të Shqipërisë në korrik të vitit 1943. Si pasojë e kushteve të vështira të luftës, vendi i botimit ndryshonte shpesh për shkak të terrorit që ushtronin fashistët. Pjesëmarrja e gruas në luftën e armatosur tronditi botëkuptimin borgjez, konceptet dhe paragjykimet mbi rolin dhe pozitën e saj në shoqëri. Ky botëkuptim dhe këto koncepte ishin kultivuar në shekuj. Pjesëmarrja e gruas në luftën e armatosur hodhi tej propagandën fashiste, e cila përpiqej t'i mbante gjallë e t'i ushqente koncepte frenuese. Fakti që gruaja ishte në gjendje të përballonte me sukses të gjitha pengesat e vështirësitë që sillte me vete lufta e armatosur, shkatërronte mitin, sipas të cilit gruaja si "seks i dobët" "ishte e destinuar gjoja vetëm për të lindur e rritur fëmijë, por, aspak e aftë të luftonte si burri, me armë në dorë dhe aq më tepër për luftën partizane", koncept ky i rrënjosur thellë në vetëdijen e shumë njerëzve, si të burrave ashtu dhe të grave.

### **Gruaja shqiptare në formacionet luftarake**

Në LANÇ, një numër i madh grash u rreshtuan në njësitë dhe formacionet e ndryshme të UNÇSH-së. Grave e vajzave iu ngarkuan detyra të rëndësishme si komandante e komisarë, përgjegjëse të rinisë dhe të grave në formacione të ndryshme si në

kompani, në batalion e në brigada sulmuese. Rol të rëndësishëm kanë luajtur gratë që ishin në detyra dhe përgjegjësi në seksionet politike të brigadave e divizioneve sulmuese. Kështu gra të tilla si: Eleni Terezi, Fiqirete Sanxhaktari, Vangjelo Sotiriadhi, Ramize Gjebrea, Urani Prendi, Liri Hakani etj., kanë pasur përgjegjësi në radhët e UNÇSH-së.

Kështu, në mjaft brigada sulmuese, si në BrIS, BrIIS, BrVS, BrXXS, BrXVIII, gratë dhe vajzat që ishin në detyra zinin mbi 30% të numrit të tyre. Në 13 brigada sulmuese, rreth 100 gra e vajza kanë qenë përgjegjëse rinie brigade, batalioni e kompanie, si dhe mbi 47 prej tyre kanë qenë në detyra komisarë e zëvendëskomisarë batalioni e kompanie. Është e rëndësishme të theksojmë se mjaft gra e vajza arsimtare ishin të lidhura me lëvizjen e dhanë një kontribut të vlefshëm.

Në Kongresin e Parë të Bashkimit të Gruas, në nëntor 1944, u shpalo kontributi dhe heroizmi i treguar nga gratë dhe vajzat shqiptare në luftën kundër pushtuesve nazifashistë dhe bashkëpunëtorëve të tyre. Një pjesëmarrje e tillë e organizuar, nuk ishte vërejtur më parë gjatë historisë tonë. Vajzat dhe gratë shqiptare u bënë shembull frymëzimi për guxim e trimëri, për ndershmëri e pastërti morale e shpirtërore, si dhe për forcimin e marrëdhënieve vëllazërore në radhët e luftëtarëve të lirisë.

Për aktet e larta të trimërisë dhe të vetëmohimit mbi 250 gra dhe vajza ranë dëshmore dhe midis tyre u shpallën Heroina të Popullit:



Bule Naipi, Persefoni Kokëdhima, Liri Gero, Margarita Tutulani, Shejnaze Juka, Mine Peza, Hibe Palikuqi, Nimete Progonati, Inajete Dumi, Zonja Çure, Qeriba Derri, Fato Berberi, Qybra Sokoli, Ylbere Belibashi, Shenjnaze Juka, Emine Peza, etj.

Pjesëmarrja e gruas në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, nuk ishte vetëm kushti vendimtar për çlirimin kombëtar e shoqëror të saj. Në të njëjtën kohë, kjo luftë shërbeu dhe si një shkollë e madhe për emancipimin shpirtëror të gruas shqiptare. Duke marrë pjesë aktive në të gjitha format e luftës e të organizimit, deri në kryengritjen me armë, gruaja shqiptare theu mjaft koncepte e praktika të vjetra dhe afirmoi veten e saj të denjë për një shoqëri të lirë dhe demokratike.

Në sajë të kësaj lufte dhe të përpjekjeve të vijueshme të bëra në këto 80 vjet pas lufte, ajo sot është më tepër e organizuar dhe po zë një vend të merituar në të gjitha shtresat e shoqërisë demokratike shqiptare. Fakt është se gruaja shqiptare sot është pedagogë, deputete, ministre, biznesmene, diplomate, oficerë, police, drejtuese institucionesh etj... Vetë lufta, kuraja dhe përpjekjet e saj në shoqëri e kanë radhitur atë të barabartë me burrat, dhe sot gëzon të drejta të plota, të njohura botërisht dhe të garantuara me ligje e Kushtetutë.

# Vajzat shqiptare që ranë për liri

## **Heroina e Popullit Hibe Palikuqi, komisarja trime partizane nga Dibra**

Hibe Palikuqi u lind në qytetin e Dibrës në vitin 1927. Qysh në moshë të re u përfshi në veprimtarinë që zhvillonte rinia në qytetin e Dibrës dhe shtëpia e saj ishte bazë e LANÇ-it. Në vitin 1943 u arrestua bashkë me të ëmën. Pas lirimit nga burgu ajo vazhdon me pasion të shumëfishuar veprimtarinë e saj antifashiste. Më vonë u rreshtua në batalionin partizan të Dibrës. Do të vazhonte më pas në radhët e Brigadës XVIII Sulmuese me detyrë zv/komisare kompanie. Mori pjesë në shumë luftime që kreu kjo brigadë në ato anë. Hibe Palikuqi ra dëshmore e Atdheut, më 23 shtator 1944, në luftimet që zhvilloi Brigada XVIII Sulmuese për çlirimin e Kërçovës. Që në moshën 17 vjeçare, Hibe Palikuqit, iu besua detyra e komisaresh së kompanisë së dytë, të batalionit të katërt, të Brigadës XVIII Sulmuese Partizane. Vitet e fëmijësisë të vajzës dibrane, Hibe Palikuqi, rrodhën të zbehtë, pa asgjë të veçantë nga ata të shoqeve të saj. Pasi kreu katër klasë të shkollës fillore, ajo u mbyll në shtëpi. Jashtë dilte e mbuluar me çarçaf dhe gjithnjë e shoqëruar nga njerëz të familjes. Fanatizmi kishte krijuar ligjet e veta, që s'mund t'i shkelte lehtë cilido. Por krisi pushka partizane dhe idetë e reja hynë në çdo shtëpi. Populli priste e dëgjonte me kënaqësi fjalët e luftëtarëve të lirisë. Edhe shtëpia e Sabrije Palikuqit, nënës së Hibës, u bë bazë e sigurt, ku shpesh kalonin dhe qëndronin ilegalët. Kështu që në vitin 1942, Hibja ra në kontakt me shokë ilegalë, të cilët strehoheshin përkohësisht në shtëpinë e saj, ose vinin për të marrë pjesë në mbledhjet që organizoheshin aty. Nën ndikimin e tyre Hibja u bë shpejt një propagandiste e shkathët në masën e grave. Ajo u mësonte grave dhe të rejave këngë partizane, organizonte mbledhje ndihmash për partizanët dhe kohën e grumbullimit të grave në stacionin e ujërave termale të Banishtit, e kthente në manifestime të hapura antifashiste, ku bisedohej e propagandohej për LANÇ-in. Veprimtaria e saj dhe dalja e vëllait të saj, Estrefit, në çetë në prill 1943, u bë shkas që fashistët ta burgosnin së bashku me nënën e saj dhe me motrën e vogël. Edhe në burg Hibja qëndroi ballëllartë. Me t'u liruar nga burg, Hibja u hodh edhe më me guxim në LANÇ. Vajza dikur e mbuluar me çarçaf, në prag të kapitullimit të Italisë fashiste, u pranua në radhët e Rinisë. Në manifestimin popullor që u organizua ditën që kapitulloi Italia fashiste, Hibja së bashku me 15 të reja dibrane u bashkua me manifestimet dhe, që atë ditë, u bë partizane efektive e batalionit të Dibrës.

Të gjitha detyrat që iu ngarkuan nga komanda partizane ajo i kreu



me guxim, zgjuarsia e shkathtësi. Pas luftës së Dibrës, nëntor 1943, forcat partizane u tërhoqën nga qyteti. Hibja u hodh në ilegalitet dhe veprroi në zonën e Zhupes së Dibrës, në fshatrat Ballancë, Prapanik, Selcë etj. Aty vazhdoi punën agjitative në popull dhe udhëhoqi një aksion të armatosur kundër një autokolone në rrugën Strugë-Dibër. Okupatori, në bashkëpunim të ngushtë me parinë reaksionare të Dibrës, organizoi gjatë dimrit 1943-1944 një operacion të rreptë. Hibja hyri ilegalisht në qytetin e Dibrës dhe, duke kaluar nga njëra shtëpi në tjetrën, u tregoi qytetarëve se parullat helmuese të armikut ishin të gënjeshtra, se partizanët s'do vononin të ktheheshin përsëri për ta goditur përfundimisht armikun dhe tradhtarët.

Në pranverën e vitit 1944, Hibja u hodh rishtazi në batalionin partizan të Dibrës dhe, që me organizimin e Brigadës XVIII Sulmuese, më 18 gusht 1944, u caktua zëvendës komisar e kompanisë së dytë të batalionit të katërt, i cili, më 16 shtator 1944, mori urdhrin që të hidhej në Kërçovë në ndihmë të brigadave shqiptaro-maqedonase

për të çliruar qytetin. Gjashtë ditë e gjashtë net udhëtoi batalioni. Shumë vështirë e patën partizanët gjatë rrugës. Hibja, megjithëse u lodh shumë, nuk u dha. Me këngën partizane në gojë, me optimizmin e thellë, ajo frymëzonte edhe shokët për të kapërcyer vështirësitë e rrugës, të mungesës së ushqimeve etj. Gjatë luftës, në një çast kritik, përpara kompanisë së dytë doli detyra që, një skuadër, me kundërsulm, të zaptonte një lartësi e që aty të mbronte tërheqjen e kompanisë dhe të gjithë batalionit. Hibe Palikuqi u vu në krye të kësaj skuadre dhe me breshëri automatiku u sul drejt kodrës, por mitralozi armik e plagosi rëndë dhe ajo ra heroikisht.

Rapsodi popullor dibran, për të kujtuar heroizmin e kësaj bije trime, dekoruar me titullin më të lartë “Heroinë e Popullit”, këndon:

“Shumë kish vuejt kjo Dibra plakë,/ Kudo tym e kudo flakë,  
Kish vuejt shumë, por nuk u shtrë./ Brof në kambë populli  
u çue,/ Brigad’ t’re na ka formue,/ N’ at Kërçovë na paska  
shkue,/ Gjermanët para i ka vue, / Shumë armiq o i ka farue./ -  
Kush asht ajo qi prin m’at anë?/ Po thot Hibja - Para partizanë!”

### **Qeriba Hoxha-Derri**

Qeriba Hoxha-Derri, luftëtarja e LANÇ-it, komandante dhe përgjegjëse e gruas, lindi në vitin 1905, në një familje me tradita atdhetare, në fshatin Matogjin të Vlorës. Idetë e mëdha të Rilindjes dhe të Pavarësisë Kombëtare, u ngulitën që kur ishte fëmijë tek Qeribaja. Ishte fëmijë 5-vjeçare kur nga jeta iu larguan babai dhe pastaj edhe nëna. Atë e zunë hallet dhe po rritej në mes të vështirësive e varfërisë. Rapsodi popullor i ka kënduar: “Qeriba, moj varfanjake,/ Moj e rritura bonjake,/ Jeta jote gjithë plagë,/ U rrite pa nënë e babë”. Të afërm dhe fisi Hoxha u kujdesën për të si për vajzën e tyre. Filloi të mësonte në shkollën e Matogjinit, ku mësues ishte atdhetari i madh, Halim Xhelu Tërbaçi. Ajo u martua me ushtarakun Shaqo Derri, i cili më vonë do të bëhej një nga atdhetarët e krahinës së Mesaplikut. Kështu Qeribaja përballoi me vendosmëri vështirësitë e jetës, përmes të cilave kalitej dhe bëhej e pathyeshme, sa në fshatrat Matogjin e Bashaj, e deri në Vlorë. Veprimtaria atdhetare e saj filloi që në Luftën e Vlorës 1920, ku u aktivizua në prapavijë si mbledhëse bukë e municione që dërgoheshin në vijën e frontit. Ajo merrej dhe me mjekimin e të plagosurve dhe ndihmonte familjet që ishin në vështirësi. ...Shaqo ishte oficer i Qeverisë së Nolit në vitin 1924.

Regjimi i mbretit Zog e ndoqi, por ai emigroi në Francë. Qeribaja mbeti në Smokthinë me familjen e të shoqit. Në vitin 1930, ajo siguroi vajtjen pranë bashkëshortit në Francë. Në Francë filloi një jetë e re. Ajo u takua me mësuesin e Matogjinit, Halim Xhelu. Të dy bashkë u ndodhën në krahë të tij. Qeribaja filloi të zhvillonte veprimtari dhe si aktiviste u zgjodh anëtare e Komitetit të Çlirimit Nacional (KÇN), që vepronte në mërgim. Ajo ishte e vetmja grua shqiptare që punonte me punëtorët francezë. Kjo detyrë e bëri që të mësonte frëngjishten. Qeribaja u bë kështu një aktiviste



e palodhur dhe propagandiste e flaktë e idesë së çlirimit kombëtar në radhët e punëtorëve shqiptarë të emigruar në Francë. Si arkëtare e degës të KÇN-së, mbante ndihmat e grumbulluara nga punëtorët emigrantë shqiptarë për nxjerrjen e gazetës “Liria Kombëtare”.

Në vitin 1933, Qeribaja dërgohet me detyrë në Shqipëri, ku bëri lidhje me antizogistët, dhe shpërndau materiale propagandistike. Ajo e bëri disa herë rrugën nga Parisi në Shqipëri, duke plotësuar detyrat që i caktoheshin. Të gjithë fshatrat e Lumit të Vlorës e njihnin Qeribanë, sepse ajo dallohej si agjitate dhe grua e thjeshtë. Kur shkonte në Bashaj ajo vishej me çitjane labe, merrte tërkuzën dhe shkonte me shoqe në mal për dru e në ara për të punuar. Në këtë mënyrë ka vepruar për të humbur gjurmët e punës patriotike që bënte në popull, por sidomos me masën e grave dhe të vajzave. Ajo jetoi për një kohë të gjatë në Francë. Ishte labe e shqiptare në shpirt. Diskutonte me gra e vajza dhe dëgjohej me vëmendje prej tyre. Duke qenë anëtare e degës së Komitetit të Çlirimit Nacional, ndihmonte shokët për raportin që përgatitej lidhur me Shqipërinë. Në vitin 1937 vjen përsëri në Shqipëri. Shkon në Tërbaç, ku ngushëllon familjen e Halim Xhelos, për vdekjen e tij. Në vitin 1938 kthehet përsëri në Francë dhe raporton tek Ali Kelmendi për gjendjen në Shqipëri. Takohet dhe me anëtarë të organizatës “Bashkimi Kombëtar”, si me Qazim Koculin, Ali Këlcyrën, Bahri Omarin etj. Veprimtaria e saj patriotike dhe revolucionare, bëri që Qeribaja të përfshihej në Luftën

Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Në vitin 1939, ajo bashkë me Shaqon kthehen në Shqipëri dhe shkojnë në fshatin Bashaj të Smokthinës. Që ditët e para të pushtimit fashist të Shqipërisë, edhe Qeribaja u rreshtua së bashku me luftëtarët e lirisë, për çlirimin e vendit nga pushtuesit. Qeribaja e gjeti Smokthinën dhe gjithë Mesaplikun që flakëronte nga lufta për çlirim, ku dëgjohej dhe kënga: “Moj krahinë e Mesaplikut/ Të griu gryka e çelikut/ Top e mortaj’ e armikut”. Dhe jo pak luftëtarë, e sidomos gra, mbledheshin rreth Qeribasë. Për veprimtarinë luftarake të Qeriba Derri flasin edhe dokumente të armikut. Në raportin e zëvendësprokurorit të Vlorës drejtuar Policisë, më 31 dhjetor 1942, thuhet se midis 100 grave pjesëmarrëse, katër prej tyre janë kryesore, midis këtyre Qeriba Derri. Kuestura e Vlorës urdhëroi që kjo të largohet nga qyteti për Smokthinë.

Në telegramin që i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë nga zëvendës kuestori R.M. njoftohet se, më 2 janar 1942, demonstrata e grave e zhvilluar ditën nga gratë e poshtme dhe nga fakti se gjatë tre ditëve popullsisë i është shpërndarë vetëm gjysma e e racionit të bukës që është 150 gramë për person. Qeriba Derri, grua e Shaqo Derri... burrat dhe prindërit e të përqendruarve janë thirrur dhe porositur dhe qenë marrë kundrejt tyre masat e më poshtme: Qeriba Derri të dërgohet në Smokthinë, që është fshati i saj dhe i burrit. Në këtë kohë, ajo ishte përgjegjëse e gruas për Mesaplikun. Shtëpia e saj u bë bazë e partizanëve dhe e ilegalëve. Fashistët kishin rënë në gjurmët atdhetare e revolucionare të saj dhe e kishin vënë në rreth të kuq. Qeribaja vepronte në qytet e në fshat, sidomos në Mesaplik. Në korrik 1943, zgjidhet përgjegjëse e këshillit krahinor të gruas për zonën e çliruar të Mesaplikut, ku më parë kishte organizuar mbledhjen e grave dhe të vajzave në fshatrat Ramicë, Brataj, Tërbaç, Vranisht etj. Pranohet anëtare e partisë në celulën e Smokthinës.

Qeribaja u bë një organizatore e dalluar e grave në Lëvizjen Antifashiste të zonës së Mesaplikut e të Lumit të Vlorës. Ajo ishte e kudondodhur. Në operacionin e Dimrit të vitit 1943-1944, shoqëroi të plagosurit nga Bolena për në spitalin partizan të Poliçanit në Gjirokastrë. Ajo gjendej pranë nënave e motrave, të cilave u jepte kurajë, për rënien e luftëtarëve në luftë. Kështu vepronte edhe në radhët partizane, ku ishte në vijat e para të luftës dhe në prapavijë, duke vepruar me energji dhe pa u trembur nga vështirësitë. Ishte bërë e pranishme e gjendej në çdo vatrë fshatari. Respektohej e nderohej jo vetëm në Smokthinë, por në tërë zonën e Mesaplikut dhe më gjerë, në Kurvelesh e Labëri. Populli i këndonte: “Në Shushicë kur u ktheve/ fishekë e gjerdan mbërtheve/ çave përpara s’u ktheve/ rrugët me gjak i leve”. Në Operacionin e Dimrit, në janar 1944, Qeribaja ndodhej bashkë me batalionin e dytë të Br.V S, në Grykë Pishë në Bolenë. Vendi ishte i mbuluar me dëborë. Korrieri që vinte nga Bolena soli lajmin se të gjitha rrugët për në Bolenë ishin të zëna nga gjermanët. Në këtë situatë kritike mbetej që rrethimi të çahet me sulm. Në këto çaste të vështira ajo u tregonte partizanëve episode nga heroizmi i komunarëve të Parisit, duke i mbushur

luftëtarët me frymëzim për luftën e drejtë që bëjnë. Batalioni partizan vazhdoi rrugën për të çarë rrethimin, ndërsa ajo kaloi në pyjet e Çipinit, ku shumë familje smokthinjote ishin strehuar për t’i shpëtuar masakrave të nazi-ballistëve.

Në këto rrethana ajo mbajti lart moralin e popullit, të grave, por u diktua nga spiunët ballistë, u kap befasisht me të kunatin, Elmazin, e tradhtuar nga njerëz të shitur tek pushtuesi nazistë dhe e burgosën në burgun e Vlorës. E mbajtën disa javë në burg. E torturuan. I kërkonin të hiqte dorë nga lufta, nga idealet e saj. Por edhe në burg, ajo qëndroi e pamposhtur, si trimëreshë edhe u dha trimëri të burgosurve nga trimëria e saj. Edhe në burg, Qeribaja u fliste shoqeve të tjera për guximin që duhej të kishin vajzat dhe gratë shqiptare, për besimin që duhej të kishin në fitoren e luftës. Në njoftimin që prefekti i Vlorës i bënte Ministrisë së Punëve të Brendshme të Tiranës, nga Vlora, më 28 shkurt 1944, thuhej se: “Kemi nderin t’ju njoftojmë se, më datë 14 të këtij muaji është arrestuar prej organizatave të Ballit Kombëtar të Vlorës gruaja e quajtur Qeriba Derri, bija e Muhametit dhe e Nefizes, bashkëshorte e ish-kapitenit Shaqo Derri, vjeç 36, pa fëmijë, lindur e banues në katundin Matogjin, Smokthinë të komunës Brataj... Qeribaja ka qenë një grua e rrezikshme komuniste dhe një nga eksponentët që ka zhvilluar propagandë në klasat femërore të kësaj prefekturë dhe të Gjirokastrës, madje duke qenë në bashkëpunim me çetat komuniste, e arratisur”.

Më 4 prill 1944, ballistët, mercenarët dhe nazistët e nxorën nga burgu bashkë me kunatin e saj Elmaz Derri, si dhe partizanët Zenel Prushi, Çize Arifi dhe Refat Hila. I rreshtuan të pestë përpara ish-xhamisë së Tabakëve për pushkatim. Qeribaja në këto moment thirri: “Gjaku ynë do të merret...”. Në njoftimin që prefekti i Vlorës i dërgonte Ministrisë së Punëve të Brendshme të Tiranës, thuhej se: “Ju parashtrojmë se më datën 4.4.1944, në tregun e këtij qyteti u pushkatuan 5 (pesë) komunistë të rrezikshëm... Të ekzekutuarit janë: Qeriba Derri, komuniste e terroriste nga Smokthina, e burgosur. Bashkangjitur ju paraqesim dhe një shpallje me dy kopje rreth ekzekutimit të tyre”.

Armiqtë e pushkatuan Qeribanë, por ajo mbeti e gjallë, jo vetëm në zemrat e smokthinjotëve, por të mbarë popullit shqiptar. Me qëndresën heroike, edhe pse ndodhej para pushkatimit, mesazhi i saj për shokët e shoqet bashkëluftëtarë ishte: “Lart zemrat!”. Dhe hyri në zemrat dhe këngën e partizanëve e të popullit dhe u dëgjua kënga: “Gjithë e panë Qeribanë,/ trimëreshën e paepur/ edhe përpara gestapos/ nuk iu shua buzë e qeshur”. ...Populli i këndoi Qeribasë: “Tek Sheshi i Vlorës, te xhamija/ shumë e hidhur historia/ Smokthinës iu vra e bija/ më lart u ngrit trimëria”. Qeriba Derri është shpallur dëshmore e Atdheut dhe Heroinë e Popullit. Emrin e saj e mban shkolla 9-vjeçare në Bashaj, si dhe një rrugë në qytetin e Vlorës. Për të është shkruar nga gjenerali Bako Dervishaj libri “Qeriba Derri - bija e Labërisë”. Për veprimtarinë dhe trimërinë e saj janë thurur dhe këndohen mjaft këngë, poezi, si dhe janë bërë skica e portrete, deri edhe Posta Shqiptare e ka etiketuar në një pullë zyrtare, etj. Në çdo përvjetor populli e nderon dhe përulet me respekt para jetës dhe veprës së saj heroike.

# ‘Të luftojmë që të mos turpërohemi para brezave...’

## Dëshmorë nga Çamëria rënë për lirinë e Shqipërisë

Xhezmi Delli lindi në Tiranë në vitin 1918, ku në rrugicën “Sulejman Pasha”, në një lagje të vjetër të saj, gjendej shtëpia e familjes Delli, me numrin e portës 39. Prindërit e tij kishin ardhur nga Margëlliçi dhe ishin vendosur në Tiranë. Shtëpia ishte prej qerpiçi dhe e vjetër, e ndarë në tri dhoma të vogla. Në njërin nga dhomat e kësaj shtëpie, në kohën e reaksionit më të egër, gjatë viteve 1942-1943, bëheshin vazhdimisht mbledhje të drejtuesve të PKSH-së, që punonin ilegalisht në Tiranë. Në shtëpinë përdhese të familjes Delli vinin të maskuar me veshje të ndryshme, herë si punëtorë, elektrikistë e herë si intelektualë, antifashistët dhe luftëtarët e lirisë Gogo Nushi, Beqir Balluku, Kozma Nushi, Fiqrete Sanxhaktari (Shehu), Nexhmie Xhuglini (Hoxha), Abdyl Këllezi, e të tjerë, ku merrnin udhëzime dhe orientime nga Tarasi, drejtuesi kryesor i PKSH-së.

Shtëpia ishte bazë e luftës dhe këtu bëheshin mbledhje të qarkorit, mbledhje organizatash Partie dhe Rinie etj. Pozicioni i shtëpisë ishte i atillë që lejonte, në rast nevojë, largimin me lehtësi të shokëve, përmes bahçeve, që lidheshin me njëra-tjetrën deri në rrugën e Fortuzit, pranë burgut. Ka ndodhur shpesh që ilegalët pas shumë orë pune, shtroheshin këmbëkryq në sofër bashkë me pjesëtarët e familjes Delli. Midis tyre gjendej dhe Enver Hoxha, i cili me thjeshtësinë dhe përzemërsinë e tij, dukej si djalë i shtëpisë. Nga kjo shtëpi niseshin për aksione anëtarë të njësiteve guerile të Tiranës, të cilët, në mes të ditës, kryenin aksione të guximshme. Kjo shtëpi e vogël, ishte bërë qendër e rëndësishme e aktivitetit revolucionar të antifashistëve dhe tërhoqi vëmendjen e armikut. Në orët e vona të një nate maji të vitit 1942, pushtuesit dhe tradhtarët e rrethuan shtëpinë. Në mënyrën më barbare, shkëputën nga gjiri i familjes djalin e shtëpisë Xhezmi Dellin. Atë e torturuan dhe i bënë presion që të tregonte për lëvizjen, por fashizmi dhe tradhtarët nuk e përkulën luftëtarin. Për mungesë faktesh e liuan. Shtëpia e tij mbeti përsëri strehë dhe bazë e ilegalëve. Në demonstratën e madhe të organizuar përpara burgut, ku u vra nga plumbat e fashizmit nëna Mine Peza dhe u plagosën shumë të tjerë, shtëpia u bë qendër, ku u grumbulluan më se dyzet vajza të reja, të cilat, të mbuluara me çarçaf, kishin marrë pjesë atë ditë në demonstratë.


Shtëpia u diktua nga fashistët, spiunët dhe tradhtarët, të cilët e rrethuan atë dhe me forca të mëdha arrestuan të gjithë sa ndodheshin brenda. Që nga kjo kohë, shtëpia u bë objekt gjurmimi të vazhdueshëm nga fashistët dhe tradhtarët.

Në muajin prill të vitit 1943, i deleguar i Komitetit Qarkor të Tiranës, Xhezmi Delli mori pjesë së bashku me patriotë pa parti në një mbledhje me disa përfaqësues, krerë të Ballit Kombëtar. Në mbledhje Xhezmiu mbrojti me vendosmëri Lëvizjen dhe luftën kundër fashizmit dhe nuk ishte dakord me përfaqësuesit e Ballit Kombëtar për qëndrimin e tyre. Po kështu Xhemziu kundërshtoi dhe kompromisin e BK-së me fashistët dhe sidomos protokollin “Dalmazzo-Ali Këlcyrë”. Këtu Xhezmiu u ekspozua shumë. Drejtuesit e lëvizjes në Tiranë e porositën të largohej nga Tirana, se qëndrimi i tij ishte në rrezik. Pas kësaj mbledhjeje, në ato ditë Xhemziu po përgatitej për t’u hedhur në ilegalitet, organet e fashizmit, spiunët e tij (SIM-i) në bashkëpunim me tradhtarët e rrëmbyen Xhezmiun. Që prej datës 23 prill 1943, Xhemziu u zhduk mizorisht nga fashizmi. Për të përjetësuar emrin e Xhezmi Dellit, në Tiranë në Njësinë Administrative nr. 3 është shkolla 9-vjeçare me emrin “Xhezmi Delli”. Është shkruar në librin “Yje të Pashuar” në vëllim I, Tiranë, 1971, f. 226.

## Nuk e lëshoi pozicionin për 55 ditë luftë

Zihni Elamaz Shaqiri ka lindur në Shqefar, pranë Konispolit, më 14 prill 1927, në një familje të thjeshtë punëtori. Në shkollën e Konispolit, Zihniu ishte nxënës i sjellshëm dhe i zellshëm për dije. Babai, Elmazi kishte dëshirë që i biri të kryente një shkollë të mesme. Por në vitin 1937 babai vdes dhe Zihniu mbeti jetim. Ishte 10 vjeç kur la shkollën dhe u detyrua të punojë për të mbajtur nënën, tre vëllezër dhe motrën. Ai u detyrua të punojë në punë të rënda dhe mbi supet e tij të njomë provoi barrën e shtypjes, fyerjen e poshtërimit. Kur fashizmi italian sulmoi Shqipërinë Zihniu ishte 12 vjeç. Në janar të vitit 1943 Lëvizja Antifashiste Nacionalçlirimtare në krahinën e Konispolit po zgjerohej dhe po krijoheshin formacione dhe njësi partizane për luftë kundër armikut dhe tradhtarëve, Zihniu u bashkua me të rinjtë antifashistë. Në korrik të vitit 1943 mori pjesë aktive në komandën partizane të vendit, që në këtë kohë kryente funksione të rëndësishme për

## DËSHMORE NGA ÇAMËRIA RËNË PËR LIRINË E SHQIPËRISË



XHEZMI DELLI



ZIHNI SHAQIRI



ALI DEMI



BIDO SEJKO

Frontin Nacionalçlirimtar, duke kryer detyrën e korrierit. Më 5 gusht 1943, në ditën e parë që forcat partizane u ndeshën me forcat gjermane që vinin nga Sajadha e Greqisë për të kaluar në Qafë Botë, Zihniu 16 vjeçar u rreshtua partizan në çetën e parë të batalionit “Çamëria”. Ai mori pjesë në të gjitha luftimet e mëvonshme që ndërmori batalioni kundër armikut dhe luftoi si anëtar i denjë i rinisë shqiptare.

Më 20 gusht 1943, nazistët gjermanë të udhëhequr nga ballistë dhe tradhtar ndërmorën një sulm të paparë kundër zonës së Konispolit. Armiku goditi me artileri të rëndë, sulmoi pozicionet partizane në Likojan dhe në Qafë Botë. Lufta ishte e rreptë. Zihniu edhe pse ishte me temperaturë, nuk u nda nga llogoret e luftës, rezistoi dhe luftoi bashkë me shokë. Temperatura nuk po i ulej dhe ishte mjaft i sëmurë, komisar i çetës urdhëroi që të shkonte pranë familjes së tij të shpërngulur nga lufta në fshatin Klllogjer. Ai shkoi, u takua me nënën, vëllezërit dhe motrën, duke u thënë: “Erdha t’u shoh për t’u çmallur, nuk prish punë se jam në ethe, ato do të kalojnë. Më duhet me çdo kusht të kthehem tek shokët sonte, sepse luftën e kemi në prag të derës. Armiku do goditur”. U përqaftua me të gjithë dhe ashtu i zhuritur nga ethet, u dha këmbëve për tek shokët që ishin në luftë. Dita e 27 shtatorit 1943 ishte vendimtare për armikun e gjakatosur rëndë në 55 ditë beteje me partizanët e batalionit “Çamëria”, si dhe forcat territoriale të të gjithë krahinës së Konispolit dhe të Vurgut. Armiku sulmoi me forca të shumta. Plani i armikut ishte që t’u impononte forcave tona të pakta në numër një luftë frontale për t’i asgjësuar lehtë, por

nuk ja arriti dot qëllimit. Në luftimet e kësaj dite ishte dhe Zihniu që luftonte... Në Butas ra. Copa të predhës së murtajes e kishin marrë në kokë dhe në kraharor...

Për dëshmorin u bë kënga: Zihni partizani, lule e rinisë,/ Zot i dole vendit, luftëtari i lirisë,/ Hije të kish shtati, pushka dhe gjerdani,/ I kuq të ndriste ylli, Zihni partizani.

Është shpallur dëshmor i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare me vendim nr. 166, datë 27 dhjetor 1977 të Komitetit Ekzekutiv të rrethit të Sarandës. Është shkruar në librin “Yje të Pashuar” në vëllim XI, Tiranë, 2002, f. 269.

### Antifashisti Ali Demi, biri i Çamërisë që ra në Labëri

Biri i Çamërisë së sflitur nga shovinizmi grek, Ali Demi, i gjendur familjarisht në Tiranë, do të jepte një ndihmesë të shquar në organizimin e qëndresës popullore kundër fashizmit në krahina të ndryshme të Shqipërisë si në Tiranë, Çermenikë, Kërrabë, Zaranik dhe në trevën e Labërisë e kryesisht në Vlorë dhe në krahinën e Mesaplikut. Tashmë dihet botërisht se më 29 prill 1943, antifashisti Ali, së bashku me 26 të burgosur politikë të tjerë, pas një pune këmbëngulëse dhe në heshtje të plotë, hapën një tunel të nëndheshëm dhe u arratisën nga burgu i Tiranës. Menjëherë Ali Demi shkoi në Çermenikë, ku kreu detyrën e komisarit të çetës në batalionin e Çermenikës, duke kryer disa luftime në Shqipërinë e Mesme. Në fund korriku 1943, u dërgua me detyrë sekretar i Qarkorit të Partisë Komuniste për Vlorën dhe më pas si sekretar politik. Në krye të kësaj detyre Aliu u gjend kudo në fshatrat e krahinës së Mesaplikut dhe në qytetin e Vlorës, së bashku me të

deleguarit e tjerë Ramize Gjebrea, Andrea Varfi, Lefter Kasneci, Selim Alimerko etj.

Trimëria dhe guximi i tij spikatën në luftimet e zhvilluara në këtë periudhë në qarkun e Vlorës. Ai dha një ndihmesë në formimin e çetave partizane të Bregdetit, “Bashkimi” të Topalltisë, “Sali Murati” të Vranishtit, “Myzeqesë” të Myzeqesë së Vogël në Vlorë, të “Halim Xhelo” e “Avni Rustemi”. Ai mori pjesë si luftëtar në Luftën e Drashovicës, ishte në Vranisht për krijimin e Gr. 2 Partizan të Vlorë, më 30 tetor 1943, ishte anëtar i Shtabit të ZIOp që në fillim të tetorit 1943. Punoi fort në përgatitjen për krijimin e Br.VS, të formuar më 28 nëntor 1943, në Gumenicë të Vlorës. Ali Demi dhe një ndihmesë të dukshme në ngritjen e pushtetit ushtarak të prapavijës në komandën e Qarkut Vlorë, në Komandat e Vendit në Topallti, Drashovicë, Brataj, Kuç, si dhe organizimin e Rojës Partizane Vullnetare Fshatare.

Duke qenë gjithnjë në lëvizje, Aliu kishte rënë në sy të pushtuesit dhe të tradhtarëve. Në mbrëmjen e 19 dhjetorit 1943, duke u kthyer natën vonë në bazën e tij në Kaninë, dhe pse në kalanë e Kaninës kishte gjermanë. Baza e tij ku strehohej ishte rrethuar nga gjermanët e ballistët. Thirrjes së tyre për t'u dorëzuar, Aliu me dy shokët, iu përgjigj me grykën e maliherit. Mbi ta filluan të bien edhe predha artilerie e mortajash. U vra shoku i tij Pano Dhimëgjoka. Plagoset Dhimitër Mandro, shoku tjetër. Aliu për të mos rënë i gjallë në duart e armikut, çan rrethimin, por te qafa e Dheut të Bardhë goditet dhe bie në fushën e nderit si trimat...

Më 9 korrik 1945, Këshilli i Përgjithshëm Antifashist, i jep titullin më të lartë, plotësisht të meritueshëm, “Hero i Popullit”. Emrin e Ali Demit e mbajnë rrugë dhe shkolla të ndryshme në Shqipëri, veçanërisht në Tiranë dhe në Vlorë. Për të janë shkruar libra, monografi, poezi, janë bërë buste dhe është pasqyruar në artet figurative. Ai është shpallur Dëshmor i Atdheut me vendim nr. 104, datë 20.06.1977, të Komitetit Ekzekutiv Tiranë dhe varri i tij gjendet në varrezat e Dëshmorëve në Vlorë. Në këtë manifestim për Antifashizmin çam, në 80 vjetorin e Çlirimit të Atdheut, populli i trevës së Labërisë përulet me nderim para veprës së lartë atdhetare të birit të shquar të Çamërisë, Ali Demi. Ai i përket Vlorës heroike, pasi dha jetën në luftë me pushtuesit gjerman dhe reaksionin në kalanë legjendare të Aranitëve. Antifashisti ngeli përjetësisht në Vlorë për t'u treguar brezave heroizmin partizan në luftë për çlirim dhe pavarësi...

#### **Mësuesi luftëtar çam Bido Sejko ra për Shqipërinë**

Bido Sejko ka lindur në vitin 1900, në qytetin e Filatit në Çamëri. Babai i tij, Haki Sejko ishte një patriot dhe i dëgjuar në krahinën e Çamërisë, burrë me autoritet dhe luftëtar. Bido në Filat nisi shkollën, ku mësues pati atdhetarë të shquar si Qamil Izet Gamin, Rexhep Hamit Demin etj. Ai u rrit me ndjenjën e frymës patriotike, kur shikonte se në shtëpinë e tij, babai si kryetar i klubit kombëtar të Filatit, organizonte mbledhje. Në shtëpi mbledheshin mjaft njerëz sa dhoma e pritjes së miqve mbushej plot. Kështu sa herë në shtëpi vinin njerëz, ai vishej me rroba të reja dhe përsëhënde ata burra të moçëm dhe fisnikë, që kuvendonin me orë të tëra për fatet e krahinës dhe të vendit. Në këtë kohë Bido ishte nxënës me studime në Torino. Në shkollën ku mësonte ai bashkë me disa shqiptarë, personeli italian në shkollë bënte një politikë diskriminuese dhe fyese kundër popullit shqiptar dhe luftëtarëve

vlonjatë. Në një nga ditët, kur një italian i quajtur Armando po villte vrer kundër luftës së popullit shqiptar, Bido, i pasuar nga shokët e tij shqiptarë iu hodh përsipër Armandos. I dha kështu një mësim të mirë. Në ato ditë duke marrë zemër nga ndërhyrja dhe mbrojtja e policisë disa elementë italianë shkruan në muret rrethues të shkollës: “Poshtë Shqipëria”. Kur Bido i pa, me një shpejtësi të madhe, i fshiu shkrimet që fyenin atdheun dhe shkroi: “Poshtë shkelësit dhe vrasësit italianë”. Bido u përjashtuan nga shkolla, si dhe e përzunë nga toka italiane. Bido, pas përjashtimit nga shkolla u kthye në vendlindje. Tashmë grekomëdhenjtë kishin krijuar kushte të padurueshme në tokën çame. Ai ishte krenar nga natyra, por dhe nga kultura familjare dhe ambienti patriotik ku u rrit dhe u formua, nuk mund t'i duronte dot veprimet djallëzore dhe të neveritshme të disa grekëve...

Për shumë vite ushtroi detyrën e mësuesit dhe dha mësim nëpër shkollat e Çamërisë, duke përgatitur dhe edukuar mjaft luftëtarë dhe patriotë për kohën. Kjo u manifestua dukshëm në vitet e Luftës së Dytë Botërore, ku Shqipëria u pushtua e para nga fashistët italianë. Në fillim të vitit 1943, mësuesi doli partizan. Trimëria e rrallë dhe aftësitë e veçanta organizative të tij, spikatën gjatë luftimeve 55 ditore kundër nazistëve në Konispol. Në këto luftime mësues Bido komandoi një njësit të batalionit partizan “Çamëria”. Në janar të vitit 1944 nga ky batalion u dërgua në Brigadën VI Sulmuese (BrVIS) një kompani, ku bënte pjesë dhe mësues, tashmë luftëtar, Bido. Ai mori pjesë në mjaft luftime, por më kryesori ishte ai për marrjen e Kalasë së Margëlliçit, ku ra heroikisht Meleq Gostinishtit, i cili ishte zëvendëskomandant i batalionit të katërt të BrVIS, që mbante emrin “Naim Frashëri”. Këtë detyrë komanda e brigadës ia ngarkoi mësuesit luftëtar Bido Sejkos. Bido mori pjesë në një sërë luftimesh dhe përpjekjesh dhe në të gjitha u shqua si një luftëtar e komandant i zoti. Në luftimet që u zhvilluan gjatë vijës Brataj-Lepenicë, në luginën e Mesaplikut me forca të shumta nazistë që përpiqeshin të çanin nëpër zonën e lirë gjatë lumit të Vlorës dhe të dilnin në Kurveleshin e Sipërm, Bido, krejt papritur, duke manovruar dhe me një njësit prej 23 luftëtarësh, u doli mbas shpine dhe i goditi befaz e me guxim nazistët. Sulmi ishte i befasishtëm dhe i hutoi dhe i goditi rëndë armiqtë, gjë që u dha mundësi forcave të tjera partizane t'i asgjësonin. Luftimi i fundit i Bido Sejkos ishte në mesditën e 22 qershorit 1944, në kreshtën shkëmbore të malit Saraqin, mbi katundin Dishat të Sarandës. Këtu, ai u ndodh përballë më se 15 nazistëve të fshehur e të strukur mbas shkëmbinjve. Ai luftoi trimërisht deri në çastin kur një plumb armik e goditi për vdekje mësuesin e dashur të krahinës, partizanin e komandantin trim Bido Sejko. Mësues Bido Sejko ishte dhe mbetet një nga figurat më të shquara të brezave të mësuesve dhe të luftëtarëve të popullit shqiptar. Ai është dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me dekoratat: “Medalja e Çlirimit”, “Medalja e Trimërisë” dhe “Medalja e Kujtimit”. Bido Haki Sejko është shpallur Dëshmori i Atdheut me vendim nr. 166, datë 27.12.1977 të Komitetit Ekzekutiv të Sarandës. Për të është shkruar në shtypin e kohës si dhe në serinë e vëllimeve të “Yje të pushuar”, në vëllim 3. Emrin e tij e mban shkolla e mesme e bashkuar “Bido Sejko” në Konispol. Varri i tij gjendet në varrezat e dëshmorëve të Konispolit.



Nazif Daut Xhavari (1927-1944)



Sami Hito Muçaj (1928-1944)



Ali Osman Spahiu (1930-1944)



Mete Bajram Gjonaj (1927-1944)



Qani Jaho Hyskaj (1926-1944)



Agllai Naum Tako (1926-1944)



Estref Abdurahman Caka (1919-1944)



Fane Petro Kromidha (1920-1944)

# Dëshmorë të BrIS, rënë për çlirimin e Tiranës

**F**orca të BrIS gjendeshin të rreshtuara nga rruga e Elbasanit-Farkë-Teqe e Bektashinjve-kodrat përmbi Xhenio-Babrru-shkolla e Dakos, me një batalion rezervë në Valias-Lankas. Sulmi për fazën e parë të luftimeve filloi më 29 tetor 1944, dhe përfundoi më 11 nëntor 1944. Në përfundim të kësaj faze, çdo gjë ishte gati për sulmin përfundimtar. Në luftimet e fazës së parë për çlirimin e Tiranës ranë dëshmorë, si dhe pati mjaft partizanë të plagosur.

## Partizani i çetës “Plakë” ra për çlirimin e Tiranës

Pranverë e vitit 1943, në të katër anët e Shqipërisë ishte ndezur lufta partizane për liri. Idetë e luftës çlirimtare kishin hyrë në çdo vatrë të thjeshtë të popullit, në çdo zemër patrioti. Këto ide ngritën peshë dhe zemrën e djaloshtit 21-vjecar Nazif Daut Xhavari nga fshati Lerven i rrethit të Fierit. Një natë maji të vitit 1943, la qetë në livadh dhe u nis për të takuar çetën “Plakë” të Mallakastrës...

## Nëntor i vitit 1944

Komanda e BrIS mori urdhër nga komanda e DIS të hidhej në mësymje për çlirimin e qytetit të Tiranës në mbrëmjen e 1 nëntorit 1944. Afër mëngjesit batalionet e BrIS u hodhën në mësymje; armiku duhej të thyhej me çdo kusht. Tirana duhej çliruar. Një tank ishte bërë pengesë për përparimin e b5p në thellësi të bulevardit të madh. Nazifi, si gjithmonë në ballë të skuadrës së tij, i armatosur me bomba dore, vendosi të asgjësojë tankun, por në momentin kur bëhet gati të hedhë bombat sipër tankut, diktohet nga mitraljeri i tankut shtiu mbi trupin e tij të njomë një breshëri plumbash... Është shpallur Dëshmor i Atdheut me vendim nr. 50 datë 31.03.1972 të Komitetit Ekzekutiv të Rrethit të Fierit.

## Në sulm për të kapur fortesën gjermane

Sami Hito Muçaj lindi në Dhëmban të Tepelenës, më 1928, në një familje fshatare të varfër, që mezi përballonte jetesën. Për një kohë, 1940-1941, punoi si punëtor në një ndërmarrje ushtarake për mirëmbajtjen e rrugëve, por si njeri i dyshimtë dhe kundërshtar i fashizmit u pushua nga puna. Pas kësaj shkon në Vlorë dhe bashkëpunon me ilegalë të qytetit. Më 1 nëntor 1943, u inkuadrua në rreshtat partizane të BrIS. Në përlëshje fyt për fyt me armikun me pushkë dhe bomba dore, në luftë për çlirimin e Tiranës, më 3 nëntor 1944, vritet në sulm përmbi një fortesë të gjermanëve. Është shpallur Dëshmor i Atdheut me vendim nr. 44 datë 03.08.1971 të Komitetit Ekzekutiv të Rrethit të Tepelenës.

## Tiranasi që ra dëshmor për Tiranën

Ali Osman Spahiu lindi në Tiranë, në mars të vitit 1930. Ishte bir i një familjeje të varfër punëtori. Në luftë e sipër, në ato mbledhjet e zjarrta, u pranua në radhët e organizatës së Rinisë Komuniste. Pas kësaj dite, mori pjesë aktive në aksionet e luftimet që zhvilloi kompania e katërt e batalionit të katërt të BrIS, ku bënte pjesë Ali Spahiu. Batalioni i katërt i brigadës, pas ndeshjeve të ashpra me armikun, përparoi prej Varrit të Bamit gjer tek instituti femëror. Kjo ishte një lëvizje me sakrificë të mëdha, çdo metër e gjak. Tregoi guxim e pjekuri në çdo luftim, deri ditën e fundit të jetës së vet, që dita e 5 nëntorit 1944. Luftohej me vetëmohim për çlirimin e Tiranës. Kjo ishte dita e fundit që partizani i vogël Ali Spahiu mori pjesë në betejat e ashpra me armikun. Ra, pa mbushur ende të pesëmbëdhjetat. Është shpallur dëshmor i Atdheut me vendim nr. 58, datë 17.08.1948 të Komitetit Ekzekutiv të KP të Rrethit të Tiranës.

### **Rrugët e Tiranës u skuqën dhe me gjakun e tij**

Mete Bajram Gjonaj, lindur më 4 qershor të vitit 1927, në një familje të varfër, por plot virtyte të Dhëmbanit, u rrit me varfëri dhe halle si gjithë të tjerët. Në fshat asnjëherë nuk e ngopi barkun me bukë. Edhe shkollën fillore nuk pati mundësi ta mbaronte, pasi që në moshën 9 vjeçare u kulloste lopët fshatarëve. Vuajtjet dhe hallet e mësuan të dallonte të mirën nga e keqja, padrejtësinë nga e drejta dhe kjo shpesh e revoltonte djalin e ri. Qysh në maj të vitit 1943, ai u lidh me shokët komunistë të fshatit, mori pjesë aktive në Rininë Komuniste të tij, duke u bërë një agjitor aktiv i Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare. Më 1 dhjetor 1943, u radhit me forcat e BrlS dhe nuk u shkëput prej saj për asnjë çast. Duke treguar guxim dhe trimëri të rrallë, gjaku i tij skuq rugët e Tiranës, më 10 nëntor 1944, në përleshje fytyrë fytyrë me fashistë e gjermanë. Është shpallur Dëshmor i Atdheut me vendim nr. 44, datë 3.8.1971 të Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit Tepelenë.

### **Qëndroi në barrikadë deri në minutën e fundit...**

Qani Jaho Hyskaj, lindi më 20 gusht 1926, në familjen e nderuar të Hyskajve të fshatit Matohasanaj. I ati, Hyska, bënte punët më të rënda për t'i siguruar familjes bukën e gojës. Këtë barrë të rëndë e ndjeu shpejt edhe djali i tij, Qaniu. Fare i ri, në shi e borë, i veshur keq dhe me opinga me tela, Qaniun do ta gjeje duke ruajtur bagëtitë e lagjes ku banonte. Kur mori lidhje me militantët e lirisë në fshat dhe krahinë hodhi pushkën krahut dhe nuk e lëshoi kurrë atë. Në fillim në çetën territoriale dhe që nga 1 dhjetori 1943 në rreshtat e BrlS. Ai luftoi si trimat, në të gjitha betejat që zhvilloi ky formacion i lavdishëm luftarak. Ra heroikisht, për të mos vdekur kurrë, më 10 nëntor 1944, në luftën për çlirimin e kryeqytetit, Tiranë. Është shpallur dëshmor i Atdheut me vendim nr. 44, datë 03.08.1971, të Komitetit Ekzekutiv të KP të Rrethit të Tepelenës.

### **Përpara shokë, të ngrini sa më parë flamurin e fitores!**

Agllai Naum Tako, kur mori vesh se brigada e saj do të sulmonte për çlirimin e kryeqytetit u shpreh "edhe unë do të jem luftëtarë e çlirimit të Tiranës, e kryeqytetit tonë! Ç' nder i madh që na bëhet", tha kur mori vesh lajmin se brigadës së saj i ishte besuar detyra e rëndësishme". Rrobat partizane, kapela me yll në ballë, automatiku i shtrënguar në gjoks e burrëronin, partizanen nga Përmeti, të marrë pjesë në të gjitha luftimet që kishte zhvilluar kjo njësi luftarake e UNÇSH-së. Automatiku në dorën e saj ish bërë shok i pandarë, dhe me të në beteja zbriti nga kodrat e Shën Prokopit, në rugën e Elbasanit e drejt qendrës së Tiranës. Iu afruan çlirimit... Me këto ëndrra hyri në Tiranë, në Tiranën e përflakur. Një mitraloz, nga një bunker i vendosur mu në qendër të qytetit, gërgëriste egërsisht dhe pengonte sulmin e partizanëve. Ngado ndiheshin krisma mitralozash dhe automatikësh të partizanëve dhe ndërmjet tyre edhe krismat e automatikut të Agllaisë. Një autobлинд gjermane vërtitej si një bishë e egër dhe qëllonte nga mundte. Agllaia ish shtrirë barkas dhe kish vënë në shënjestër një mitraloz gjerman që qëllonte nga dritarja e një pallati. Në çdo rrugë luftohej, në çdo rrugë ngriheshin barrikada. Ndërmjet luftëtarëve të lirisë ishte vajza e vogël që duke vrapuar, i afrohej asaj çerdheje mitralozi që villte zjarr nga dritarja e pallatit. Autoblinda e pengonte. Edhe bunkerit në mes të qytetit nuk e lejonte me të shtënat e tij që luftëtarja të kalonte matanë rrugës qendrore. Por ...bunkerit në mes të qytetit u përflak. Një plasje e madhe granate e gozhdoi në vend autoblindën gjermane. Partizanët sulmuan. Agllaia qëlloi kundër mitralozit të vendosur në dritare. Mitralozi për një çast heshti... Agllaia u ngrit të sulmonte së bashku me shokët e saj. Pranë Lanës hodhi një bombë, zbrazti dhe një karikator kundër armikut, u shtri barkas për t'iu shmangur një mitralozi gjerman, pastaj u ngrit përsëri dhe sulmoi... Por një plumb e preu në mes. Shokët e saj vazhdonin të sulmonin. Ajo i pa... Pa dhe bunkerin në qendër të Tiranës që nxirrte flakë... kujtoi qytetin e luleve, Përmetin, ku kish lindur në vitin 1926. Ishte data 11 nëntor

1944. Agllai Tako është shpallur dëshmore e Atdheut me vendim nr. 82, datë 17.08.1976 të Komitetit Ekzekutiv të Rrethit të Përmetit. Kryeqyteti Tiranë ka një rrugë me emrin "Ruga Agllai Tako".

### **Luftoi dhe ra në sheshin "Skënderbej"**

Estref Abdurahman Caka, lindi në Osoje të Skraparit, në vitin 1919. Më 1940 u vendos në Tiranë, ku punoi si punëtor në një shoqëri italiane. Dezertoi nga ushtria, ku ishte mobilizuar. Jataku i Estref Osojes ishin malet e larta të Skraparit. Aty ishte foleja e çetës partizane. Në radhët e saj Estrefi gjeti rrugën që ai kishte ëndërruar. Mori pjesë në çetat e para të Skraparit. Estref Caka (Osoja) komandant kompanie në BrlS ishte një luftëtar i vendosur i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, BrlS luftonte nëpër rrugët qendrore të Tiranës. Partizanët hidheshin përpara duke sulmuar me trimëri pozicionet e armikut. Një kompani luftonte në sheshin qendror, në sheshin "Skënderbej". Që lart, nga katet e ministrive qëllonin mitralozat gjermanë. Shumica e tyre heshtën, por njeri ende qëllonte mbi partizanët. Edhe ai duhej asgjësuar. Një djalosh i ri, shtrihet rrafsh me tokën dhe zvarritet drejt korbit të zi që villte zjarr, që mundahej t'u merrte jetën shokëve të tij. Ai ishte komandanti Estref Caka, dhe ai vetë do ta asgjësonte atë fole zjarri vendosur në dritaren e një ministrie. Shokët e tij, me të shtënat e tyre, i tërhoqnin vëmendjen armikut. Edhe pak, ja Estrefi u ngrit, u ngjiti e u bë një me murin, vazhdoi. Eci edhe pak. E kaloi rrezikun e plumbave.

U vra duke luftuar kundër nazistëve gjermanë për çlirimin e Tiranës, më 11 nëntor 1944. Është shpallur dëshmor i Atdheut me vendim nr. 17, datë 27.02.1978 të Komitetit Ekzekutiv të KP të Rrethit të Skraparit. Mban titullin "Hero i popullit". Shkolla dhe rrugë në Skrapar dhe në Tiranë mbajnë emrin e tij.

### **Komandanti në ballë të sulmit**

Fane Petro Kromidha lindi më 1920, në Labovë të Gjirokastrës. Prindërit e tij, me shumë pak tokë dhe një mulli që kishin, mezi arrinin t'i mbanin gjallë fëmijët. Pa i mbushur mirë të pesëmbëdhjetë vjetët Foni u shtrëngua të merrte rrugët e qytetit dhe të punonte si pjatolarës nëpër restorante. Atje e pa me sytë e vet më mirë se kudo gjer atëherë shtypjen shoqërore, së cilës iu shtua dhe shtypja kombëtare e pushtuesve fashistë. Duke jetuar në mes të të pastrehëve, pa mbushur as barkun me bukë, ai hyri në rrethet e shokëve që nisen t'i flisnin për luftën, për Partinë Komuniste, që ishte vënë në krye të saj. Ndërkaq u thirr ushtar dhe u dërgua për të shërbyer në Librazhd. Por tani që kishte armën në dorë, ai dinte kundër kujt ta drejtonte. Së bashku me një grusht shokësh u arratis nga ushtria dhe vajti në çetën e Dumresë. Që në betejat e para fitoi respektin e shokëve dhe shpejt u caktua zëvendëskomandant i çetës së Shpatit të Dytë. Ndërkaq u pranua në gjirin e Partisë. Që me formimin e Brigadës I Sulmuese, Fani u emërua zëvendëskomandant e më pas komandant i kompanisë së tretë të Batalionit IV, detyrë të cilën e kreu me nder gjer në çastet e fundit të jetës. ... Dhe ja lufta për çlirimin e Tiranës. Partizanët kryenin çdo natë sulme mbi post-komandat në periferi dhe shpesh depërtonin gjer afër qendrës së Tiranës. Kompanisë së Fanit i ishte besuar një nga drejtimet më të rëndësishme: një pjesë e Rrugës së Elbasanit, gjer te hotel "Parku", dhe akoma më thellë te bunkerit pranë xhamisë së vjetër. Atë drejtim armiku përpiqej ta mbante me çdo kusht, sepse andej kontrollonte të vetmen rrugë nga mund të tërhoqej drejt Veriut pas disfatës së pashmangshme që e priste në kryeqytet. Armiku i kishte orët të numëruara, por nëpër frëngjitë e bunkerëve dhe në dritaret e ndërtesave kishte vënë snajperë. Fani vraponte nga një pozicion në tjetrin, nga njëra ndërtesë te tjetra, nga njëri kat te tjetri. Takonte shokët, i porosiste të kishin kujdes, të mos dilnin nëpër dritare. Ndërkaq, që nga hotel "Parku" kërcisnin pushkët snajperë. Fane vrapoi drejt pozicionit, por snajperi gjerman e kishte vënë në shenjë. Ai ra... Është shpallur dëshmor i Atdheut me vendim nr. 65, datë 2.10.1971 të Komitetit Ekzekutiv të KP të Rrethit të Gjirokastrës.



# Kush bie heroikisht për liri, mbetet përjetësisht i gjallë në kujtesën popullore

## SKËNDER ÇAÇI – HERO I POPULLIT

Skënder Çaçi lindi, më 18 janar 1916, në qytetin e vogël të Leskovikut, rrëzë malit të Melesinit, në familjen e Neki Çaçit (Poda). Babai i tij ishte luftëtar trim i çetës patriotike të krahinës. Në familje Skënderi thithi nektarin e atdhedashurisë. Aty, që në shkollën fillore të vendlindjes, këndonte me ngazëllim këngë popullore për trimat luftëtarë leskoviçarë, të pushkës e penës, si Zylyftar Poda, Jani Vreto, Muço Qulli, Thanas Sina, Haki Glina e të tjerë. Këndonte e fliste me nderim për ata atdhetarë e zemra i gufente nga krenaria se ishte nga ai gjak luftëtarësh që nuk reshtën së luftuari për liri.

Më 1930 konkurroi dhe fitoi për të vazhduar mësimet në Shkollën Ushtarake në Tiranë, por ajo u mbyll dhe Skënderi vazhdoi gjimnazin në kryeqytet. Pikërisht këtu filloi pjekuria e tij politike. Shoqëria me Vasil Shanton, Asim Zenelin e të tjerë, të cilët ia qartësuan rrugën që duhej ndjekur për të përmbysur një herë e përgjithmonë regjimin obskurantist të Zogut. Sigurisht që ra në sy të autoriteteve shtetërore, ndaj filloi të shihej me dyshim. Por falë rezultateve të shkëlqyera në mësimet dhe këmbënguljes së tij, më 1935 i jepet e drejta për në Kolegjin Ushtarak të Napolit e më pas në Akademinë e Torinos, ku vendosi lidhje të ngushta ideali me Qemal Stafën. Veprimtaria e tij atdhetare dhe antifashiste rritet dita-ditës në strofkën e fashizmit në Itali. Është pikërisht Skënder Çaçi organizatori dhe udhëheqësi i protestës kolektive të studentëve ushtarakë shqiptarë në Romë që u thanë gjerakëve fashistë: “Betohem se nuk do të betohemi kurrë për skëterrën fashiste!”. Ndaj në shtator 1939 internohet në Ventotene, Itali, ku për rreth dy vjet qëndroi në shoqërinë e ndër të parëve antifashistë, bashkë-heronjve të LANÇ-it, Nazmi Rushiti, Tom Kola, Emin Durakun, Xhezmi Delli etj. Lirohet nga internimi në gusht 1941, kthehet në Leskovik dhe shpejt arrin në Tiranë, ku që në fillim me shokë të shquar vihet në krye të LANÇ-it në krahinë, duke qenë ndër 200 komunistët e parë të Shqipërisë. Është ndër aktivistët e shquar për përgatitjen dhe zhvillimin e demonstratës masive të 28 tetorit 1941, në kryeqytet. Skënder Çaçi, tashmë i burrëruar dhe luftëtar profesionist, shok i ngushtë armësh i Qemal Stafës, Gogo Nushit, Vojo Kushit, Misto

Mames etj., afirmohet si kuadër dhe organizator i shquar i LANÇ-it, si në luftën guerile ashtu dhe në formacionet partizane. Ishte pjesëtar qendror ushtarak dhe mori pjesë fizikisht në aksione të guximshme e të rëndësishme, si për rrëmbimin e shtypshkronjës, arshivës në Ministrinë e Brendshme, djegien e depove ushtarake të aviacionit, prerjen e ndërlidhjes telegrafonike, duke qenë edhe komisar i grupit që drejtonte Misto Mame. Dhe nuk ishte rastësi që tërë familja e tij ishte e përfshirë ngushtësisht në LANÇ. Tre vëllezërit dhe motrat bënë pjesë drejtpërdrejt në formacionet partizane. LANÇ po merrte përpjesëtime të gjera dhe po shtrihej në gjithë vendin. Skënder Çaçi ngarkohet me detyrën e komisarit në çetën e parë partizane të Skraparit, më pas si i dërguar i LANÇ-it në Kolonjë, ku zhvilloi veprimtari të dendur për forcimin e punës organizative e ushtarake si dhe këshillave nacionalçlirimtare. Në 1943 merr pjesë në luftimet për çlirimin e Leskovikut dhe e gëzon lirinë e vendlindjes me bashkëqytetarët e vet. Kur po sosej vera e atij viti, ngarkohet me detyra organizative për krahinën e Gorë-Oparit dhe me riorganizimin dhe zgjerimin e batalionit partizan Gorë-Opar, caktohet komisar i tij, duke patur në krah komandantin e shquar Teki Kolaneci.

Më 16 tetor, batalioni në bashkëveprim me formacione të tjera partizane morën urdhër të shpartallonin forcat xhandaro-zogiste që ishin pozicionuar në majat dominuese në veri-perëndim të Grybecit. Luftëtarët partizanë, me në krye komisarin sypatrembur, pasi thyen armikun në pozicionet e para, vazhduan sulmin në drejtim të Gurit të Bletës. Një mitraloz armik në lartësitë dominuese të Gurit të Qytetit, nuk pushonte së vjelluri zjarr. Komisari u hodh vetëtimthi mbi pozicionin armik, ashtu si Mic Sokoli e Selam Musai vite më parë, por goditet për vdekje dhe... Populli i këndoi: “...Gjëmon fusha, gjëmon mali/lufton Skënder kolonjari/trim zemërluani/e bëri si Zylyftari!”. Dy ditë më pas, më 18 tetor 1943, populli e partizanët i dhanë lamtumirën e fundit komisarit. Atë e përcollën si përcillen trimat me batore pushkësh partizane. Bashkëluftëtarët e tij, veteranë të LANÇ-it, dhe populli do të kujtojnë e nderojnë brez pas brezi figurën dhe veprën e shquar atdhetare të Heroit të Popullit Skënder Çaçi. Është një shkollë 9-vjeçare në kryeqytet që mban emrin e këtij Heroi.

# Brigada XXIV

## NË ÇLIRIMIN E TIRANËS DHE TË SHKODRËS

**B**rigada 24 e UNÇSH-së u krijua, më 4 tetor 1944, në Bicaj me 560 partizanë të batalionit të Lumës dhe vullnetarë të rinj nga krahinat e Kukësit. Brenda muajit tetor 1944, Brigada do të kapte shifrën e 1000 luftëtarëve. Në fund të Luftës ajo kishte 1185 partizanë. Aty, në kodrën ku u krijua ngrihet madhështor Lapidari që i kushtohet dëshmorëve dhe veprimtarisë luftarake të saj.

Nuk ishte hera e parë që lumjanët krijojnë një formacion të madh luftarak. Të tilla, ata kishin ndërtuar në kohën e Lidhjes së Prizrenit, 1878-1881, e sidomos në kryengritjet e viteve 1910-1912 kundër ushtrisë osmane dhe pastaj kundër agresionit serb. Por kjo Brigadë që po formohej ishte një formacion i ri. Jo vetëm nga mosha. Këtu kishte standarde të tjera. Në skuadër, togë, kompani e batalion kishte shokë nga fshatra e krahina të tjera, ndryshe nga çetat e dikurshme që plotësoheshin vetëm nga fshati ose batalioni vetëm nga bajraku. Në Brigadën XXIV S kishte partizanë nga Luma nga Gora e Dibra, po edhe nga Labëria, më pas edhe nga Lezha e Shkodra, Komisari i Brigadës major Abedin Shehu ishte nga Luma, por komandanti i saj, major Ndreko Rino ishte nga Gjirokastra, zëvendës komisari Ethem Gjinushi ishte nga Tepelena, si dhe disa kuadro të tjerë. Ashtu si lumjanët kishin luftuar e luftonin në krahina të tjera, si Xhemali Mani, që kish rënë dëshmor në skelën e Vlorës, duke luftuar kundër ushtarëve italianë, më 7 prill 1939, si Qazim Mata, që ish plagosur rëndë po atë ditë në Durrës, si Elez Braha, zëvendëskomandanti i batalionit të famshëm "Shqiponja" të Korçës

që ra në krye të tij, më 14 dhjetor 1943, në betejën e Gurit të Kamjes, si Maksut Rexhepi ish-partizan në Br.1 që do të binte trimërisht në Betejën e Tiranës, si Meriman Braha, Hasan Luma e Xhemali Bileri, që kishin rënë dëshmorë në Dibër e Poshtme, si Rrahman Parllaku që e kish nisur luftën në Vlorë e do ta përfundonte si komandant i divizionit V në Kosovë, si Imer Domi në Dibër të Sipërme e të tjerë. Brigada partizane ishte një formacion i disiplinuar, me hierarki të respektuar, nga bindja në radhë të parë, po dhe nga funksionet e gradat.

Këtu në Brigadë luftohej, po edhe mësohej shkrim e këndim. Kishte edhe komisar kompanish që ishin mësues. Komisari i kompanisë së dytë të bat.3, Ahmet Onuzi, mësues, mbante edhe armën për të luftuar po edhe mandolinën për të shoqëruar rapsodët partizanë pas luftimesh. Në Brigadë do të kishte edhe një vajzë, Teuta Agolli nga Dibra, përgjegjëse e rinisë e batalionit të katërt.

Kjo brigadë e krijuar sipas parimit të madh të LANÇ-it, pa dallim feje, krahine e ideje, do të kishte edhe myslimanë, edhe bektashinj, edhe katolikë, patriotë. Kishte edhe komisarë politik në kompani batalion e Brigadë, kishte edhe komunistë, të cilët mund të dalloheshin vetëm ngaqë prinin në ballë të sulmit në vendet më të rrezikshme dhe binin me nder në fushën e luftës.

Brigada XXIV do të nisej drejt Jugut për të marrë pjesë në çlirimin e Tiranës. Drejt jugut, nuk ishte edhe ky një teatër i ri luftarak. A nuk kish kaluar nëpër Lumë Isë Boletini, në nëntor 1912, me 100 trimat e tij për të shkuar në Vlorë, a nuk kishin shkuar lumjanët me Bajram

Currin deri në Tiranë në qershor 1924, 20 vjet më parë?

Edhe atëherë për çlirimin e kryeqytetit kishin luftuar, ashtu siç kishin luftuar denbabaden për çlirimin e mbrojtjen e kryeqytetit të Shqipërisë etnike, Prizrenit. Ndonëse ishte një Brigadë e re, për partizanët e saj ky ishte një nder. Nuk ish problem, kishin dalë në luftë për të çliruar Shqipërinë, jo thjeshtë krahinën e fshatin e tyre. Në Betejën e madhe për çlirimin e Tiranës merrnin pjesë brigada nga më të shquarat e UNÇSH-së, si Brigada I, IV, VIII, që kishin bërë emër an' e kënd Shqipërisë. Aty do të thirreshin edhe disa Brigada të reja, si X, XVII XXIII, dhe XXIV. Posaçërisht, siç kish urdhëruar Komanda e Përgjithshme, edhe për të marrë përvojë, por edhe për të bërë histori. Lumjanët



Grup partizanësh të Brigadës XXIV Sulmuese.



i kish prekur aty ku ishin më të ndjeshëm. Donin të bënin emër. Për ta, lufta ishte edhe një garë për t'u dalluar mbi të tjerët. Kështu kish ardhur kjo ambicie luftarake nga brezi në brez. A nuk kishin thënë historianët ushtarakë osmanë se Luma prodhon luftëtarë?! “Për hajër”, “me faqe të bardhë”, “mos na koritni”, këto ishin fjalët e lumjanëve për djemtë e tyre që po hynin në këtë Brigadë.

Kronika e luftimeve të Br. XXIV përmbante një pritë kundër forcave gjermane në rrugën Kukës–Prizren dhe një marshim të sforcuar tre ditë nga Luma në Mat e në Tiranë, ku arriti me datën 10 nëntor. Rajoni i saj i luftimeve shtrihet nga Medreseja në Laprakë dhe në kodrat e Domjes me thellësi deri në Laknas, në krahun e djathtë të rrugës, midis Brigadës së I dhe Brigadës XXIII, që luftonte nga Vora e më tej. Përballë saj në anën tjetër të rrugës ishte Brigada X dhe batalioni “Antonio Gramshi”. Detyra e tyre ishte të bllokonin hyrjen dhe daljen e forcave gjermane nga Tirana.

Në Tiranë mbrohej një garnizon i fuqishëm gjerman, i pajisur me tanke, autoblanda dhe artileri të rëndë. Brigada XXIV nga 11 deri më 17 nëntor zhvilloi në rajonin e saj 10 luftime kundër forcave gjermane, në kushte të vështira moti (shiu të dendur), në mungesë të theksuar të armëve kundërtanke. Ndërkohë nga Vora niseshin grupe të fuqishme për t'u futur në Tiranë. Kundër tyre Brigada XXIV dhe Brigada X, kishin ndërtuar barrikada në rrugë. Tanket gjermane pasi i gjuanin barrikadat me predha, së fundi sulmonin për t'i shkatërruar fizikisht me peshën e tyre të blinduar. Në këto ndeshje të egra me tanket gjermane partizanët e Br. XXIV luftonin me armët e këmbësorisë, me ndonjë granatë, e rrallë, ndonjë anti-tank. Plus faktit që ata ishin një Brigadë e sapokrijuar, e pastërvitur për luftën në qytete dhe kundër tankeve. Ditën që filloi sulmi vendimtar i forcave të Korpamatës I për çlirimin e Tiranës më 11 nëntor, forcat e Br. XXIV kryen tre sulme, njërin te Ura e Lanës (mbi rrugën Tiranë-Vorë), një tjetër tek ura mbi lumin e Tiranës në rrugën Tiranë-Kamëz, të tretin kundër pikëmbështetjes armike në Domje. Si rrjedhojë autokolona gjermane s'hyri dot në Tiranë dhe mori drejtimin për Shkodër.

Më 13 nëntor, forcat e Br. XXIV në bvp, e forcat e Br. X, u mbrojtën

kundër një force prej rreth 1000 ushtarë të nisur nga Vora, shoqëruar me tanke, dhe një kompanie tjetër armike të nisur me të njëjtën detyrë nga Tirana të hapnin rrugën për në Vorë. Për më shumë se 5 orë, prej Laprake deri në Kashar, u zhvilluan kundër tyre luftime të përgjakshme. Megjithëse trupat gjermane, pasi lanë në rrugë shumë të vrarë, mundën të hynin në Tiranë në mbrëmje, rruga Tiranë-Vorë mbeti përsëri e bllokuar.

Më 14 nëntor, po ai batalion gjerman, i nisur nga Tirana për në Vorë, për të spastruar dy anët e kësaj rruge, u godit nga Brigada XXIV në dalje të Tiranës dhe kur mbërriti në Mëzes, u godit nga forca të Br. X. Vetëm pasi ishte errur, gjermanët u vunë përsëri në lëvizje drejt Vorës. Më 15 nëntor, forca të Brigadës XXIV i dëbuan gjermanët nga autoreparti në dalje të Tiranës nga rruga e Durrësit dhe po këtë ditë, dy batalione të saj zhvilluan me forca gjermane një përleshje të përgjakshme në terrenin e Laknasit. Më 16 nëntor dy batalione të Br. XXIV e goditën dhe e shpartalluan rëndë grupin e luftimit armik që sulmoi nga fusha e aviacionit për të çelur me çdo kusht rrugën Tiranë-Vorë. Trupat gjermane, të përqendruara në Vorë, u shtrënguan të tërhiqeshin e mbylleshin në fortifikata. Po atë ditë, një batalion i Br. XXIV dhe një kompani e Brls sulmuan armiqtë në afërsi të autorepartit.

Natën e 16-17 nëntorit forca të Br. XXIV dhe të Br. X goditën trupat gjermane që u tërhoqën përfundimisht nga Tirana për në Vorë. Ushtarët gjermanë të bashkuar me trupa të tjera që vinin nga Vora, të shumtë në numër e të shoqëruar me tanke, çanë pritën e vazhduan tërheqjen. Më 17 nëntor partizanët e Korpamatës I çliruan Tiranën.

Brigada ka zhvilluar këtu luftimet më të ashpra në historinë e saj. Përballë tankeve dhe autoblandave gjermane, partizanët e Brigadës vunë gjokset e tyre duke shkruar faqe heroizmi të pashembullt. Tipik është luftimi dhe rënia e komandantit të kompanisë së dytë Vehbi Shehut dhe dy partizanëve të tjerë, Nuredin Brahës dhe Sadik Palushit. Bashkëluftëtari i së njëjtës llogore me to, Sadik Kërzhaliu, ka treguar kështu: “Dy tanke përpara dhe një autobлиндë pas tyre



Vehbi Shehu




Ethem Gjinushi



Abedin Shehu



Ndreko Rino



Hasan Kërkhaliu

Bushticë, Idriz Nuri Gafurri, Çajë, Maliq Imer Topuzi Dibër, Nuredin Tahir Braha, Bicaj, Osman Halit Qinani, Arrën, Ramadan Muharrem Kotarja, Gjegje, Ramadan Hamit Shahu, Bardhoc, Sabri Islam Gjici, Bushticë, Sadik Tahir Palushi, Palush Shefit Mehmet Smana, Çajë, Vehbi Ramadan Shehu, Bicaj, Xheladin Nuredin Mici, Gjegjën. Emri i shtatëmbëdhjetë është i dëshmorit të Br.I, Maksut Rexhepi.

Më 17 nëntor Br. XXIV dhe XXIII morën urdhër që t'i ndiqnin trupat gjermane drejt Shkodrës. Më 22 nëntor në luftime kundër gjermano-ballistëve në Krujë bie partizani Xhafer Ollomani nga Borja. Më 24 -29 nëntor 1944, Brigada XXIV do të sulmonte për çlirimin e kryeqendrës historike të Veriut dhe

po vinin drejt barrikadës së kompanisë së dytë... Vehbi Shehu me granata dhe një pushkë anti-tanke në dorë u nis në sulm drejt tankut të parë duke qëlluar mbi të. Kur u afrua 6-7 metra mori të hidhte granatat, por në këtë çast autoblanda e qëllon për vdekje. Ai ra buzë xhadesë afër barrikadës. Togkomandanti Nuredin Braha, dhe pas tij Sadik Palushi, u hodhën në sulm kundër tankeve, qëllonin me bomba dore dhe përparimi i tyre u bllokua. Nuredini mori në krah komandant Vehbiun për ta tërhequr, por sa u ngrit në këmbë u godit me dy predha, njëra në kokë dhe tjetra në anën e djathtë të gjoksit. Megjithatë ai ecte duke u lëkundur e i larë në gjak, në ndihmë i shkoi Sadiku, por edhe ky ra i vdekur nga plumbat e armikut. Nuredini bëri disa hapa, por nga plagët e rënda dhe pesha e komandantit që mbante në krah ra përtokë përpara pozicioneve ku po luftonte ...e gjithë kompania jonë. Barrikadën tonë lumjane nazistët nuk e kaluan dot". Kështu ranë si trimat 16 partizanët te Brigadës XXIV, nga 194 luftëtarë që ranë dëshmorë për çlirimin e Tiranës. Mu te Kthesa e Kamzës, në dy pllaka të thjeshta mermeri janë gdhendur emrat e tyre. Tetë prej tyre ranë aty te kthesa e Kamzës dhe po aq ranë në pozicionet e tjera majtas e djathtas, nga ish-autorepartit (sot Instituti Harry Fultz) e deri në kodrat e Domjeve. Këta janë: Abaz Tahir Peposhi, Lusën, Dervish Hasan Hasani, Dibër, Elmaz Hasan Ademi, Bardhoc, Gani Hajdin Duraku, Morin, Hakik Sherif Gjici,

terreni i saj i luftimit do të ishin kodrat e Bërdicës dhe të Beltojës, përballë mbrojtjes së fortifikuar gjermane dhe artilerisë së rëndë të vendosur në Kalanë e Rozafës. Në portat e Shkodrës ranë edhe 5 partizanë të tjerë të Brigadës së 24 S: Emri Metush Halilaj nga Bicaj, Hasan Hysen Lika nga Lusna, Islam Ramadan Xhahu nga Gjegjini, Isuf Jashar Seferi nga Fshati dhe Imer Ramadan Mata nga Zapodi. Me pjesëmarrjen në çlirimin e Tiranës dhe të Shkodrës, me 22 dëshmorët e rënë këtu, Brigada e XXIV e kaloi me sukses provën e saj historike. Brigada u shpërnda në maj 1945.

Në këtë 80-vjetor të krijimit të saj, kujtojmë me nderim dhe mirënjohje dëshmorët e saj, gjithë ish-partizanët dhe kuadrot e tjerë drejtues si komandantin Ndreko Rino, (Hero i Popullit) komisararin Abedin Shehu e Zenel Hamiti, ish-kuadrot e Brigadës: Et'hëm Gjijnushi, Nijazi Hoxha, Petro Lalaj, Rasim Guri, dhe të batalioneve :Madan Haxhiu , Filat Muça , Teki Hasani , Abaz Shehu, Muhedin Kërkhaliu, Hasan Kërkhaliu (Hero i popullit) Anesti Andoni, Xhelal Gjidedaj e Llazi Lipivani, Abdi Mati, Ismail Shehu, Ramadan Halilaj, Teuta Agolli, Maliq Gashi, Hazir Onuzi, Nexhip Visha etj. Veteranët e saj sot janë të rrallë. Por ka prej tyre si Tosun Tota, që ndonëse 98 vjeç nuk mungon kurrë të bëjë homazhe e t'u flasë pasardhësve të veteranëve, rinisë e nxënësve te Lapidari që i kushtohet dëshmorëve te Brigadës këtu në Tiranë, te kthesa e Kamzës.

# 80 - vjetori

## i Brigadës XVIII Sulmuese

Br. XVIII Sulmuese u formua në Sllatinë të Dibrës, më 18 gusht 1944, sipas urdhrit të Shtabit të Përgjithshëm të UNCSH-së, mbi bazën e tre batalioneve, të Dibrës, Martaneshit, Çermenikës dhe batalionit të ri që u formua me partizanë të rinj, të ardhur nga krahina të tjera të vendit. Kjo brigadë u inkuadrua në Divizionin I Sulmues.

### Disa nga kuadrot drejtues

Në drejtimin e Brigadës në ditën e formimit ishin Esat Ndreu, komandant, vëllai i patriotit dhe luftëtarit Elez Isuf Ndreu, Zëvendës komandant Zoi Themeli, Mico Kallamata komisar dhe Sotir Vullkani zëvendës komisar.

Më vonë u bënë ndryshime në komandën e Brigadës. Petrit Dume u bë komandant brigade, Hilmi Causholli, komisar, Xhevdet Petrela, Zëvendës komandant, Teme Sejko, Zëvendës komisar, Milo Qirko Zëvendës komisar.

Gafur Korca ishte komandant i batalionit të parë, Qazim Peshku, komandant i batalionit të dytë, Ajet Rusi, komandant i batalionit të tretë dhe Gafur Mehmeti komandant i batalionit të katërt, Rexhep Doda, komisar i batalionit të parë, Ferit Muha nga Bllaca, komandant i kompanisë parë në këtë batalion, Uke Cami komisar i kompanisë së parë etj.

### Luftimet kryesore

Luftimet e kryera së bashku me Brigadën e V Sulmuese në malin e Korabit kundër forcave gjermane që bënë të dështonte faza e fundit e operacionit “fucsjargt” (“gjahu i dhelprave”). Kryerja e disa aksioneve luftarake kundër autokolonave gjermane gjatë tërheqjes në rrugën automobilistike Prizren/ Kukës/ Pukë dhe lufta për çlirimin e Kukësit. Luftimet përtej kufirit shtetëror për çlirimin e qytetit të Dibrës së Madhe, për çlirimin e Kërçovës dhe të Prizrenit.

### 4 muaj luftime të përgjakshme të Br. XVIII sulmuese

Fill pas formimit, Brigada u angazhua në luftime çlirimtare. Më 23 gusht 1944 Br.18 çliroi qytetin e Peshkopisë. Pas luftimesh në Inoskë e Korab, forcat gjermane dhe mercenare u tërhoqën në Dibër të Madhe. Batalioni IV luftoi në Shutovë të Kërçovës, ku ranë në atë betejë Ibe Palikuqi, Hakik Xhika, Haxhi Xhediku, Zenel Paci dhe Myrtezan Zuna.

Më 25 gusht, na u dha për detyrë çlirimi i Dibrës së Madhe. Më 3 shtator 1944, u bë çlirimi i Dibrës së Madhe nga forcat e batalionit I dhe II të Br.18 dhe nga Br.V, të cilat arritën të mposhtin sulmet gjermane dhe ato të mercenarëve.

Batalioni i parë u vendos në frontin Bajnisht-Kojnarë, batalioni i katërt

u vendos në frontin Bofmollë-Ura e Spiles. Frontet e tjera ishin zënë nga një pjesë e forcave të Divizionit të parë.

Pas 24 orë luftimesh, forcat gjermane në qytet të ndihmuara edhe nga batalioni “Drini”, i komanduar nga Dilaver Dine, u tërhoqën nga Dibra e Madhe. Dibra u çliroi.

Brigada e katërt shqiptaro-maqedonase e drejtuar nga Qemal e Nexhat Agolli dhe ku bënte pjesë edhe Esat Cami mori drejtimin e Strugës dhe më pas të Shkupit.

Brigada XVIII mori urdhrin për të shkuar në drejtim të Kukësit e të Prizrenit, në mbështetje të Brigadës 5 Sulmuese.

Batalioni i parë i komanduar nga Gafurr Korça dhe Rexhep Doda nga mesi i natës filloi marshimin në drejtim të Kalasë së Dodës dhe në orën pesë të mëngjesit sulmon Kalanë, nga Kalla, Vlesha e Sllava dhe nga Zall-Kalisi dhe pas pesë orë luftimesh të përgjakshme u mor Kalaja. Një pjesë e mirë e luftëtarëve nacionalistë u kthyen me ne dhe luftuan deri në fund kundër gjermanëve.

Këtu kemi parë edhe masakrën më të madhe njerëzore, Hajdar Dushin me 22 shokë të vrarë, ndërmjet tyre edhe 2 shoqe partizane, të cilat i kishin zhveshur lakuriq dhe u kishin ngulur nga një hu në prapnicë dhe i kishin mbështetur për shkëmbi. Urrejtja ndaj pushtuesit por edhe ndaj atyre që u shkonin pas si nacionalistë e antikomunistë nuk kishte kufi dhe nuk mund të tregohet.

Përsëri njoftohemi se shtabi i brigadës së pestë është në rrezik në fshatin Ujmishtë nga forcat e Muharrem Bajraktarit.

Pas rrethimit që i bëme forcave të Bajraktarit e çliroam shtabin e Brigadës së pestë, por nga kjo brigadë kishin mbetur në luftim 60 partizanë, kryesisht të vrarë nga forcat e Muharrem Bajraktarit. Ja ku kishte arritur vëllavrasja midis shqiptarëve, antifashistëve dhe antikomunistëve.

Populli i kësaj zone më shumë mbështeti Nacional-Çlirimtaren se sa Muharrem Bajraktarin dhe u rreshtua në Brigadën e 24 kundër gjermanëve.

Në këto momente tabloja e luftimeve ishte e tillë: Shtabi i Br.XVIII ishte vendosur në Bicaj, shtabi i Br.V në Has, ndërsa forcat gjermane dhe mbështetësit e tyre në Kukës e Prizren. Batalioni parë i Br.XVIII së bashku me batalionin e Lumës bënë një aksion tek kulla e Lumës dhe asgjësuan një repart gjerman që vinte nga Prizreni, ku u kap rob edhe qarkkomandanti i Kukësit.

Batalionit të Parë të Br.XVIII iu dha detyrë të sulmonte Topojanin, Zapodin dhe Dragashin. Në Dragash na u dha urdhri për të marshuar



Azis Asllani etj.

Të nesërmen batalioni i parë organizoi një aksion tjetër në fund të fshatit Morin, ku asgjësohet plotësisht një kompani gjermane, por u vra edhe partizani Elez Mena nga Bllaca si dhe u plagos Met Hajrullai dhe Shuaip Baruti.

Pas tërheqjes nga Dragashi, batalioni i katërt ishte urdhëruar për të sulmuar kalanë e Prizrenit, ndërsa batalioni i parë do të sulmonte Zhurin. Brigada e pestë do të sulmonte Prizrenin. Pas gjashtë orë luftimesh, më 17 nëntor 1944, Prizreni u çlirua. Luftimet vazhduam për çlirimin e Kukësit dhe më 18 nëntor 1944 u çlirua Kukësi. Në këto luftime nga Br.18 ranë dëshmor Shehat Halili, Shahin Kaja, Imer Alliu, Hysni Krrusa, Latif Perkola, Sadik Nurcja, Xhetan Hoda, Jashar Kurtulla, Aqif Konesha, Haki Zerja, Gafur Mehmeti dhe pati shumë të plagosur.

Pastaj të gjitha forcat partizane përqendrohen për çlirimin e Kukësit.

Forcat gjermane largohen dhe përqendrohen në Shkodër.

Ndërsa forcat e Brigadës sonë ndodhen në Luginën e Valbonës në Tropojë, njoftohemi më 29 nëntor se forcat partizane kanë çliruar Shkodrën.

Më 1 janar 1945, na u dha urdhri për të kaluar në Mirditë, batalioni i parë dhe batalioni i katërt i Brigadës XVIII. Batalioni i parë do të kalonte qafën e Malit dhe

drejt Kukësit, ku në fshatin Bardhoc bllokuam rrugën automobilistike. Luftimet në Bardhoc u zhvilluan më 25 tetor 1944. Kishim këputur në mes edhe urën dhe qëndronim në pritje ardhjen e autokolonës gjermane. Pranë meje (Uke Cami) ishin Shaqir Shira nga Zall Dardha dhe Jonuz Duka nga Maqellara. I pari hapi zjarr partizani Dine Rama nga Shumbati. Gjermanët pa urë kalimi ishin të detyruar të zbrisnin nga makinat dhe të zinin front në tokë por koha punonte për ne, sepse ne ishim të pozicionuar dhe të gatshëm për të qëlluar. Në një darë të hekurt pas katër orë luftimesh, gjermanëve u vjen përsëri ndihmë në njerëz, teknikë luftarake e logjistike. Ndërsa partizanëve pas katër orë luftimeve filluan t'u mbaronin rezervat, por edhe tërheqja ishte e vështirë. Midis Përbregut dhe Bardhosit u organizua tërheqja me luftim, por patëm të vranë e të plagosur. U plagosën Met Hajrullai,

batalioni i katërt do të kalonte Qafën e Kumbullës. Bora binte pa pushim dhe kishte arritur lartësinë dy metra. Duke kaluar qafën vdiqën katër partizanë. Tuneli i dëborës bllokohej në çast. Në krye të kolonës ishin Gafurr Korça, Rexhep Doda, Albert Paparisto, Ferit Muha. Alberti ishte nga Elbasani dhe nuk ishte mësuar me dimra të tillë.

Në shtëpinë e një fshatari u strehua Ferit Lleshi, Hamdi Doda, Pali Carapuli, Sali Hoxha etj. Kështu u shpërdanë dhe kaluan natën të gjithë partizanët. Nuk bëhej fjalë për të ngrënë, pasi as fshatarët nuk kishin ç'të hanin për vete, por vetëm për të futur kokën e për të shpëtuar nga ngrija e nga vdekja.

Pasi dëborë ngriu kalonim mbi dëborë dhe udhëtuan drejt Mallkuqes, Domgjonit, Iballës e Pukës për të arritur në detyrën e re që i ishte ngarkuar brigadës.

# Rrugëtimi historik i Ismail Qemalit dhe pavarësisë në 4122 km

**N**ë përkujtim të burrave të Pavarësisë, që shkruan histori 112 vite më parë, në përkujtim të babait të kombit Ismail Qemal bej Vlora, që në rrugëtimin historik nga Stambolli evropian në Vlorë bëri 4122 kilometra, që historia e kombit tonë ta regjistrojë si heroin e shqiptarëve që shpalli pavarësinë shqiptare; në nderim e respekt të 40 firmëtarëve të pavarësisë si dhe gjithë delegatëve të Kuvendit të Vlorës, por dhe qeverisë së parë të përkohshme të Vlorës, që përfaqësonte gjithë trojet shqiptare. Me rastin e ditës së përvjetorit të shpalljes së pavarësisë, mbarë shqiptarizma është me sy e veshë nga Vlora e flamurit, ku në imazhin e shqiptarëve brenda e jashtë kufijve administrativë të Shqipërisë, tek vepra e madhe e para 111 vitesh, tek shpallja e mëvetësisë. Ligjëratë e plotë e Ismail Qemal bej Vlorës, të mbajtur, më 28 Nëntor 1912, në ngjarjen më madhore të kombit shqiptar, atë të ngritjes së flamurit dhe shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë në Vlorë, ishte postulat i shekujve, për realizimin e ëndrrës së shumëpritur shekullore të shqiptarëve. Është pikërisht ligjërimi i një kombi të tërë që historia e ka gdhendur në histori madhore e së shkuarës kombëtare, dhe si detyrim i së ardhmes, fjalët e zemrës të mendjendriturit shqiptar Ismail Qemal bej Vlora, që bëri rrugëtimin historik nga Stambolli në Vlorë e tij të dashur, për të shpëtuar kombin në prag të shkërmoqjes së perandorisë osmane dhe urisë e lakmisë së fqinjëve për troje nga toka arbërore e drobitur prej vuajtjeve nga pushtimet e gjata. Ismail Qemal bej Vlora, i cili jetoi në disa shtete



si në Turqi, Greqi, Itali, Bullgari, Siri, për pak kohë në Francë, Angli, Zvicër e Gjermani, erdhi në Shqipëri, si kryeministër, si kryetar i parë në historinë e shtetit shqiptar, që drejtoi nga 28 Nëntori i vitit 1912 deri në 22 janar 1914, për 12 muaj e 56 ditë. Ishte Ismail Qemali që vendosi vulën historike të burrit të madh të flamurit, të Pavarësisë së shqiptarëve, të diplomatit e shtet-formuesit që

shkroi histori epokale për shqiptarët. Pavarësia shqiptare dhe epoka e rilindjes shqiptare dhe e rilindësve nuk mund të ndahen, për vetë kushtet që u poqën nga një brez i madh intelektualësh eruditë që punuan gjatë për mëvetësinë dhe krijimin e shtetit. Pavarësia udhëtoi nga Moti i Madh i Gjergj Kastriotit tek Moti i Madh i Ismail Qemalit 4 shekuj e 63 vjet. (1443-1912). Ismail Qemali me udhëtimin e tij të famshëm, plaku i bardhë i flamurit, në nëntor 1912, rrugëtoi 4122 kilometra nga Stambolli evropian në Vlorë. Ai me patriot të tjerë përshkruan rrugën Stamboll-Konstancë-Bukuresht; nga Bukureshti në Vjenë; nga Vjena në Budapest; nga Budapesti sërish në Vjenë; nga Vjena në Trieste; nga Trieste në Durrës për t'u finalizuar në Vlorë e përjetësuar të flamurit. Pavarësia për shqiptarët ka qenë shpesh në rend të ditës, në penën e intelektualizmit shqiptar, në mendjen gjeniale të rilindjes shqiptare të frymëzuar edhe nga iluminizmi francez. Por nga ana tjetër Pavarësia ka qenë edhe në grykën e pushkës e në majën e jataganit në qindra beteja nëpër shekuj. Amaneti i gjakut të shqiptarëve udhëtoi përmes shekujsh për t'u naltuar më 1912-tën.

#### **Vullneti i popullit shqiptar finalizohet 112 vite më parë**

Në mendjen dhe zemrat e shqiptarëve tingëllojnë edhe sot pas 112 vitesh fjalët e Ismail Qemalit, që mbajti në atë kuvend historik, në ngjarjen më të rëndësishme për shqiptarinë dhe shqiptarët, më 28 nëntor 1912, në atë kuvend që u hap në orën 16, pasdite, në shtëpinë e kushëririt të Ismail bej Qemalit, Xhemil bej Vlorës dhe ku morën pjesë 42 delegatë. Ligjërata e pavarësisë ishte: "Shqiptarët nuk e kanë harruëm kurrë as gjuhën e as kombsinë e tyre, dhe prova më e mira janë përpjekjet dhe kryengritjet që kanë bërë herë mbas here e sidomos ndër këto katër vjet e fundit për të rrujtur të drejtat e zakonit e veta. Qeverija othomane nuk e kuptoi kurrë interesën e saj e nuk dëshoi kurrë t'u shpërblejë me të mirë Shqiptarët shërbimet e mëdha që i kishin bërë. Tashti vonë pati rrëfyem një farë dëshiri që të merrej vesht me popullin t'atë. Por prap nuk vuni të gjithë vullnetin e mirë e nuk muer të gjitha masat e nevojshme për të kënaqur e paqum Shqiptarët. Që ndër këto rrethana që plasi lufta me katër Pushtetet ballkanike, të cilat kërkonin prej saj reforma e të drejta për vllaznit e tyre të një kombi e të një bese. Por këto, si panë se lufta po u vinte mbarë, e harruen qëllimin e parë e u muerën vesht për coptimin e pjestimin e mbretënisë e pra edhe të Shqipërisë. Shqiptarët, të cilët kishin marrë pjesë në këtë luftë më fort si të zotë e vëndit e për të shpëtum veten e tyre se si ushtarë, kur e panë se ushtria e Turqisë u mund e s'po munde me qëndruem më, nxituen me marrë masat që u impononte gjëndja për të shpëtum vëndin e vet. Kështu u bë që un u nisa nga Stambolli e, mbasi u mora vesht edhe me Shqiptarët e Bukureshtit, vota në Vjenë, ku fillova kontaktet me ato Pushtete të mëdha që kanë interesa më të gjalla në Ballkan. E mbasi nuk mbetej më asnjë shpresë me e shpëtum Shqipërinë me armë, e vetmja udhë shpëtimi ishte të shkëputunit e saj prej Tyrqije. Ky mendim u pa me vend edhe nga anë e Pushteteve të mëdha e sidomos në Vjenë e në Romë. Vetëm Rusia mund të mbahet pakëz e ftohët nga shkaku i fqije t'atë slavë, por as ajo nuk e

mohon kombsinë shqiptare.." dhe që finalizohet me shprehjen e vullnetit të popullit "që Shqipëria me sot të bëhet në vehte, e lirë e e mosvarme".. (sipas Revistës "Flamuri", të publikuar në korrik-Shëndre 1952, nr. 31-36, faqe 3, në Romë; si dhe "Besa", nënduer 1954, nr.15, Istanbul (Constantinople). Është fakt historik se, ligjërimi 5-minutësh i Ismail Qemalit në pasditen e 28 Nëntorit 1912, Vlorë, përmbante 450 fjalë. Ndërprerja më e gjatë e fjalimit të Ismail Qemalit është në momentin që ai nxjerr flamurin dhe e valëvit atë në ajër dhe thotë "Rroftë Shqipëria e Lirë!" dhe ndërkohë Pavarësia e Ismail Qemalit përfshinte të gjitha trevat shqiptare, Kosova, shqiptarët e Maqedonisë, Çamëria dhe pjesa e shqiptarëve, që u shkëput më vonë nga Mali i Zi.

#### **SHQIPTARËT & TROJET SHQIPTARE: "TË LIRË TË PAVARUR DHE MËVEHTE...!"**

*Ja ligjërata e tij me flamur në dorë menjëherë pasi ishte nënshkruar pavarësia:*

"Vëllezër shqipëtarë! Oh! Sa të lumtur që e ndiej vehten sot, që shoh, këtu në Vlorë, kaqë burra Shqipëtarë të mbledhur tok, tuke pritur me kureshti e padurim përfundimin e kësaj mbledhjeje historike, për fatin e Atdheut tonë të dashur. Plot me gaz e me lot ndër sy, nga mallëngjimi, pra, po dal këtu para jush që t'ju gëzoj me sihariqin e madh, se sot, edhe këtë minutë, Kongresi çpalli mëvetësinë e Shqipërisë, duke lajmëruar gjithë botën mbarë për këtë punë e duke më ngarkuar mua kryesin' e qeveris së përkohshme të Shqipërisë së lirë.

Porsi ëndërr më duket ky ndryshim i madh i vëndit t'atë, që hoqi e voi të zezat e të lirit pesëqind vjet me radhë ndënë sundimin turk, por që tani në kohët e fundit, ishte gati të jepte shpirtin përgjithënjë, të shuhej e të çfarrosej krejtësisht nga faqia e dheut, këjo Shqipëri, që, dikur, shkëlqente nga trimëria e pashoqe e bijve të saj; kjo Shqipëri, që kur i kërcënohej rreziku Europës nga pushtimet e Turqisë, ndënë kryetrimin e pavdekur të saj, Skënderbejnë, u bë porta e hekurtë kundra sulmeve më të tërbuara të sulltanëve më t'egër që ka pas Turqija. Mirëpo, desh Zoti, që me punën, me trimërinë dhe guximin e pashoq të Shqipëtarëve, sot e tutje të marrin fund mjerimet dhe vuajtjet e Atdheut t'atë, sepse, këtu e kështu, jemi të lirë të pavarur dhe mëvehte, prandaj: qeshni e gëzoni!

Për t'ia arrijtur kësaj dite të bardhë e të madhe, na ka ndihmuar gjaku i dëshmorëve dhe puna e vlefshme e patriotëve t'atë dhe e të gjithë shokëve që muarnë pjesë në këtë mbledhje dhe e të gjithë juve, që tani po ju gufon zemëra nga gazi i madh që ndieni; mirëpo mbledhja si më plak që jam, m'a ngarkoi mua Ngritjen e shënjtë të shënjës t'atë Kombëtare, të flamurit t'atë të ëndërruar e të dashur (nxjerr Flamurin, të cilin e ka të vendosur në një shtizë hekuri, natyrisht të vogël, dhe të pshehur nën pallto dhe pasi e mba një sekondë në dorë e ngul në shtyllat e ballkonit. Shqiptarët, posa e shohin Flamurin thërrasin me gëzim e me zë të lartë: Rroftë Flamuri, Rroftë Shqipëria e Lirë). Ja, pra, ky është Flamuri Ynë i kuq e me shqiponjën dykrenare të zezë në mest. Dhe tani, të gjithë bashkë, si një trup i tërë dhe i pandarë, le të punojmë për t'a mburuar, për

t'a përparuar e për t'a qytetëruar si i ka hije Atdhenë t'onë të Lirë. Tuke përfunduar, s'më mbetet gjë, veçse t'i drejtoj një lutje Zotit të Madh, që, bashkë me bekimet e Tij që i lipij të na japë për të qenë të denjë të kësaj dite, të pranojë që këtej e tutje të jem unë dëshmor i më i parë i Atdheut, ashtu siç pata nderin dhe fatin që të jem i pari ta puth e ta bëj të valvitet i Lirë. Flamuri i ynë, n'atdhenë t'onë të lirë. Rroftë Flamuri! Rroftë Shqipëria!". (Sipas origjinalit në AQSH, Fondi dokumentar 245/II, Dosja 1. faqe 43; si dhe libri "Ismail Qemali (Përmbledhje dokumentesh) 1888 – 1919", Shtëpia botuese "8 Nëntori", Tiranë, 1982, faqe 231-232). Kabineti i qeverisë së Vlorës është i dokumentuar në këtë mënyrë: Kryeministër dhe ministër i jashtëm: Ismail Qemali; Zëvendëskryeministër Nikoll Kaçorri, më vonë Ministër i Jashtëm Myfit Libohova, Ministër i Luftës Mehmet Pashë Dërralla, Ministër i Drejtësisë Petro Poga, Ministër i Arsimit Luigj Gurakuqi, Ministër i Financave Abdi Toptani, Ministër i Bujqësisë Pandeli Cale, Ministër i Post Telegrafit Lef Nosi.

## **FJALËARTI ISMAIL QEMALI**

### **DHE FLAMURI I SHQIPËRISË SË LIRË**

Pas shpalljes së mëvetësisë, përpjekjet 14 mujore të qeverisë së parë të përkohshme nuk reshtën në kushtet tejet të vështira, por në kujtesën e kombit nuk harrohen fjalët e Ismail Qemalit për Kosovën kreshnike dhe krejt Shqipërinë e përbashkuar në një shtet të vetëm dhe të unifikuar. Është pikërisht ligjërata e babait të kombit, Ismail Qemalit në Vlorë në tetorin e vitit 1913, që shprehej: "Zotërinj! Ju lutem të më ndjeni që ju bëra të më prisni por kam për t'ju thënë një lajm të mirë që ma solli zoti koshull/konsull i Austro-Hungarisë, me të cilin fola gjer tani. Ky lajm do ta shpërblejë mundin që muarrtë të prisnin gjer tani. Zoti Kushull më lajmëroi se, Serbët u hoqën nga të gjitha viset që kishin zënë kohët e fundit edhe këto ditë do të hiqen nga ato nja dy vise ku gjenden akoma. Kam shpresë që për së shpejti do t'u jap edhe një lajm të mirë që Grekët u hoqën nga viset të vendosura t'i mbesin Shqipërisë. Kërkova të piqem me ju edhe t'ju thom se ç'bëri e ç'nuk bëri qeveria gjer më ditën e sotme edhe përse u banë disa vepra të cilat ndofta nuk duheshin të ishin bërë. Tani mbushen njëmbëdhjetë muaj që kur se po rrojmë nën hijen e flamurit të Shqipërisë së lirë. Sot e një mot, kur të huajt i shkelën të gjitha viset e Shqipërisë, po thua, pa kurrë farë kundërshtimi, neve të bijve të këtij vendi, nuk na kishte mbetur veçse një detyrë; të përpiqemi për të formuar një qeveri, e cila duke i mbajtur të liruara viset që nuk kishin rënë akoma nën pushtetin e të huajve, të përpiqemi e të ngrejmë zërin tonë për shpëtimin e viseve të tjera e për të drejtat e Kombit Shqiptar". Fjalë-arti, plaku i bardhë i flamurit e donte Shqipërinë përtej kufijve të "Shqipërisë londineze", në kufijtë që kërkonte që në prillin e 1913-tës, në kryeqendrat e kancelarive europiane.

## **DOKUMENTI I PAVARËSISË SHQIPTARE**

### **DHE FIRMËTARËT E PAVARËSISË**

Dokumenti i pavarësisë është ekspozuar për herë të parë në nëntor 1937 me rastin e 25 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, fotografuar nga Marubi. Revista e përmuajshme "Përpjekja shqiptare", nr.13, datë 13.1.1938, fq 52 (Kapitulli "jeta dhe

librat"); rol në ruajtjen e dokumentit ka luajtur Lef Nosi, anëtar i kuvendit të Vlorës dhe ministër në qeverinë e Ismail Qemalit; dhe që ky dokument ka qenë ruajtur në një nga kasafortat e Bankës së Shqipërisë, edhe sipas Aleksandër Xhuvanit, por edhe sipas Kristo Frashërit dhe që është sot një mister që shkon deri në vitin 1962, në 50-vjetorin e shpalljes së pavarësisë dhe më tej që ka aludime që duket se nuk po hedhin dritë realisht mbi të vërtetën. Asambleja e Kuvendit të Vlorës prej 40 delegatëve në qytetin e Vlorës, më 28 nëntor 1912, hartoi një procesverbal, ku u radhitën firmat e të dërguarve të përzgjedhur delegatë të kuvendit kombëtar të Vlorës. Dokumenti u diktua nga Ismail Qemal bej Vlora, u shkrua në shqip nga Luigj Gurakuqi dhe në osmanllisht nga Shefqet Dajut. Teksti i procesverbalit ka këtë përmbajtje: "Në Vlonë më 15/28 të Vjeshtës së Tretë 1328/1912, pas fjalëvet që tha z. Kryetar Ismail Kemal beu, me të cilat tregoi rrezikun e math në të cilin ndodhet sot Shqipëria, të gjithë delegatët me një zâ venduan që Shqipëria më sot të bâhet në vehte, e lirë e e mosvarme". Pasi u përmendën prej Ismail Qemal Beut Kryetarit të Kongresit, rreziqet e mjerimet në të cilat ndodhet Shqipëria, kongresistët me një zâ pranuan Independencën edhe e proklamuan Shqipërinë Shtet Independent e të lirë.

Nënshkruesit e deklaratës së Pavarësisë janë: Ismail Kemal bej Vlora (1844 -1919); Dom Nikoll Kaçorri (1862-1917); Vehbi Dibra Agolli (1867-1937); Jorgji Karbunara – Babë Dudë Karbunara (1842-1917); Elmas Boce (1852-1925); Veli Harçi (1850-1914); Qazim Kokoshi (1882-1945); Jani Minga (1872-1947); Rexhep Mitrovica (1888-1960); Dhimitër Tutulani (1875-1937); Aristidh Ruçi (1875-1950); Abdi Toptani (1864-1942); Abas Dilaver Celkupa (1855-1926); Mit'hat Frashëri (1880-1949); Shefqet Dajiu (1882-1946); Zihni Abas Kanina Hamzaraj (1885-1957); Xhelal Koprëncka (1782-1919); Hajredin Cakrani (1860-1942); Qemal Karaosmani Elbasani (1875-1949); Iljaz Vrioni (1882-1932); Sali Gjuka (1876-1925); Dhimitër Beratti (1888-1970); Dhimitër Mborja Emanoil (1884-1945); Dhimitër Zografi (1878-1947); Murad Toptani (1867-1918); Pandeli Cale (1879-1923); Luigj Gurakuqi (1879-1925); Bedri Pejani (1885-1946); Spiridon Ilo (1876-1950); Thanasi Floqi (1884-1945); Qemal Mullaj (1881-1966); Lef Nosi (1873-1946); Dr. Hafiz Myrteza Ali Struga; Nuri Sojliu (1870-1940); Mustafa Merlika Kruja (1887-1958); Ferit Vokopola (1887-1969); Ymer Deliallisi (1873-1944); Xhemal Deliallisi (1880-1941); Nebi Sefa (1861-1942); Zyhdi Ohri (1872-1938).

Ndërsa më 1962 përvjetorin e 50-të të shpalljes së Pavarësisë, Nexhip Pelivan Alban (nga Zhulati i Gjirokastrës), botoi në Turqi librin "Arnavutlugun Bagimsizligi ve Avlonyali Ismail Kemal" (Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë...), ku në faqen 24, Nexhip Alban ka përkthyer shkrimin në osmanllisht që thotë se në dokumentin "Dokumenti i shpalljes së Pavarësisë" dhe përfundoi katër rreshta në turqisht: "Ismail Qemal Beu, kryetar i Kongresit (Kuvendit) deklaroi rreziqet e mjerimet ku ndodhej Shqipëria dhe kongresistët pranuan me një zâ independencën dhe proklamuan Shqipërinë shtet independent e të lirë".



## Alfred Moisiu, jeta dhe karriera e pasur e një ushtaraku dinjitoz e të talentuar



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

### ***Në kuadrin e 95-vjetorit të lindjes (1 dhjetor 1929 - 1 dhjetor 2024)***

Në historinë 112-vjeçare të Shtetit shqiptar, pa dyshim që ka një vend nderi presidenti, ministri i Mbrojtjes, drejtori dhe ushtaraku i lartë, veterani Dr. Alfred Moisiu. Ai është një nga figurat më të shquara të ushtrisë dhe të shkencës ushtarake shqiptare në fund shek. XX dhe fillim shek. XXI. Ai erdhi në ushtrinë shqiptare nga një familje intelektuale ushtarake. Babai, major Spiro Moisiu ishte një ushtarak madhor i ushtrisë shqiptare, të nisur karrierën e tij ushtarake në vitet

e mbretërisë, komandant batalioni, për të vijuar më tej në vitet e stuhishme të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në këtë mjedis familjar ai ka pasur kushte për të marrë një edukatë të shëndoshë familjare dhe ushtarake, që e ka ndihmuar gjatë gjithë jetës për të patur rezultate të larta si nxënës, student ushtarak dhe në të gjithë jetën e tij aktive në Forcat e Armatosura dhe civile. Shkollën fillore e nisi në qytetin e Fierit, ku i ati shërbente për të vijuar të mesmen në Shkodër, ku u dallua për rezultate shumë të mira, për të përfunduar në gjimnazin “Qemal Stafa” në Tiranë në vitin 1945, ku mori njohuri të plota në të gjitha lëndët dhe u përgatit me formim të gjithanshëm. Gjatë luftës, në situatat e turbullta dhe të ndërlikuara politike të vendit, në sajë të ndjenjave patriotike dhe të ideve përparimtare, familja e tij u orientua shpejt dhe mori pjesë aktivisht në Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare. Major Spiro Moisiu zgjidhet komandant i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, më 10 korrik 1943, në Kongresin e Përmetit u gradua gjeneralmajor dhe pas Çlirimit të vendit kreu detyrën e kryetarit të Shtatmadhorisë të UNÇSH.

Ndërsa Alfred Moisiu u përfshi në luftë i organizuar në rininë Antifashiste dhe në mjaft aksione të zhvilluara prej saj. Me çlirimin e vendit studimet e larta Alfred Moisiu i kreu në shkollat dhe akademitë ushtarake të BS. Siç ka shkruar në kujtimet e tij: “Kërkova të

regjistrohem për ushtarak, por im atë ishte kundër, me arsyetimin se do të ishte mirë të studioja në ndonjë degë civile, për arsye se jeta ushtarake është e vështirë dhe nuk dëshironte të ndiqja rrugën e tij. Mirëpo edukata ushtarake e prindit kishte bërë punën e vet, gjatë rritjes fëmijët edukohen dhe familjarizohen me profesionet e prindit, duke marrë pjesët më të mira. Duke u edukuar me rregullin, disiplinën, uniformën ushtarake, ishte dashuria për karrierën ushtarake, por dhe ëndrra për të studiuar në shkollat ushtarake të BS”.

Kështu u nisën studimet në Akademinë e Xhenios në BS me njohjen e rregullave, pasi ato ishin shumë të rëndësishme për çdo ushtri, sepse rregullon gjithë marrëdhëniet ndërmjet eprorëve dhe vartësve, si dhe jetën e brendshme të reparteve ushtarake. Aty mësoi se përmbajtja e tyre mund të ndryshojnë në bazë të traditave të çdo ushtrie, por pa një rregullore, asnjë ushtri nuk mund të jetojë dhe ushtrojë veprimtarinë e saj në mënyrë të rregullt. Në mësimin e parë iu desh për të mësuar, shpjeguar dhe kuptuar përcaktimi dhe ndryshimi midis “gjitharmësh” dhe “lloj arme”. Këto ishin terma të mirëfillta ushtarake dhe duhej kuptuar brendësia e problemit. Një mësim të vyer mori nga studimet ushtarake, ruajtja e dokumenteve të rëndësishme, sepse ato kanë rëndësi për vendimet e drejta të marra dhe të zbatuara me mjeshtëri në kohën e duhur. Pra, krahas teorisë në Akademi mësoi shumë nga shembujt që jepeshin për luftën, për të rritur përfytyrimin real mbi veprimet luftarake në fushën e betejës. Falë zotërimit të shpejtë të gjuhës ruse, studimet i përfundoi me rezultate shumë të mira, shkëlqyeshëm Shkollën Ushtarake të Xhenios në Bolshevo dhe në Leningrad në vitin 1948.

Oficeri i ri Alfred Moisiu u emërua komandant toge dhe pedagog në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve. Në vitet 1948-1951 kreu detyrën e komandantit të togës dhe njëkohësisht ka dhënë mësim e ka zhvilluar stërvitje në lëndën e xhenios. Ndonëse oficer i ri, puna e tij vlerësohej, si nga kolegët, komanda, ashtu dhe nga kursantët ushtarakë. Kërkesa për të qenë prezent gjatë gjithë kohës pranë togës në mënyrë që kursantët të ishin vazhdimisht nën kontroll, natyrisht që ishte një ngarkesë e përditshme shumë e madhe për kuadrin. Ndërsa kërkesa për një rritje cilësie të stërvitjes, kërkonte kohë për t’u përgatitur çdo ditë. Pedagogu i ri i shtron komandës propozim për ndarje lënde midis oficerëve-pedagog, për dy togat xheniere, që kishin të njëjtin program. Komanda e vlerësoi drejt propozimin dhe u bë ndarja, ku Alfred Moisiu zhvilloi lëndët: ura ushtarake, fortifikata, rrugë ushtarake, lëndë plasëse dhe shkatërtime fushore, taktike speciale dhe lëndë të tjera që kishin të bënin me përgatitjen xheniere, ndërsa kolegu mori lëndët: punime nëntokësore, pengesa me mina, furnizim me ujë etj.


Tekstet mësimore në vitin 1948 ishin të pakta. Oficerët e rinj u detyruan të përkthehin rregulloret kryesore në gjuhën shqipe. Ishte një punë e vështirë, dhe u kërkua ndihmë nga drejtuesit kryesore të Drejtorisë së Xhenios (në atë kohë Komanda e Xhenios), të cilët e përkrahën mendimin. Ngarkesa e përkthimit u nda dhe të gjitha këto bëheshin në kohën e lirë dhe pa asnjë shpërblim. Vështirësia qëndronte jo vetëm tek problemi i literaturës, por një çështje jo e vogël ishte dhe terminologjia. Nga ushtria shqiptare nuk kishim rregullore, por dhe përkthimet nga italishtja dhe terminologjia e saj ishte pothuajse e njëjtë. “Kërkuam dhe insistuam, - thekson në kujtime presidenti, -që gjatë përkthimit të bënim përpjekje për të përcaktuar terminologjinë në gjuhën shqipe, që nuk ishte dhe e thjeshtë për ta bërë, por me punë ia dolën”.

Alfred Moisiu vijoi studimet e larta në Akademinë e Xhenios në Moskë në vitet 1952-1958, ku u diplomua përsëri me medalje të artë. Me kthimin nga studimet e larta ushtarake emërohet në drejtorinë e Xhenios në Ministrinë e Mbrojtjes. Në këto vite operacionet luftarake për repartet xheniere përgatiteshin në drejtori, si hartimi i planeve operative luftarake, detyrat e sigurimit xhenier të njësive gjitharmëshe të ushtrisë, përpilimi i programeve të zhvillimit të armës së xhenios, hartimi i pjesës xheniere të planeve të stërvitjeve, pjesëmarrja në stërvitjet e ndryshme që drejtonte Drejtoria dhe Ministria e Mbrojtjes, nga stërvitjet e shtabeve, komando-shtabi me pjesëmarrje të



pjeseshme të trupave dhe me mjete ndërlidhjeje në terren, në stërvitje me trupa etj. Ishte një punë tepër intensive për oficerët në drejtori, pasi për çdo stërvitje bëhej hartimi i planeve për punimet fortifikuese për repartet xheniere të RKP (Rezervë e Komandës së Përgjithshme), hartimi i planit të punimeve operative për njësitë e ushtrisë, ndjekja e tyre, koordinimi i punës me Institutin e Projektimit të Ushtrisë dhe hartimi i detyrave të projektimit për të, sipas nevojave të reparteve xheniere dhe të njësive të ushtrisë. Në të gjithë këtë veprimtari teorike dhe praktike reflektohej dhe përvoja e talenti Alfred Moisiut. Krahas kësaj pune intensive, kërkohesh dhe përgatitja e literaturës së nevojshme për punimet fortifikuese, shtabet e reparteve xheniere, dhe shtabet xheniere të njësive gjitharmëshe. Në vijim vinte dhe studimi i taktikës, i teknikës xheniere të ushtrive të huaja, i të dhënave të zbulimit për ushtritë e huaja, në mënyrë të veçantë për vendet fqinje, por dhe të dhëna për NATO-n dhe Ushtrinë Sovjetike. Ishte një kohë kur Ushtria Shqiptare kryente shumë stërvitje, nga të gjitha llojet dhe në stërvitje të ndryshme të mëdha që bënte ushtria shqiptare, gjithmonë do të ishin dhe përfaqësues të Komandës së Traktatit të Varshavës. Nisur nga zotërimi i mirë i gjuhës ruse, Alfred Moisiu shpesh i shoqëronte në stërvitje.

Në punë, siç ka shkruar, është udhëhequr nga lajtmotivi se “Po nuk respektoam veten, nuk ka për të na respektuar njeri”. Nga praktikat dhe stërvitjet e shtabit që zhvilloheshin në mënyrë të dendur në repartet e ushtrisë, ndaj eprorëve dhe vartësve gjithmonë është treguar një ushtarak korrekt dhe në respekt të punës dhe të rregulloreve ushtarake. Në këtë stërvitje që përpunoheshin të gjithë elementët e nevojshëm, të cilët duhet të njiheshin dhe të



përvetësoheshin nga oficerët dhe komandantët e njësisë, përparësi iu kushtonte elementeve të edukatës ushtarake. Kështu gjatë tërë viteve në drejtorinë xheniere ushtaraku i lartë Alfred Moisiu ka dhënë një kontribut të çmuar në hartimin e planeve, të drejtimeve dhe të organizimit të punës shkencore për repartet xheniere. Në korrik të vitit 1962 merr gradën ushtarake “major”.

Nga fundi i vitit 1966, në Ministrinë e Mbrojtjes u zbatua vendimi për qarkullimin e kuadrit. Në qarkullim u përfshi dhe Alfred Moisiu, duke u caktuar komandant i Brigadës të Urave të Rënda në Kavajë. Në këtë njësi të re të Ushtrisë u udhëhoq nga parimi se komandanti nuk mendon, ai vendos! Këtë mësim e kishte marrë nga akademitë ushtarake, ku mendimet i jep shtabi dhe jo komandanti. Kështu ushtaraku, aq më tepër komandanti i brigadës i duhej të ishte shumë i prerë dhe shumë i qartë në shprehjet e tij. Këtë ia kishte mësuar shkolla, por dhe fjalori ushtarak, i cili nuk pranon ujëra të tepërta, pasi në situata luftarake minutat janë shumë të çmueshme dhe koha duhet përdorur në mënyrë racionale. Po ushtria gjithmonë, edhe në paqe, është në luftë, pasi detyrat duheshin kryer si në luftë. Krijimi i kësaj njësie ushtarake ishte një ngjarje e shënuar për ushtrinë, por dhe një hap shumë i madh përpara për riorganizimin, reformimin dhe zhvillimin e njësisë. Komandant Alfredi me kulturën e tij të gjerë dhe aftësitë ushtarake e organizative dhe një kontribut të çmuar për ngritjen dhe organizimin e brigadës. Për këtë njësi, për gjithçka, që nga fillimi, komandanti kontribuoi mendërisht dhe fizikisht, nga kompletimi i saj deri në përgatitjen dhe sjelljen në formën e duhur të gatishmërisë luftarake, me një teknikë të panjohur, deri atëherë në ushtrinë shqiptare.

Me formimin e lartë, pasi kishte përfunduar dhe Kursin e Lartë të Shtabit të Përgjithshëm pranë Akademisë Ushtarake, me përvojën e gjithanshme të fituar në studime dhe në punë si komandant brigade, me intuitën e thellë për parashikime largpamëse, Alfred Moisiu si drejtor i Drejtorisë së Xhenios në MM dhe një ndihmesë të veçantë në zgjidhjen e mjaft problemeve që qëndronin para kësaj drejtorie.

Një nga problemet e rëndësishme të fillimit, ku Alfred Moisiu ishte në funksion si drejtor ishte se përpara se të fillonin punimet fortifikuese kërkoi studimin topografik dhe gjeologjik të terrenit, ku do bëheshin punime fortifikuese. Më tej shtroi nevojën e organizimit dhe të përgatitjes në masë të zjarrmëtarëve ushtarët aktiv, nëpërmjet kurseve të veçanta që zhvilloheshin nga xhenierët në ushtri. Ndërsa me oficerët e këmbësorisë dhe të artilerisë që

drejtonin punimet, u organizuan kurse të veçanta për perfeksionimin e tyre. Por në të njëjtën kohë, në programet e shkollave ushtarake për oficerët e rinj u futën këto disiplina. Njëkohësisht ndryshoi dhe plan-kalendarin vjetor të periudhës së kryerjes të punimeve fortifikuese në ushtri. Ishte një kohë që nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm dhe ministri i Mbrojtjes kërkonin llogari për ndërtimin e tuneleve dhe të punimeve të tjera fortifikuese, sesa për çështjet e stërvitjes. Kjo ndryshoi me programe në saj të përpjekjeve të drejtor Alfred Moisiut.

Një problem tjetër i rëndësishëm i kësaj periudhe ishte dhe fortifikimi, pjesa profesionale, për të cilën kishte përgjegjësi të veçantë. Në studim të fortifikimit hasi në kontradiktën midis një fortifikim solid, në një kohë kur mbrojtja ishte e manovrueshme. Kështu që sugjeroi të shikoheshin shpenzimet e mëdha për fortifikimin e vendit në brezat e mbrojtjes së fortifikuar, të cilat lëshoheshin me lehtësi. Në Drejtorinë e Fortifikimit u punua për të ndërtuar një sistem fortifikimi me një qëndrueshmëri maksimale. U studiuan përvojat e njohura botërore të fortifikimit, shkolla të ndryshme të fortifikimit, secila me veçori të tyre, dhe u kalua në përvojën shqiptare. Në këtë kohë drejtoria përbëhej tërësisht nga oficerë të rinj, me një nivel të mirë kulture të përgjithshme dhe ushtarake, të etur për të mësuar dhe të prirë nga një shpirt gare për të dalë me rezultate më të mira se drejtoritë e tjera.

Problem i rëndësishëm në detyrën e zëvendësministrit, në nëntor 1980, ishin uzinat ushtarake ku u dërgua i komanduar në Mjekës të Elbasanit si drejtues i punimeve në ndërtimin e Uzinës së Barutit, që kishte mbetur prapa në raport me grafikun e miratuar. Përvoja që dha ushtaraku i lartë ishte bashkëpunim, pasi mosbashkëpunimi kishte krijuar shqetësime dhe tendenca të theksuara për t'i lënë përgjegjësinë njëri-tjetrit.

Problemet rrodhën ndryshe dhe zëvendësministri u transferua në një njësi të Burrelit. Meqë kishte qenë kuadër me përgjegjësi të lartë në ushtri, dhe rrjedhimisht ishte në dijeni të mjaft sekreteve të ushtrisë, u paralajmërua se, nëse dekonspiron do mbante përgjegjësi penale. E emëruan në detyrën e shefit të xhenios të Brigadës në Burrel. Ushtaraku me përvojë, pavarësisht se shkoi në njësi me ulje në detyrën ushtarake, qëndroi dinjtoz, kështu që komanda dhe personeli oficer ruajtën respekt dhe dashamirësi. Koha e kërkoi në detyrën e ministrit të Mbrojtjes për një periudhë të shkurtër, pasi nuk ishte pjesëtar i asnjë force politike. E pranoi detyrën, sepse ushtaraku vlerësoi situatën dhe u vu në roje të Atdeut. Më tej u gjend në detyrën e këshilltarit në Ministrinë e Mbrojtjes. Kundërshtoi heqjen me ngut dhe për të zhdukur çdo shenjë të së kaluarës, vendimin për ndryshimin e emblemës së ushtarakëve, për të hequr yllin nga kapela. Përsëri në detyrën e zëvendësministrit të Mbrojtjes u kujdes dhe propozoi disa ndryshime të cilat u miratuan. Konkretisht aparati që ishte direkt në vartësi të ministrit të ndahej në bllokun politik me zëvendësministër A. Moisiu dhe blloku ekonomik... Kështu në këtë kohë u krijua Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë si dhe Dega e Veteranëve të Luftës.

Vlerësoi krijimin e shoqatës shqiptare të Atlantikut dhe punoi për vazhdimësinë e aktiviteteve të saj pas largimit nga Ministria e Mbrojtjes. Përherë lajtmotivi i Alfred Moisiut ka qenë se nëpunësi i shtetit dhe shtetari duhet të punojnë me ndershmëri, duke mos abuzuar kurrsesi me detyrën e tyre. Motoja e punës në raport me detyrat shtetërore gjithmonë ka qenë: të bëj detyrën dhe shteti të mendojë për mua (ushtarakun). Me gjithë angazhimet e mëdha në drejtimin e ushtrisë, në punën administrative, drejtuese dhe në veprimtarinë mësimore e shkencore, Dr. Alfred Moisiu ka një prodhimtari të pasur botuese. Ai është autor dhe bashkautor i disa teksteve mësimore për xhenion shqiptare, por edhe i disa librave, si dhe i një numri të madh me artikuj, referime shkencore dhe studime të botuara në organe të ndryshme të vendit e të huaja. Dr. Alfred Moisiu dhe në moshën 95 vjeçare, përsëri është një emër i ndritur në historinë e arsimit të lartë ushtarak dhe të shkencës ushtarake shqiptare.

# Organizata Kombëtare e Dëshmorëve të LANÇ dhe të Dëshmorëve të tjerë të Atdheut, takim jubilar me rastin e 80-vjetorit të Çlirimit të Atdheut

**N**ë kremtim të 80-vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë, Organizata Kombëtare e Dëshmorëve të LANÇ-it dhe të Dëshmorëve të tjerë të Atdheut organizoi një takim jubilar, qëllimi i të cilit është të nderojë kontributin e dëshmorëve dhe veteranëve në 80-vjetorin e Çlirimit të Shqipërisë, duke vlerësuar sakrificën e tyre për lirinë e vendit dhe të rrisë ndërgjegjësimin për këtë periudhë vendimtare në histori, përmes kumtesave të të pranishmëve.

Organizatorët synojnë të përkujtojnë 80-vjetorin e çlirimit nga pushtimi nazist. Kjo ngjarje përfaqëson kulmin e një lufte të gjatë dhe të përgjakshme që kërkoi sakrificën e shumë patriotëve, të cilët me guxim dhe vendosmëri luftuan për lirinë e atdheut të tyre. 29 Nëntori shënon ditën e triumfit të popullit shqiptar, një ditë që ka një rëndësi të paçmuar për historinë tonë kombëtare dhe që u përcjell brezave të ardhshëm mësim të rëndësishme.

Dr. Gjergji Velo, kryetar i Organizatës Kombëtare për Dëshmorët e LANÇ-it dhe Dëshmorët e tjerë të Atdheut, i cili mbajti dhe fjalën e hapjes u shpreh se: “Në këtë 80-vjetor të çlirimit të Atdheut, bashkia Tiranë në bashkëpunim me Organizatën Kombëtare të Dëshmorëve të LANÇ-it dhe të Dëshmorëve të tjerë të Atdheut organizon këtë takim jubilar me ju nëna, motra, vëllezër e nipër të Dëshmorëve të Atdheut. Personalisht e kam kërkuar të kishim në këtë veprimtari pushtetin vendor e atë qendror dhe ja ku kemi këtu mes nesh Presidentin e Republikës, zotin Bajram Begaj, ish-presidentët e Republikës, zotërinjtë Alfred Moisiu, Rexhep Meidani e Bamir Topi, kryetaren e Kuvendit të Shqipërisë, zonjën Elisa Spiropali, zëvendëskryeminstren, zonjën Belinda Balluku, kryetarin e Bashkisë, zotin Erjon Veliaj, ministren e Arsimit, zonjën Orgesa Manastirliu, prefektin e Tiranës, zotin Afrim Qendro, kryetarin e Këshillit të Qarkut, zotin Aldrin Dalipi, nënkryetarin e Bashkisë, zotin Andi Seferi, kryetaren e këshillit bashkiak, zonjën Romina Kuko, deputetë dhe të tjerë. Në emrin tuaj u uroj mirëseardhjen në këtë takim jubilar!

Në prag të dy datave historike, 28 Nëntorit të Pavarësisë dhe 29 Nëntorit të Çlirimit të Atdheut organizojmë këtë takim festiv për të nderuar bijtë më të lavdishëm të Shqipërisë, veprën e të gjithë çlirimtarëve heroikë, Heronjtë e Popullit dhe Dëshmorët e Atdheut, që i kontribuon 28 Nëntorit të

lavdishëm, si dhe ata që ranë e mbetën përjetë lapidarë për 29 Nëntorin e çlirimit të Shqipërisë.

Historia e popullit është histori lavdie. Që të vinte 28 Nëntori, Dita e Mëvetësisë Kombëtare, u desh të luftohej pa ndërprerë për t’u shkëputur një herë e përgjithmonë nga sundimi i gjatë otoman dhe për t’iu bashkuar Europës si shtet më vete. Për këtë kauzë luftuan, ranë dhe mbetën lapidarë shumë nga trimat e pushkës e të penës së periudhës së Rilindjes, si dhe shumë luftëtarë të çetave të para kryengritëse dhe të Lirisë.

Dita e 28 Nëntorit, që është futur në histori si Dita e Flamurit, ka qenë dhe ka për të mbetur Përmendore e lartë Historie. Gjejmë rastin t’u drejtojmë Plakut të urtë të Flamurit, Ismail bej Vlorës dhe patriotëve të tjerë firmëtarë të Aktit të Pavarësisë, tërë mirënjohjen tonë të thellë.

Edhe mbas 28 Nëntorit historik popullit tonë iu desh të mos e hiqte pushkën nga dora. Sepse kohët ishin të turbullta dhe situata në Ballkan e në Europë ishte tepër e rrezikshme. Duheshin mbrojtur kufijtë e juglindjes nga andartët grekë, por edhe viset e veriut prej ndërhyrjeve të egra serbe!

Ishte koha kur Konferenca të ndryshme europiane e shqyenin Shqipërinë, duke i shkaktuar një tragjedi shekspiriane. Në këto kushte, në jug e në veri të vendit, shqiptarët e rreshtuar në çeta atdhetare u vunë në mbrojtje të kufijve të shenjtë të Atdheut. Sot u përulemi dhe do të vazhdojmë t’u përulemi me shumë respekt këtyre bijve të pavdekshëm, që iu përgjigjën zërit të Atdheut dhe shumë prej tyre nuk kursyen as gjakun për çështjen e shenjtë të Shqipërisë.

S’janë të paktë të rënë e flijuar për drejtësi shoqërore dhe liri





demokratike. Në vargun e gjatë të martirëve të sakrifikuar për emancipim shoqëror janë edhe tërë ato figura të shquara e të pavdekshme, që sot i kemi mbi piedestale të lartë. Pozicionuar në krahun e duhur të historisë, në krahun e atdhetarizmit, këta dishepuj të Atdheut nuk u pajtuan me regjimin e Zogut, pranuan vetëmohim e deri edhe flijim të jetës së tyre.

Qofshin përherë të paharruar në mendjet dhe në zemrat tona!

Fashizmi mbetet kudo e kurdoherë fashizëm. Ai është rrezik i madh për çdo vend. Ja pse dhjetëra e qindra guximtarë shqiptarë kaluan male e dete dhe iu gjendën pranë popullit spanjoll në ditët e tij më të vështira për të asgjësuar bishën gjakatare fashiste. Dhe sot, nga ky takim solemn historik, ne u bëjmë homazh antifashistëve shqiptarë në Spanjë, që luftuan e mjaft prej tyre ranë për një kauzë të shenjtë: asgjësimin e bishës më të egër që ka njohur njerëzimi: nazizmit gjerman. Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e Popullit Shqiptar është epopeja më e madhe e popullit shqiptar. E filluar kjo më 7 prill të vitit 1939, kur atdhetarët e vërtetë shqiptarë u përballën me mijëra pushtues italianë, Mujo Ulqinaku me shokë i dëshmuar Europës dhe botës se antifashizmi shqiptar ishte flamur lufte. Antifashistët me në krye Mujon u bënë qëndresë heroike pushtuesve italianë. Mbreti Zog, që kishte premtuar se do të vishte opingat për të dalë malit për të luftuar kundër pushtuesve italianë, mbushi valixhet me flori dhe ia mbathi për jashtë shtetit! Mbasi hëngri drekë e darkë në Zemblak, tradhtoi Atdheun – Shqipërinë! Por shqiptarët u komanduan nga ndërgjegjja e tyre. Shkuan me vetëdije drejt flijimit në emër të Atdheut. Ndërkohë, kodrave të Pezës gjëmonte pushka e trimave të Çetës së parë Antifashiste në Shqipëri. Radio Londra i bënte të ditur Europës, se antifashistët e Myslim Pezës luftonin trimërisht dhe korrnin fitore kundër pushtuesve italianë. E ideuar, e frymëzuar dhe e udhëhequr nga

Partia Komuniste Shqiptare, Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare, e realizuar në bashkëpunim edhe me nacionalistët e ndershëm dhe patriotët, që në fillimet e veta mori përpjesëtime të gjëra. Pas Konferencës së Pezës nisën e vazhduan të krijoheshin njëra mbas tjetrës çetat e para partizane, si dhe këshillat nacionalçlirimtare. Nuk do të vononte shumë dhe, më 10 korrik 1943, do të krijohet në Elbasan Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare me komandant major Spiro Moisiun dhe komisar Enver Hoxhën. Dhe vetëm një muaj më pas, më 15 gusht 1943, do të krijohet në Vithkuq Brigada I Sulmuese Partizane, e cila do të pasohej edhe nga shumë të tjera.

Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e Popullit Shqiptar ka qenë, është e do të mbetet medaljon historie për atdheun. Pinjollët e Ballit Kombëtar, por edhe disa pseudo historianë servilë të pushteteve të radhës përpiqen ta njollosin këtë Luftë me të ashtuquajturën luftë civile (!), por e kanë marrë të qartë përgjigjen nga pjesëtarët e Familjeve të Dëshmorëve, nga Pasardhësit e Veteranëve të Luftës, si dhe nga kushdo tjetër që i dhimbset Atdheu. Sigurisht, na vjen keq kur shikojmë të botohen libra që fyejnë kuadrot e larta të Luftës, madje edhe Heronjtë e Popullit, duke i konsideruar kriminel luftë (!), por ne nuk do të pushojmë së punuari për t'u nxjerrë bojën këtyre kalemxhinjve. E njohur zyrtarisht nga Aleatët e mëdhenj anglo – sovjetë – amerikanë në dhjetor të vitit 1942, Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e Popullit Shqiptar vazhdoi të ndizej flakë jo vetëm në Shqipëri, por edhe jashtë kufijve shtetërorë të saj. Në vijim të planeve që zbatonte Koalicioni Antifashist Botëror, me urdhër luftarak të Komandantit të Përgjithshëm, disa brigada partizane kaluan matanë kufirit shtetëror dhe vazhduan t'i ndiqnin nazistët gjermanë këmba – këmbës edhe në trojet e Kosovës martire dhe të ish-Jugosllavisë, gjatë të cilave ranë e mbetën yje të pashuar rreth 60 partizanë, 20 prej të cilëve ishin komisarë. Përfjetë lavdi trimave që ranë në Kosovë dhe në trojet jashtë kufijve shtetërorë!

Gjatë këtyre tridhjetë e katër vjetëve demokraci kanë rënë në krye të detyrës mbi 250 punonjës të Policisë së Shtetit, që tashmë kanë zënë vend në gjerdanin e artë të Dëshmorëve të Atdheut.

Qofshin përjetë të paharruar!

Ndërsa kujtojmë e nderojmë dy datat lapidare, 28 dhe 29 Nëntorit, veprën e Dëshmorëve që çuan në këto dy lapidare, nuk mund të mos kujtojmë e të mos përkulemi me plot nderim edhe përpara të rënëve të lavdishëm të vëllezërve tanë në Kosovë. Epopeja e Adem Jasharit nuk ka për t'u harruar kurrë. Gjaku i Heronjve dhe i Dëshmorëve të Kosovës gjendet në themelet e shtetit më të ri të Europës, Kosovës martire.

Shqipëria ka bërë dhe vazhdon të bëjë hapa të shpejta përpara drejt familjes së civilizuar europiane, drejt institucioneve të saj më të larta, në themelet e të cilave është antifashizmi. Le të punojmë të gjithë së bashku, që të forcojmë shtetin ligjor dhe të emancipojmë pareshtur demokracinë.

Në emrin tuaj, pjesëmarrës të nderuar, si dhe në emër edhe të rinjve që ndodhen këtu përsërisim mesazhin aktual: ta transmetojmë stafetën e lavdisë së Dëshmorëve nga brezi në brez! Ndërkohë, rikujtojmë atë çka kemi ngritur prej kohësh, që shteti të na përfshijë në protokollin e vet dhe në Ditën e Dëshmorëve të Atdheut të mbahet një minutë heshtje kombëtare për ata që kanë bërë luftën dhe që kanë dhënë jetën për interesat më të larta të Shqipërisë. Ripërsërisim kërkesën që Simbolet e LANÇ-it dhe Varrezat e të rënëve për Atdhe të urbanizohen për t'i bërë sikundër i ka Europa dhe bota e qytetëruar demokratike. Ndërkohë, do të ishte në nderin e Shtetit në qoftë se do të krijonte një institucion që do të merrej me studimin e ngjarjeve më madhore të historisë së popullit tonë, filluar nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe deri në ditët tona.

Lavdi Dëshmorëve të LANÇ dhe Dëshmorëve të tjerë të Atdheut! Rrofshin 28 dhe 29 Nëntori, dy lapidarët më të lartë të historisë së popullit tonë!

# "WOMEN IN UNIFORM", burim i vyer i eksperiencës dhe përvojës

## ***Bashkëpunimi i Forcave të Armatosura të RSH dhe Forcave të Armatosura Britanike***

Në kuadër të programit të partneritetit të bashkëpunimit ndërmjet Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcave të Armatosura të Britanisë së Madhe, në vijimësi janë zhvilluar aktivitete të përbashkëta që nga stërvitjet e përbashkëta deri tek aktivitetet e barazisë gjinore.

Sjellin në vëmendje disa nga këto stërvitje, ku Forcat tona të Armatosura kanë realizuar me sukses pjesëmarrjen e tyre. Si, stërvitja "Joint Effort-16", stërvitja "Silver Arrow", stërvitja e Përbashkët Command Post Exercise "LogEx 17" më 2017 në Shqipëri, Stërvitja e Përbashkët "Albanian Lion 2018", Stërvitja "Albanian Effort" e zhvilluar në vendin tonë në 2017; Stërvitja "Strong Eagle", Stërvitja e përbashkët detare bregdetare "Austere Wolf-24", "Corridor VIII Response", që u zhvillua paralel me 39; "Strategic Reserve Force 39" etj.

Por ndër aktivitetet e shumta të FARSH-së, janë edhe ato të "Barazisë Gjinore", "Women in Uniform", "Gruaja, Paqja e Siguria", etj. "Vetëm gjatë këtij viti janë realizuar një sërë aktivitetesh, me trajnime mbështetur nga UNDP me qëllim njohjen dhe orientimin e pjesëmarrësve me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, lidhur me parimet dhe standardet e barazisë dhe mos diskriminimit, kuptimin e dhunës, ngacmimit, ngacmimit seksual dhe të mjedisit të sigurt në punë, kryesisht në sektorët e MM dhe SHPFA.

Nga ambasada Britanike, në vijim të aktiviteteve vjetore në kuadër të bashkëpunimit janë realizuar konferenca, seminare dhe aktualisht jemi në procesin e projektit "Women in Uniform", i cili konsiston në zhvillimin e trajnimeve bazë të sportit të vetëmbrojtjes", na thotë Arben Mollaj, specialist në drejtorinë J9, i cili është koordinator i projektit "Women in Uniform".

Në siparin e këtyre aktiviteteve referuan dhe përfaqësuese nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, mes tyre dhe kolonele Razie Mehmeti, e cila mes të tjerash tha: "Ne jemi shumë krenare për vajzat dhe gratë tona të guximshme në uniformë, për kontributin e tyre të shkëlqyer. Nga përvoja ime si grua në uniformë kam bërë ato punë që bëjnë dhe burrat, por të qenit grua hap dier të tjera nga komuniteti ku shërben, duke krijuar mundësinë për t'u angazhuar me të gjithë shoqërinë".

Ky projekt po zhvillohet në një shtrirje të gjerë gjeografike në territorin e Shqipërisë me pjesëmarrës nga personeli i FA-së si pjesë e bashkëpunimit të Forcave të Armatosura të RSH-së dhe Forcave të Armatosura të Britanisë së Madhe.

Në vitin 2013 filloi zyrtarisht implementimi i projektit "Guidë vetëvlerësimi për çështjet e barazisë gjinore në Forcat e Armatosura", ku një nga çështjet e diskutimit ishte bashkëpunimi i ngushtë dhe i thellë për barazinë gjinore në Forcat e Armatosura. Respektimi i barazisë gjinore dhe të femrës në Forcat e Armatosura, e cila përfaqësohet në të gjitha nivelet jo vetëm brenda vendit por prej vitesh ka qenë pjesë e misioneve paqeruajtëse.

Implementimi i projektit u mundësua nga "Qendra për Kontrollin Demokratik në Forcat e Armatosura", në Gjenevë dhe u mbështetet nga organizata e Kombeve të Bashkuara UNWomen.

Guida e vetëvlerësimit në FA ka shërbyer si një instrument për të matur përgjegjshmërinë dhe rezultatet në fushën e barazisë gjinore, parë në këndvështrimin e të drejtave të individit në FA, femra dhe meshkuj.

Herë pas here janë zhvilluar anketime me qëllim përpilimin i një studimi mbi pozitën që ka aktualisht gruaja në radhët e Forcave të Armatosura, si dhe cilat janë masat dhe sugjerimet që duhen dhënë për arritjen e objektivave strategjike për barazinë gjinore në Forcat e Armatosura. Gratë në FARSH janë njohur në vijimësi me Rezolutën 1325 "Gruaja, Paqja dhe Siguria".

Autoritete të larta ushtarake si gjeneralmajor Manushaqe Shehu, kolonel Razie Mehmeti, kolonel Irela Nebiaj, si dhe gra ushtarake nga FARSH, kanë qenë të pranishme në konferencat e zhvilluara Brenda e jashtë vendit "Gruaja, Paqja dhe Siguria", me mbështetjen e Ambasadës Britanike, në kuadër të zbatimit të Rezolutës 1325 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Trajtimi historik i rekrutimit të gruas shqiptare në Forcat e



Armatosura, duke marrë pjesë në shumë trajnime/stërvitje dhe misione paqeruajtëse jashtë vendit si në Afganistan, Detin Egje, Kosovë, Letoni, gjithashtu dhe në përfaqësitë tona ushtarake jashtë vendit.

Gratë në Forcat tona të Armatosura zënë një përqindje të lartë, bazuar kjo në planin e veprimit dhe Direktivën e Mbrojtjes 2024, për të arritur një përfaqësim prej 15%. Gatishmëria dhe roli i gruas në Forcat e Armatosura është e madhe, ku nga FARSH dhe MM i kushtohet një rëndësi akoma dhe më e madhe me qëllim që femrat ushtarake të ndihen të vlerësuara ashtu si dhe kolegët e tyre.

Gjatë vitit 2024 janë realizuar një numër aktivitetesh, me qëllim njohjen dhe orientimin e pjesëmarrësve me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, lidhur me parimet dhe standardet e barazisë dhe mos diskriminimit, kuptimin e dhunës, ngacmimit,



ngacmimit seksual dhe të mjedisit të sigurt në punë, kryesisht në sektorët e MM dhe SHPFA. Ndërkohë që projekti "Women in Uniform", konsiston në zhvillimin e trajnimeve bazë të sportit të vetëmbrojtjes. Ky projekt është në vijim të projektit "Women in Uniform Association", realizuar gjatë 2023, i cili konsiston në zhvillimin e trajnimeve bazë të sportit të vetëmbrojtjes.

Edhe gjatë kësaj periudhe ky aktivitet i drejtuar nga Ambasada Britanike do të zhvillohet nga 2 (dy) instruktore femra dhe 1(një) mashkull, efektivë të Forcave të Armatosura të Mbretërisë së Bashkuar, të cilët do të trajnojnë personelin femra dhe meshkuj nën uniformë (do të dominojë personeli femër) nga strukturat e FARSH-së, Policisë së Shtetit, Drejtorisë Burgeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Këto aktivitete do të zhvillohen në qytetet: Tiranë, Durrës, Berat, Vlorë dhe Shkodër. FARSH do të krijojë ekipeve sportive nga strukturat e ndryshme për trajnim në disiplinën e sporteve të vetëmbrojtjes. Kjo është një mundësi e mirë jo vetëm për përmirësimin e aftësive të mirëfillta ushtarake, por edhe një mundësi e mirë për të promovuar disiplinën e sporteve të vetëmbrojtjes.

#### **Partneritet bashkëpunimi, ndërveprim i suksesshëm i FA-ve të RSH me FA-të e Britanisë së Madhe**

Forcat tona të Armatosura vazhdojnë të marrin denjësisht pjesë në stërvitjet e përbashkëta, në kuadër të partneriteteve dhe bashkëpunimit me aleatët.

Stërvitja "Joint Effort-16", Stërvitje e përbashkët me qëllim rritjen e ndërveprueshmërisë ndërmjet SHBA-së, Britanisë Madhe, Italisë, Kosovës, Malit të Zi dhe Shqipërisë, janë një burim i vyer i eksperiencës dhe përvojës në fushëbetejë dhe vijnë të mbeten dhe një instrument i rritjes së ndërveprimit të Forcave Armatosura. Kjo i shërben rritjes së kapaciteteve operacionale të shtabeve dhe njësive të FA-së në procesin e planëzimit dhe ekzekutimit të operacioneve luftarake në mjedis të përbashkët dhe multinacional, në nivel taktik dhe operativ.

Stërvitja "Joint Effort - 16" kishte për objekt trajnimin dhe stërvitjen e pjesëmarrësve për të përballuar sfidat operacionale aktuale dhe të ardhme me qëllim përgjigjen ndaj krizave të ndryshme dhe operacioneve në mbështetje të paqes nga 6 vende me rreth 1500

trupa e zhvilluar në Kepin e Palit.

Stërvitja "Silver Arrow", Stërvitje e zhvilluar në Riga, Letoni, në nëntor 2016, në kuadër të stërvitjeve të Forcave të Reagimit të Shpejtë të NATO-s, (VJTF), ishte më e madhja dhe kishte pjesë përbërëse shtetet aleate si Letonia, Gjermania, SHBA, Britania e Madhe, Estoni, Lituani, etj. Fokusi i stërvitjes ishin çështjet e sigurisë në kufijtë verilindorë të NATO-s. Ky demonstrim i VJTF në "Silver Arrow", tregoi edhe njëherë profesionalizmin, kohezionin dhe frymën e lartë të ndërveprueshmërisë që karakterizon NATO-n", e cila është dhe pikë kthese në trajtimin e çështjes së sigurisë së Letonisë dhe rajonit të Baltikut.

Stërvitja e Përbashkët (Command Post Exercise) "LogEx 17" në 2017, në Shqipëri. Instruktorë nga SHBA-ja, Britania e Madhe, Austria, Franca drejtuan këtë stërvitje me pjesëmarrjen e 135 trupave nga Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Kroacia, Finlanda, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Serbia, Suedia, si dhe vëzhgues nga Polonia dhe Sllovenia. Stërvitja shërbeu si një tjetër hap pozitiv për rritjen e bashkëpunimit, vijimin e dialogut dhe rritjen e mirëbesimit midis vendeve të rajonit tonë, si dhe forcimin e lidhjeve midis NATO-s dhe Partneritetit për Paqe.

Stërvitja e Përbashkët "Albanian Lion 2018", e cila u zhvillua në vendin tonë me pjesëmarrjen e forcave ushtarake nga Britania e Madhe, Kroacia, Kosova dhe Shqipëria, në rajonet stërvitore të Forcës Detare po zhvillohen elementë stërvitore të ndryshëm. Në gjirin e Dukatit, Vlorë, u zhvilluan stërvitje të trupave zhytëse, të cilat vazhdojnë aktivitetin që prej datës 12 me pjesëmarrjen e palombarëve anglezë, kroatë dhe shqiptarë. Ndër elementët stërvitorë kryesorë të tyre janë kërkimi nënujor, gjetja e objekteve të ndryshme si dhe nxjerrja e tyre në sipërfaqe, kërkime rrethore etj. Në stërvitjen zhytëse marrin pjesë mjete lundrimi të tre vendeve: Britanisë së Madhe, Kroacisë dhe Shqipërisë. Në të njëjtën kohë, në rajonin Kepi i Palit, Porto Palermo, Forca Detare me katër anije dhe një grup bordingu zhvilluan stërvitje detare me anijen britanike "Lyme" dhe helikopterin "Wild Cat", duke ekzekutuar elementë të ndryshëm stërvitorë si: mbrojtje e afërt dhe e largët, operacion zbarkimi trupash, mbrojtjen e anijes komandë nga sulme të befasishme etj.

Stërvitja "Albanian Effort" e zhvilluar në vendin tonë në 2017, ishte një stërvitje ndërkombëtare me angazhimin e trupave nga Shqipëria, SHBA-ja, Italia, Gjermania, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Britania e Madhe, Kroacia, Sllovenia, Turqia, Polonia etj. Mjedisi i përbashkët i sigurisë kërkon një përjasje gjithëpërfshirëse dhe kontribute të përbashkëta, të cilat kanë nevojë për më shumë bashkëpunim dhe mirëkuptim si dhe për besim reciprok midis vendeve.

Stërvitja "Strong Eagle" më 2022, dhe ajo 2024, ku Shqipëria dhe Mbretëria e Bashkuar kanë kryer një stërvitje të përbashkët mbrojtje. Qëllimi i stërvitjes, ishte që personeli të ndante eksperiencat e tyre të veçanta dhe të mësonin nga njëri-tjetri. Britania dhe vendi ynë kanë një kulturë të fortë bashkëpunimi dhe partneriteti së bashku. Regjimenti i Operacioneve Speciale Shqiptare dhe trupat nga Brigada e Operacioneve Speciale të Mbretërisë së Bashkuar u stërvitën së bashku gjatë stërvitjes së pestë "Strong Eagle". Qëllimi i stërvitjes ishte që personeli nga çdo vend të mësonte nga njëri-tjetri, të forconte marrëdhëniet ekzistuese profesionale dhe personale dhe të punonte drejt zhvillimit të aftësive të Forcave Speciale Shqiptare.

Stërvitja e përbashkët detare bregdetare "Austere Wolf-24" me kolegët e tyre të Britanisë së Madhe, në Bazën Detare Pashaliman në kuadër të stërvitjes "Corridor VIII Response". Kjo stërvitje u zhvillua paralel me "Strategic Reserve Force" (SRF), të cilat do të vijnë kalimin në itinerarin e Korridorit VIII, Shqipëri (Durrës ose Vlorë) - Maqedoni e Veriut - Kosovë - Shqipëri. Kjo stërvitje e planëzuar nga pala britanike, kishte për qëllim zbarkimin e trupave dhe mjeteve lundruese në kushte të vështira bregdetare në bashkëpunim me vendin pritës.

# ZGJOHUNI!

## Alarm nga teknologjia në duart e gabuara



KOLONEL HYSNI GJERGJI

Kjo “telefonatë” nga e ardhmja, na paralajmëron jo vetëm për çfarë po vjen, por dhe për implikimet ekonomike globale, të sigurisë dhe politike, të cilat kanë të ngjarë të ndodhin. Jemi në prag të një agimi të ri për njerëzimin. Teknologjitë e së ardhmes, mbi të gjitha, inteligjenca artificiale dhe inxhinieria gjenetike, do të jenë ndryshe nga çdo

gjë që kemi parë më parë. Kryesore për të ardhmen e teknologjisë është “problemi i kontrollit”, i cili ka të bëjë me aftësinë e ruajtjes së kontrollit tonë “njerëzor” mbi teknologjitë e fuqishme, si sfidën thelbësore të epokës sonë.

Pyetja vendimtare e shekullit tonë do të jetë: Si mundet ne të sigurojmë ruajtjen e ritmit të shpejtë teknologjik, përpara se revolucionet të krijojnë botën që ne nuk e dëshirojmë? Vala e re e inteligjencës artificiale pritet të kërkojë përgjigje për pyetjet: Si mund të verifikojmë një përmbajtje që publikohet? Si mund të dallojmë dezinformimin, si mund të analizojmë tekstin për të përcaktuar nëse është i besueshëm dhe jo i gënjeshtërt?

Shkenca sot duhet të eksplorojë në kohë ekzistencën e rreziqeve që AI-ja dhe bioteknologjia paraqesin për njerëzimin, si dhe të ofrojë zgjidhje praktike për ne e që të mund të përballojmë këtë evolucion, pa pasojat e tij negative. Ardhja e valës teknologjike është analizuar shkencërisht tek libri best seller “Vala që po vjen” e Mustafa Suleyman. Ai në këtë botim të përkthyer mjeshtërisht në shqip nga gjeneral Qemal Shkurti, ngre alarmin e sigurisë së njerëzimit, nëse ne nuk arrijmë ta menaxhojmë me mençuri këtë proces, AI-ja mundet edhe të na shkatërrojë.

AI-ja në të ardhmen e afërt, do ta ndryshojë mënyrën se si ne punojmë, komunikojmë, mësojmë, udhëtojmë, si dhe të kemi akses në kujdesin shëndetësor. Është një mundësi e pabesueshme por dhe emocionuese, për të cilën duhet të mendojmë edhe për efektet anësore. Ardhja e

valës teknologjike po shërben gjithashtu edhe si një udhërrëfyes për të eksploruar një ambient të ri, pa paprecedentë, të pazbuluar më parë. Revolucion i AI-së është në fillimin e tij, por a e kuptojmë vërtet ne mirë atë?

Inteligjenca artificiale (AI) po bëhet gjithnjë e më e zakonshme në jetën tonë të përditshme, por jo çdo përdorim është pozitiv. AI-ja ka sjellë ekzistencën e “falsifikimeve të ndërlukuara”, të cilat janë imazhe ose regjistrime që janë ndryshuar ose krijuar për të keqinterpretuar dikë. Fatkeqësisht, AI-ja po e bën më të lehtë për njerëzit që të krijojnë foto të rreme lakuriq ose video të dikujt dhe ta përdorin këtë pornografi artificiale për t'i shkakuar dikujt shqetësim ose siklet, shpesh të referuara si “pornografi hakmarrëse”. Kjo teknologji është e lehtë për t'u gjetur dhe e lehtë për t'u përdorur, duke e bërë të thjeshtë për abuzuesit qasjen dhe shfrytëzimin e viktimave të tyre.

Kjo është ora me alarmin “zgjohu”. AI-ja gjeneruese, biologjia sintetike, robotika dhe risi të tjera po përmirësohen dhe janë duke u përhapur shumë shpejt. Kjo shpejtësi përhapjeje do të çojë në krijimin e një hendeku të madh mes një pakice “smart” që e kupton dhe ndjek këtë teknologji dhe atyre që mbeten pas. Kështu që AI-ja sjell përfitime të mëdha, por edhe rritje të rreziqeve reale, të cilat vijnë nga sfida e mosnjohjes.

Tani varet nga ne që të veprojmë pasi AI-ja ofron një dozë të nevojshme të specifikave dhe qartësi në lidhje me potencialin e paparashikuar dhe pasojat në biologjinë sintetike, teknologjive ushtarake dhe të tjera të avancuara. AI-ja e sotme është revolucion eksploziv teknologjik dhe nëse bie në duar të gabuara, kthehet në rrezikues. Teknologjitë e reja sot priren të shumohen përtej mundësive absorbuese të shoqërisë sonë. Ritmi i shpejtë eksponencial teknologjik ka tejkaluar pritshmëritë dhe mundësitë e manaxhimit pozitiv të saj, duke u kthyer në një pushtet që kërcënon; pushtet të një elite të ditur mbi shumicën.

AI-ja e ka aftësinë të krijojë pasuri të pallogaritshme pa punuar shumë njerëz, dhe në këtë mënyrë do të shkaktojë një përçarje të paprecedentë midis punës, fuqisë punëtore njerëzore dhe të mirave materiale. Megjithatë, para se të arrijmë te ky stad, siç tregon historia e teknologjisë, përparimet kanë ardhur prej kohësh me efekte anësore të padëshiruara. Teknologjia është, në thelb, një grup idesh që ndryshojnë vazhdimisht. Teknologjitë e reja evoluojnë duke u përplasur me teknologjitë e tjera dhe më të vjetra. Ligjet që rregullojnë një evolucion të tillë janë darviniane, pra fiton dhe evoluon specia (shpikja) më e mirë. Kombinimet efektive mbijetojnë dhe bëhen blloqe ndërtimi për risi të mëtejshme. Kështu, shpikja ushqehet nga vetvetja. Përparimi i djeshëm bëhet një nën-komponent i inovacionit të sotmes dhe të nesërmes. Por teknologjia nuk evoluon në vakum; ajo është pjesë e

botës sonë dinamike duke u zhvilluar hap pas hapi.

Si shembull marrim telefonat tanë celularë të cilët kanë “gëlltitur” gjithçka, nga GPS tek kodet QR dhe njohja biometrike e fytyrës, për t’u bërë pajisje shumë-funksionale që mbajmë në xhepat tanë sot. Pa diskutuar komunikimin me zë dhe figurë, në çdo pikë të globit në kohë reale, brenda smartphone-it tonë ne kemi, bankën, bibliotekën më të madhe të librave që kemi patur ndonjëherë, informacione për motin, shëndetin, fatkeqësitë në pritje, bëjmë llogaritje matematikore, blerje shitje, transferime, udhëtime etj.

Por nga ana tjetër nga një smartphone aktivizohen bomba, vidhen identitete, dëmtohen njerëz dhe biznese etj. Një kod QR është një lloj barkodi matricor dydimensional, i shpikur për herë të parë në 1994, nga kompania japoneze “Denso Wave” për etiketimin e pjesëve të automobilave. Sistemi i etiketimit QR u aplikua përtej industrisë së automobilave për shkak të lehtësisë së të shpejtë të imazhit optik dhe nxënësisë së të madhe të ruajtjes së të dhënave në zbatime të tilla, si gjurmimi i produktit, identifikimi i artikujve, gjurmimi i kohës, menaxhimi i dokumenteve dhe marketingu i përgjithshëm.

Një kod QR përbëhet nga katrorë të zinj të renditur në një rrjet katror në një sfond të bardhë, duke përfshirë disa elementë besimi, të cilët sot mund të lexohen nga një pajisje imazherie brenda telefonit tonë, si dhe të përpunohen duke përdorur korrigjimin e gabimit “Reed-Solomon”, derisa imazhi të mund të interpretohet drejt dhe saktë. Të dhënat e kërkuara

analizojmë eksplozivët e shpikur të Alfred Nobelit, ishin projektuar për t’u përdorur në miniera dhe ndërtime hekurudhore, jo në fushën e betejës ku do të vriteshin njerëz. Rezultati ishte revolucion në shpikjen e armëve për të vrarë dhe gjymtuar njëri-tjetrin. Johannes Gutenberg, shpikësi gjerman projekttoi një pajisje shtypshkrimi për të printuar Biblën, që rezultoi shumë fitimprurëse në masën popullore të besimtarëve katolikë. Por më vonë, shtypshkronja e tij nxiti Revolucionin Shkencor, duke minuar autoritetin e institucionit të kishës konspirative, që e kishte dominuar jetën politike në Evropë për shekuj. Historikisht, shoqëritë u përpoqën të anashkalonin telashe të tilla, duke ndaluar me dhunë teknologjitë që i shkaktonin këto telashe. Dhjetëra shtete e ndaluan shtypshkronjën, duke dëmtuar autoritetin dhe reputacionin e saj, pasi menduan se kështu do ndalonin përhapjen e ideve të shkruara nga shtypshkronja. Gjatë Revolucionit Industrial, artizanët shkatërruan makinëritë e reja pasi i quajtën kërcënuese për shkurtimin e vendeve të tyre të punës.

Pasojë të tilla quhen “efekte hakmarrije”, pasi duhet t’i kërkojmë dhe t’i dallojmë. Antibiotikët, janë një kurë mrekulie që funksionon mirë, saqë ne u ekzaltuam, duke i mbivlerësuar ato, por faktikisht krijuam lloje të reja të sëmundjeve rezistente ndaj trajtimit me antibiotikë. Eksplorimi i kozmosit, lëshimi i satelitëve dhe raketave u kthye në anën e “hakmarjes”, aq sa ambiciet tona në hapësirë tani kërcënohen madje nga armatosja e tyre, si dhe mbetet që rrotullohen rreth planetit tonë. Pasojat më të mëdha


dhe më të paparashikuara janë të lidhura me teknologjitë shumë të suksesshme. Sa më e përhapur të bëhet një teknologji, aq më shumë përdoruesit e saj e riformësojnë, e keqpërdorin dhe e ri-interpretojnë atë. Përparimet galopante teknologjike, shpesh fillojnë nga një shkencëtar ose haker i vetmuar në një garazh, por ato kthehen shpesh në telashe shoqërore.

Facebook dhe X nuk u nisën për të përshpejtuar përhapjen e dezinformatave që të helmojnë demokracinë, por kjo është pikërisht ajo që ndodhi, pasi miliona qytetarë amerikanë filluan të mbështeteshin vetëm tek Facebook dhe X si burime lajmesh gjatë zgjedhjeve presidenciale të 2016 dhe rrezikojnë ato të vitit 2024. Teknologjitë novatore si AI-ja dhe inxhinieria gjenetike duket se do të rezultojnë gjithashtu shumë të vështira për t’u ndaluar. Ashtu si zbulimet e mëparshme, pranimi i tyre e ka plotësisht mundësinë të krijojë efekte të mëdha hakmarrije. Cilat do të

jenë këto efekte dhe çfarë mund të bëjmë për t’i menaxhuar ato, duke shfrytëzuar përfitimet e teknologjive të tilla të fundit, është tema që duhet të analizojmë.

Në fushën e sigurisë, teknologjia si pjesë e luftës kibernetike, është arti i të praktikuarit të atyre teknikave nëpërmjet të cilave vidhen informacione (të tipit sensitiv, informacion i klasifikuar, sekret shtetëror ose i NATO-s nga individë të ndryshëm, konkurrentë, rivalë, grupe, si dhe qeveri armike. Informacionet e vjedhura përmes kësaj teknologjie mund të kenë karakter politik, ushtarak, ose ekonomik, të cilat mund të sigurojnë avantazh në fushat e sipërpërmendura. Këto informacione sigurohen duke përdorur metoda shkencore, duke shfrytëzuar mundësitë që ofrohen nga Interneti, rrjetet software-ike, të cilat kërcënohen realisht nga AI-ja.

I ashtuquajtur “Luftëtari elektronik” i aftë në përdorimin e AI-së tashmë po zë një vend gjithnjë edhe më të rëndësishëm edhe në operacionet ushtarake si në Ukrainë ashtu edhe në Gaza. Komponentëve Tokësore, Detare dhe Ajrore i është shtuar edhe komponenti kibernetik, pasi vitet e



nxirren nga modelet që janë të pranishme në përbërësit horizontalë ashtu edhe në atë vertikalë të imazhit QR. Kodet QR përdoren në disa sisteme të realitetit të argumentuar për të përcaktuar pozicionet e objekteve në hapësirën 3-dimensionale.

Një barkod është një imazh optik i lexueshëm nga smartphone-i, që përmban informacion specifik për artikullin apo shërbimin e etiketuar. Kodi QR përmban të dhënat për një lokalizues, një identifikues dhe për gjurmimin në web. Për të ruajtur me efikasitet të dhënat, kodet QR përdorin mënyra të standardizuara të kodimit. Kodet QR mund të përdoren për t’u identifikuar në faqet e internetit: në faqen e identifikimit, në një ekran kompjuteri dhe kur një përdorues i regjistruar e skanon atë me një smartphone të verifikuar, ai automatikisht do të identifikohet. Autentifikimi kryhet nga smartphone, i cili kontaktin serverin. Në terma inxhinierie, ky është një zhvillim i virtutshëm reagimesh.

Teknologjitë shpesh nuk përdoren siç synohet, dhe efektet e “valëzimit hakmarrës” janë normë. Kjo “hakmarje” krijoi një industri të tërë dhe ndryshoi kulturën popullore përgjithmonë. Në mënyrë të ngjashme, po të

fundit luftërat nuk zhvillohen më si tradicionalisht, vetëm në tokë, det apo ajër, por edhe në hapësirën kibernetike.

Janë krijuar për herë të parë batalione dhe brigada kibernetike, si nga anëtarët e NATO-s ashtu edhe nga kundërshtarët e saj: Rusia, Kina, Irani dhe Koreja e Veriut. Ushtritë e NATO-s përfshirë, vendin tonë, kanë rritur kapacitetet dhe kanë ndryshuar strukturat, me ngritjen e qendrave të inovacionit (QI), duke i dhënë një vend gjithnjë e më të madh “Luftërave kibernetike”.

Progresi i paparë i telekomunikimit dhe rrjeteve globale kompjuterike ka krijuar kushte, për realizimin edhe të akteve të dënueshme nga strukturat terroriste dhe kriminale në sferën e teknologjive të sofistikuara. Aktet terroriste në hapësirën kibernetike, realizohen jo vetëm nga individë të veçantë apo grupime terroristësh, por edhe nga shtetet kundër njeri-tjetrit, shënjestër e të cilit vendi ynë është bërë disa herë vitet e fundit.

Grupimet ekstremiste, forcat separatiste, propaganduesit e ideve radikale, që u kundërvihen vlerave të përgjithshme të njerëzimit; po shfrytëzojnë në mënyrë tepër intensive teknologjinë bashkëkohore dhe AI-në për të përhapur nëpërmjet saj, ideologjitë e tyre frikësuese dhe rekrutuese. Armët autonome janë një tjetër kapitull në tryezën e politikanëve dhe ushtarakëve, për shkak të efekteve anësore që do të sjellë. Dhënia e të drejtës AI-së, për të vrarë një njeri është një hap thelbësor në fushën e të drejtës ndërkombëtare dhe ligjeve të luftës. Ky kapërcim i vendimit nga njeriu tek makina, është një tjetër hakmarje që makina bën ndaj nesh si projektues dhe krijues të saj.

Përmbajtje të ngjashme mashtruese, krijuar përmes inteligjencës artificiale, nisën të shpërndahen pasi Rusia nisi pushtimin e Ukrainës në vitin 2022. Një video e manipuluar nga AI-ja shfaq presidentin ukrainas, Volodymyr Zelensky, duke urdhëruar ukrainasit që të dorëzoheshin. Në disa raste, fotografitë nga konfliktet apo fatkeqësitë e tjera janë ripërdorur dhe janë paraqitur si fotografi të reja. Në të tjera raste, programet gjeneruese të inteligjencës artificiale janë përdorur për të krijuar imazhe nga fillimi, sikurse një fotografi, që u bë virale në ditët e para të luftës, ku shfaqej një foshnje, duke qarë dhe duke qëndruar në gërmadhat e krijuara nga bombardimet. Çdo herë kur ne hedhim në përdorim një mjet që detekton këtë, armiqtë tanë mund të përdorin inteligjencën artificiale për të fshehur gjurmët që çojnë deri te provat.

Në mesin e imazheve të shtëpive të bombarduara dhe rrugëve të shkatërruara të Gazës, disa nga fotografitë veçoheshin për tmerrin që pasqyronin: fëmijë të përgjakur e të braktisur. Të shikuara me miliona herë online që kur nisi lufta, këto fotografi janë të manipuluar, pasi janë krijuar duke përdorur inteligjencën artificiale. Nëse shikohen me vëmendje, mund të vërehen gjurmët e përdorimit të inteligjencës artificiale: gishtërinj të përthyer në një formë të çuditshme, apo sy që shndrisin me një shkëlqim jo natyral. Të gjitha këto janë shenja të një mashtrimi digjital.

Fotografitë, videot dhe audiot, të krijuara duke përdorur inteligjencën artificiale do të jenë një përshkallëzim që ne akoma nuk e kemi parë. Sa më i rëndë të jetë imazhi, aq më shumë ka gjasa që lexuesi ta mbajë mend dhe ta shpërndajë atë, kështu padashur ka përhapur më shumë dezinformimin. Njerëzve po iu thuhet në këtë rast: shikojeni fotografinë e kësaj foshnje! Dezinformata është dizajnuar në atë formë që na bën të përfshihemi në të. Rob Joyce, drejtor i sigurisë kibernetike në Agjencinë e Sigurisë Kombëtare, ka paralajmëruar për rolin në rritje të inteligjencës artificiale në kërcënimet kibernetike. Aktorët kriminalë shtetërorë dhe individë po përdorin gjithnjë e më shumë teknologjitë e AI-së për të përmirësuar operacionet e tyre kibernetike.

Ky ndryshim nënkupton transformim të rëndësishëm në peizazhin e

kërcënimit kibernetik, me AI-në që luan një rol kritik si për sulmuesit ashtu edhe për mbrojtësit. Teknologjitë e AI-së nuk e bëjnë “te zgjuar” një person të paaftë, ato misin shumë efikasitetin e atyre personave që i njohin mirë dhe mund t’i përdorin ato. Mjetet e drejtuara nga përdoruesit dhe mjeshtrit e AI-së krijojnë e-mail-e bindëse për phishing dhe kryejnë operacione më të sofistikuara hakerimi. Këto zhvillime kërkojnë një përgjigje të fortë nga agjencitë e sigurisë kombëtare për të qëndruar përpara në këtë realitet në zhvillim.

Ekspertët e sigurisë kombëtare paralajmërojnë dy rreziqe kryesore që vijnë nga inteligjenca artificiale. Së pari, sistemet më të avancuara të inteligjencës artificiale mund të përdoren si armë. Së dyti, ka shqetësime brenda laboratorëve krijues të AI-së, se në një moment ata mund të “humbin kontrollin” mbi vetë krijesit që ata zhvillojnë, me “pasojë katastrofike për sigurinë globale”. “Rritja e inteligjencës artificiale i ka mundësitë për të destabilizuar sigurinë globale në mënyra që të kujtojnë programet për krijimin e armëve bërthamore, duke shtuar se ekziston rreziku i një “gare të re armatimi” të AI-së.

Rritja e shpejtë e teknologjisë së inteligjencës artificiale do të mund ta vendoste në rrezik të ardhmen e njerëzimit. Sipas shumicës së amerikanëve të anketuar në një sondazh të agjencisë “Reuters” dhe “Ipsos”-it më shumë se dy të tretat e amerikanëve janë të shqetësuar për efektet negative të inteligjencës artificiale dhe 61 për qind e tyre



besojnë se kjo teknologji do të mund ta rrezikonte civilizimin. Në bazë të të dhënave të anketës, 61 për qind e pjesëmarrësve besojnë se inteligjenca artificiale paraqet rreziqe ndaj njerëzimit, ndërsa 22 për qind nuk u pajtuan me këtë.

Informacioni i rremë dhe keqinformimi janë në krye të listës së rreziqeve globale për dy vitet e ardhshme 2024 - 2026. Ndikimi i mundshëm tek zgjedhjet në mbarë botën në dy vitet e ardhshme është domethënës dhe kjo mund të çojë në dyshime për legjitimitetin e demokracisë dhe qeverive të zgjedhura. Dhe kjo, nga ana tjetër, mund të kërcënojë, proceset demokratike, duke shkaktuar më shumë polarizim social, trazira apo edhe dhunë.

Duhet të kemi një zgjidhje shumë më të madhe dhe gjithëpërfshirëse për të krijuar “armët anti-AI”. Detektimi dhe përpjekja për t’i eliminuar pasojat negative të AI-së, nuk janë më zgjidhje. Strategjia jonë e Sigurisë Kombëtare për 5 vitet e ardhshme nxjerr në pah kërcënimet kryesore që lidhen me sektorë të ndryshëm, duke nisur nga ekonomia, sulmet kibernetike, siguria energjetike, mjedisi, etj., ndërsa parashtron edhe përgjigjet institucionale ndaj tyre, deri në vitin 2028.



# Gjuha shqipe, amaneti i të parëve, simbol i identitetit kombëtar

**K**ongresi i Manastirit nuk ishte vetëm kongres për gjuhën shqipe po pararendës i një kompozimi idesh gjithëpërfshirëse për çështjen kombëtare. Ky kongres i madh për shqiptarët erdhi si thirrje e iniciativë e klubit “Bashkimi”, dhe e dëshirës për unifikimin e gjuhës shqipe, që në atë kohë ishte në disa versione. Kongresi pati përfaqësuesit më të shquar dhe atdhetarët e nacionalistët më të flaktë të Shqipërisë si: Gjergj Fishta, Mithat Frashëri, Ndre Mjeda, Shahin Kolonja, Bajo Topulli, Parashqevvi Qirjazi etj. Për këtë u mbledhën nga 4 vilajetet: i Janinës, Manastirit, Kosovës, Shkodrës si dhe nga shoqëritë shqiptare në Bukuresht, Sofjes, Filipolit, Kostancës, Egjiptit, 50 delegatë për diskutimin dhe marrjen e vendimeve për çështjen e gjuhës shqipe. Në të kishte rryma të ndryshme heterogjene lëvizjesh dhe mendimtarësh nga të gjitha hapësirat shqiptare. Një grup reformist me në krye Mithat Frashërin ishin për diskutimin vetëm të gjuhës shqipe, motoja e tyre ishte “Jo me pushkë po me pendë”. Një rrymë tjetër që vinte nga Shkupi, shqiptarët e Amerikës etj., kërkonin që

kongresit t’i shtoheshin pikëpamjet politike dhe ekonomike. Në këtë kongres u vendos që të përdorej alfabeti i Stambollit dhe ai i quajtur latin. Nga ana tjetër u bënë dhe mbledhje të mbyllura, ku u diskutua raporti i Shqipërisë me regjimin e atëhershëm xhonturk, lufta për çështjet kombëtare dhe çështjet e zhvillimit të përgjithshëm në të gjitha aspektet të Shqipërisë së asaj kohe. Vendimet që u morën në kongres u paraqitën në parlamentin turk, ku kërkohej: Mësimi në gjuhën shqipe në të gjitha shkollat fillore dhe gjimnazet e ulëta, gjuha turke të mësohej në vitin e katërt; Ndalimi i subvencionit të shkollave të elementit ortodoks nga qeveria greke, shndërrimi i shkollave të të krishterëve në shkolla kombëtare; Përdorimi i një pjese të të ardhurave të vakëfeve për qëllime kombëtare; Mbledhja e antikiteve nga të katër anët e vilajetit dhe ruajtja e tyre në Muzeun e Elbasanit; Zvogëlimi i shërbimit ushtarak në dy gjysma ose dy vjet; shqiptarët do të shërbenin vetëm në vilajetin e tyre, duke përjashtuar rastin e luftës; Nënoficerët e ushtrisë të përbëheshin nga shqiptarët; Oficerët e xhandarmërisë



në Shqipërisë të ishin shqiptarë; Zgjedhja e kryetarëve të bashkisë të bëhej sipas sistemit të zgjedhjeve publike, të bëhej zgjerimi i kompetencave të tyre; Hapja dhe shfrytëzimi i minierave si dhe ndërtimi e funksionimi i hekurudhave të shkonte në interes të Shqipërisë; të kufizohej ndërhyrja dhe ndikimi i të huajve përmes ligjit; Në emërimin e nëpunësve civilë në vilajetet shqiptare t'u sigurohej shqiptarëve preferenca para kombësive të tjera; Të gjithë të ardhurat e caktuara për punë botërore t'i lireshin administratës lokale, ndërsa një pjesë e të ardhurave të përgjithshme të përdorej për punime publike; Ngritja e ekonomive dhe e shkollave të ulëta bujqësore; Ekzekutimi i dënimeve me vdekje që parashikoheshin për krimet në Shqipëri; E drejta e këshillave të sanxhakut dhe të vilajetit në caktimin e taksave të veçanta në shkolla; Themelimi i universitetit shqiptar; në buxhetin e shtetit të parashiheshin për çdo vit pesë bursa për shqiptarët që do të studionin në universitetet europiane; Njohja zyrtare e gjuhës dhe e kombësisë shqiptare; në Nufus Tesqeret (letërnjoftim) të vihej shënimi shqiptar i krishterë ose shqiptar mysliman; Priftërinjtë katolikë e ortodoksë të paguheshin nga shteti me qëllim që të pengohej përzierja dhe ndikimi i huaj, si ai i Austrisë, i Italisë dhe i Greqisë; Rregullimi i lumit të Korçës dhe tharja e kënetës së Maliqit.

#### **Kongresi i dytë i Manastirit**

Në kushtet e represionit të xhonturqve kundrejt shkollave shqipe dhe masave të reja që morën ata, në kushtet gjithashtu të një përballje me këtë problem madhor nga rrethet dhe klubet e fshehta patriotike u pa e nevojshme të mbahej Kongresi i Dytë i Manastirit, nga 1 në 6 prill 1910, ku u mbledhën 40 delegatë të shoqërive patriotike.

Si përfaqësues kongresistë ishin: Fehim Zavalani (kryetar i klubit qendror "Bashkimi"), Dervish Hima (Përfaqësues i Klubit të Stambollit), Petro Nini Luarasi, Tefik Panariti, Ferit Ypi, Qazim iliaz

Dibra, Temak Gërmenji e shumë figura të tjera patriotike.

Delegatët e Kosovës erdhën me vonesë për shkak të vështirësive të atyre viteve. Pjesa e parë e kuvendit ishte e hapur, kurse një pjesë tjetër ishte përsëri si në 1908 me dyer të mbyllura. Në këtë kongres u vendos:

Qendra e deriatëhershme e klubeve shpërngulet nga Manastiri në



Stamboll; në gjirin e klubit të atjeshëm qendror do të formohej një këshill i posaçëm i përbërë nga deputetë patriotë. Në Stamboll do themelohej akademia që do merrej me botimin e librave, fjalorëve, gazetave.

Do të thirrej kongresi kombëtar në Janinë, ku do shqyrtohej puna e klubeve dhe do nxirrej rezoluta për qeverinë turke. Do të zgjidhej komisioni i lartë, ku do të drejtonte lëvizjen kombëtare në Shqipëri. Do të zhvillohej propagandimi rreth veprimtarisë së shkrimit shqip dhe përhapjes së arsimit; të bëheshin përpjekje për themelimin e institutit pedagogjik në Shkup që do të përgatiste kuadrin e mësimin për shkollat e mesme dhe nxjerrjen e gazetave shqipe.

Përmes një rekomandimi kërkohet nga qeveria turke të ndërpritej çdo veprimtari dhe propagandë kundër gjuhës shqipe.

Megjithatë ky kongres kishte presionin e madh të qeverisë turke,

e cila formoi shoqatën “Arnavud Mahvil Maarifi” (Rrethi Arsimitor Shqiptar). Qëllimi i kësaj shoqate ishte zhvillimi i arsimit po me alfabet arab, nismë e marrë nga veziri i madh Ferid Pasha.

Nga ana tjetër kjo pati një rezistencë të fortë nga Shoqata e Intelektualëve të Rinj Shqiptarë që ishte formuar gjithashtu në Stamboll. Qeveria këtu solli Galip Beun, i cili donte të organizonte propagandën kundër shkrimit shqip, t’i shpërbënte klubet shqiptare dhe çorientimin e lëvizjes shqiptare.

Shefi i policisë së Stambollit, Galip Beu organizoi gjithashtu një grup për çorientimin e detyrave për shkrimin shqip në Vilajetin e Kosovës.

Me gjithë përkrahjen dhe instrumentalizimin që donin të bënin në Vilajetin e Kosovës, nuk ia arritën dot ta kthejnë lëvizjen në favor të kundërt, të çorientimit të shkrimit shqip. Kjo lëvizje u braktis nga shqiptarët që iu bashkuan lëvizjes së dalë nga Kongresi i Manastirit.

### Rishkruhet historia

20-25 nëntor 1972, mbledhet Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe.

50 vjet më parë, u mbajt në Tiranë me nismën e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë dhe me praninë e 87 delegatëve nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe arbëreshët e Italisë, Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, padyshim ngjarja më e rëndësishme për gjuhën tonë kombëtare pas Kongresit të

strukturës fonetike, gramatikore, fjalëformuese e leksikore.

Ai pasqyron gjendjen e sotme dhe prirjet e përgjithshme të zhvillimit të gjuhës sonë letrare, e cila mbështetet gjerësisht në gjuhën e folur të popullit. Duke ngritur në një shkallë më të lartë traditën e shkrimit të shqipes, drejtshkrimi i sotëm synon njësimin e mëtejshëm të normës së gjuhës letrare kombëtare mbi bazën e trajtave të përbashkëta që janë përvetësuar e përvetësohen prej saj.


Kongresi i zhvilloi punimet e tij nga 20 deri më 25 nëntor të vitit 1972, ku të pranishëm ishin 87 albanologë (delegatë) nga mbarë trevat shqiptare, nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe arbëreshë nga Italia.

Qëllimi i Kongresit ishte të përcaktonte parimet dhe drejtimit kryesore të hartimit të drejtshkrimit, për të pasur një gjuhë letrare të njësuar.

Gjuha letrare u krijua që shqiptarët të kuptoheshin më lehtë me njëri-tjetrin dhe të vihej një standard i përhershëm drejtshkrimor. Në unifikimin e standardeve të gjuhësh shqipe, rol përcaktues ka pasur delegacioni nga Shqipëria. Kongresi i Drejtshkrimit kishte konstatuar se Shqipja letrare kishte hyrë në fazën më të lartë të zhvillimit të saj dhe se ajo sipas delegatëve funksionon si një gjuhë letrare e përbashkët dhe e njësuar në të gjitha sferat e veprimtarisë shoqërore.

Nga Kongresi pesëditor ishte nxjerrë një rezolutë, ku ndër të tjera, thuhej se rregullat e drejtshkrimit të mbështeten sa më gjerë në trajtat e përbashkëta të gjuhës kombëtare shqipe. Disa nga delegatët kryesorë në kongres ishin: historiani prof. Aleks Buda, prof. Androkli Kostallari, drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të USHT në Tiranë, prof. Bedri Dedja, zv/Ministër i Arsimit dhe i Kulturës, prof. Dhimitër Shuteriqi, Kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve në Tiranë, prof. Eqrem Çabej, gjuhëtar, prof. Idriz Ajeti, dekan i Fakultetit Filozofik në Prishtinë, prof. Josif Ferrari, studiues arbëresh dhe profesor i gjuhës në Bari

Për jetë nderim e mirënjohje të gjithë atyre që kontribuan 50 vjet më parë në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës



Manastirit që miratoi alfabetin me gërmat e arta.

Me Kongresin e Drejtshkrimit, gjuha shqipe mbërriti të ketë standardet e një gjuhe moderne, të unifikuar në normën drejtshkrimore, ashtu sikundër duhet të jetë në fakt gjuha si elementi bazë e padyshim më i rëndësishëm i përveçimit të identitetit tonë kombëtar!

Prandaj, shteti shqiptar në radhë të parë, e më tej e gjithë bota kulturore e akademike shqiptare, por edhe i gjithë kombi ynë do të duhej të nderonte në këtë përvjetor, veprën e paçmuar për nga dimensionet e pesha patriotike, kulturore e shkencore e të gjithë delegatëve të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, të cilët ishin përfaqësuesit më të shquar të elitës shkencore e akademike nga gjuhësia, letërsia, historia e mësimdhënia!

Drejtshkrimi i njësuar i gjuhës shqipe është shprehje e kristalizimit të normës letrare kombëtare në të gjitha hallkat kryesore të

Shqipe, të gjuhës tonë për të cilën Ndre Mjeda pati shkruar:

*“Geg’ e tosk’ malci, jallia,*

*Jan’ një komb, me u da s’duron,*

*Fund e maj një a Shqypnia,*

*E një gjuh’ t’gjith na bashkon!”*

Sipas kësaj filozofie të shprehur me aq largpamësi nga Mjeda, vlerësimi i Kongresit të Drejtshkrimit me realizëm e objektivitet për çfarë kontribui në zhvillimin e gjuhës shqipe, e bën të domosdoshme një nismë të atyre përmasave, për të reflektuar gjithë zhvillimet që ka pësuar gjuha jonë e proceset nëpër të cilat ajo ka kaluar në këta 50 vjet,

Është një sfidë që i takon në radhë të parë bashkësisë së punëtorëve të gjuhës shqipe, por edhe të gjithë shkencëtarëve e intelektualëve që dinë të kuptojnë rëndësinë që ka përmbushja e sfidave të tilla të mëdha e me interes kombëtar.



# Nëntori i bekuar i shqiptarëve

**N**ëntori është muaji ku prej shekujsh shqiptarët i ka mbledhur nga çdo cep i shqiptarisë, si muaji ku në kohëra të ndryshme kemi festuar për diellin më të bukur në botë, për këtë tokë të larë me gjak, ku hisen që zoti e caktoi si toka Arbërore ta mbrojmë si dritën e syve. 581 vite më parë, pikërisht më 28 Nëntor të vitit 1443, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu ngriti flamurin në Krujë. Ngjarje të mëdha historike ka sjellë ky Flamur, ky simbol qëndrese dhe krenarie, që në vetvete ngërthen tërë qenien e kombit. Bujaria, besnikëria, trimëria, burrëria e, mbi të gjitha, sakrificat tona shekullore për liri e pavarësi. Kuqezi. Në mes shqipja dykrenare me shikimin e

mprehtë dhe krenari të lindur shqiptare.

Patriotët shqiptarë brenda dhe jashtë, me penë e pushkë, nuk ndalën asnjë çast veprimtarinë e tyre atdhetare. Çetat çlirimtare kishin mbushur malet. Qielli i Shqipërisë përflakej nga betejat e pareshtura. Vlorës, këtij djepi të shqiptarizmsë, i takoi fati ta përgatiste edhe terrenin e shpalljes së Pavarësisë. Në gjakun e derdhur brenda viteve 1910-1912 po krijohet ky vend i vogël që çuditi shekujt... Plaku i urtë, Ismail Qemali, i përkrahur nga patriotët shqiptarë, duke ndjerë rrezikun, nxitoi pa u ndalur. - O sot, o kurrë! - thanë ata, dhe vrapuan nëpër Evropë. Atdheu ishte në zgrip të zhbërjes, andaj lypsej trimëri e mençuri...

## 28 Nëntori i vitit 1443

28 Nëntori i vitit 1443. Gjergj Kastrioti – Skënderbeu, u kthye në qytetin e tij të lindjes në Krujë, i shoqëruar nga bashkëluftëtarët e vet e ngriti mbi kështjellën legjendare të Krujës, flamurin me shqiponjën dykrenore. Kjo ngjarje shënon një moment të veçantë historik për mbarë popullin shqiptar.

Skënderbeu iu drejtua popullit me fjalët: “Shqiptarë, lirinë nuk ua solla unë, por e gjeta këtu! Në zemra rronte liria e Atdheut. Vënie, pra, lart, o vëllezër, flamurin e Shqipnisë sonë. Tregojeni, pra, trimërinë tuaj, ashtu si burrat dikur moti...!”. Pothuajse, dy dekada pas ngritjes së Flamurit nga Skënderbeu, nëntori i lavdisë dhe krenarisë shqiptare, shndërrohet në një datë tjetër, në atë të dokumentit të parë të gjuhës shqipe “Formula e Pagëzimit”. Më 8 nëntor të vitit 1462, në një kishë të Matit, është lëshuar një dokument në gjuhën shqipe, i cili shkruante: “Un të pagëzoj pr’rement (t’) atit e t’Birrit e t’Shpirtit Shenjt”

Këtë qarkore në gjuhën shqipe, aso kohe e kishte shkruar Kryepeshkvi i Durrësit, Pal Engjëlli. Pal Engjëlli ishte një figurë historike, atdhetare e humaniste. Po ashtu, ai ishte bashkëpunëtor i afërt i Gjergj Kastriotit si dhe mik e moshatar i tij. Gjatë një vizite që ia kishte bërë dioqezës së tij, Pal Engjëlli e pa të arsyeshme që ta lëshojë këtë dokument, që u jepte leje prindërve t’i pagëzonin fëmijët e tyre me këtë formulë nga pamundësia që të shkonin në kishë, për shkak të kushteve dhe rrethanave të kohës.

Nëntori i shkronjave shqipe (4 deri më 22 nëntor të vitit 1908) Megjithatë, rrugëtimi drejt çlirimit të tokave shqiptare dhe daljes nga errësira, nuk kishte të ndalur. Pas 600 vjetësh përpjekjeje e sakrifice, populli shqiptar arriti te një datë tjetër e muajit nëntor: tek “Nëntori i shkronjave shqipe”.

Më 14 deri më 22 nëntor të vitit 1908, në Manastir, u mbajt Kuvendi mbarëshqiptar, ku morën pjesë 50 delegatë nga të gjitha viset shqiptare. Madje, edhe shqiptarët që jetonin në mërgatë, si Amerikë, Egjipt, Sofje, Ruman, Itali e vende të tjera. Në këtë Kuvend u shqyrtua dhe alfabeti i shkronjave shqipe. Qëllimi kryesor i këtij Kongresi ishte Alfabeti shqip i unifikuar, ngase deri në këtë kohë përdoreshin edhe disa alfabete të tjerë. Për të përfunduar këtë çështje zgjodhën një Komision të cilin e udhëhoqi At Gjergj Fishta. te “Lahuta e Malcis”, Gjergj Fishta, me këtë alfabet, do t’iu këndonte dëshmorëve. Rrugëtimi i shqiptarëve drejt çlirimit nga kthetrat pushtuese dhe hapjes së dritareve të dritës, duke i mbyllur dritaret e territ, nuk kishte të ndalur. Pas katër vjetësh të Kongresit të Manastirit, historia shqiptare shënon një datë edhe më të rëndësishme.

## 28 nëntor 1912, shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë

Më 28 nëntor 1912 në Vlorë, u mbajt Kuvendi i Pavarësisë, në përbërje të 40 delegatëve shqiptarë. Në krye të Kuvendit u zgjodh Ismail Qemali, i cili shpalli Shqipërinë të lirë dhe të pa varur, pikërisht me këtë datë, pra 28 Nëntor 1912. Pas gjashtëqind vjetësh në qytetin e Vlorës ai ngriti flamurin kombëtar kuq e zi. Flamurin që e kishte përdorur edhe Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, gjatë luftërave kundër ushtrisë

osmane të asaj kohe. Dhe, më në fund, ditë e bardhë agoi. 28 Nëntor 1912. Vlorë kishte festë, ajo do bëhej nuse dhe tundej e hidhej nga gëzimi. Po hynte në histori për të ngelur legjendë. Qe zgjuar me natë për të pritur mysafirët nga mbarë trojet shqiptare. Edhe dielli sikur po ngutej. Ia behu edhe pas dreka. Ora e madhe e historisë po trokiste hareshëm. Plaku shtatëdhjetëvjeçar po dridhej nga entuziazmi. Mezi e mbante në dorë Flamurin e Marigosë, që e kishte qëndisur brenda natës. Brohoritjet e fuqishme: “Rroftë Flamuri! Rroftë Shqipëria!” e ngazëllyen edhe më. Me mund nguli shtizën në ballkonin e shtëpisë së vjetër stërgjyshore dhe masës së pafund iu drejtua: “Vëllezër shqiptarë!...Ja, pra, ky është Flamuri ynë...Sot dhe këtë minutë, Kongresi shpall MËVETËSINË E SHQIPËRISË...”.

Me aktin e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, Ismail Qemali, njoftoi të gjitha fuqitë e mëdha për shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, si dhe vendet përreth saj që të heqin dorë nga okupimet e tokave shqiptare. Por cila ishte mbështetja e fuqive të mëdha për pavarësinë e proklamuar, më 28 Nëntor 1912, gjegjësisht kush ishte aleati kryesor në mbështetje të saj. Padyshim, është vetëm një emër, Woodrow Wilson, presidenti i atëhershëm amerikan. Ai, jo vetëm që ishte përkrahësi më i madh i pavarësisë, por ishte edhe armiku kryesor i atyre shteteve që dëshironin ndarjen e tokave shqiptare. Woodrow Wilson fitoi zgjedhjet presidenciale në Shtetet e Bashkuara tre javë para se Shqipëria të shpallte pavarësinë në nëntor të vitit 1912. Por, duhet të kalonin disa vjet para se refuzimi prej tij i planeve për ndarjen e Shqipërisë, t’i siguronte ish-Presidentit amerikan një vend nderi në historinë shqiptare. Vizioni i Presidentit Wilson për botën, roli i shqiptaro-amerikanëve dhe rrethanat historike kontribuuan në vendimin që do të rikonfirmonte pavarësinë e Shqipërisë. Kur i hedh një vështrim botës së pas Luftës së Parë Botërore, në vitet 1919-1920 dhe vendimit të Woodrow Wilsonit për të mos lejuar copëtimin e Shqipërisë, nuk mund t’i shpëtosh mendimit, se sikur rrjedha e ngjarjeve të kishte shkuar vetëm pak më ndryshe, harta e Shqipërisë nuk do të ishte kjo që njohim sot. Fuqitë evropiane donin të vazhdonin diplomacinë tradicionale. Presidenti Wilson e hodhi poshtë idenë e aleancave sekrete në diskutimet e tij në Paris.

## 29 Nëntori 1944

29 Nëntori është një datë e lavdishme e historisë së popullit shqiptar si Dita e Çlirimit të Shqipërisë nga pushtuesit e egër nazifashistë.

Tërheqja e forcave të fundit naziste nga Shkodra, në orët e para të mëngjesit të datës 29 nëntor 1944 dhe çlirimi i saj me grykën e pushkës së gjashtë Brigadave partizane të Divizionit II Sulmues është një fakt i pakontestueshëm historik, i shkruar me gjak..

Për bijtë dhe bijat më të mirë të kësaj toke, për veprën e tyre sublime, përkulemi me mirënjohje të thellë!

Gjithçka gëzojmë sot dhe na bën krenar në çdo cep të botës janë këto data dhe Nëntorët e bekuar të shqiptarëve!



# Duhesh të jesh Shqiptar, ta kuptosh



**ANJEZA MUSOLLARI,**  
Shefe e Sektorit të Botimeve

**N**jë ditë, një djalë i ri ishte duke gjuajtur nëpër male, një shqiponjë fluturoi mbi të duke rrahur fort krahët dhe ndaloi në një shkëmb. Shqiponja ishte shumë e madhe dhe mbante një gjarpër në sqepin e saj. Pas

pak, shqiponja fluturoi mbi shkëmb dhe ndaloi aty, ku kishte follenë e saj. Djaloshi i ri kërcëu mbi shkëmb dhe vuri re se në fole ishte një shqiponjëz e vogël që po luante me gjarpurin e ngordhur. Por zvarraniku grabitqar nuk ishte i ngordhur. Në atë çast gjarpri ngre kokën dhe u pozicionua gati për të pickuar shqiponjëzën e vogël me dhëmbët e tij helmues. Djaloshi nxori në çast harkun dhe shigjetën dhe qëllon mbi gjarpurin për vdekje. Më pas e mori shqiponjëzën dhe mori rrugën e kthimit. Kur s' kish bërë veçse disa hapa, dëgjon mbi kokën e tij një zhurmë të fortë përplasje krahësh, ishte shqiponja mëmë.

- Përse po më rrëmben foshnjën time, iu qa shqiponja.

- Shqiponjëza tani është imja, pasi unë i shpëtova jetën, duke vrarë gjarpurin që donte ta pickonte, 'kafshën' që ti nuk e vrave dot vetë, iu përgjigj djaloshi.

- Më kthe zogthin tim dhe unë do të të jap si këmbim mprehtësinë e syve të mi dhe forcën e krahëve të mi. Do të bëhesh i fortë dhe i

pathyeshëm dhe do të njihesh me emrin tim.

Djaloshi u bind dhe ia ktheu zogthin mëmës. Kur shqiponjëza u rrit dhe nisi të fluturonte, shihej gjithnjë të fluturonte në qiell diku mbi kokën e djaloshtit, kudo që ai shkonte, djaloshi u rrit dhe u bë burrë, u bë një gjuetar dhe luftëtar i madh. Kur kalonte afër ndonjë vendi të banuar me njerëz dridhej toka nga frika e njerëzve kundrejt njeriut me shqiponjë. U bë një prijës i mençur dhe i urtë, çdo vend kërkonte urtësinë e tij. Me harkun dhe shigjetat e tij ai vrau shumë grabitqare nëpër pyje dhe me shpatën e tij u preu kokat shumë kundërshtarëve dashakeqës. Të mrekulluar nga bëmat e djaloshtit gjuetar e luftëtar, banorët e atyre anëve e zgjedhën atë prijësin e tyre dhe e quajtën Shqiptar ose bir i shqipes, dhe trojet ku banonin i quajtën Shqipëri ose Vendi i Shqiponjave. Përgjatë tërë këtyre viteve, shqiponja e shoqëroi djaloshin dhe e udhëhoqi pa iu ndarë as edhe një çast.

#### **Ata ishin të pandashëm, një trup me dy koka**

Dhe bijtë e shqipes rriten e trimërohen, me forcën e shqipes me dy krerë, me dashurinë e saj për folenë. Flamuri Shqiptar ashtu si dhe gjuha e tij kanë karakter kozmik, prandaj ai duket se është po aq i vjetër sa dhe vetë ndërgjegjja njerëzore. Gjithashtu i gjen të mishëruara brenda simbolit të tij të gjitha etapat historike në të cilat ka kaluar gjaku i shqiptarëve nëpër mijëvjeçarë dhe

peripecitë e civilizimit të vet nëpër rrugëtimin e vështirë drejt së ardhmes europiane.

Mbi flamurin shqiptar padysim në gjatësinë e shekujve është folur shkruar dhe komentuar mjaft. Ky simbol është shenja më kuptimplote si dëshmitari i përjetshëm i origjinës tonë. Historia e tij është krejt e veçantë siç është e veçantë dhe historia e popullit tonë.

#### **Sa i hershëm duhet të jetë ky simbol? Po populli shqiptar sa i hershëm është?**

Ai përfaqëson gjithashtu në mënyrë të sintetizuar filozofinë, kulturën, traditën dhe eksperiencën e epokave të ndryshme, dëshmitar i momenteve pozitive dhe negative, dëshmitar i dorës së parë në sukseset dhe dështimet tona.

Flamuri i Bijve të Shqipes, nëpërmjet tij zbulojmë origjinën tonë, nga vijmë dhe që në mënyrë të dukshme na shtyn sot të vazhdojmë të ruajmë lidhjet tona shpirtërore.

Bijtë e Shqipes, filozofia e jetës së tyre s'ka dyshim që gjendet e pasqyruar në librat e shenjtë, në shpella, në gurët e varreve, në shkollat dhe universitete.

Ata lanë gjurmë kudo ku shkelën duke kaluar dhe jetuar. Ata ishin mjeshtër ndërtimesh, njerëz me kurajë të veçantë optimistë të pandreqshëm dhe mësues të mëdhenj po ashtu. Luftëtarë të rreptë që askush nuk jua pa shpinën. Gjuha e tyre ishte gjuha e Zotit. Kishte të drejtë profeti Nostradamus (1503-1566) kur predikonte për ne: "Shqiptarët ende nuk i kanë luajtur të gjitha kartat e tyre dhe se padysim ata përsëri do ta habisin gjithë botën në arenën ndërkombëtare.

Ilirët ishin popullsia e parë dhe origjinale e Evropës me vlera të padiskutuara në fushën e dijes e teknologjisë. Shqiponja dykrenare është simbol i idealit dhe frymës bashkuese shqiptare të mbretërisë së uzurpuar nga raca aziatike greke e më vonë edhe e barbarizmes së ardhur sllave pas rrënimit kataklizmik të Dardanisë.

Qielli dhe toka po marrin ngjyrat kuq e zi e me mijëra këto ditë po marshojnë qëllimshëm drejt historisë. Dhe unë do doja të jem diku lart... ja pikërisht atje në qiellin e hapur, lart po aty ku fluturon ajo Shqiponjë... që të ta përshkruaj si frymon Shqiptaria këto ditë, në mënyrë që Ti vogëlushi i sotëm dhe burri i shtetit të këtij kombi ta lexosh, pasi tani kemi shkuar në 112-Vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë... imazhi i madhërisë...ndjenja të përziera...!

Flamuri kuq e zi valon gjithandej, dhe po, kur e shikon të stërmbrush nga brenda, të drejton shtatin dhe krenaria fillon të fluturojë. Dhe po, pikërisht ky Flamur i zbuluar nga Albanologët, Flamuri i Skënderbeut valëvitet gjithandej ku ka sot shqiptarë. Ishte ky Flamur që valëvitej edhe shekujve të robërisë, duke i dhënë dritë shpresës për liri, dhe ja po i këndojmë, 112 vite të lirë në hisen e tokës që na takon.

Duhet të jesh Shqiptar ta kuptosh këtë lidhje, sepse është e vështirë për ta përshkruar. Paramendoje fluturimin mbi një shqiponjë të zezë shtigjeve të përgjakura të lirisë, duke mbledhur lule të kuqe, të cilat i shtrëngon aq fort sa që gjithçka brenda teje ulërin.

Dikush më pyeti, "po çfarë simbolizon Flamuri i kuq që në mes ka shqiponjën dykrerëshe?". Më fal...nuk përshkruhet... përjetohet, veç atëherë do e kuptosh madhësinë e 'hyjësisë' para të cilit përkulemi si para Zotit...



# Uniforma ushtarake

## Lëkurë e dytë

### Lëkura e Dytë: Uniformat Ushtarake me teknologji të lartë

Një revolucion në teknologjinë ushtarake. Këto fjalë ka të ngjarë të ngjallin imazhe të super armëve, ose ndoshta një gjeneratë të re sensorësh dhe softuerësh. Por revolucioni i ardhshëm në teknologjinë ushtarake mund të përqendrohet rreth një prej artikujve më të përlulur por më të përhapur të pajisjeve ushtarake: uniformën e pjesëtarit të shërbimit.

E quajtur lëkura e dytë, kjo teknologji synon të prodhojë pëlhuara që “marrin frymë”, duke e mbajtur të rehatshëm përdoruesin, duke e mbrojtur kundër agentëve kimikë dhe biologjikë. Në fushën e betejës, këto uniforma ushtarake futuriste mund të bëjnë dallimin midis efektivitetit dhe paaftësisë, midis jetës dhe vdekjes. Përtej fushëbetejës, e njëjta teknologji mund të shpëtojë ushtarakët dhe punonjësit e tjerë të urgjencave - si dhe shërben për një mori qëllimesh të përditshme dhe industriale.

### Një frymë jete

Epoka moderne e agentëve kimikë dhe biologjikë të luftës filloi njëqind vjet më parë me përdorimin e klorit dhe gazit mustardë gjatë Luftës së Parë Botërore. Komandantët shpejt zbuluan se vlera ushtarake e këtyre agentëve qëndronte jo vetëm në efektet e tyre të tmerrshme, por edhe në masat mbrojtëse që ata kishin të detyruar mbi mbrojtësit.

Trupat amerikane të dislokuara në Lindjen e Mesme dhe Afganistan përballeshin me sfidat brutale të veshjes së mjeteve të plota mbrojtëse ndërsa luftojnë në një klimë ekstreme kundër armiqve që besohet se zotërojnë dhe përdorin agentë të luftës kimike. Maskat e gazit dhe pajisjet e tjera mbrojtëse janë jo t'at rehatshme dhe përgjithësisht të vështira për t'u veshur. Një ushtar i mbështjellë në mbrojtje të plotë kundër agentëve kimikë dhe biologjikë shpejt zhytet në djersë, nxehet dhe rraskapitet. Aktiviteti i sforcuar është i padurueshëm e sfilitës dhe shumë shpejt bëhet i pamundur dhe ajri i pastër mungon. Vigjilenca dhe fokusi mendor janë konsumuar. Në këto kushte, ushtarët nuk luftojnë mirë.

Zgjidhja e këtij problemi është pajisje mbrojtëse që “merr frymë” - që lejon ajrin të rrjedhë, dhe veçanërisht lejon avujt e ujit të dalin - në mënyrë që djersa të mund të avullojë, mekanizmi kryesor ftohës i trupit. Megjithatë, ingranazhet duhet të bllokohen akoma agentët kimikë dhe biologjikë. Dhe këtu hyn në lojë teknologjia e lëkurës së dytë. Por kjo teknologji është në të vërtetë vetëm një aplikim i një revolucioni më të gjerë të përqendruar në nanotubat e karbonit.

### Nanotubat e karbonit zmadhohen

Që nga fillimi i kimisë moderne më shumë se një shekull më parë, karboni është njohur për aftësinë e tij për të ndërtuar struktura molekulare më të mëdha dhe më komplekse se çdo element tjetër. Kimia organike ka të bëjë kryesisht me gjërat që mund të bëni me karbonin; është i njohur për arsye të mirë si blloku ndërtues i jetës.

Duke filluar rreth viteve 1970, ajo që mund të quhet potenciali arkitektonik i karbonit u rrit në vëmendje dhe në vitin 1991 datojnë nanotubat e parë të vërtetë - në thelb tuba ose zorra në shkallë nano. Këto tuba, të ndërtuar nga atome të lidhura karboni, mund të jenë vetëm pak më të mëdhenj në diametër se atomet individuale, një finesë që inxhinierët e mëparshëm vështirë se mund ta kishin ëndërruar apo edhe ta konceptonin.

Nanotubat e karbonit kanë një gamë të gjerë përdorimesh të mundshme; për shembull, ato mund të funksionojnë si nano-litarë jashtëzakonisht të fortë. Siç raportohet nga Engadget, studiuesit po punojnë gjithashtu për t'i zhvilluar ato si transistorë më kompaktë



sesa mund të arrihen me silikon.

Edhe viruset janë shumë të rëndë për të kaluar nëpër nanotuba, megjithëse ajri dhe avujt e ujit kalojnë aq lirshëm sa që pëlhuara që “merr frymë” më mirë se pëlhurat e njohura komerciale si “Gore-Tex”. Agentët kimikë janë më kompakt dhe mund të rrëshqasin edhe nëpër një nanotub. Zgjidhja është t'i bëjmë nanotubat inteligjentë, duke i pajisur me grupe funksionale molekulash që do të veprojnë si roje për të bllokuar kërcënimin. Udhëheqësi i ekipit të “Livermore Kuang” Jen Wu thotë se pëlhuara “do të jetë si një lëkurë e dytë e zgjuar që i përgjigjet mjedisit”.

Studiuesit besojnë se këto pëlhuara mbrojtëse të reja inteligjente, që “marrin frymë”, të cilat mund të mbulojnë çdo veshje të plotë të trupit plus helmetë dhe doreza, duke e bërë atë të ngajë me pajisjet e sotme luftarake - mund të jenë gati për fushën e betejës brenda 10 viteve. Por kjo teknologji nuk do të qëndrojë e kufizuar në fushën e betejës. Ashtu si teknologjitë nga radio në shërbimet paramedikale, “lëkura e dytë” do të gjejë së shpejti aplikime civile përtej uniformave ushtarake futuriste.

### Mburoja në çdo mjedis

Aplikimi i parë civil për teknologjinë e “lëkurës së dytë” me siguri do të jetë për ekipet e emergjencave dhe reaguesit e tjerë të parë. Punonjësit e urgjencës përballeshin gjithashtu me kërcënimin e agentëve vdekjeprurës nga të cilët duhet të mbrohen, të kombinuara me nevojën për forcë dhe vigjilencë, të cilat fshihen shpejt nga pajisjet mbrojtëse konvencionale.

Përtej fushës së shërbimeve të urgjencës, teknologjia e “lëkurës së dytë” me siguri do të gjejë një mori përdorimesh të tjera, praktike dhe ndoshta edhe në modë. Mbrojtja kundër agentëve të rrezikshëm biologjikë do të mbrojë gjithashtu nga veçoritë e mjedisit si pjalmi i etheve të barit që mund të jetë i bezdisshëm edhe nëse nuk është i rrezikshëm. Ndërsa teknologjia maturohet, aftësi të tjera të lidhura me shëndetin me siguri do të dalin nga teknologjia e “lëkurës së dytë”.

Më gjerësisht, aftësia e pëlhurave për të “marrë frymë” është thelbësore për rehati, veçanërisht në mot të ngrohtë, duke e bërë këtë teknologji të zbatueshme për gjithçka që veshim, si dhe për perdet, tendat dhe ndarësit fleksibël të të gjitha llojeve, si dhe filtrat industrialë - një sërë përdorimesh përgjatë gjithë spektrit nga utilitar në modë.

“Frymëmarrja e zgjuar” shton një gamë tjetër përdorimesh të mundshme. Për shembull, duke iu përgjigjur feromoneve të lëshuara nga trupi, këto pëlhuara mund t'i përgjigjen edhe disponimit tonë. Kush e di se çfarë do të mendojnë stilistët e modës pasi të kenë në dorë këto pëlhuara inteligjente?

# Mark Rutte merr detyrën si Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s

**M**ark Rutte mori detyrën si Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s. Ai u prit në selinë e NATO-s në Bruksel nga Sekretari i Përgjithshëm në largim Jens Stoltenberg, mandati i të cilit përfundon pas dhjetë vjetësh. Z. Rutte dhe z. Stoltenberg vendosën një kurorë lulesh gjatë një ceremonie në Memorialin e NATO-s për të rënë.

Në një seancë speciale të Këshillit të Atlantikut të Veriut, Stoltenberg ia dorëzoi zyrtarisht detyrën Sekretarit të Përgjithshëm Mark Rutte. “Është një nder i madh të jem këtu dhe të marr postin e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s”, - tha zoti Rutte, përpara se të falënderonte aleatët që i besuan atij përgjegjësinë për të udhëhequr Aleancën në vitet e ardhshme.

Sekretari i Përgjithshëm Rutte përshkroi tre prioritetet e tij për Aleancën. “E para është të mbajmë NATO-n të fortë dhe të sigurojmë që mbrojtja jonë të mbetet efektive dhe e besueshme, kundër të gjitha kërcënimeve”, - filloi ai. “Prioriteti im i dytë është të shtoj mbështetjen tonë për Ukrainën dhe ta afrojmë atë gjithnjë e më shumë me NATO-n, sepse nuk mund të ketë siguri të qëndrueshme në Evropë pa një Ukrainë të fortë dhe të pavarur”, - vazhdoi ai, duke shtuar se “përparësia e tij e tretë është të forcojë partneritetet tona, në një botë më të ndërlidhur”.

Sekretari i Përgjithshëm gjithashtu nderoi paraardhësin e tij, duke e përshkruar mandatin e tij si “shembullor” dhe duke shtuar se “sot NATO është më e madhe, NATO është më e fortë dhe më e bashkuar se kurrë, kjo është në masë të madhe për shkak të lidershit tuaj”.

Në fjalën e tij të lamtumirës, Stoltenberg përgëzoi pragmatizmin dhe aftësitë e zotit Rutte për të krijuar konsensus, ndërsa vuri në dukje se “ju nuk bëni kompromis me vlerat dhe parimet tona”. Ai vlerësoi gjithashtu angazhimin personal të pasuesit të tij ndaj “lidhjes sonë transatlantike dhe mbështetjen tuaj të palëkundur për Ukrainën”.

## Çfarë është një Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s?

Më 1 tetor, ne i dhamë lamtumirën Sekretarit të Përgjithshëm Jens Stoltenberg, i cili shërbeu 10 vjet në krye të NATO-s dhe mirëpritëm Mark Rutte në këtë pozicion. Por çfarë është saktësisht një Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s dhe si e fiton dikush punën? Sa kohë shërbejnë dhe çfarë bëjnë çdo ditë?

## Çfarë bën një Sekretar i Përgjithshëm?

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s është fytyra publike e Aleancës dhe personi që drejton procesin e konsultimit dhe vendimmarrjes midis 32 Aleatëve. Nuk është një punë e lehtë, sepse 32 vende të ndryshme me 32 këndvështrime të ndryshme (dhe shumë kultura dhe gjuhë të ndryshme) duhet të bien dakord për të gjitha vendimet përpara se të zbatohen.

## Si zgjidhet Sekretari i Përgjithshëm?

Aleatët e NATO-s parashtrojnë figura të larta politike nga vendet e tyre për postin e Sekretarit të Përgjithshëm. Vendet anëtare



angazhohen në konsultime diplomatike joformale derisa të jenë në gjendje të arrijnë konsensus për një kandidat.


## Sa kohë shërben Sekretari i Përgjithshëm?

Sekretari i Përgjithshëm emërohet nga Aleatët e NATO-s për një periudhë fillestare prej katër vjetësh, por kjo mund të zgjatet nëse të gjithë aleatët bien dakord. Për shembull, Jens Stoltenberg u zgjat katër herë për të udhëhequr Aleancën për një total prej 10 vjetësh!

## Si duket përditshmëria e Sekretarit të Përgjithshëm?

Sekretari i Përgjithshëm kryeson komitetet kryesore, duke përfshirë mbledhjet e rregullta të organit kryesor vendimmarrës politik të Aleancës, Këshillit të Atlantikut të Veriut, si dhe organeve të tjera kyçe. Ata mbajnë takime me liderë nga vendet anëtare dhe partnere për të diskutuar temat në axhendën e NATO-s në selinë e NATO-s dhe jashtë saj, duke udhëtuar rregullisht nëpër botë. Ata veprojnë si zëdhënës për NATO-n, duke përfaqësuar Aleancën për publikun, për organizatat e tjera ndërkombëtare dhe për shtypin dhe median ndërkombëtare. Sekretari i Përgjithshëm është gjithashtu CEO de facto i Stafit Ndërkombëtar të NATO-s, i cili sigurohet që Aleanca të funksionojë pa probleme.





## **Ekipi kombëtar i mundjes i FA-së, merr trofeun “FAIR - PLAY TROPHY” në Botërorin e Armenisë**



**K**ampionati botëror i mundjes për femra dhe meshkuj është pjesë e organizimit të aktiviteteve sportive nga Këshilli Ndërkombëtar Ushtarak i Sporteve (CISM) me seli në Bruksel, ku vendi ynë është anëtar me të drejta të plota që nga viti 1993. Anëtarë të CISM-së janë 140 shtete të botës, ky aktiviteti është pjesë e kalendarit sportiv të “United World Wrestling”.

Në këtë aktivitet morën pjesë mbi 250 mundës, 52 shtete pjesëmarrëse, të ndarë në: Stilin Greko – Romak, Stilin e Lirë dhe atë të Femrave, u zhvilluan mbi 350 ndeshje, duke e bërë aktivitetin konkurrues dhe sfidues, pjesa më e madhe e pjesëmarrësve ishin sportistët më të mirë të botës, kampionë botëror, kampionë Evrope, kampionë Olimpikë, etj.

Pjesë e këtij aktiviteti të rëndësishëm të zhvilluar në Yerevan, Armeni ishte dhe pjesëmarrja e ekipit Shqiptar të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët përfaqësuan denjësisht vendin tonë, me trajner Major Zylfi Shehun dhe mundësit, nënkolonel Honorifik Bajram Sina, major Honorifik Paris Karepi, dhe ushtar III Marjan Kola.

Qëllimi kryesor në këtë aktivitet botëror ishte përfaqësimi i Forcave të Armatosura të Shqipërisë, me objektiv futjen në zonën e medaljeve. Sporti i mundjes është sport i traditës në Forcat e Armatosura dhe sidomos në vendin tonë që nga lashtësia, për këtë arsye pjesëmarrja në kampionatin botëror ishte thelbësore, me qëllim kryesor ngritjen e flamurit kombëtar sa më lart dhe gjithashtu për të shfaqur aftësitë dhe nivelin e lartë të vendit tonë në sportin me të vjetër në botë siç është mundja. Nëpërmjet përfaqësimit dhe zhvillimit të ndeshjeve me shtetet më të forta në botë sportistët tanë treguan potencialin e lartë të përgatitjes tekniko - taktike, duke zhvilluar ndeshje me superioritet teknik të lartë me kundërshtarë shumë të fortë, ku sportisti Paris Karepi bëri një paraqitje të shkëlqyer, duke zhvilluar ndeshje tepër të forta, ai u ndesh edhe me kampionin e botës dhe kampionin Olimpik, mundësin e Rusisë, etj..



Në përfundim të aktivitetit, në darkën Gala të ndarjes së çmimeve, për vitin 2024, ekipi i mundjes dhe trajneri i mundjes Major Zylfi Shehu u vlerësuan nga organizatorët e aktivitetit dhe CISM me çmimin: “FAIR - PLAY TROPHY”, për përfaqësim dinjitoz të ekipit shqiptar në botërorin e mundjes.

Sportistët “Honorifikë”, sidomos në sportet ndeshës janë një vlerë e shtuar për FARSH-në, ç’ ka ndikon në rritjen e rezultateve dhe për një përfaqësim sa më dinjitoz në arenën ndërkombëtare në të ardhmen. Ky kampionat ishte i përmasave të një organizimi madhështor me pjesëmarrjen e yjeve botërore të sportit të mundjes. Konkurrenca ishte jashtëzakonisht e nivelit të lartë sportiv, pasi mundja është shumë e zhvilluar në këtë rajon, ku dhe pjesëmarrja ishte e madhe. Ky aktivitet, përveç përvojës dhe përshtatjes, na ndihmon jashtëzakonisht që në të ardhmen të krijojmë një ekip sa më cilësor, me qëllim hartimin e strategjive, metodologjive dhe ideve të reja për të arritur rezultate botërore dhe pse jo për t’u futur në zonën e medaljeve në garat e ardhshme. Në darkën Gala të ndarjes së çmimeve, për vitin 2024, ekipi i mundjes dhe trajneri, major Zylfi Shehu, u vlerësuan nga organizatorët e aktivitetit dhe CISM me trofeun: “FAIR - PLAY TROPHY”, për përfaqësim dinjitoz të ekipit shqiptar në botërorin e mundjes.



# REVISTA MBROJTJA



<http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja>